




VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

**PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA VAU-DEJËS**

1000

1000

1000

1000

1000

1000

1000

1000

1000

1000

1000

1000

Raport Përfundimtar
Vlerësimi Strategjik Mjedisor
Plani i Përgjithshëm Vendor
Bashkia Vau-Dejës

Konsulenti UTS-01:

Markel Baballëku

Alfred Lako

Oltion Marko

Anisa Llango





Tabela e Përmbajtjes

SEKSIONI 1: PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE	3
1.1 Hyrje.....	3
1.2 Kuadri i Vlerësimit.....	10
1.3 Objektivat e VSM.....	10
1.4 Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore	13
1.5 Procesi i Konsultimeve	15
1.6 Konkluzione dhe Rekomandime.....	16
SEKSIONI 2: HYRJE.....	18
2.1 Çfarë është VSM.....	18
2.2 Kuadri Ligjor i VSM	18
2.3 Fazat kyç të procesit të VSM-së.....	19
SEKSIONI 3: PËRSHKRIM I PËRGJITHSHEM I PLANIT.....	21
3.1 Objektivat, politikat dhe analiza e sistemit.....	21
3.1.1 Analiza SWOT sipas sistemeve.....	23
3.1.2 Strategjia territoriale për secilin nga pesë sistemet territoriale të Bashkisë Vau-Dejës (N, U, B, UB, IN)	32
3.1 Ndërhyrjet në Infrastrukturën publike dhe rrjeti rrugorë i propozuar	39
3.1.1 Furnizimi me ujë dhe kanalizimet	39
3.1.2 Furnizimi me energji elektrike	42
3.1.3 Mbledhja dhe menaxhimi i mbetjeve	46
3.1.4 Sistemi rrugor i propozuar	47
3.2 Analiza e planeve ekzistuese, strategjive, politikave, normave dhe standardeve.....	48
3.2.1 KUADRI LIGJOR, STANDARDET DHE NORMAT.....	48
3.2.2 Analiza e dokumenteve të planifikimit dhe PPV-ve të mëparshme	51
3.2.3 Analiza e planeve, strategjive, politikave, dokumenteve dhe proceseve ekzistuese	52
3.2.4 Planet ekzistuese hapësinore kombëtare dhe sektoriale	52
3.3 Lidhja me politika dhe dokumente të tjerë	63
SEKSIONI 4: PËRSHKRIMI I GJENDJES AKTUALE	67
4.1 Analiza mjedisore.....	67
4.1.1 Burimet natyrore	67
4.1.2 Topografia dhe klima;	73
4.1.3 Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës.....	83
4.1.4 Zonat e trashëgimisë kulturore dhe historike.....	87
4.1.5 Sipërfaqet ujore	107
4.1.6 Hidrogeologjia dhe hidrologjia;.....	110
4.1.7 Landfill-i i Bushatit.....	119
4.1.8 Rreziqet mjedisore si pasojë e pranisë së landfill-it	121
4.1.9 Vendgrumbullimet e mbetjeve të paligjshme në territorin e bashkisë.....	123
4.1.10 Zonimi makrosizmik dhe në varësi të rëndësisë, zonimi mikrosizmik;	124
4.2 Analiza metabolike.....	131
4.2.1 Hyrje	131
4.2.2 Energjia dhe uji në rajon	132
4.2.3 Analiza e bashkisë Vau-Dejës	136
4.2.4 Fluksi i energjisë	137

4.2.5	Fluksi i ujit.....	139
4.2.6	Fluksi i ushqimit.....	142
4.2.7	Përfundime.....	147
SEKSIONI 5: TENDENCAT E MUNDSHME NË TË ARDHMEN, PA PLANIN (ALTERNATIVA "0") 149		
5.1	Toka.....	149
5.2	Ajri.....	149
5.3	Faktorët Klimatike.....	150
5.3.1	Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike.....	150
5.3.2	Masat zbutëse ndaj ndryshimeve klimatike.....	150
5.4	Uji.....	151
5.5	Biodiversiteti.....	151
5.6	Mbetjet.....	151
5.7	Zhurma.....	152
5.8	Popullsia dhe asetet materiale.....	152
5.9	Trashëgimia Kulturore.....	153
5.10	Peizazhi.....	153
SEKSIONI 6: BAZA PËR PËRGATITJEN E VLERËSIMIT MJEDISOR 154		
6.1	Përcaktimi i Objektivave Mjedisore.....	154
6.1.1	Detyrimet e specifikuar në konventat e ratifikuara dhe në direktivat respektive të BE-së, si dhe në dokumentet strategjike të Shqipërisë.....	156
6.1.2	Identifikimi i ndikimeve mjedisore.....	169
6.2	Metodika e Vlerësimit të ndikimit në mjedis.....	170
SEKSIONI 7: VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISE SË OBJEKTIVAVE..... 184		
7.1	Vlerësimi i përputhshmërisë së objektivave dhe politikave të Planit me objektivat mjedisore.....	184
SEKSIONI 8: VLERËSIMI I OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE 190		
8.1	VLERËSIMI I PROJEKTEVE PILOT.....	193
SEKSIONI 9 VLERËSIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE..... 198		
9.1	Vlerësimi i pasojave nga zbatimi i Planit dhe ndikimet e pasojave të zbatimit të Planit për realizimin e objektivave mjedisore të Planit.....	198
9.1.1	Toka.....	198
9.1.2	Ajri.....	199
9.1.3	Faktorët klimatike.....	201
9.1.4	Uji.....	202
9.1.5	Natyra.....	203
9.1.6	Mbetjet.....	205
9.1.7	Ndodja prej zhurmës.....	206
9.1.8	Popullatat dhe asetet materiale.....	207
9.1.9	Trashëgimia kulturore.....	209
9.2	Mbetjet.....	209
9.2.1	Peizazhi.....	210
9.2.2	Konkluzion mbi Vlerësimin.....	211
9.3	Impaktet Kumulative.....	212
SEKSIONI 10. UDHEZIME DHE MASA ZBUTËSE..... 214		
10.1	Toka.....	214

10.2	Ajri	215
10.3	Faktorët klimatike	216
10.3.1	1Masat zbutëse ndaj ndryshimeve klimaterike.....	216
10.3.2	Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike	217
10.4	Uji	218
10.5	Mjedisi Natyror	219
10.6	Zhurmat.....	220
10.7	Popullsia dhe asetet materiale.....	221
10.8	Trashëgimia kulturore	222
10.9	Peizazhi	223
10.9.1	Strategjia e Peizazhit	223
10.9.2	Masat e përgjithshme zbutëse ndaj peizazhit	223
	SEKSIONI 11: MONITORIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	225
	SEKSIONI 12: PROCESI I KONSULTIMEVE	229

Lista e figurave

Figura 3.1 Harta e sistemit natyror.....	33
Figura 3.2 Harta e sistemit ujor.....	34
Figura 3.3 Harta e sistemit bujqësor.....	35
Figura 3.4 Harta e sistemit urban.....	37
Figura 3.5 Harta e sistemit infrastrukturor.....	38
Figura 3.6 Vendndodhja e stacioneve të pompimit (majtas: jashtë funksionit; djathtas: në funksionim).....	40
Figura 3.7: Harta energjetike e rajonit.....	42
Figura 3.8: Pasqyre përmblledhëse e HEC V.Dejes.....	43
Figura 3.9 Rrjeti energjetik rajonal.....	44
Figura 3.10 Skema e rrjetit prodhues të energjisë elektrike, rajoni V. Dejes.....	44
Figura 3.11 Sistem infrastrukturor ekzistues dhe i propozuar.....	48
Figura 3.12 Poli i zhvillimit rajonal Shkodër – Lezhë.....	53
Figura 3.13 Plani Rajonal Shkodër – Lezhë.....	55
Figura 3.14 Kufiri i Planit Kombëtar Sektorial.....	58
Figura 3.15 Kufiri i studimit.....	60
Figura 3.16 Kufiri i planit të bashkisë Vau-Dejës.....	61
Figura 3.17 Nënrajonet me potencialet bujqësore.....	63
Figura 4.1 Rezervat peshku, liqeni i Vau-Dejës.....	73
Figura 4.2 Pozita gjeografike e Vau-Dejës.....	74
Figura 4.3 Mali i Cukalit 1722 m (Burimi: http://www.panoramio.com).....	74
Figura 4.4 Harta topografike e Vau-Dejës.....	75
Figura 4.5 Ullësira e Zadrimës.....	76
Figura 4.6 Harta e zonave klimatike.....	76
Figura 4.7 Shpërndarja brendavjetore e rrezatimit të përgjithshëm diellor dhe rrezatimit UV.....	77
Figura 4.8 Ecuria brendavjetore e diellzimit.....	78
Figura 4.9 Ecuria brendavjetore e temperaturës së ajrit.....	78
Figura 4.10 Shpërndarja brendavjetore e reshjeve atmosferike.....	80
Figura 4.11 Trëndafil i erës për dy muajt karakteristikë të vitit.....	81
Figura 4.12 Pamje ajrore e peizazhit të mbrojtur.....	83
Figura 4.13 Harta e PUTM në bashkinë Vau-Dejës.....	84
Figura 4.14 Shpella e Malagjisë. (Burimi: AKZM).....	85
Figura 4.15 Harta e zonave të mbrojtura ekzistuese dhe të propozuara për zgjerim.....	87
Figura 4.16 Pamje nga Kalaja e Sapës.....	89
Figura 4.17 Pamje nga Kalaja e Vigut.....	91
Figura 4.18 Zona arkeologjike A dhe B.....	93
Figura 4.19 Pamje nga Varrezat e Komanit.....	94
Figura 4.20 Pamje nga Kalaja e Dalmacës.....	95
Figura 4.21 Pamje nga Kalaja e Vaut të Dejës.....	98
Figura 4.22 Pamje nga Kisha e Shën Mërisë (përpara shembjes).....	99
Figura 4.23 Pamje nga Kisha e Shën Markut.....	101
Figura 4.24 Pamje nga Kalaja e Shurdhahut.....	103
Figura 4.25 Pamje nga Kompleksi Ndre Mjeda.....	105
Figura 4.26 Liqeni i Vau-Dejës.....	107
Figura 4.27 HEC i Vau-Dejës.....	108
Figura 4.28 Diga e Komanit.....	109
Figura 4.29 Liqeni i Komanit.....	110
Figura 4.30 Harta hidrogeologjike e qarkut Shkodër - Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.....	111
Figura 4.31 Baseni ujëmbledhës i lumit Drin.....	117
Figura 4.32 Pamje nga landfill-i i Bushatit.....	120

Figura 4.33 Pamje e një vendgrumbullimi të paligjshëm.....	123
Figura 4.34 Shpërndarja e vendgrumbullimeve ilegale në territorin e bashkisë.....	124
Figura 4.35 Harta e epiqëndrave të tërmetejeve karakteristike.....	126
Figura 4.36 Harta sismotektonike e Shqipërisë.....	128
Figura 4.37 Harta e PGA për Vau Dejës në truall shkëmbor, me RP 475 vjet.....	129
Figura 4.38 Paraqitje grafike e rrezikut sismik për njësitë administrative.....	130
Figura 4.39 Harta e fluksëve në territorin e Bashkisë Vau-Dejës Tabela.....	132
Figura 4.40 Ndarja në zona sipas shpejtësisë së erës dhe orëve vjetore.....	134
Figura 4.41 Energjia diellore në Shqipëri.....	134
Figura 4.42 Potenciali dhe konsumi i energjisë.....	138
Figura 4.43 Hidrocentralet në territorin e Shqipërisë.....	139
Figura 4.44 Fluksi i ujit.....	141
Figura 4.45 Konsumi i ujit.....	141
Figura 4.46 Prodhimet bujqësore.....	144
Figura 4.47 Fluksi i ushqimit.....	145
Figura 4.48 Fluksi i mbetjeve.....	147

Lista e Tabelave

Tabela 1.1 Ndërhyrjet strategjike sipas objektivave.....	7
Tabela 2.1 Fazat kyç të procesit të VSM-së	19
Tabela 3.1 Kuadri ligjor	49
Tabela 3.2 Vendimet e KRRTRSH dhe KKT për Bashkinë Vau-Dejës.....	51
Tabela 3.3 Qendrat urbane të prekura nga Masterplani i Alpeve	58
Tabela 3.4 Përmbledhje e dokumentacionit të konsultuar	63
Tabela 4.1 Shpërndarja e sipërfaqes për llojet kryesore pyjore. Burimi: (Drejtoria e Pyjeve, Mjedisit, Veterinarisë dhe Bujqësisë, Bashkia Vau-Dejës).....	69
Tabela 4.2 Kullotat natyrore brenda territorit të Bashkisë Vau-Dejës	71
Tabela 4.3 Intensiteti i reshjeve (mm) për disa intervale orare	81
Tabela 4.4 Rastisja e erës sipas intervaleve	82
Tabela 5: Vlerat e rrezikut sizmik: PGA e SA (g) për Bashkinë Vau Dejës	129
Tabela 4.6 Fuqia dhe kapaciteti i hidrocentraleve në vend.....	133
Tabela 4.7 Popullsia banuese në Shqipëri (INSTAT, 2011)	137
Tabela 4.8 Njësitë ekonomike familjare në Shqipëri sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohje në zonat urbane dhe rurale (INSTAT, 2011).....	138
Tabela 4.9 Bilanci i energjisë elektrike, në rang vendi (INSTAT, 2011).....	139
Tabela 4.10 Fermat në Bashkinë Vau-Dejës (QTTB dhe MBZHRAU, 2014)	142
Tabela 11: Fermat bujqësor dhe blegtoral në Bashkinë Vau-Dejës	143
Tabela 4.12 Prodhimi bujqësor dhe blegtoral në Bashkinë Vau-Dejës.....	144
Tabela 4.13 Importi dhe eksporti i mbetjeve në Shqipëri	146
Tabela 6.1- Lidhja mes sektorëve të mjedisit dhe objektivave mjedisore si dhe dokumentet përkatës të planeve, programeve apo politikave mjedisore	156
Tabela 6.2 Identifikimi i ndikimeve potenciale mjedisore	169
Tabela 7.1 Grafiku i Vlerësimit të nivelit të përputhshmërisë mes objektivave	184
Tabela 7.2 Vlerësimi i përputhshmërisë së politikave të Planit me Objektivat Mjedisore	185
Tabela 8.1 Lidhja midis shkallëve të vlerësimit	190
Tabela 8.2 Programet Strategjike që pritet të shkaktojnë Ndikime në Mjedis.....	191
Tabela 8.3 Krahasimi i programeve specifike në kuadrin e përputhshmërisë së tyre me objektivat mjedisore; përqindjet e ndikimeve të vlerësuara	192
Tabela 9.1 Vlerësimi i shkallës së ndikimit të programeve strategjike në objektivat mjedisore	212
Tabela 11.1 Monitorimi i ndikimeve në mjedis prej zbatimit të planit	227

SHKURTIME

AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
ARM	Agjencia Rajonale e Mjedisit
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BER	Burimet e Energjisë së Rinovueshme
BMA	Bimët medicinale dhe aromatike
BTEX	Benzen, Toluen, Etilbenzen dhe Ksilol
CFC	Klorfluorkarbonet
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
GHG	Shkarkimet e gazeve sere
HCFC	Hidrogjen flourklorkarbonet
IAP	Gazsjellësi Joniano-Adriatik
IEA	Zona me Rëndësi Ekologjike
INSTAT	Instituti i Statistikave
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrimin
IPA	Instrumenti për Asistencën e Para-Anëtarësimit
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Ndotur
IUCN	Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
KE	Komisioni Evropian
KEE	Këshilli Ekonomik Evropian
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KKT	Këshilli Kombëtar i Territorit
KM	Këshilli i Ministrave
Konsulenti	Kompania UTS-01
KTZH	Komiteti Teknik i Zhurmave
LAeq	Niveli i zhurmave urbane
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MRR	Mbetje të rrezikshme
NATURA 2000	Rrjeti i zonave të mbrojtura të natyrës në territorin e Bashkimit Evropian
NBSAP	Strategjia Kombëtare e Biodiversitetit dhe Plani i Veprimit
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
NMVO	Përbërës organikë të paqëndrueshëm pa-metan

NOPIU	Njësia Kombëtare e Implementimit të Projekteve të Ozonit
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OM	Objektiv Mjedisor
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
PCB/PCT	Bifenile të poliklorinuara / Trifenile të poliklorinuara
PINS B	Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin
PKPZM	Programi Kombëtar i Punës për Zonat e Mbrojtura
Plani	Plani i Përgjithshëm Vendor
PPK	Plani i Përgjithshëm Kombëtar
SKMIU	Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Ujerave
SKMM	Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNM	Vlerësim i Ndikimit në Mjedis
VOC	Përbërës organikë të paqëndrueshëm
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

SEKSIONI 1: PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

1.1 Hyrje

Ky raport paraqet gjetjet e Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) në kuadër të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, të territorit administrativ të Bashkisë Vau-Dejës. Ky dokument është hartuar paralelisht me procesin e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, proces i cili ka filluar në janar 2017. Në këtë raport janë marrë parasysh të gjitha ndikimet që mund të kenë në mjedis propozimet e bëra nga Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) për të gjithë territorin që administron kjo bashkia.

Gjatë këtij procesi janë kryer konsultime me specialistë të institucioneve përkatëse dhe me grupet e interesit, siç është parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Ligji nr. 91/2013, datë 28.02.2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor", përcakton që në bazë të një Raporti Paraprak lidhur me impaktet mjedisore të rëndësishëm nga zbatimi i Planit, Autoriteti propozues kryen konsultime, që në momentet e para të përpunimit të Planit, me subjektin që është ngarkuar për përpunimin e tij dhe subjektet e tjera kompetente në fushën e mjedisit, me qëllim përcaktimin e rëndësisë dhe nivelit të detajimit të informacioneve që do të përfshihen në Raportin Mjedisor.

Raporti përfundimtarë është hartuar me synimin për të favorizuar integrimin midis instrumenteve të ndryshëm të programimit, planifikimit dhe vlerësimit që kanë të bëjnë me territorin në studim, duke mbajtur parasysh në të njëjtën kohë, të kalimeve të shkallës të nevojshëm të cilët mund të përdoren për përfaqje më të thelluara.

Në vijim paraqiten direktivat e përgjithshëm të zhvillimit për secilin nga pesë sistemet territoriale.

Sistemi Natyror (N)

- Mbrojtja dhe zgjerimi i biodiversitetit të territorit.
- Lidhja e Parkut Kombëtar të Alpeve me Peizazhin e Mbrojtur Bunë-Velipojë, nëpërmjet luginës së Drinit duke krijuar një korridor të lundrueshëm, natyror e peizazhistik mal-det.
- Zbutja dhe ulja e ndikimit të vendbanimeve ekzistuese urbane brenda dhe përreth zonave natyrore të mbrojtura.
- Zvogëlimi progresiv dhe zhdukja e niveleve aktuale të ndotjes së lumenjve / liqeneve, në harkun kohor të dy dekadave.
- Rritja e zonave pyjore në zonat kodrinore e malore.
- Promovimi i turizmit natyror, lundrimit dhe të ekskursionit.
- Ndërtimi dhe menaxhimi i rrjetit ekologjik territorial, si një lidhje strukturore midis zonave me vlerë dhe pasuri të madhe të biodiversitetit.
- Promovimi dhe përgatitja e instrumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të zonave me interes mjedisor.
- Zbutja dhe ulja e ndikimit të zonave dhe objekteve industriale dhe të minierave ekzistuese brenda dhe përfaq zonave urbane.

- Bashkimi dhe homogjenizimi i sistemeve të mbrojtjes mjedisore, që shpeshherë rezultojnë të mbivendosura dhe të vështira për tu kuptuar dhe zbatuar.

Sistemi Ujor (U)

- Ruajtja dhe mbrojtja e burimeve dhe rezervave natyrore hidrologjike.
- Rigjenerimi i trupave ujorë kryesore, në të mirë të ekosistemeve lokale dhe të një zhvillimi të mundshëm të turizmit sportiv.
- Zhvillimi i lundrimit (transportit), të turizmit sportiv dhe peshkimit.
- Modernizimi i rrjetit të ujësjellësit dhe rrjeteve të shpërndarjes lokale.
- Ruajtja, modernizimi dhe rritja e kapacitetit prodhues të hidrocentraleve.
- Forcimi i sistemit të menaxhimit dhe shpërndarjes së ujit publik, i parë si një nga të mirat/resurset e përgjithshme.
- Krijimi i një Autoriteti Publik Menaxhimi të burimeve ujore, në njohjen e zonave homogjene territoriale, si një mjet kontrolli dhe menaxhimi të cilësisë.

Sistemi Bujqësor (B)

- Promovimi dhe zhvillimi i modernizimit dhe inovacionit në sektorin e industrive vendase dhe në sektorin e integrit të zinxhirëve të strukturave të prodhimit dhe përpunimit të ushqimit.
- Promovimi dhe zhvillimi i prodhimit cilësor në sektorin bujqësor, blegtoral dhe pyjor (produktet e Zadrimes).
- Përmirësimi i aftësive sipërmarrëse dhe profesionale të punëtorëve në sektorin e bujqësor dhe pyjor.
- Promovimi i metodave të kultivimit biologjik dhe të permakulturës.
- Konvertimi për përdorim bujqësor, i zonave të degraduara dhe të braktisura.
- Rinisja dhe mbështetja e aktivitetit blegtoral pyjor në zonat kodrinore, në lugina dhe zonat malore të brendshme, të kultivimit të bimëve aromatike dhe mjekësore (çaj mali etj.), të eterovajorëve, të kultivimit të peshkut, si dhe të bletarisë.
- Rinisja dhe mbështetja e aktivitetit blegtoral, në zonat fushore e bujqësore blegtoriale, në zonat kodrinore dhe ato malore.
- Riorganizimi dhe zhvillimi i strukturave mbështetëse për aktivitetin bujqësor, të tilla si shoqëritë (konsorciumet) bujqësore për shërbim dhe trajnime, për fermat e vogla dhe të mesme.
- Rivendosja në punë e rrjetit të kanaleve të vaditjes e kullimit të tokave bujqësore, gjë e cila do shërbejë edhe si një masë mbrojtëse nga përmbytjet.
- Zhvillimi i ndërtimit të objekteve të logjistikës për mbledhjen, ruajtjen, ngrirjen dhe shpërndarjen e produkteve ushqimore vendore, mbi bazë të konsorciumit dhe/ose kooperativës.

- Promovimi i krijimit të qendrave të kërkimit dhe trajnimit në agrobiznes dhe edukimit në mirë ushqimin, madje edhe në shkolla dhe fushën e arsimit (shkolla profesionale Bushat).
- Promovimi i ngritjes e shpërndarjes territoriale të strukturave akomoduese (struktura agro-turizmi, B&B ekologjike, ferma didaktike, fshatra ekologjike) dhe të restoranteve cilësorë që valorizojnë produktet dhe traditat ushqimore vendase, si dhe peshkimin dhe kultivimin e peshkut.

Sistemi Urban (UB)

- Nxitja e rikuperimit dhe rivitalizimit të qendrës historike të qytetit të Vau-Dejës si dhe qendrave të vogla urbane apo monumenteve historike, nëpërmjet përdorimit turistik.
- Fuqizimi i aktiviteteve akomoduese dhe shërbimeve plotësuese për turizmin kulturor, mjedisor, sportiv (aktiv), ujqor, në zonat urbane të Vau-Dejës, pranë fshatrave Nënshat, Vig, Koman, në zonën me interes natyror, peizazhistik dhe mjedisor të luginës së Drinit, si dhe në fshatrat e zonave të thella malore.
- Përshtatja sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kategorive të urbanizimit kryesor (rrjetet kryesore) në zonat urbane dhe në vendbanimet informale të legalizuara
- Përshtatja sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të pajisjes me shërbime urbane dytësore (arsim, struktura publike, gjelbërim dhe parkim) në zonat urbane kryesore
- Zhvillimi i shërbimeve të reja urbane në Vau-Dejës, Mjedë, Bushat, Rranxë, Barbullush, dhe Hajmel dhe lokalitetet e tjera të mëdha urbane (qendra formimi dhe aftësimi, biblioteka dhe mediateka lokale).
- Zhvillimi i sistemeve me lëvizje urbane alternative (pista biçikletash, rrjete pedonale) të integruara me sistemin e transportit publik automobilistik dhe hekurudhor
- Racionalizimi dhe zgjerimi i rrjetit të rrugëve automobilistike, të integruar me sistemin e parkimeve urbane dhe territoriale.
- Rimëkëmbja dhe ripërdorimi, si një korridor transporti me lëvizje të shpejtë, i linjës ekzistuese hekurudhore, në përputhje me rimëkëmbjen e saj si një infrastrukturë e rëndësishme kombëtare; rehabilitim ky, i parashikuar edhe në PPK.
- Nxitja e qasjes, përdorimit dhe shkëmbimit të resurseve urbane të përbashkëta (Urban Commons) për të gjithë qytetarët, me vëmendje të veçantë për personat me aftësi të kufizuara.
- Garantimi i qyteteve dhe të mirave të përbashkëta të aksesueshme, të sigurta dhe që arrijnë drejtpërdrejtë të fëmijët (Qyteti mik i fëmijëve).

Sistemi Infrastrukturor (IN)

- Garantimi i efijencës dhe funksionimit të plotë të rrjetit infrastrukturor me karakter kombëtar (korridorit kombëtar) nëpërmjet ndarjes së trafikut lokal, realizimit të kryqëzimeve të rrafshëta dhe mbikalimeve të rrjeteve lokale, transformimi progresiv në autostradë.
- Zhvillimi i polit të lëvizjes plurimodale dhe ndërlidhjes Mjedë – Vau-Dejës (hekurudhë, rrugë automobilistike, lundrim, korsi biçikletash, shtigje këmbësore)
- Krijimi i një rrjeti transporti uhor publik dhe funksional
- Rimëkëmbja dhe zhvillimi i rrjetit hekurudhor kombëtar, për lidhje ndërkombëtare si dhe për përdorim urban dhe lokal.
- Rimëkëmbja dhe zhvillimi i stacioneve hekurudhore, si pikat aksesit dhe shërbimi të qendrave të banuara, dhe si pika të lidhjes me rrjetin e korridoreve të gjelbër, të cilët realizojnë ndërveprimin ndërmjet zonës bregdetare dhe asaj malore.
- Krijimi i një qendre logjistike strategjike, e lidhur me hekurudhën dhe korridorin infrastrukturor.
- Zhvillimi dhe konsolidimi i rrjetit të parkimit në nivel territorial, urban dhe lokal.
- Zhvillimi i një rrjeti rrugor me lëvizshmëri të ngadaltë, të lidhur me rizbulimin e vendeve dhe peizazheve me interes natyror, kulturor dhe arkeologjik, etno-antropologjik, agroushqimor cilësor (rrugët e vajit, verës, prodhimeve lokale)
- Zgjerimi dhe përmirësimi sistemeve aktuale operative dhe menaxhimi i ciklit të mbeturinave të ngurta urbane.
- Fuqizimi i rrjeteve urbane teknike, në veçanti rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve.
- Kontrolli dhe nxitja për kursimin e energjisë dhe për rikuperimin/ripërdorimin/ riciklimin e mbetjeve të ngurta komunale dhe menaxhimin e pikave të grumbullimit.
- Forcimi dhe zhvillimi i rrjeteve të telekomunikacionit dhe jo-materiale, si në nivel territorial (rrjetet satelitore), ashtu edhe në nivel urban (rrjeti wireless), të instaluar në qendrat kryesore.
- Zhvillimi dhe fuqizimi i rrjetit të infrastrukturës energjetike, me vëmendje ndaj ndikimeve të shkaktuara (ndotja elektromagnetike) dhe zhvillimi i burimeve të rinovueshme energjetike.
- Zhvillimi i sistemeve të prodhimit energjetik nga burime të rinovueshme në fushën urbane dhe në mbështetje të impianteve industriale ekzistuese dhe të aktiviteteve ekonomike kryesore urbane.

Në tabelën më poshtë jepen ndërhyrjet që plani ka parashikuar për territorin sipas objektivave strategjike.

Tabela 1.1 Ndërhyrjet strategjike sipas objektivave

	PROGRAMET	PROJEKTET
OBJEKTIVA STRATEGJIKE 1: PAJISIA ME SHËRBIMET BAZË	1.1 Përmirësimi i rrjeteve teknike	Përmirësimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale
		Mirëmbajtja dhe zhvillimi i rrjetit të furnizimit me ujë
		Përmirësimi dhe zhvillimi i sistemit të kanalizimeve
		Sistemi i pastrimit të ujërave të zeza me gropa septike në zonat periferike
	1.2 Ruajtja e peizazhit dhe siguria e territorit	Sistemi për mbledhjen e mbetjeve të ngurta urbane
		Pastrimit të rrugëve të qytetit
		Realizimi i veprave për mbrojtjen e qendrave të banuara nga përmbytjet dhe erozioni
	1.3 Shërbimet publike	Shërbimet bazë (kopshte, shkolla fillore, qendrat shëndetësore bazë, kujdesi për të moshuarit)
		Shërbimi i autobusëve shkollor
		Përmirësimi i shërbimeve administrative të ofruara
		Qyteti mik i fëmijëve
OBJEKTIVA STRATEGJIKE 2: LËVIZJA ME MËNYRA TË NDRYSHME	2.1 Rrugët automobilistike	Përmirësimi i rrugës Shkodër-Pukë-Kukës
		Përmirësimi i rrugës përgjatë rrëzës së maleve
		Përmirësimi i rrugës Vau-Dejës-Bushat-Velipojë
		Përmirësimi i rrugës Vau-Dejës-Koman (Projekt Pilot)
		Përmirësimi i rrugës Vau-Dejës-Vig
		Përmirësimi i rrugës Koman-Uk-Bibaj
		Realizimi i rrugës Hajmel-Nënshatë
	2.2 Korridori lumor	Realizimi i linjës së transportit ujqor Vau-Dejës-Koman (Projekt Pilot)
		Realizimi i shtigjeve dhe rrugëve për lidhjen e stacioneve të tragetit me fshatrat malorë
		Kalimi i lumit me zgjidhje të ndryshme në pjesët e territorit të ndara nga lumi
	2.3 Ndërhyrje të tjera për lëvizjen	Stacion shkëmbimi intermodal në Vau-Dejës dhe Mjedë

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 3: QENDRAT URBANE	3.1 Pole shërbimesh për territorin përreth	Përmirësim i dy stacioneve hekurudhore në Vau-Dejës dhe Hajmel
		Sistemi i transportit publik Vau-Dejës, Bushat, Barbullush, Hajmel
		Realizimi i pistave të biçikletave
	3.2 Zhvillimi i qendrave lokale	Pol për shërbime turistike, ekonomike, kulturore, shoqërore shëndetësore dhe teknike (Vau-Dejës/Mjedë)
		Pol për shërbime të ndihmës teknike, logjistike dhe organizative për bujqësinë (Bushat/Ranxë) (Projekt Pilot)
		Zhvillimi i qendrës urbane Vau-Dejës (Projekt Pilot)
		Zhvillimi i qendrës urbane Mjedë
		Zhvillimi i qendrës urbane Bushat (Projekt Pilot)
		Zhvillimi i qendrës urbane Ranxa
		Zhvillimi i qendrës urbane Barbullush
		Zhvillimi i qendrës urbane Koman
		Zhvillimi i qendrës urbane Hajmel
		Zhvillimi i qendrës urbane Nënshatë
		Zhvillimi i qendrës urbane Stajkë
		Zhvillimi i qendrës urbane Kosmaç
		Zhvillimi i qendrës urbane Vig
		Zhvillimi i qendrës urbane Benë
	3.3 Rikualifikimi urban	Rikualifikim i qendrës urbane Vau-Dejës (Projekt Pilot)
OBJEKTIVA STRATEGJIKE 4: TURIZMI	4.1 Turizmi mjedisor	Park lumor rajonal: krijimi i një korridori të mbrojtur mjedisor mes zonave të mbrojtura të Alpeve dhe Bunës/Velipojës për realizimin e një itinerari turistik
		Zhvillimi i eksursionizmit dhe sporteve ujore përgjatë lumit Drin
		Zhvillimi i plazheve dhe rekreacionit pranë stacioneve të tragetit përgjatë lumit Drin
		Realizimi i një korridori të gjelbër Vau-Dejës-Vig, përgjatë lumit Gjadër përfshirë promovimin e kalasë së Vigut
		Zhvillimi dhe promovim i vlerave turistike të Fushës së Liqethit
		Realizimi i një itinerari për turizmin kulturor Sapë-Danjë-Sardë-Koman (Projekt Pilot)
	4.2 Turizmi kulturor	Promovim i vlerave arkeologjike të Komanit
		Realizimi i një itinerari për turizmin energjetik
		Projekt për rehabilitimin dhe ruajtjen e ndërtesave tradicionale (kullat) dhe ansambleve urbane (Fshati i Ri)
		Projekt ndriçimi skenografik i kalasë së Sardës dhe digave të Vau-Dejës dhe Komanit
		Krijimi i një tregu artizanal dhe etnografik për rajonin e Zadrimës, në Vau-Dejës

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 5: BUJQËSIA, BLEGTORIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT	4.3 Ndërhyrje të tjera për zhvillimin e turizmit	Realizim qendrash për agro-turizëm dhe turizëm eno-gastronomik
		Projekt për pyllëzim mjedisor të kodrës së Zefjanës
		Projekt për certifikimin dhe brandimin e prodhimeve lokale me markën e zonës (p.sh. 'Zadrëma')
		Projekt për koordinimin ndërkufitar me bashkinë Tropojë për zhvillimin e integruar të turizmit
	5.1 Strukturat e shërbimit	Realizimi i tre qendrave agro-ushqimore për grumbullimin dhe evadimin e prodhimit në Bushat, Hajmel dhe Mjedë (Projekt Pilot)
		Treg prodhimesh bujqësore dhe blegtorale me km zero në Stajkë
		Përmirësim dhe zhvillim i rrjetit të kanaleve ujitëse dhe kulluese në zonat fushore si dhe masat kundër erozionit dhe përmytjeve në zonat malore
		Organizim i degës së prodhimit bujqësor dhe blegtoral pranë bashkisë
		Nxjtja e shoqërizimit të punës për rritjen e prodhimit bujqësor
		Qendër përpunimi, standardizimi, magazinimi për gështenjën, lajthinë e butë, kumbullën dhe eterovajoret në Shllak dhe Temal
	5.2 Rritja e prodhimit	Zhvillimi i kultivimit të orizit në fshatrat Barbullush, Kukël dhe Dheu i Lehtë
		Zhvillimi i komplekseve blegtorale në Bushat, Vau-Dejës dhe Shllak
		Zhvillimi i peshkimit dhe rezervateve në ligenin e Vau-Dejës
		Zhvillimi i serave të perimeve në Kosmaç dhe në fshatra të tjera të bashkisë
		Zhvillimi i baxhove në Hajmel, Vig-Mnelë dhe Shllak
		Zhvillimi i vreshtave në Hajmel, Bushat, Vau-Dejës e Vig-Mnelë
		Asistencë teknike e veçantë Part-Time me specialistë të profilizuar për dy asete me rëndësi të bashkisë: a) Kultivimi i perimeve në sera; b) Kultivimi i vreshtave dhe teknologjia e përpunimit të rrushit
		Zbatimi i projektit për mbjelljen e 150 ha shegë në 6-të fshatra me nga 25 ha në bllok (Projekt Pilot)
OBJEKTIVA STRATEGJIKE 6: ENERGJIA	6.1 Zhvillimi i prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme	Park bletësh në Shllak e Temal
		Zhvillimi i impianteve për prodhimin e energjisë fotovoltaike
	6.2 Diferencimi i prodhimit të energjisë	Zhvillimi i impianteve për prodhimin e energjisë së biomasës
		Modernizim i landfillit të Bushatit nëpërmjet ndërhyrjeve për ripërdorimin, riciklimin, prodhimin e biogazit dhe pyllëzimin e kurrës

1.2 Kuadri i Vlerësimit

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një nga instrumentet kyç për integrimin e çështjeve mjedisore dhe parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin Strategjik dhe vendimmarrjen. Ai është një mjet i njohur globalisht për planifikimin me pjesëmarrje që përdoret për të analizuar dhe përfshirë çështjet e mjedisit në politikat, planet dhe programet e propozuara.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor mund të kuptohet si *“një proces sistematik i cili parashikon dhe vlerëson efektet e mundshme mjedisore gjatë hartimit të një plani apo programi, me qëllim adresimin e këtyre efekteve në mënyrë të përshtatshme që në fazat më të hershme të vendim-marrjes”*.

Kuadri ligjor i VSM-së përfshin në mënyrë të detyrueshme Ligjin Shqiptar për VSM-në, ndërkohë që, për të qenë koherent, nuk është lënë mënjanë edhe kuadri ligjor ndërkombëtar. Referencat përkatëse ligjore janë dhënë më poshtë:

- Ligji nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”
- Direktiva 2001/42/EC e Komisionit Evropian
- Protokolli i VSM-së i hartuar dhe miratuar në Konventën e Espoo (UNECE)

1.3 Objektivat e VSM

Objektiva kryesore e VSM-së është që të shqyrtohen ndikimet në mjedis të projekteve të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vau-Dejës dhe të jep sugjerime e të hartojë programe për mbrojtjen e mjedisit në mënyrë që ndikimet negative në mjedis të jenë sa më të vogla.

Raporti i VSM-së përcakton sektorët më të rëndësishëm mjedisore, objektivat mjedisore si dhe përcakton dhe analizon ndikimet potenciale si më poshtë:

➤ Toka

Objektiva Mjedisore 1 (OM 1): Garantimi i menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të tokës dhe mbrojtja e saj.

Objektiva Mjedisore 2 (OM 2): Parandalimi i shfrytëzimit të burimeve natyrore, duke rritur nivelin e përdorimit të materialeve të riciklueshme nga mbetjet që gjenerohen gjatë ndërtimit/rehabilitimit të infrastrukturës.

Ndikimet Potenciale:

- fragmentimi i zonave me aktivitet të dendur bujqësor apo zona pyjore;
- përdorimi i burimeve të energjisë së rinovueshme dhe karburanteve “bio”;
- administrimi i mbetjeve të gjeneruar nga aktivitetet e ndërhyrjeve infrastrukturore.

➤ Ajri

Objektiva Mjedisore 3 (OM 3): Garantimi i arritjes së objektivave afatgjata për sasitë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, për të arritur përputhshmërinë me kufijtë maksimalë të lejueshëm nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferikë.

Ndikimet Potenciale:

- emetimi i ndotësve në ajër, të cilët kanë ndikime të dëmshme tek ekosistemet dhe biodiversiteti;
- emetimi i ndotësve për të cilët janë përcaktuar kufijtë e sipërm në nivel kombëtar;
- ndikimi në shëndet (sistemi respirator) në rastet e një pranie të lartë të ndotësve në ajër.

➤ **Faktorët klimatike**

Objektiva Mjedisore 4 (OM 4): Adoptimi i infrastrukturës në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve "sere" në nivelet e përcaktuara në SKZHI II.

Ndikimet Potenciale:

- ndjeshmëria e rrjeteve dhe strukturave ndaj situatave ekstreme të motit;
- emetimet e gazrave "sere" që shkaktohen nga djegia e karburanteve.

➤ **Uji**

Objektiva Mjedisore 5 (OM 5): Kufizimi i efekteve negative mbi ujerat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ujerat e njelmët, ujerat bregdetare dhe burimet e ujit të pijshëm.

Ndikimet Potenciale:

- siguria nga përmytjet;
- ndikimet e substancave të rrezikshme në cilësinë e ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësore, në rast të derdhjeve aksidentale të tyre;
- ndikimet tek ujësjellësit dhe cilësia e ujit të pijshëm;
- ndikimet mbi ujerat që përdoren për larje (plazh).

➤ **Mjedisi natyror**

Objektiva Mjedisore 6 (OM 6): Garantimi i kohezionit të popullatave dhe mbrojtjes së biodiversitetit.

Objektiva Mjedisore 7 (OM 7): Ruajtja e zonave që kanë një status të veçantë mbrojtjeje, prej aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme.

Ndikimet Potenciale:

- fragmentimi i habitateve;
- ndikim në linjat e migrimit të kafshëve;
- ndikim në integritetin dhe funksionalitetin e zonave të mbrojtura dhe të zonave të Natura 2000
- ndikime mbi tipologjinë dhe cilësitë e veçorive të çmuara natyrore.

➤ **Mbetjet**

Objektiva Mjedisore 8 (OM 8): Kompletimi tërësor i infrastrukturës së landfilleve e inceneritorëve dhe njëkohësisht reduktim i sasisë së depozitimit të mbetjeve në landfill nëpërmjet proceseve të reduktimit dhe rritjes së riciklimit e ripërdorimit.

Ndikimet Potenciale:

- ndikimet nga zona të ndotura të njohura si Hot-Spote (mbetje kimike, materiale të rrezikshme) që akoma nuk janë sistemuar;
- ndikimet nga venddepozitime të hapura (të ligjshme dhe të paligjshme);
- kapacitet i pamjaftueshëm i landfilleve ekzistues/mungesa e tyre
- mbetjet inerte, mbetjet e rrezikshme, mbetjet spitalore dhe mbetjet e kafshëve nuk trajtohen sipas kërkesave ligjore;
- ndarja në burim e mbetjeve/riciklimi (kuadri ligjor është plotësuar që prej vitit 2011, por nuk zbatohet në praktikë).

➤ **Zhurma**

Objektiva Mjedisore 9 (OM 9): Reduktimi i ndotjes së zhurmës/akustike dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE dhe OBSH.

Ndikimet Potenciale:

- ndotja akustike që shkaktohet gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të infrastrukturës përkatëse dhe ndikimi tek shëndeti i njerëzve.

➤ **Popullsia dhe asetet materiale**

Objektiva Mjedisore 10 (OM 10): Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme.

Ndikimet Potenciale:

- ndikime mbi asetet materiale për shkak të nevojës për hapësire;
- aksesibiliteti dhe lidhjet mes zonave/rajoneve të ndryshme;
- ndikimet që lidhen me sigurinë rrugore.
-

➤ **Trashëgimia Kulturore**

Objektiva Mjedisore 11 (OM 11): Ruajtja e shtrirjes, përmbajtjes dhe veçorive të zonave dhe strukturave të trashëgimisë kulturore.

Ndikimet Potenciale:

- ndikime në elementet e trashëgimisë kulturore.

➤ **Peizazhi**

Objektiva Mjedisore 12 (OM 12): Garantimi i ruajtjes së peizazheve të veçanta dhe zonave peizazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar dhe krijimi i një imazhi peizazhi me cilësi të larte.

Ndikimet Potenciale:

- ndryshimi i peizazhit dhe i veçorive pamore të hapësirës.

Ndikimet e rëndësishme në mjedis dhe objektivat mjedisore janë analizuar dhe vlerësuar sipas shkallëve të mëposhtme:

Shkallët e vlerësimit të ndikimit të Planit ndaj arritjes së objektivave mjedisore:

A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv

B – ndikim i parëndësishëm

C – ndikimi behet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse

D – ndikim i rëndësishëm

E – ndikim shkatërrues

X – Vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur

Vlerësimi i ndikimeve të Planit sipas shkallës A, B dhe C do të thotë që ndikimet e zbatimit të Planit ndaj arritjes së objektivave mjedisore janë të pranueshme. Ndikimet e parëndësishme janë vlerësuar me B, ndërsa ndikimet që behen të pranueshme vetëm pas zbatimit të masave zbutëse përkatëse, janë vlerësuar me C. Shkallët D dhe E nënkuptojnë se ndikimet e zbatimit të Planit ndaj arritjes së objektivave mjedisore janë të papranueshme.

1.4 Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore

Objektivat e përcaktuara mjedisore duhet të jenë në përputhje me Ligjin 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor", objektivat e përcaktuara në SKZHI II dhe Direktivën 2001/42/KE, të cilat janë të rëndësishme për të vlerësuar politikat dhe projektet që parashikon Plani për të arritur objektivat e tij.

Për të përcaktuar rëndësinë e objektivave mjedisore, duhet të vlerësohet përputhshmëria e objektivave dhe politikave të Planit me objektivat e përcaktuara mjedisore. Vlerësimi i përputhshmërisë krijon konflikte apo veprime të ndërsjellat mes objektivave dhe politikave të ndryshme, si dhe konflikte të theksuara interesi mes objektivave, të gjitha këto duhen vene në dukje veçanërisht në pjesën e Vlerësimit të projekteve specifike të Planit.

Në përgjithësi, në këndvështrimin e përputhshmërisë me objektivat mjedisore, objektivat dhe politikat e Planit, janë si më poshtë:

- ✓ objektivat përputhen plotësisht (4 objektive)
- ✓ objektivat përputhen pjesërisht (8 objektiva)
- ✓ lidhja mes objektivave është e zbehte (2 objektiva)

Në këndvështrimin e lidhjes mes objektivave të Planit dhe objektivave mjedisore, vërehet një diversifikim i përputhshmërisë sipas fushave përkatëse mjedisore. Konkretisht:

- Secila prej objektivave të Planit (përveç 1 objektivave të sistemit të Infrastrukturës dhe objektivave të sistemit Bujqësor) është në përputhshmëri të plotë me të paktën 3 objektiva mjedisore;
- Shtatë objektiva të planit kanë një lidhje të pjesshme me të paktën një objektiv mjedisore;
- Shtatë objektiva të planit kanë një lidhje të zbehte me të paktën 1 objektiv mjedisor;
- Dy objektiva të planit që lidhen me sistemin urban dhe turizmin janë në përputhshmëri të plotë me të gjitha objektivat mjedisore;
- Secila prej objektivave të planit (përveç dy objektivave që lidhet me sistemin urban dhe turizmin) nuk kanë lidhje me të paktën 1 objektiv mjedisor;

Edhe në këndvështrimin e lidhjes mes objektivave të Planit dhe objektivave mjedisore diversifikimi i përputhshmërisë është i lartë. Sidoqoftë objektiva mjedisore OM 10:Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme, është objektivat me nivelin më të lartë të përputhshmërisë me objektivat mjedisore.

Plani ka përcaktuar gjithashtu gjashtë objektiva strategjike si më poshtë:

OBJEKTIVA STRATEGJIKE		Objektivat Mjedisore
		PROGRAMET
1	PAJISJA ME SHËRBIMET BAZË	1.1 Përmirësimi i rrjeteve teknike
		1.2 Ruajtja e peizazhit dhe siguria e territorit
		1.3 Shërbimet publike
2	LËVIZJA ME MËNYRA TË NDRYSHME	2.1 Rrugët automobilistike
		2.2 Korridori lumor
		2.3 Ndërhyrje të tjera për lëvizjen
3	QENDRAT URBANE	3.1 Pole shërbimesh për territorin përreth
		3.2 Zhvillimi i qendrave lokale
		3.3 Rikualifikimi urban
4	TURIZMI	4.1 Turizmi mjedisor
		4.2 Turizmi kulturor
		4.3 Ndërhyrje të tjera për zhvillimin e turizmit
5	BUJQËSIA, BLEGTORIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT	5.1 Strukturat e shërbimit
		5.2 Rritja e prodhimit
6	ENERGJIA	6.1 Zhvillimi i prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme
		6.2 Diferencimi i prodhimit të energjisë

Si konkluzion i përgjithshëm, bazuar edhe në analizën që u është bërë programeve në tabelën Tabela 9.1) mund të thuhet se objektivat strategjike të planit janë në përputhshmëri me objektivat mjedisore.

Krahasimi i objektivave strategjike paraqitet si më poshtë:

- Pothuajse të gjithë programet që bëjnë pjesë në objektiven strategjike Nr. 1 dhe 2: Përmirësimi i rrjeteve teknike, ruajtja e peizazhit dhe siguria, korridoret lumore apo programet që përmbajnë projekte me ndikim të ulët në mjedis, janë në përputhshmëri me objektivat mjedisore.
- Të gjithë programet që i përkasin objektives strategjike Nr. 3: Qendrat Urbane, kanë një impakt negativ në mjedis kryesisht gjatë fazës së ndërtimit. Këto impakte zbehen dhe pjesërisht zhduken nën zbatimin e masave zbutëse.
- Programet që bëjnë pjesë në Objektiven Strategjike Nr. 4: Turizmi – dhe kryesisht programet që kanë të bëjnë me turizmin mjedisor dhe kulturor kanë një impakt të ulët në mjedis dhe përputhshmëria me objektivat është e lartë.
- Programet që bëjnë pjesë në Objektivat Strategjike Nr. 5 dhe 6, përgjithësisht janë të përputhshme me objektivat mjedisore, pasi projektet që këto programe përfshijnë kanë impakt të ulët në mjedis ose kanë ndikim pozitiv pasi kanë të bëjnë me pyllëzim apo ulje të çlirimit të gazeve të dëmshme në ambient dhe përdorimi i tyre për prodhim energjie.

Programet strategjike do të përputhen plotësisht apo pjesërisht me objektivat mjedisore, gjatë zbatimit dhe funksionimit të aktiviteteve përkatëse. Për të gjitha aktivitetet duhet të garantohet zbatimi i masave zbutëse për të reduktuar ndikimin në mjedis, sipas kërkesave të legjislacionit përkatës.

1.5 Procesi i Konsultimeve

Pjesëmarrja e grupeve të interesit dhe konsultimi me ta është një pjesë shumë e rëndësishme e procesit të hartimit të VSM-së. Përfshirja efektive e grupeve përkatëse të interesit ka kontribuar në cilësinë e Vlerësimit, ka sjellë të dhëna për analizën dhe raportin e VSM-së, dhe do të mbështesë zbatimin e planit pas miratimit të tij, si dhe do të kontribuojë në një pranim më të lehtë dhe më të zbutur të projekteve përkatëse.

Procesi i konsultimeve ka nisur para hartimit të raportit paraprak të VSM dhe ka vazhduar edhe gjatë hartimit të raportit përfundimtarë. Ai është përqendruar kryesisht në dy pika:

(i) qëllimet e veprimt;

(ii) mbledhja e të dhënave dhe informatave të nevojshme për analizat e mëtejshme.

Për të pasur konsultime dhe pjesëmarrje efektive të grupeve të interesit është bërë identifikimi i tyre, është përcaktuar qëllimi i angazhimit të tyre dhe janë përzgjedhur mënyrat e konsultimit dhe pjesëmarrjes.

Gjatë procesit të hartimit të VSM-së do të konsultohen grupet e mëposhtme:

- Ministritë e linjës
- Autoritetet mjedisore
- Njësitet e qeverisjes vendore

- OJF-të
- Universitetet
- Publiku i gjere

Konsulenti në bashkëpunim me ekipin ka realizua disa takimesh me grupet e interesit. Takimi i pare u mbajt në datë 24.07.2016, ku u prezantuan pikat dhe çështjet kryesore që do të trajtohen në raportin paraprak të Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Në këtë takim u diskutua lidhur edhe me shqetësimet e specialistëve të bashkisë mbi mjedisin.

1.6 Konkluzione dhe Rekomandime

Procesi i VSM, nisur nga analiza e impakteve të projekteve strategjike në lidhje me arritjen e objektivave mjedisore konkludon si më poshtë:

- Në përgjithësi, evidentohet që me anë të pozicionimit të përshtatshëm të aktiviteteve hapësinore dhe duke ndërmarre gjithë masat zbutëse, të gjithë grupet e projekteve të propozuara janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor;
- Gjatë zbatimit të projekteve, priten të ndodhin impakte pozitive dhe negative. Impaktet pozitive priten për ajrin dhe ndryshimet klimatike si edhe për popullsinë dhe asetet materiale;
- Përgjithësisht, shumica e impakteve negative janë të lidhura me fazën e planifikimit (pozicionimi i infrastrukturës specifike në hapësirën e territorit dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme), pasi Lezha ka veçori të theksuara të ndryshme dhe të shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peizazhistike që mund të ndikohen konsiderueshëm prej zhvillimeve të infrastrukturës, sidomos atyre me shtrirje të gjere dhe korridoreve sipas sektorëve (transport, energji, ujë, etj.);
- Impakte negative mbi shëndetin human mund të ndodhin për shkak të rritjes së ndotjes nga zhurmat dhe impaktet në cilësinë e ajrit, veçanërisht në zonat me densitet të lartë banimi ku do të përqendrohen edhe një seri veprimesh në territor të ngushtë dhe kjo do të ndikojë kryesisht në fazën e zbatimit të projekteve specifike.

Në vijim raporti VSM thekson edhe rekomandimet e mëposhtme të përgjithshme:

- Ka nevojë për të forcuar bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet autoriteteve përkatëse të sektorëve të caktuar ekonomike me autoritetet e mjedisit dhe shëndetësisë;
- Ka nevojë për integrim të mëtejshëm mjedisor të planeve sektoriale dhe atyre vendore në Plan, me qellim zbatimin e masave zbutëse dhe zbatimin e procedurave të parashikuara nga VSM-ja dhe VNM-të specifike;
- Ka nevojë për të siguruar infrastrukturën mjedisore dhe standardet e parashikuara për shërbimet. Kjo nevojë duhet të ndiqet me përmirësimin e praktikës së menaxhimit mjedisor të sektorëve përkatës;
- Plotësimi i standardeve mjedisore duhet të shoqërohet edhe me rritjen e portofolit financiar dhe investimeve në drejtim të menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit;
- Rritja e transparencës për investimet e reja, kontrollin e shkarkimeve në ujë apo ajër, administrimin e zonave të mbrojtura, menaxhimin e mbetjeve, etj.

ndihmon në rritjen e bashkëpunimit me publikun dhe zbatimin e politikave të parashikuara nga Plani;

- Përgatitja dhe zbatimi i planeve apo projekteve specifike mjedisore si dhe efektshmëria e zbatimit të Planit në tërësi, janë masa të rëndësishme për të siguruar shëndetin e publikut dhe për të rritur kontributin në lidhje me arritjen e objektivave mjedisore;

SEKSIONI 2: HYRJE

2.1 Çfarë është VSM

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një nga instrumentet kyç për integrimin e çështjeve mjedisore dhe parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin strategjik dhe vendimmarrjen. Ai është një mjet i njohur globalisht për planifikimin me pjesëmarrje që përdoret për të analizuar dhe përfshirë çështjet e mjedisit në politikat, planet dhe programet e propozuara.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor mund të kuptohet si *“një proces sistematik i cili parashikon dhe vlerëson efektet e mundshme mjedisore gjatë hartimit të një plani apo programi, me qëllim adresimin e këtyre efekteve në mënyre të përshtatshme që në fazat më të hershme të vendimmarrjes”*.

Qëllimi i VSM-së mund të përkufizohet si garantimi që konsideratat mjedisore informojnë dhe integrohen në vendim-marrjen strategjike në mbështetje të një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm nga këndvështrimi mjedisor. Më konkretisht, procesi i VSM-së mbështet autoritetet përgjegjëse për planet dhe programet, si dhe vendim-marrësit, që të marrin në konsideratë:

- Tendencat kyç mjedisore, potencialet dhe shqetësimet që mund të prekin apo mund të preken nga plani apo programi;
- Objektivat dhe indikatorët mjedisore që janë në përputhje me planin apo programin;
- Efektet e mundshme dhe të konsiderueshme mjedisore të opsioneve të propozuara dhe të zbatimit të planit apo programit;
- Masat për të shmangur, zvogëluar apo zbutur efektet negative dhe ato për të rritur e përforcuar efektet pozitive;
- Pikëpamje, sugjerime dhe informacion nga autoritetet përkatëse, publiku dhe, sipas rastit, vendet fqinjë që preken nga zbatimi i planit apo programit.

Në përgjithësi, VSM-ja aplikohet për plane, programe, politika dhe dokumente të tjerë me natyrë strategjike (përfshirë mundësisht edhe dokumentet ligjore).

2.2 Kuadri Ligjor i VSM

Kuadri ligjor i VSM-së përfshin në mënyre të detyrueshme Ligjin Shqiptar për VSM-në, ndërkohë që, për të qenë koherent, nuk është lënë mënjanë edhe kuadri ligjor ndërkombëtar. Referencat përkatëse ligjore janë dhënë më poshtë:

- ❖ **Ligji nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”**, i cili ka për qëllim të sigurojë mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit, rishikimit, ndryshimit ose modifikimit të planeve a programeve me pasoja të mundshme negative në mjedis. Ligji përcakton institucionet dhe autoritete përkatëse, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe rregullat e procedurës për kryerjen e Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Ligji është përafëruar me Direktivën 2001/42/KE, datë 27 qershor 2001. Me shume informacion gjendet në http://www.legjislacioni.gov.al/frontend/change_documents/129.

❖ *Direktiva 2001/42/EC e Komisionit Evropian mbi Vlerësimin e efekteve në mjedis prej planeve apo programeve të caktuara (Direktiva e VSM-së). Më shume informacion gjendet në <http://ec.europa.eu/environment/eia/home.htm>.*

❖ *Protokolli i VSM-së i hartuar dhe miratuar në Konventën e Espoo (UNECE). Më shumë informacion gjendet në http://www.unece.org/env/eia/sea_protocol.htm.*

2.3 Fazat kyç të procesit të VSM-së

Në tabelën më poshtë përshkruhen fazat kyç të procesit të VSM-së.

Tabela 2.1 Fazat kyç të procesit të VSM-së

Faza	Përshkrimi
Shqyrtimi	Gjatë shqyrtimit identifikohet nevoja për VSM që aplikohet në një plan, program apo projekt specifik. Shqyrtimi si proces fokuson burimet tek ato plane, programe apo projekte të cilat mund të shkaktojnë efekte të konsiderueshme në mjedis dhe shëndet, dhe përjashton nga procesi i VSM-së ato të cilat kanë ndikime të vogla, ose nuk kanë fare ndikime. <i>Qëllimi i shqyrtimit është të identifikojë nëse VSM-ja duhet të aplikohet për një plan, program apo projekt specifik.</i>
Studimi i shtrirjes/qëllimit të VSM	Çështjet e identikuara gjatë studimit të shtrirjes/qëllimit të VSM-së do të orientojnë Vlerësimin e gjendjes baze të mjedisit, Vlerësimin aktual të ndikimeve të pritshme dhe konsideratat për opsione të mundshme alternative. VSM-ja merr në konsideratë përfshirjen e aspekteve me të gjera mjedisore apo sociale, siç janë adaptimet ndaj ndryshimeve klimatike, mundësitë për punësim etj. <i>Qëllimi i kësaj faze është të përcaktohen çështjet kyç që duhen adresuar në raportin e VSM-së.</i>
Analiza e gjendjes ekzistuese	Analiza e gjendjes ekzistuese do të përbejë bazën për Vlerësimin e ndikimeve dhe përpilimin e skemës së monitorimit. Për VSM-në është e rëndësishme që të përvijohen tendencat e mundshme në të ardhmen – kështu që duhet të bëhet analiza e tendencave në të kaluarën, me qëllim që të parashikohen zhvillimet që do të ndodhin në të. Vlerësimi i ndikimeve të pritshme nuk mund të bëhet pa kuptuar mirë gjendjen ekzistuese të çështjeve kyç të identikuara në studimin e shtrirjes/qëllimit të VSM-së. <i>Qëllimi i analizës së gjendjes ekzistuese është që të orientojë drejt një specifikimi më të mirë të çështjeve kyç, dhe një identifikimi më të mirë të problemeve kryesore që lidhen me planet, programet apo projektet përkatëse.</i>

Analiza e ndikimeve dhe formulimi i masave zbutëse	VSM-ja analizon efektet e konsiderueshme negative si dhe ato pozitive të planeve të propozuara. Një nga përfitimet kryesore prej VSM-së është se ai mundëson identifikimin e efekteve mjedisore të një numri projektesh të përfshira në dokumentin strategjik, dhe si i tillë ai do të adresojë efektet e pritshme kumulative, të cilat mund të rezultojnë prej aktiviteteve të vogla individualisht, por të konsiderueshme të marra se bashku, që do të kryhen për një periudhë të caktuar kohore. Në vijim të rreziqeve dhe ndikimeve të identifikuara, VSM-ja sugjeron masa zbutëse për të adresuar efektet e pritshme negative si dhe për të rritur ndikimet pozitive që do të vijnë nga zbatimi i planeve, programeve apo projekteve përkatëse. <i>Kjo fazë ka për qëllim të vlerësojë efektet e konsiderueshme negative dhe pozitive të planeve përkatëse, dhe, në vijim të konkluzioneve të analizës së ndikimeve, të marrë në konsideratë alternativat dhe opsionet, dhe të formulojë masat zbutëse për të parandaluar, reduktuar dhe, sa me shume të jetë e mundur, të kompensojë çdo ndikim të konsiderueshëm negativ të planeve, programeve apo projekteve përkatëse.</i>
Hartimi i raportit të VSM-së	Raporti i VSM-së përmbledh të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e nxjerra gjatë gjithë procesit të VSM-së dhe shërben si baze për konsultimet me autoritetet përkatëse dhe grupet e tjera të interesit. <i>Qëllimi i kësaj faze është përgatitja e një raporti të shkruar mire dhe të kuptueshëm, i cili paraqet të gjithë informacionin dhe të dhënat e rëndësishme, konkluzionet dhe rekomandimet në një mënyrë të qartë, dhe kështu do të mundësojë konsultime efektive me autoritetet përkatëse dhe grupet e tjera të interesit.</i>
Adoptimi	Jepet informacion mbi adoptimin e planit, programit apo projektit përkatës, si janë reflektuar komentet dhe sugjerimet e procesit të konsultimeve, si dhe për metodat e monitorimit të efekteve të konsiderueshme mjedisore që vijnë nga zbatimi i planit, programit apo projektit përkatës.
Monitorimi	Monitorimi i efekteve të konsiderueshme mjedisore dhe realizimi i veprimeve të duhura korrigjuese/zbutëse për çdo efekt mjedisor të konsiderueshëm të paparashikuar.

SEKSIONI 3: PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I PLANIT

3.1 Objektivat, politikat dhe analiza e sistemit

Pozicionimi i bashkisë përgjatë rrugës Shkodër Pukë – Kosovë e ka identifikuar Vaun e Dejës si një portë hyrëse në drejtim të Kosovës, duke identifikuar nevojën për të studiuar dhe trajtuar korridorin rrugor kryesor Mjedë Vau-Dejës, si dhe ristrukturimin urban të territoreve të banuara në këtë segment.

Hartimi i PPV të Bashkisë Vau Dejës vjen si një domosdoshmëri për të krijuar kushte për një zhvillim të qëndrueshëm të territorit në tërësinë e tij nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore. Në përputhje me Planin e Përgjithshëm Kombëtar dhe duke vlerësuar potencialin aktual e perspektiv për zhvillimin e territorit në nivel vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publikë e privatë, duke bashkërenduar punën për mbrojtjen e burimeve natyrore, si: toka, në veçanti toka bujqësore, ajri, uji, pyjet, flora, fauna, peizazhet, PPV synon të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë. Si rezultat PPV është zbatimi i standardeve të unifikuara të planifikimit, të cilat janë nivelet optimale të cilësisë, që përdoren si norma e referenca gjatë procesit të vazhdueshëm të planifikimit dhe të cilat mundësojnë një zhvillim të qëndrueshëm brenda kufijve të territorit.

I parë në këndvështrimin rajonal, zhvillimi i qëndrueshëm i Bashkisë Vau-Dejës, synon të arrijë objektivat ligjorë, respektimin e normave dhe standardeve territoriale dhe mjedisore, si dhe të respektojë zhvillimin demografik duke siguruar mundësitë për ecurinë e aktiviteteve industriale, tregtare, të biznesit, të infrastrukturës; plotësimin e nevojave sociale, të banimit, të pushimit dhe mbrojtjen e burimeve natyrore si mjete të domosdoshme, që garantojnë qëndrueshmërinë dhe integritetin e zhvillimit të Bashkisë.

Kjo fazë është tepër e rëndësishme, për shkak se produkti final do të bazohet pikërisht mbi këto të dhëna. Më konkretisht, për procesin e Analizës objektivat do të ishin:

1. Konceptimi i ecursisë dhe rritjes së qëndrueshme të Bashkisë si pjesë integrale në zhvillimin e rajonit;
2. Kuptimin e synimeve dhe orientimeve, që Bashkia synon të arrijë, të shpërndara sipas zonave;
3. Klasifikimet që ndikojnë pronësinë dhe vlerën e tokës nëpërmjet:
 - Pesë sistemeve territoriale bazë
 - Klasifikimit funksional;
 - Hapat dhe mënyrat e implementimit (futjes në zbatim);
 - Norma e sipërfaqes së ndërtimit dhe tipologjia e banesave që do të jenë si rezultat i mekanizmave të implementimit;
4. Kategorizimi në zonat funksionale të territorit, nisur nga situata ekzistuese, përdorimet e mundshme, dendësia e popullsisë, infrastruktura aktuale sociale dhe inxhinierike si dhe rregullat që duhet të aplikohen në rast ndryshimi të funksioneve të lejuara. Këto sipërfaqe do të përcaktohen bazuar mbi parimet aktuale të përdorimit të territorit.

Qëllimi i kësaj Analize dhe Vlerësimi të thelluar të territorit është të krijojë një bazë të dhënash për hapat e mëtejshëm të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV), të identifikojë problemet me të cilat përballlet zhvillimi i qytetit dhe se si mund të zgjidhen në të mirë të komunitetit. Kuptimi i këtyre zhvillimeve të qytetit shihet i lidhur ngushtë me zhvillimet në një shkallë më të gjerë rajonale dhe kombëtare.

Zhvillimi i integruar i kësaj Bashkie nënkupton marrjen në konsideratë dhe përfshirjen në një paketë propozimesh aspektet që mbështesin dhe garantojnë ndryshimet pozitive që do të ndodhin. Në këtë pikëpamje do të përfshihen, analizohen dhe kombinohen aftësitë ekonomike, sociale, mjedisore, të planifikimit territorial, aftësitë e institucioneve publike dhe ato të sektorit privat.

Në mënyrë më të përmbledhur, studimi synon të pasqyrojë:

- Strukturën e përgjithshme organike të territorit të përvijuar nëpërmjet elementëve që përcaktojnë llojin e zhvillimit, në veçanti nga rrjetet kryesore të transportit elementët natyrore, rrjeti i infrastrukturës ekzistuese dhe sipërfaqet e rezervuara për qëllime strategjike për Bashkinë dhe rajonin.
- Përcaktimi i ndërhyrjeve për ruajtjen e aseteve bujqësore, historike dhe peisazhistike së bashku me kufizimet në lidhje me përdorimin e tyre, si dhe elementët e dhënë nga normativat shtetërore, në lidhje me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
- Studim të situatave hidrologjike, gjeologjike dhe sizmike të territorit në mënyrë që të vlerësohet përputhshmëria e planeve të propozuara me to.
- Kufizimet mbi ndërtimet për ato territore apo zona që janë të ndjeshme në lidhje me mjedisin, peizazhin dhe trashëgimitë kulturore e historike.
- Ruajtja e funksionalitetit të infrastrukturës dhe zonave që kanë interes publik. Mbrojtja nga rreziqet e mundshme për banorët dhe objektet vulnerabël.
- Përcaktimi i rrethanave që mund të kërkojnë një rishikim të PPV-së. Ky rishikim duhet të derivojë nga kërkesa e popullsisë dhe indeksi i rritjes, përdorimi i tokës dhe intensiteti i mbulimit të sipërfaqes së ndërtimit, si dhe nga elementët e përgjithshëm, që fillimisht kanë ndikuar klasifikimin original të territorit në zonim.

PPV duhet të sigurojë gjithashtu mbështetje për çështjet të cilat janë kompetencë e Bashkisë Vau-Dejës, si:

- Infrastruktura dhe shërbimet publike,
- Funksionet Social-Kulturore dhe rikrijuese,
- Zhvillimi ekonomik lokal,
- Rendi dhe siguria.

Plani i Përgjithshëm Vendor i Planifikimit të Territorit, që do të mbështetet te instrumentet e planifikimit për të operuar me efikasitet, ka gjithashtu nevojë për një kapacitet të përshtatshëm menaxhues të stafit të Bashkisë, në veçanti për monitorimin dhe modernizimin e planeve përmes kësaj periudhe zhvillimi.

Plani i Përgjithshëm Vendor për bashkinë Vau-Dejës përcakton ndarjen e territorit në pesë sisteme, analizën SWOT dhe strategjinë territoriale për secilin prej tyre si me poshtë:

3.1.1 Analiza SWOT sipas sistemeve

3.1.1.1 Analiza e përgjithshme

Pikat e forta

- Pozicion gjeografik i favorshëm, në brendësi të një territori që përfshin zona malore, kodrinore dhe fushore, të pasur me burime hidrike, në afërsi me detin dhe me një klimë të këndshme
- Territori karakterizohet nga toka mjaft pjellore, peizazhe tërheqëse dhe sipërfaqe të lundrueshme
- Identitet i fortë historik dhe kulturor, lidhur me vendbanimet e vjetra por edhe me kulturën dhe traditën e sotme (kultura e Komanit, qyteti i Sardës, Danjës, Sapës, kultura dhe artizanati i Zadrimes etj.)
- Përfshirja e territorit të Vau-Dejës në parashikimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe Planit Sektorial të Alpeve
- Afërsi me qendrat e Polit të Zhvillimit Rajonal; Shkodrën dhe Lezhën
- Vau-Dejës është pjesë e portës perëndimore të Rajonit Malor Verior
- Përqindje e lartë e popullsisë me moshë të re, popullsi aktive
- Vetëdije e pushtetit vendor të rolit të tij me dëshirën për të kontrolluar zhvillimin e tokës në një bazë të qëndrueshme
- Prirje e komuniteteve lokale drejt veprimeve të solidaritetit dhe mbrojtjes së përbashkët ndaj rreziqeve

Pikat e dobëta

- Nivel i konsiderueshëm i të papunëve dhe rritje e ulët ekonomike
- Nivel i të ardhurave mesatarisht të ulëta në popullsinë lokale
- Prezenca e zonave me periferialitet urban, varfëri dhe përjashtime sociale
- Nivel i lartë i informalitetit, qoftë në ekonominë ashtu edhe në proceset urbane
- Nivel i ulët i resurseve publike lokale
- Niveli i ulët i ofertës së aftësive teknike dhe profesionale lokale, për shkak të zhvendosjes së fuqisë punëtore të kualifikuar dhe të kuadrove teknike dhe profesionale në qendrat e mëdha urbane (Shkodër, Lezhë, Tiranë)
- Mungesa e strategjive dhe instrumenteve të zhvillimit të bazuar në analiza dhe interpretime të sakta të gjendjes faktike
- Paqartësia e pengesave, ruajtjes dhe mbrojtjes së të mirave të përbashkëta urbane
- Prani e ulët e shoqatave në mbrojtje të pasurisë publike.
- Pasiguri mbi të drejtën e pronës
- Fragmentim i lartë i pronës së tokave bujqësore, me ndërmarrje të tipit familjar që prodhojnë kryesisht për vetëkonsum
- Mungesa infrastrukturash për magazinimin dhe transportin e mallrave
- Nivel i ulët i kreditimit bankar, shpeshherë i paaksesueshëm nga ndërmarrjet e vogla dhe shumë të vogla

- Mungesë e menaxhimit të duhur të ciklit të mbetjeve urbane
- Mungesë e infrastrukturave të tjera në pjesë të mëdha të territorit, si rrjetet e kanalizimeve, uji i pijshëm, rrjeti rrugor, rrjeti hekurudhor (tashme pothuajse jashtë përdorimit) etj.

Mundësitë

- Potencial i lartë ekonomik në bujqësi dhe industri të lehtë
- Zhvillimi i shërbimeve ndaj turizmit në raport me rritjen e kërkesës turistike brenda dhe jashtë vendit
- Çmim i ulët i truallit, i fuqisë punëtore dhe i faktorëve përbërës të ndërtimit
- Mundësia e përfitimit nga afërsia territoriale me qendrat e Polit të Zhvillimit Rajonal, Shkodrën dhe Lezhën, në bazë të lidhje së mirë ekzistuese infrastrukturore.
- Pozicion strategjik në raport me Parkun Kombëtar të Alpeve (Parashikuar nga PPK), që krijon mundësinë për përfshirje në ofertën turistike të rajonit të veriut.
- Rritja, faktike dhe potenciale, e sektorit turistik të vendit, integrimi i të cilit me bujqësinë dhe agro-turizmin mund të ndihmojë në shpërhapjen e produkteve lokale dhe rajonale.
- Prezenca në rritje e investitorëve të huaj , që mundëson krijimin e ekonomive të shkallës, tejkalimin e pengesave të mungesës së likuiditetit për financimin e prodhimit dhe përshtatjen e prodhimit bujqësor shqiptar me kërkesat e cilësisë dhe gjurmueshmërisë të kërkuara nga normativat evropiane.
- Mundësi përfitimi të drejtpërdrejtë ekonomik apo zhvillimor nga prania e katër Hidro Elektro Centraleve dhe landfillit të Bushatit në territorin e bashkisë.

Rreziqet

- Varfëria, përjashtimi social dhe informaliteti në proceset prodhues dhe urbane mund të shndërrohen në probleme sociale
- Braktisje në rritje e vendbanimeve rurale dhe malore të brendshëm dhe i zonave bujqësore me përdorim bujqësor dhe blegtoral
- Migrim drejt zonave urbane fushore dhe qendrave urbane rajonale e kombëtare
- Zaptim i tokave prodhuese bujqësore për përdorim rezidencial, edhe në mungesë të drejtës së pronësisë
- Paaftësi e sistemit territorial për të tërhequr projekte dhe investime në prodhim, për shkak të faktorëve të dobësive të shumta të territorit (mungesa e infrastrukturës dhe shërbimeve)
- Degradim territorial në rritje, si pasojë e paaftësisë së kontrollit të zhvillimit të territorit dhe në orientimin e zhvillimit dhe rinovimit urban
- Mungesa e koordinimit dhe marrëdhënieve efikase midis organeve të ndryshme të qeverisjes administrative (administratat lokale dhe rajonale)

- Mungesa e riorganizimit të “makines” administrative lokale në periudhën pas reformës administrative

3.1.1.2 Analiza SWOT - Sistemi Natyror

Pikat e forta

- prezenca e asetëve natyrore, si:
 - a) Peizazhi i mbrojtur Lumi Buna - Velipojë
 - b) Lugina e Drinit dhe liqenet e Vau-Dejës dhe Komanit
 - c) Monumentet natyrore
 - Ndërthurja e territorit me Parkun Kombëtar të Alpeve (Propozuar nga PPK)
 - Biodiversitet i lartë i pranishëm në territor, i shprehur nga pasuria e florës dhe e faunës e karakterizuar nga lloje të shumta endemike (që nuk gjenden në vende të tjera) dhe nga prezenca e specieve që motivojnë përcaktimin e zonave të mbrojtura ekologjike mjedisore

Pikat e dobëta

- Mungesa e mjeteve të kontrollit dhe pengimit të modifikimit dhe shkatërrimit të peizazhit natyral dhe resurseve ekologjike nga ana e administratave publike
- Ndërgjegjësim i ulët publik në masat dhe mjetet e kontrollit mjedisor
- Përhapja e vendbanimeve joformale dhe spontane në zonat e mbrojtura dhe me ndjeshmëri të lartë mjedisore, (shtretërit e lumenjve, rripat bregdetarë)
- Degradim progresiv i cilësisë mjedisore të përgjithshme, për shkak të mungesës së sistemeve të trajtimit, rimëkëmbjes, riciklimit dhe ripërdorimit të mbetjeve solide urbane
- Mungesë analoge e sistemeve të përshtatshme të trajtimit të mbetjeve solide urbane, sidomos në kontekstin bujqësor dhe përhapjen urbane

Mundësitë

- Mundësia e zhvillimit të turizmit natyror, ekskursionistik, sportiv, kulturor dhe arkeologjik, qoftë në zonat e brendshme ashtu edhe në zonat bregdetare
- Mundësi e turizmit dhe e aktiviteteve të kërkimit dhe eksperimentimit në fushën mjedisore dhe në zonat e mbrojtura
- Përmirësimi i përgjithshëm i ekuilibrit ekologjik dhe i faktorit të biodiversitetit për politika të përshtatshme të mbrojtjes dhe progresit ekologjik lokal
- Përmirësimi i përgjithshëm i cilësisë së jetesës në qendrat dhe në kontekstet urbane mbështetur në modelin e zhvillimit të qëndrueshëm duke krijuar një ambient të pastër e të shëndetshëm

Rreziqet

- Rritja e shtrirjes urbane në dëm të zonave me interes dhe vlera mjedisore dhe peizazheve
- Humbja e resurseve ujore prej ndotjes së akuiferëve sipërfaqësorë dhe nëntokësorë
- Ulja e cilësisë së ajrit dhe mjedisit për shkak të shpyllëzimit progresiv të zonave malore, zonave liqenore, dhe të shtretërve të lumenjve.
- Rrezik i lartë zjarresh për shkak të mungesës së kontrollit, menaxhimit të aktiviteteve pyjore dhe blegtorale, mungesa e kundërvënies ndaj kriminalitetit
- Humbje progresive e biodiversitetit dhe balancave të ekosistemit, zvogëlimi i specieve të mbrojtura, për shkak të mungesës së rregullave, kontrolleve dhe programimeve të aktivitetit të gjuetisë
- Rrezik nga ndotja e mundshme që do të sillte keq menaxhimi i landfillit të Bushatit.

3.1.1.3 Analiza SWOT – Sistemi Ujor

Pikat e forta

- Prania e resurseve të pasura ujore si në nëntokën dhe në sipërfaqe
 - a. rrjedha uji gjithëvjeçare
 - b. basene ujore
 - c. ujëra nëntokësore
 - d. rrjeti i kanalizimeve artificiale për përdorim bujqësor
- Sipërfaqe të mëdha të lundrueshme

Pikat e dobëta

- Rrezik i lartë nga përmytjet në zonat urbane dhe bujqësore
- Mungesa e mirëmbajtjes së rrjetit të ujitjes dhe kullimit
- Shkarkimi i mbetjeve urbane në shtratin e rrjedhave të ujit natyrorë dhe artificiale
- Shkarkimi i ujërave të zeza në rrjedhat ujore sipërfaqësore
- Mungesa e furnizimit të drejtpërdrejtë me ujë të pijshëm në shumë fshatra dhe qendra të vogla urbane
- Kapacitet i ulët i furnizimit me ujë i të gjitha qendrave urbane
- Mungesa e të ardhurave të përshtatshme nga tarifimi i resurseve ujore

Mundësitë

- Përmirësimi dhe zhvillimi i sistemeve ekzistuese të ujitjes për bujqësinë
- Vijimi i shfrytëzimit të potencialit hidroenergjetik ende të papërdorur
- Racionalizimi i përdorimit të resurseve ujore të pijshme, nëpërmjet masave dhe mjeteve të menaxhimit më të mirë të resurseve të tilla

- Fuqizimi i sistemeve të menaxhimit dhe të shpërndarjes së ujërave publike, të menduara si të mira të përbashkëta
- Rikualifikim dhe rigjenerim në aspektin ekologjik mjedisor të trupave kryesorë ujorë, në dobi të ekosistemeve lokale dhe të një zhvillimi të mundshëm të turizmit sportiv
- Përdorimi i lundrimit si atraksion kryesor në ofertën turistike lokale dhe rajonale
- Zhvillimi i peshkimit dhe kultivimit të peshkut si një sektor ekonomik i rëndësishëm

Rreziqet

- Përkeqësimi i ekosistemeve lokale për shkak të ndotjes së trupave ujor natyralë dhe artificial
- Humbje progresive e pakthyeshme e resurseve ujore të pijshme, për shkak të ndotjeve industriale, bujqësore për shkak të pesticideve dhe plehrave kimike, mbetjet solide dhe të lëngshme urbane, pusët e ujërave të zeza të shpërndara gjerësisht në zonat bujqësore urbane
- Përmbytjet dhe aluvionet periodike, lidhur edhe me përshkallëzimin e fenomeneve meteorologjike, si pasojë e ndryshimeve klimaterike dhe të rritjes së temperaturave mesatare
- Rreziku i përmbytjeve periodike nga shkarkimi i rezervave të tepërta të hidrocentraleve
- Humbja e jetëve njerëzore, dëme ndaj njerëzve dhe materialeve, shkatërrimi i ekonomive, infrastrukturave dhe pasuri e patundshme si pasojë e fenomeneve të sipërpërmendur
- Modifikimi dhe humbja e cilësisë së peizazheve lumore dhe liqenore

3.1.1.4 Analiza SWOT – Sistemi Bujqësor

Pikat e forta

- Prezenca e aktiviteteve të konsiderueshme bujqësore në territorin e Bashkisë
- Prezenca në Vau Dejës e Shkollës Profesionale Kombëtare “Ndre Mjeda”, ku ofrohen profilet: veterinar, teknologji agro-ushqimore, bujqësi dhe ekonomi bujqësore.
- Rezervat e mëdha ujore si dhe sistem bonifikues përgjithësisht i mirë zbatuar, me kanale kullues dhe ujitës dhe sipërfaqe të konsiderueshme të drenazuara me tuba qeramike;
- Fermerët trashëgojnë eksperiencë shumë pozitive në fushat e bujqësisë dhe blegtorisë;
- Terreni fushor dhe i sistemuar mirë përben një aset shumë të vlefshëm në mekanizimin e proceseve të punës, faktor baze për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë;
- Numri i madh i krerëve në gjedh dhe të imta si dhe sipërfaqet e mëdha të kultivuara me kultura bujqësore që rrisin pjellorinë e tokës (si jonxha dhe tërfili);

- Klima e favorshme dhe struktura e tokës, favorizojnë rritjen e kulturave të ndryshme bujqësore.

Pikat e dobëta

- Fragmentimi i lartë i pronave bujqësore, përmasa të vogla të prodhimit dhe të punësimit të ndërmarrjeve bujqësore lokale
- Gjendje problematike në lidhje me pronësinë e tokës
- Mungesa e organizimi e sektorit të prodhimit dhe shpërndarjes së produkteve bujqësore
- Mungesa e kujdesit në mirëmbajtjen dhe investimet në rrjetin e kanaleve ujitës dhe kullues, pritave malore, veprave të artit, erozionit etj.
- Mungesa e qendrave të magazinimit të ushqimeve, ruajtjen dhe shpërndarjen e produkteve ushqimore në tregjet lokale dhe kombëtare
- Niveli përgjithësisht i ulët i teknologjisë dhe njohurive të sektorit si dhe nivel i ulët i arsimit dhe njohurive të fermerëve
- Mungesa e strukturave dhe eksperteve në stafin e Bashkisë (dhe Njësi Administrative) që mbulojnë zhvillimin e sektorit të bujqësisë
- Mungesa e dokumentacionit për studimet agro-pedologjike dhe të bonitetit të kryera ndër vite dhe nevoja e përditësimit të tyre;
- Mungesa e subvencioneve shtetërore (procedura të tejzgjatura dhe bllokuese) dhe mungesa e përvojës në evidentimin e produktit.
- Mungesa e kontrolleve për cilësinë e inputeve bujqësore dhe çmimet e larta të këtyre inputeve
- Mungesa e kushteve për standardizimin dhe marketingun e prodhimit
- Interesat e larta në dhënien e kredive nga ana e institucioneve bankare

Mundësitë

- Mundësia e eksportit të produkteve bujqësore organike (bio) në tregjet lokale, në zonën rajonin Shkodër-Lezhë (ne bashkitë kufitare) dhe në perspektivë, në tregjet e Ballkanit dhe vendeve të Adriatikut
- Mundësia e rritjes së prodhimit në sera
- Mundësia e rinovimit dhe zhvillimit të llojeve të reja dhe të vjetra të bimëve cilësore, në lidhje me bujqësinë organike, në territoret kodrinore dhe të rrëzës së malit (sidomos në kultivimin e ullirit, vreshtave dhe pemëtarisë)
- Zhvillimi dhe rimëkëmbja e pylltarisë e bujqësisë në zonat rrëzë malit, në luginat e në zonat malore të brendshme, si dhe në fushën e bimëve aromatike dhe mjekësore
- Rimëkëmbja dhe zhvillimi i aktiviteteve blegtorale
- Kultivimi i peshkut në zonat liqenore
- Iniciativa për të stimuluar krijimin e fermave të përbashkëta duke organizuar fermerët e vegjël dhe të mesëm në forma të shoqatave kooperative;
- Trajnimi dhe mbështetja për formimin e kopshteve urbane të shpërndara në zonat me marginalizim të madh dhe varfërisë urbane;

- Zhvillimi i një sistemi të ofertave të hotelerisë cilësore, lidhur me vlerësimin e produkteve dhe traditave ushqimore lokale.
- Organizimi i Sektorit Teknik për Bujqësinë pjese e strukturës së Bashkisë.

Rreziqet

- Rritja progresive e përdorimit të tokës bujqësore për banim, që sjell fragmentimin dhe dëmtimin e tokave bujqësore.
- Problemet e lidhura me sistemin e pronësisë. Në shume raste Z.V.R.P.P. Shkodër behet pengese për dhënien e dokumentacionit të pronësisë në kohë.
- Humbja e tokës bujqësore për shkak të përmytjeve të mundshme të përsëritura të lumenjve (pasojat ekonomike të rrezikut të pakontrolluar hidro-geologjik)
- Humbja e tokës dhe kulturës së specializuar bujqësore për shkak të braktisjes dhe degradimit mjedisor që rrjedh prej tij;
- Humbja e cilësisë dhe vlerës së peizazhit për shkaqet e braktisjes së kulturave të specifike (ullinj, vreshtat, pemëtoret).

3.1.1.5 Analiza SWOT – Sistemi Urban

Pikat e forta

- Prania e zonave urbane me mundësi dendësimi të ndërtesave dhe të rritjes së faktorëve urbanë (urbanizim dhe shërbime)
- Prania e ndërtimeve të reja ose e ndërtesave me moshë mesatare, pa probleme serioze strukturore
- Zona urbane të karakterizuara nga funksione mikse, pa probleme të dukshme ndarjeje
- Kosto të ulëta ndërtimi
- Prania e veprave energjetike me rëndësi kombëtare
- Prania e zonave me interes historik dhe kulturor (Vigu, Sapa, Danja, Sarda, Komani)

Pikat e dobëta

- Mungesa e hapësirave të gjelbra në zonat rezidenciale
- Mungesa e hapësirave të dedikuara lojërave të fëmijëve dhe kohës së lirë të të moshuarve
- Mungesa e ndërtesave publike me funksion specifik të lidhur me kulturën, artin dhe turizmin
- Degradimi i zonave urbane, urbanizim i pakontrolluar dhe i paplanifikuar
- Prania e ndërtimeve informale dhe e ndërtesave edhe në zona bujqësore në mungesë totale të veprave të urbanizimit primare dhe sekondare
- Prania e problematikave të ndryshme të lidhura me strehimin, në veçanti lidhur me kërkesën e ndërtimit social

- Rritje urbane spontane përreth kornizës infrastrukturore dhe rurale. Zhvillimi është i tipit spontan, jo i planifikuar dhe është i karakterizuar së pari nga intensifikimi i të ndërtuarit në zonat qendrore dhe pranë rrugëve kryesore të qarkullimit
- Mungesa e hapësirave publike dhe cilësi e dobët e atyre ekzistuese.
- Mungesë e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave urbane
- Prania e ndërtimeve të reja ose me moshë mesatare, që nuk respektojnë normat ndërkombëtare të sigurisë sizmike dhe të kursimit të energjisë
- Prania e një pjese të konsiderueshme të ndërtesave publike tashmë të ndërtuara, me cilësi të ulët të ndërtimit, me paqartësi pronësie, që nuk respektojnë standardet normale të ndërtimit dhe natyrisht standardet ndërkombëtare të mbrojtjes sizmike dhe të kursimit të energjisë, me aspak ose shumë pak vlerë ekonomike
- Mungesë e kujdesit për zonat me vlerë historike dhe me impakt të rëndësishëm në terma të peizazheve vizuale

Mundësitë

- Rehabilitimi administrativ dhe urbanistik i ndërtesave informale në proces legalizimi
- Mundësi e zhvillimit të industrisë së lehtë dhe asaj bujqësore me anë të prodhimit cilësor
- Përmirësimi i sistemit të mobilitetit, nëpërmjet realizimit dhe riorganizimit të rrjetit automobilistik dhe integritit dhe rritjes së transportit ujqor, hekurudhor, rrugëve pedonale dhe pistave çiklistike
- Zhvillimi i sektorit turistik në lidhje me natyrën, kulturën, sportin, itineraret eno-gastronomike (turizmi me bazë ushqimet lokale), lidhur me ofertat e reja pritëse (hotele, bed&breakfast, agro-turizmi, hostelet rinore, kampingjet) dhe me shërbimet plotësuese të turizmit (zona sportive, golfi, qendrat e hipizmit, shtigjet e kalërimit, qendrat sportive të integruara, parqet për aventura, etj.)
- Mundësia e ndërtimit të ndërtesave publike (shërbime publike) në terrenet në pronësi të bashkisë, ose në formën e kompensimeve të të drejtës së pronësisë mbi prona private, sipas programeve të barazisë urbanistike
- Mundësia e realizimit të veprave të urbanizimit në formën e një konsorciumi për zbritjen e kostove të urbanizimit ose nëpërmjet operacioneve Project Financing (projekte të vetëfinancuara)

Rreziqet

- Degradimi i përgjithshëm i gjendjes së banesave dhe i mjedisit urban
- Humbja e karakterit dhe e identitetit të qendrave historike
- Ndotje progresive dhe rritje e rrezikut mjedisor (në veçanti landfilli i Bushatit)
- Humbje progresive e jetës sociale në qendrat e vogla rezidenciale
- Braktisje dhe degradim progresiv, zvogëlim i dendësisë së popullsisë në zonat malore verilindore, si pasojë e pamundësisë së shtrirjes së shërbimeve

- Prirja për vazhdimësinë e fenomeneve të ndërtimit të paligjshëm, për shkak të mungesës së kontrollit dhe rregullave sanksionuese

3.1.1.6 Analiza SWOT – Sistemi Infrastrukturor

Pikat e forta

- Pozicioni dhe afërsia me korridoret e mëdha kombëtare të trafikut dhe me nyjat kryesore të transportit (prania e rrugës ndërrbane (SH1) Tiranë-Hani i Hotit si pjesë e korridorit strategjik gjatësor, rrugës ndërrbane (SH5) Shkodër-Kukës e cila realizon lidhjen e pjesë Veri-Perëndimore me atë Veri-Lindore të Shqipërisë, si një nga akset e rëndësishme tërthore mbështetëse, linjës hekurudhore Durrës – Hani i Hotit dhe afërsia me Portin e Shëngjinit).
- Prania e disa tipave të transportit, transporti rrugor, hekurudhor (11.82km hekurudhë të linjës Durrës – Hani i Hotit) dhe ai ujor i brendshëm (lundrimi përgjatë liqeneve artificiale në lumin e Drinit).
- Mbulim i plotë nga rrjeti elektrik i zonës kryesore urbane
- Prania e veprave energjetike me rëndësi kombëtare (HEC Ashta 1, Ashta 2, Vau i Dejës, Koman)

Pikat e dobëta

- Infrastruktura rrugore lokale në gjendje jo të mirë deri në të keqe
- Pamjaftueshmëri në furnizimin me ujë dhe largimin/trajtimin e ujërave të zeza
- Mungesa e një sistemi racional të largimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane
- Mungesa e një rrjeti të transportit publik mes qendrave urbane
- Rrjet hekurudhor i amortizuar
- Mosrespektim i distancave të ndërtimeve të reja nga kufiri i rrugëve, veçanërisht përgjatë akseve kombëtare
- Rrezikshmëri e lartë dhe nivel i lartë aksidentesh në kryqëzimet dhe nyjat lidhëse (kryqëzimet në nivel) të rrjetit rrugor kryesor dhe dytësor

Mundësitë

- Rivitalizimi i rrjetit hekurudhor në kuadër të lidhjes në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar (lidhje me Malin e Zi) dhe si bazë e riorganizimit të marrëdhënieve në shkallë rajonale dhe lokale
- Përmirësimi i infrastrukturës të mobilitetit duke transformuar Vau-Dejës në pikën kryesore të tërheqjes së flukseve të turizmit natyror, kulturor dhe mjedisor të rajonit Shkodër – Lezhë
- Zhvillimi i rrjetit të transportit ujor si infrastrukturë shërbimi urban dhe si rrjet i promovimit turistik.
- Zhvillimi i një rrjeti të lëvizshmërisë të ngadaltë, të integruar me realizimin e rrjetit ekologjik rajonal dhe kombëtar

- Mundësia e lidhjes së Vau-Dejës me bregdetin e Velipojës dhe atë të Shëngjinit.
- Zhvillimi i turneve tematike në mbështetje të turizmit kulturor dhe mjedisor dhe të lidhur me vlerësimin e resurseve bujqësore dhe ushqimore lokale
- Afërsia me aeroportin e Gjadrit si infrastrukturë me potencial turistik zhvillimi në të ardhmen

Rreziqet

- Zhvillim urban përgjatë akseve infrastrukturore dhe lidhjeve të tyre, që sjell rreziqe reciproke për efikasitetin e brendshme, si të sektorit të sistemeve urbane, ashtu edhe të mobilitetit
- Degradim progresiv i rrjeteve ekzistuese për shkak të mungesës së resurseve të përshtatshme dhe nga nevoja në rritje për investime
- Mungesa e fondeve për mirëmbajtjen e duhur të rrjeteve dhe infrastrukturave
- Rreziqe të lidhura me realizimin e infrastrukturave të reja, pa ndërhyrjet e duhura të masave zbutëse (ndotja e burimeve natyrore, rritja e pakontrolluar urbane, impakt mbi peizazhin dhe mbi zonat natyrore)
- Rreziku potencial i ndotjes nga landfili i Bushatit.
- Rreziqe të lidhura me përmytjet si pasojë e pamundësisë së kontrollit mbi prurjet në infrastrukturën e energjisë hidroelektrike si dhe për shkak të mungesës apo amortizimit të infrastrukturës mbrojtëse.

3.1.2 Strategjia territoriale për secilin nga pesë sistemet territoriale të Bashkisë Vau-Dejës (N, U, B, UB, IN)

Strategjia territoriale, është shtjelluar për secilin sistem territorial në listat e objektivave strategjike të sektorit, përcaktimi i të cilave bëhet edhe në bazë të rezultateve të analizës SWOT të secilit sistem.

Përmbledhja krahasuese e rezultateve të analizës SWOT, shoqëruar me listën e këtyre objektivave, sqaron këtë marrëdhënie dhe formon bazën për përcaktimin e projekteve që plotësojnë dhe japin rezultatin faktik të Planit Strategjik për Bashkinë Vau-Dejës.

Në vijim paraqiten direktivat e përgjithshme të zhvillimit për secilin nga pesë sistemet territoriale.

3.1.2.1 Sistemi Natyror (N)

- Mbrojtja dhe zgjerimi i biodiversitetit të territorit.
- Lidhja e Parkut Kombëtar të Alpeve me Peizazhin e Mbrojtur Bunë-Velipojë, nëpërmjet luginës së Drinit duke krijuar një korridor të lundrueshëm, natyror e peizazhistik mal-det.
- Zbutja dhe ulja e ndikimit të vendbanimeve ekzistuese urbane brenda dhe përreth zonave natyrore të mbrojtura.

- Zvogëlimi progresiv dhe zhdukja e niveleve aktuale të ndotjes së lumenjve / liqeneve, në harkun kohor të dy dekadave.
- Rritja e zonave pyjore në zonat kodrinore e malore.
- Promovimi i turizmit natyror, lundrimit dhe të ekskursionit.
- Ndërtimi dhe menaxhimi i rrjetit ekologjik territorial, si një lidhje strukturore midis zonave me vlerë dhe pasuri të madhe të biodiversitetit.

Figura 3.1 Harta e sistemit natyror

3.1.2.2 Sistemi Ujor (U)

- Zhvillimi i lundrimet (transportit), të turizmit sportiv dhe peshkimit.
- Modernizimi i rrjetit të ujësjetllësit dhe rrjeteve të shpërndarjes lokale.
- Ruajtja, modernizimi dhe rritja e kapacitetit prodhues të hidrocentraleve.
- Forcimi i sistemit të menaxhimit dhe shpërndarjes së ujit publik, i parë si një nga të mirat/resurset e përgjithshme.
- Krijimi i një Autoriteti Publik Menaxhimi të burimeve ujore, në njohjen e zonave homogjene territoriale, si një mjet kontrolli dhe menaxhimi të cilësisë.




Figura 3.2 Harta e sistemit ujor

3.1.2.3 Sistemi Bujqësor (B)

- Promovimi dhe zhvillimi i modernizimit dhe inovacionit në sektorin e industrive vendase dhe në sektorin e integrit të zinxhirëve të strukturave të prodhimit dhe përpunimit të ushqimit.
- Promovimi dhe zhvillimi i prodhimit cilësor në sektorin bujqësor, blegtoral dhe pyjor (produktet e Zadrimës).
- Përmirësimi i aftësive sipërmarrëse dhe profesionale të punëtorëve në sektorin e bujqësor dhe pyjor.
- Promovimi i metodave të kultivimit biologjik dhe të permakulturës.
- Konvertimi për përdorim bujqësor, i zonave të degraduara dhe të braktisura.

- [illegible]

- Riorganizimi dhe zhvillimi i strukturave mbështetëse për aktivitetin bujqësor, të tilla si shoqëritë (konsorciumet) bujqësore për shërbim dhe trajnime, për fermat e vogla dhe të mesme.
- Rivendosja në punë e rrjetit të kanaleve të vaditjes e kullimit të tokave bujqësore, gjë e cila do shërbejë edhe si një masë mbrojtëse nga përmytjet.
- Zhvillimi i ndërtimit të objekteve të logjistikës për mbledhjen, ruajtjen, ngrirjen dhe shpërndarjen e produkteve ushqimore vendore, mbi bazë të konsorciumit dhe/ose kooperativës.
- Promovimi i krijimit të qendrave të kërkimit dhe trajnimit në agrobiznes dhe edukimit në mirë ushqimin, madje edhe në shkolla dhe fushën e arsimit (shkolla profesionale Bushat).
- Promovimi i ngritjes e shpërndarjes territoriale të strukturave akomoduese (struktura agro-turizmi, B&B ekologjike, ferma didaktike, fshatra ekologjike) dhe të

restoranteve cilësorë që valorizojnë produktet dhe traditat ushqimore vendase, si dhe peshkimin dhe kultivimin e peshkut.

3.1.2.4 Sistemi Urban (UB)

- Nxitja e rikuperimit dhe rivitalizimit të qendrës historike të qytetit të Vau-Dejës si dhe qendrave të vogla urbane apo monumenteve historike, nëpërmjet përdorimit turistik.
- Fuqizimi i aktiviteteve akomoduese dhe shërbimeve plotësuese për turizmin kulturor, mjedisor, sportiv (aktiv), ujqor, në zonat urbane të Vau-Dejës, pranë fshatrave Nënshat, Vig, Koman, në zonën me interes natyror, peizazhistik dhe mjedisor të luginës së Drinit, si dhe në fshatrat e zonave të thella malore.
- Përshtatja sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kategorive të urbanizimit kryesor (rrjetet kryesore) në zonat urbane dhe në vendbanimet informale të legalizuara
- Përshtatja sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të pajisjes me shërbime urbane dytësore (arsim, struktura publike, gjelbërim dhe parkim) në zonat urbane kryesore
- Zhvillimi i shërbimeve të reja urbane në Vau-Dejës, Mjedë, Bushat, Rranxë, Barbullush, dhe Hajmel dhe lokalitetet e tjera të mëdha urbane (qendra formimi dhe aftësimi, biblioteka dhe mediateka lokale).
- Zhvillimi i sistemeve me lëvizje urbane alternative (pista biçikletash, rrjete pedonale) të integruara me sistemin e transportit publik automobilistik dhe hekurudhor
- Racionalizimi dhe zgjerimi i rrjetit të rrugëve automobilistike, të integruar me sistemin e parkimeve urbane dhe territoriale.
- Rimëkëmbja dhe ripërdorimi, si një korridor transporti me lëvizje të shpejtë, i linjës ekzistuese hekurudhore, në përputhje me rimëkëmbjen e saj si një infrastrukturë e rëndësishme kombëtare; rehabilitim ky, i parashikuar edhe në PPK.
- Nxitja e qasjes, përdorimit dhe shkëmbimit të resurseve urbane të përbashkëta (Urban Commons) për të gjithë qytetarët, me vëmendje të veçantë për personat me aftësi të kufizuara.
- Garantimi i qyteteve dhe të mirave të përbashkëta të aksesueshme, të sigurta dhe që arrijnë drejtpërdrejtë të fëmijët (Qyteti mik i fëmijëve).




Figura 3.4 Harta e sistemit urban

3.1.2.5 Sistemi Infrastrukturor (IN)

- Garantimi i efikasitetit dhe funksionimit të plotë të rrjetit infrastrukturor me karakter kombëtar (korridorit kombëtar) nëpërmjet ndarjes së trafikut lokal, realizimit të kryqëzimeve të rrafshëta dhe mbikalimeve të rrjeteve lokale, transformimi progresiv në autostradë.
- Zhvillimi i polit të lëvizjes plurimodale dhe ndërlidhjes Mjedë – Vau-Dejës (hekurudhë, rrugë automobilistike, lundrim, korsi biçikletash, shtigje këmbësore)
- Krijimi i një rrjeti transporti ujor publik dhe funksional
- Rimëkëmbja dhe zhvillimi i rrjetit hekurudhor kombëtar, për lidhje ndërkombëtare si dhe për përdorim urban dhe lokal.
- Rimëkëmbja dhe zhvillimi i stacioneve hekurudhore, si pikat aksesi dhe shërbimi të qendrave të banuara, dhe si pika të lidhjes me rrjetin e korridoreve të gjelbër, të cilët realizojnë ndërveprimin ndërmjet zonës bregdetare dhe asaj malore.
- Krijimi i një qendre logjistike strategjike, e lidhur me hekurudhën dhe korridorin infrastrukturor.
- Zhvillimi dhe konsolidimi i rrjetit të parkimit në nivel territorial, urban dhe lokal.

3.1 Ndërhyrjet në Infrastrukturën publike dhe rrjeti rrugorë i propozuar

3.1.1 Furnizimi me ujë dhe kanalizimet

Furnizimi me ujë të pijshëm

Të përgjithshme

Bashkia Vaut-Dejës, pavarësisht burimeve të shumta ujore, ende nuk garanton mbulim tërësor të territorit me këtë shërbim publik. 19 rrjete sistemi të ujësjellësve operojnë gjithsej në bashki, ku vetëm 9 operojnë në Bushat, që përfaqëson edhe njësinë administrative që paraqitet më mirë me furnizimin me ujë të pijshëm të popullatës. Nga 19 rrjetet e ujësjellësit, 13 prej tyre janë me rrjete me ngritje mekanike, pra që kanë edhe sistemet përkatëse të pompimit (respektivisht 15 sisteme pompimi). 5 rrjete ujësjellësi janë me rrjedhje të lirë, çka do të thotë se janë sisteme me kosto të reduktuara të funksionimit. Vetëm 4 prej tyre, funksionojnë në njësinë administrative Shllak. Këto sisteme ujësjellësi favorizohen nga natyra kodrinore e zonës.

Një pjesë e konsiderueshme e familjeve në fshatra sigurojnë ujin e pijshëm nëpërmjet burimeve natyrore (krua) si dhe nëpërmjet përdorimit të puseve. Problematik mbetet furnizimi me ujë higjienikisht të pastër për 24 orë të familjeve në zonën urbane të Vaut të Dejës. Kjo zonë ka një numër të madh të familjeve, që aktualisht nuk u sigurohet ujë i pijshëm nëpërmjet rrjetit të ujësjellësit.

Gjendja ekzistuese

Në asetet e UK sh.a Vau-Dejës, si elementë të sistemeve të furnizimit me ujë bëjnë pjesë:

- Katër rezervuarë rregullues me kapacitet përkatësisht 500, 200, 100 dhe 50 m³;
- Tre stacione pompimi;
- Linjat e dërgimit të ujit nga stacionet e pompimit për në rezervuarë (linjat e jashtme), rrjeti i tubacioneve shpërndarës të ujit nga rezervuarët për tek konsumatori, pajisjet elektromekanike, elektrike, rakorderitë hidraulike, pusetat, saraçineskat, pus-shpimet, etj.

Furnizimi i rezervuarëve me kapacitet 500 m³ dhe 200 m³, kryhet nga një stacion pompimi i ndërtuar në vitin 1980 dhe i rikonstruktuar në vitin 2012. Stacioni përbëhet nga 4 pompa, secila me kapacitet 108 l/min, dy prej të cilave janë jashtë funksionit.

Dy stacionet e tjera, të ndërtuara në vitin 1966, aktualisht janë jashtë funksionit.

Rezervuarët e ujit janë prej betoni të armuar dhe guri. Dy prej tyre (100 dhe 50 m³) janë jashtë funksionit.

Rrjeti i linjave të jashtme, magjistrалët dhe rrjeti shpërndarës i tubacioneve të ujit, janë realizuar me tubacion çeliku që varion nga Ø 300 - 70 mm me një gjatësi totale prej 21.350 ml, si dhe me tuba zinkato 2 "deri ¾", me një gjatësi prej 10.950 ml.

Tubacionet janë shtrirë përgjatë bankinave të segmenteve rrugore, në mënyrë që të furnizojnë një numër sa më të madh banesash për një gjatësi sa më të shkurtër. Në përbërje të rrjetit janë edhe 8 puseta kontrolli me dimensione 1.5 x 1.5 x 1.5 m, si dhe 24 saraçineska për kontrollin e fluksit. Numri i kontatorëve për abonentët është 738.



Figura 3.6 Vendndodhja e stacioneve të pompimit (majtas: jashtë funksionit; djathtas: në funksionim)

Kanalizimet e ujërave të përdorura

Përgjithësisht, rrjeti i KUP paraqet infrastrukturën publike më kritike në bashki. Ky sistem është pothuajse inekzistent. Shifrat në këtë shërbim përfaqësohen vetëm nga 7.5 km rrjet kryesor në Bushat, nga i cili përfitojnë 1.100 familje. Ndërsa në Hajmel, për shkak të iniciativës së vetë banorëve, është ndërtuar rrjeti sekondar i KUP me gjatësi 0.5 km, që ka përfshirë 378 familje përfituese.

Metoda kryesore e evakuimit të ujërave të përdorura, në kushtet e mungesës së infrastrukturës së KUP, janë përdorimi i gropave septike, të cilat ndikojnë negativisht në parametrat mjedisorë.

Në këto kushte, prioritet për ndërtimin e rrjeteve të ujërave të përdorura dhe pastrimin e tyre, mbeten zonat urbane në Vau-Dejës, që përfaqësojnë përqendrimet më mjaftueshme të popullsisë për investime në infrastrukturë të tillë.

- Njësia Administrative Vau-Dejës

Rrjeti i furnizimit me ujë për qytetin Vau-Dejës është ndërtuar që në vitin 1964. Ndërrhyrjet për rehabilitimin e tij datojnë në vitet 1995 dhe 2006. Gjatë ndërhyrjes së fundit është kryer rikonstruksioni i rrjetit nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, por aktualisht vetëm 20 % e këtij rrjeti është në funksion.

Vepra e marrjes ndodhet në Laç, brenda territorit të qytetit. Prurjet që merren nga pushepi janë përkatësisht 45 l/sek (minimale) dhe 75 l/sek (maksimale).

Linja e jashtme e ujësjellësit është e përbërë kryesisht prej tub çeliku, me gjatësi 19.8 km, dhe tub zinkato me gjatësi 14.1 km. Diametri i kësaj linje varion nga 1 " deri 200 mm.

Furnizimi i linjës së jashtme kryhet nëpërmjet stacionit të pompimit në Vau e Dejës, prurja e të cilit, në varësi të sezonit, varion nga 50 - 70 l/sek.

Aktualisht sistemi ka në përbërjen e vet katër rezervuarë, me kapacitetet përkatëse, siç është përmendur më sipër.

Përsa u përket linjave shpërndarëse, ato janë të përbëra kryesisht prej tub çeliku, me diametër 76 - 133 mm, dhe tub zinkato, me diametër 1/2 - 2 ".

Sasia ditore e ujit të prodhuar arrin deri në 2.066 m³, ndërsa çmimi i faturimit varion në varësi të subjektit: 20 ALL/m³ për familjarët, 80 ALL/m³ për institucionet dhe subjektet private.

Sasia e ujit të faturuar është rreth 2.440 m³/muaj për abonentët të pajisur me matës uji dhe 11.200 m³/muaj për abonentët pa matës (*à forfait*), pra rreth 22 % e sasisë së prodhuar.

Sasia e inkasimeve arrin 269.000 ALL në muaj. Numri i abonentëve me kontratë të miratuar nga ERU është 976, ndërsa nuk ka sisteme individuale të furnizimit me ujë.

Lidhur me cilësinë e ujit të shpërndarë, çdo muaj kryhen analizat rutinë nga ana e DRSH dhe nuk ka pasur probleme të cilësisë.

Kohëzgjatja mesatare ditore e furnizimit me ujë është 9 orë.

- Njësia Administrative Bushat

Rrjeti i furnizimit me ujë për qytetin e Bushatit është ndërtuar që në vitin 1998. Deri më sot nuk ka pasur asnjë ndërhyrje rehabilitimi.

Linja e jashtme e ujësjellësit është e përbërë kryesisht prej tub polietileni, me gjatësi 8.424 ml.

Furnizimi i linjës së jashtme kryhet nëpërmjet stacionit të pompimit, prurja e të cilit është rreth 30 m³/h.

Rregullimi i prurjes ditore bëhet nga rezervuari rregullues në kuotën 300 m.

Sasia ditore e ujit të prodhuar arrin në 300 - 360 m³/ditë, ndërsa sasia e ujit të faturuar është 60 % (6.480 m³/muaj, 272.160 ALL/muaj).

Çmimi (tarifa) i faturimit është 42 ALL/m³ për të gjitha subjektet. Sasia e inkasimeve është 40 % e ujit të faturuar, rreth 108.864 ALL/muaj.

Numri i abonentëve të lidhur me sistemin e centralizuar është 265, ndërsa nuk ka sisteme individuale të furnizimit me ujë.

Lidhur me cilësinë e ujit të shpërndarë, çdo muaj kryhen analizat rutinë nga ana e DRSH dhe nuk ka pasur probleme të cilësisë.

Kohëzgjatja mesatare ditore e furnizimit me ujë është 12 orë.

Si problem kryesor në funksionimin e sistemit evidentohet gjendja e amortizuar e pompave në stacionin e pompimit.

- Njësia Administrative Hajmel

Aktualisht në territorin e kësaj njësie funksionon vetëm një rrjet ujësjellësi që është ai që furnizon një pjesë të fshatrave të njësisë administrative, ndërkohë që disa fshatra furnizohen nga pusët private. Rrjeti i ujësjellësit të njësisë është ndërtuar në vitin 1995, është rikonstruktuar në vitin 2009 dhe mbulon vetëm një pjesë të territorit të Hajmelit, ndërkohë që një pjesë e mirë e tij furnizohet me ujë nga pusët private. Problematikë mbetet mungesa e një sistemi të filtrimit të ujërave.

Me gjithë investimin e kryer, UK sh.a Vau-Dejës nuk ka kapacitete të mjaftueshme për furnizimin me ujë të të gjithë territorit të njesisë.

3.1.2 Furnizimi me energji elektrike

Furnizimi me energji elektrike ne TL

Vau-Dejës furnizohet me energji elektrike nga nënstacioni 220/110/6KV. Shërbimi i furnizimit është i vazhdueshëm gjatë 24 orëve për qytetarët dhe bizneset (me përjashtim të rasteve të veçanta*).



Figura 3.7: Harta energjetike e rajonit

Nënstacioni furnizohet nga hidrocentrali i Vau-Dejës. Azhornimet e këtij hidrocentrali dhe nënstacionit kanë qenë të shpeshta, por jo duke bërë ndryshime thelbësore në kapacitetet prodhues dhe transmetues për konsumatorët e rrethinave.

Ky HEC rezervon hapësira për rritje të rendimentit dhe kapacitetit prodhues. Rezervat janë konkrete bazuar në kapacitetin përpunues të rezervave hidrike dhe mundësisë për shtesa të hidro-gjeneratorëve elektrik dhe rritjen e kapacitetit të atyre ekzistues.




Figura 3.8: Pasqyrë përmbledhëse e HEC V. Dejës

Përsa i përket perspektives për ndërtim të veprave të reja për prodhimin e energjisë elektrike duhet thënë dhe duke u bazuar dhe në studimet e divizionit të prodhimit KESH, që ndërtimi i HEC-ve të tjerë midis HEC Ashta 1&2 nuk është e mundur për arsye teknike. Shtimi i HEC-eve të tjerë do të ndërhynte në regjimin e punës së Ashta 1&2, për shkak të devijimit dhe kushtëzimit të kapaciteteve hidro-gjeneruese.




Figura 3.9 Rrjeti energjetik rajonal




Figura 3.10 Skema e rrjetit prodhues të energjisë elektrike, rajoni V. Dejes

Furnizimi me energji elektrike TM

Ndërsa gjendja ekzistuese e furnizimit me energji elektrike te zonës është duke u përmirësuar. Këtu bën pjesë rinovimi i rrjetit të ri 20KV ne Bushat. Linjë e cila furnizohet nga nënstacioni i Shkodrës.

Përsa i përket zonave të tjera, Vig-Mnelë, Hajmel, Temal, Shllak, rrjeti ekzistues TM vazhdon te jete 6KV dhe tejet i amortizuar.

Për shkak te nivelit të tensionit aktual 6kV, linjave ajrore të ngarkuara, cilësia e furnizimit me energji deri në kabinat elektrike. Vihen re humbjet te tensionit ne TM qe ne momente piku kalojnë 10% ΔU problem qe i shtohet dhe humbjeve te tensionit ne TU.

Po kështu problemet e mësipërme kane dhe anën negative te tyre te cilat janë humbjet teknike ne rrjet. Këto humbje qe llogariten rreth 22% kane dhe koston financiare te tyre.

Gjendja aktuale e linjave ajrore paraqiten ne kushte te këqija dhe jashtë normave te sigurimit teknik. Ne shume pjese te trakteve te linjave vihen re kurora te bimësisë qe kalojnë distancën e sigurisë me linjat elektrike, gjithashtu godina banimi shume afer me keto linja, shtylla te dala nga qendra e rëndesës si dhe izolator te shumëllojshëm për te cilat karakteristikat teknike elektrike dhe mekanike janë te ndryshme.

Kapacitet energjetike te zonës kane kapacitetet e duhura për furnizimin me energji si nga nënstacioni i Shkodrës (i cili tashme është kthyer ne anën sekondare ne 20KV) ashtu dhe nga nënstacioni i Vaut të Dejës, megjithëse ky i fundit duhet te ndryshoj tensionin ne sekondar.

Investimet do te prekin jo vetëm pjesën gjeneruese te rrjetit por edhe ndryshimin e linjave ekzistuese 6KV ne 20KV.

Pjese e këtyre investimeve duhet te jene dhe kabinat elektrike dhe sjellja ne parametra standarde sipas normave ne fuqi nga OSHEE.

Furnizimi me energji elektrike TU

Ashtu si dhe rrjeti ne TM dhe rrjeti elektrik ne TU është tejet i amortizuar dhe i ngarkuar. Shumica e këtyre linjave përbëhen nga linja ajrore me përcjellës alumini të zhveshur.

Përgjatë trakteve te këtyre linjave vihen re lidhje dhe degëzime jashtë kushteve teknike si dhe përdorimi i materialeve rrethanore apo produkte te pa standardizuara për te tilla rrjete.

Probleme kryesore hasin zonat periferike, siç u tha dhe më sipër, duke nisur qe nga humbjet e TM ne transmetim deri ne kabine elektrike. Shtimi i konsumatorëve ka çuar ne një mbingarkesë te këtyre kabinave. Dëmtimet elektrike te transformatorëve nga faktorë elektrik nuk kane qene te rralla.

Mosstandardizimi i rrjetit transmetues ne TU here pas here është bere dhe burim aksidentesh dhe ndërhyrjesh te pa ligjshme ne rrjet.

Vihet re diversitet tipologjie produktesh qe përbejnë rrjetin shpërndarës duke nisur qe nga standardi shqiptar (pjese qe ka ngelur nga rrjeti i trashëguar), produkte te standardizuara nga Evropa lindore si dhe produkte EC. Xhuntimet dhe ndërhyrjet ne linja janë jashtë kushteve teknike ne kontakt me agjentet atmosferik.

Ndriçimi publik Rrugor

Vau-Dejës është në rritje dhe zhvillim të vazhdueshëm, zone me potencial të jashtëzakonshëm turistik. Si e tillë ndriçimi i ambienteve publike të qytetit kthehet në një domosdoshmëri. Pjesa më e madhe e lagjeve të zonës aktualisht janë të ndriçuara, por teknologjia e përdorur le për të dëshiruar pasi ky sistem ndriçimi konsumon dhe ndikon në ndotje mjedisore. Ndriçimi nuk është i kënaqshëm dhe kostoja e mirëmbajtës është relativisht e lartë.

Integrimi i ndriçimit LED është pjesë përbërëse e të gjithë procesit që ka të bëjë me zhvillimin e realizimin e suksesshëm të të gjitha objektivave strategjike për këtë qytet. Kostot e faturave elektrike që Bashkia paguan për ndriçimin e qytetit janë të larta, dhe ky investim do ketë një kthim tepër të lartë duke konsideruar uljen e ndjeshme të këtyre kostove.

Ndriçimi LED lidhet jo vetëm me zhvillimin bashkëkohor infrastrukturor të qytetit, por dhe atë ekonomik, me peizazhin e zhvillimin miqësor me mjedisin. Nëpërmjet këtij projekti synohet të zëvendësohen llambat ekzistuese me llamba të reja të teknologjisë LED, të cilat sigurojnë një ndriçim më të mirë, kursejnë energji në mënyrë të konsiderueshme dhe kanë një jetëgjatësi më të lartë. Ky investim do ketë një kthim tepër të shpejtë duke konsideruar uljen e ndjeshme të kostove.

Rrjeti shpërndarës elektrik në zonën e qytetit

Pjese e zonave në zhvillim turistik, përveç atij agroturistik është dhe zona e liqenit.

Si shtypte për zhvillim është dhe elektrifikimi në mënyrë konstante dhe të sigurtë i këtyre zonave.

Rrjeti Telefonik

Në këtë zone ushtrojnë aktivitetin të telefonisë fikse (Albtelekom sh.a) dhe asaj të lëvizshme, nëpërmjet operatorëve, T-Mobile, Vodafone, Eagle Mobile dhe Plus.

Për secilën zonë turistike të vendoset një ambient "P.T", ku të parashikohet central telefonik me kapacitetin e nevojshëm për furnizimin e abonentëve të zonës. Në ambientet publike të vendosen kabina telefonike me kartë.

Rrjeti shpërndarës i telefonisë të realizohet me linjë kabllore telefonie, futur në tubo plastmasi shtrirë në tranche përgjatë trotuarit, në zonat ku nuk mundësohet kalimi në trotuar të kalohet në linja ajrore fiksuar me tirant.

3.1.3 Mbledhja dhe menaxhimi i mbetjeve

Menaxhimi i mbetjeve në Shqipëri është në një nivel të ulët. Shërbimi i grumbullimit dhe largimit të mbetjeve të ngurta urbane kryhet në pjesën më të madhe të qyteteve. Riciklimi kryhet për një pjesë shumë të vogël të mbetjeve. Metoda më e përdorur e asgjësimit të mbetjeve është hedhja e tyre. Në vend që ka landfille të ndërtuara siç duhet. Shërbimi i grumbullimit dhe largimit të mbetjeve nuk kryhet në zonat rurale dhe në qytetet e vogla. Asgjësimi i pjesës më të madhe të mbetjeve në këto zona bëhet duke i hedhur neper kanale, lugina apo anash rrugëve dhe pasi bëhet pastrimi i rrugëve ato hidhen në vendet tjera dhe në fundmi edhe në rrjedhat e ujërave. Nuk ekziston një sistem për menaxhimin e sigurtë të

mbetjeve te rrezikshme (familjare dhe tregtare). Riciklimi i mbetjeve eshte ne nje nivel te dobët.

Aktualisht shërbimi i pastrimit në bashkinë Vau-Dejës është një shërbim në nivele të kënaqshëm dhe përbën praktikë të mirë për vendin tonë. Shërbimi i pastrimit ofrohet nëpërmjet instrumentit të bashkëpunimit ndër vendor, instrument i konsoliduar mes disa njësive vendore në rajon që përpara reformës territoriale. Ndër komunalja e Zadrimës lehtëson ofrimin e shërbimit për një pjesë të madhe të territorit të bashkisë Vau-Dejës. Mbetjet organike, bimore apo shtazore, kompostohen pranë shtëpive me qëllim ripërdorimin e tyre për pleh për kulturat bujqësore, ndërsa mbetjet inerte depozitohen në vendpozitime të caktuara. Një organizim i tillë ka ulur ndjeshëm kostot e depozitimit dhe transportimit të mbetjeve.

Megjithatë, ende ky shërbim nuk ofrohet në të gjithë territorin, si në Temal e Shllak. Sfidë mbetet që një organizim i tillë të ofrohet në të gjithë territorin e bashkisë, të paktën në qendrat urbane të dy njësive më të largëta.

Aktualisht, në territorin e bashkisë, në Bushat, gjendet edhe landfilli i grumbullimit të mbetjeve urbane, që ka një periudhë shërbimi për 20 vjet. Tashmë që bashkitë kanë territor më të gjerë dhe popullsi më të madhe, mund të krijohen premiset e duhura që ky landfill të përdoret në kapacitetin e tij të plotë.

3.1.4 Sistemi rrugor i propozuar

Ndërhyrjet në infrastrukturën ekzistuese të Bashkisë Vau-Dejës janë elementë të rëndësishëm të Strategjisë së zhvillimit, që janë shtruar në PPV dhe janë përvijuar në Planin e veprimit sipas prioritetit dhe mundësisë për ndërhyrjen nisur edhe nga fondet e nevojshme.

Mund të ritheksojmë se përditësimi i infrastrukturës është pjesë e domosdoshme për të mundësuar dhe garantuar çdo formë të mëtejshme zhvillimi, qoftë në planin ekonomik edhe në planin urban apo social. Rëndësia që merr Infrastruktura në hartimin e Planit vjen edhe nga futja e konceptit ligjor të Sistemit Infrastruktural.

Parashikohet ndërhyrja në sistemin ekzistues rrugor nëpërmjet tri mënyrave:

- 1) Zgjerimi i rrjetit rrugor nëpërmjet lidhjeve të reja rrugore. Konkretisht propozohen:
 - Devijimi i segmentit të rrugës Tiranë-Hani i Hotit, e cila propozohet të kthehet në rrugë të kategorisë A, gjeometria e së cilës tregohet në hartat përkatëse.
 - Propozohen disa devijime të rrugëve të kategorisë C, pranë qendrave të banuara si psh. ndërtimi i një segmenti të ri në Mjedë, në Bushat, në Barbullush etj.
 - Propozohet ndërtimi i segmenteve të reja rrugore të kategorisë E, pranë qendrave urbane.
- 2) Rikonstruksioni i rrugëve ekzistuese. Me rikonstruksion nënkuptohet çdo ndërhyrje që i bëhet trupit të rrugës (zgjerim i trupit të rrugës, asfaltimi etj.) për të përmirësuar funksionimin e saj.
- 3) Përmirësimi i rrugëve ekzistuese. Me përmirësim nënkuptohet çdo ndërhyrje që bëhet në rrugë pa ndikuar në trupin e rrugës. Në këtë mënyrë ndërhyrje përfshihet

shtimi i korsive të biçikletave paralel rrugës ekzistuese apo shtimi i zonave të gjelbëruara.




Figura 3.11 Sistem infrastrukturor ekzistues dhe i propozuar

3.2 Analiza e planeve ekzistuese, strategjive, politikave, normave dhe standardeve

3.2.1 KUADRI LIGJOR, STANDARDET DHE NORMAT

Më poshtë në trajtë të përmbledhur është dhënë i gjithë kuadri ligjor, në kontekstin e të cilit është përgatitur dokumenti i Analizës dhe Vlerësimit të Territorit të Bashkisë Vau-Dejës. Përveç akteve ligjore dhe nënligjore për planifikimin e territorit të cilët kanë qenë referenca kryesore në hartimin e këtij dokumenti, më poshtë janë dhënë disa nga ligjet dhe VKM kryesore sektoriale që do referohen nga ekspertët e fushave të ndryshme në procesin e hartimit të PPV.

Sa më sipër, vlen të theksohet që në tabelën vijuese, nuk janë paraqitur dokumente ligjor që kanë lidhje direkte me territorin e kësaj bashkie (siç mund të jenë VKM për miratimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore apo mjedisore). Ato janë dhënë specifikisht në kapitujt përkatës të këtij raporti ku trajtohen këto asete apo problematika.

Tabela 3.1 Kuadri ligjor

Ligj	Nr. 107/2014 dt. 31.07.2014	“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar me Ligjin Nr. 73/2015, Dt.Aktit: 09.07.2015)
Ligj	Nr. 115/2014 dt. 31.07.2014	“Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar me Ligjin Nr.180/2014,
Ligj	Nr. 139/2015 dt. 17.12.2015	“Për vetëqeverisjen vendore”
Ligj	Nr. 7850 dt. 29.07.1994	Kodi civil i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar)
Ligj	Nr. 8378 dt. 22.07.1998	Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar)
Ligj	Nr. 72/2012 dt. 28.06.2012	“Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”
Ligj	Nr. 91/2013 dt. 28.02.2013	“Për vlerësimin strategjik mjedisor”
Ligj	Nr. 9408 dt. 07.04.2003	Për trashëgiminë kulturore (i ndryshuar)
Ligj	Nr. 9244 dt. 17.06.2004	Për mbrojtjen e tokës bujqësore (i ndryshuar)
Ligj	Nr. 9710 dt. 10.04.2007	Për portet turistike (i ndryshuar me Ligji Nr. 28/2012)
Ligj	Nr. 9385 dt. 04.05.2005	Për pyjet dhe shërbimin pyjor (i ndryshuar)
Ligj	Nr. 9693 dt. 19.03.2007	Për fondin kullosor (i ndryshuar)
Ligj	Nr. 9817 dt. 22.10.2007	Për bujqësinë dhe zhvillimin rural
Ligj	Nr. 81 dt. 04.05.2017	Për zonat e mbrojtura
Ligj	Nr. 93/2015 dt. 27.07.2015	Për turizmin
Ligj	Nr. 10463 dt. 22.09.2011	Për menaxhimin e integruar të mbetjeve (i ndryshuar)
Ligj	Nr. 111 dt. 15.11.2012	Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore
Ligj	Nr. 9587 dt. 20.07.2006	Për mbrojtjen e biodiversitetit (i ndryshuar)
Ligj	Nr. 10006 dt. 23.10.2008	Për mbrojtjen e faunës së egër.
Ligj	Nr. 10253 dt. 11.03.2010	Për gjuetinë.
VKM	Nr. 682 dt.02.11.2005	“Për shpalljen e Lumit Buna dhe territoreve ligatinore përreth tij “peizazh i mbrojtur”.

VKM	Nr. 408 dt.13.05.2015	"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" (ndryshuar me VKM. Nr. 672, dt. 29.07.2015)
VKM	Nr. 671 dt. 29.07.2015	"Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit"
VKM	Nr. 1096 dt. 28.12.2015	Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike.
VKM	Nr. 219 dt. 11.03.2015	"Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit"
VKM	Nr. 575 dt.24.06.2015	Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte
VKM	Nr. 31 dt.21.01.2016	Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit
VKM	Nr. 691 dt. 29.07.2015	"Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015–2020"
VKM	Nr. 829 dt. 07.10.2015	Për miratimin e dokumentit "Standardet shtetërore për specifikimet teknike të infrastrukturës së informacionit gjeohapësinor në Shqipëri" tema
VKM	Nr. 942 dt. 18.11.2015	Për miratimin e rregullores "Për planifikimin dhe realizimin e fotografimit ajror të territorit të Republikës së Shqipërisë"
VKM	Nr. 1077 dt. 23.12.2015	Për miratimin e rregullores "Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për cdo temë"
VKM	Nr. 1078 dt. 23.12.2015	Për miratimin e dokumentit "Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri", tema - Kufijtë e
VKM	Nr. 410 dt. 27.06.2012	Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës
VKM	Nr. 1354 dt. 10.10.2008	Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor
VKM	Nr. 153 dt. 07.04.2000	"Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë"
VKM	Nr. 628 dt. 15.07.2015	Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve (i ndryshuar me VKM Nr. 111, dt.10.02.2016)
VKM	Nr. 283 dt. 01.04.2015	Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore
VKM	Nr. 426 dt. 13.07.2007	Për miratimin e kartës shqiptare të restaurimit
VKM	Nr. 369 dt. 18.05.2016	Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit"
VKM	Nr. 712 dt. 29.10.2014	Për miratimin e rregullores teknike "Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë"
VKM	Nr. 768 dt. 29.09.2015	Shpalljen e zonave arkeologjike "A" dhe "B" të vendbanimit të Komanit (Dalmaca e Vjetër) dhe miratimin e rregullores së administrimit

Gjithashtu, material kryesor referues, për të gjithë procesin e hartimit të PPV-së për bashkinë Vau-Dejës janë dhe Plani i Përgjithshëm Kombëtar dhe Planet Ndërsektoriale.

Gjatë fazës së parë janë siguruar edhe dokumente të tjerë që lidhen me planifikimin dhe zhvillimin ndër vite të zonave urbane në territorin e Bashkisë Vau-Dejës. Një përmbledhje më e hollësishme e dokumenteve të planifikimit paraqitet në vijim.

3.2.2 Analiza e dokumenteve të planifikimit dhe PPV-ve të mëparshme

Siç u trajtua më sipër Bashkia Vau-Dejës është e përbërë nga 6 njësi administrative, nga të cilat asnjëra nuk ka një Planin të Përgjithshëm Vendor të miratuar. Në vitet e fundit janë bërë përpjekje për hartimin e një seri dokumentesh strategjikë dhe planifikues për njësi të ndryshme administrative të bashkisë, por në asnjë rast nuk është arritur miratimi i PPV-ve.

Në vijim paraqitet një listë e Vendimeve të KRRTRSH dhe KKT në territorin e Bashkisë Vau-Dejës.

Tabela 3.2 Vendimet e KRRTRSH dhe KKT për Bashkinë Vau-Dejës

Vendime KRRTRSH	Nr. 03 19.10.2001	Për sheshin dhe lejen e ndërtimit për hidrocentralin e Bushatit ne rrethin e Shkodrës. Miratohet sip.750ha
	Nr. 14 07.05.2005	Për miratimin e studimit urbanistik dhe sheshit te ndërtimit për Objektiv "Kazerma e repartit ushtarak nr.1101 Vau Dejës-Shkodër, i forcave tokësore. Miratohet sip.364.03 ha
	Nr. 08 21.11.2006	Për miratimin e sheshit dhe lejes se ndërtimit për nënstacionin e ri elektrik 110/20 KV ne Bushat, Shkodër.
	Nr. 03 22.05.2007	Për miratimin e sheshit dhe lejes se ndërtimit për objektin « Vend depozitimi rajonal te mbetjeve urbane, ne komunën Bushat, Shkodër »
	Nr. 01 14.07.2009	Miratimi i sheshit te ndërtimit për Hidrocentralin e Ashtës ne Komunën Bushat, Qarku Shkodër.
	Nr. 04 21.07.2009	Për miratimin e studimit urbanistik dhe sheshit te ndërtimit për Objektiv "fabrika e çimentos ne komunën Bushat", ne qarkun e Shkodrës, për shoqërinë "SEASIF GROUP" sh.p.k (Miratohet sipërfaqja 16,75 ha).
	Nr. 14 21.07.2009	Detyrë Projektimi dhe Studim Urbanistik ne Komunën Bushat, Qarku Shkodër.
Vendime KKT	Nr. 05 29.12.2014	Për identifikimin e zonave te urbanizuara ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë dhe miratimin e hartave ku mund te ndërhyhet ne funksion te zhvillimit urban (i ndryshuar)
	Nr. 01 30.07.2015	Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave qe do te ndiqen nga autoritetet e zhvillimit te territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri ne miratimin e planeve te përgjithshme vendore (i ndryshuar).
	Nr. 09 09.09.2015	"Leje Ndërtimi për objektin "Hidrocentralet Gjadër 1/1; Gjadër 1/2; Gjadër 2; Gjadër 3; Gjadër 4; Gjadër 6", me vendndodhje në Komunën Qerret, Rrethi Pukë, Komuna Ungrej, Rrethi Lezhë dhe Komuna Vig Mnelë, Rrethi Shkodër, me subjekt aplikues shoqërinë konçesionare "S.P.E Gjadër" sh.p.k.

Studimi i këtyre dokumenteve bëhet për të kuptuar kontekstin ekzistues, për marrjen e të dhënave të cilat mund të jenë të ri-përdorshme në lidhje me territorin nën studim, por mbi të gjitha për të analizuar vizionet e mëparshme të zhvillimit.

Kjo analizë do të ndihmojë në propozimin e skenarëve më të qëndrueshëm në raport me territorin e bashkisë në fjalë.

3.2.3 Analiza e planeve, strategjive, politikave, dokumenteve dhe proceseve ekzistuese

Kjo fazë është mjaft e rëndësishme për njohjen me dokumentet bazë mbi të cilat administrohet dhe zhvillohet territori. Në këtë mënyrë do të mund të bëhet një analizë komplekse mbi përputhshmërinë e dokumenteve të ndryshëm, impaktin dhe efektshmërinë e tyre në politikat zhvillimore të deritanishme. Këto dokumente do të vlerësohen në disa këndvështrime: ligjore, urbane, ekonomike, sociologjike dhe historike. Burimet e informacionit do të jenë: bashkia Vau-Dejës dhe bashkitë kufitare, instituti i statistikave, AKPT, institucione të tjera kombëtare etj. Gjithashtu do të shfrytëzohet edhe dokumentacion jo zyrtar që do të mund të plotësojë panoramën e informacionit mbi territorin dhe mekanizmat e zhvillimit. Në një tentativë për të mbledhur dhe bashkuar copëzat e këtij mozaiku, do të bëhet leximi dhe deshifrimi i mekanizmit zhvillimor. Ky proces do të ndihmojë në vlerësimin pasardhës të qasjes strategjike dhe në krijimin e vizionit të ri mbi territorin.

Gjatë gjithë procesit të mbledhjes së të dhënave, konsulenti do të bashkëpunojë ngushtë me institucionet publike, në nivel lokal dhe kombëtar. Koordinatori do të supervizojë procesin e mbledhjes së të dhënave dhe do të garantojë bashkëveprimin efikas me institucionet përkatëse. Vëmendje e veçantë në këtë fazë do të kushtohet marrëdhënies me AKPT-në dhe MIE-në për identifikimin e politikave kombëtare të planifikimit që influencojnë zhvillimin e bashkisë Vau-Dejës. Informacioni i mbledhur dhe i analizuar nga ekspertët do të bëhet pjesë e vlerësimit të përgjithshëm dhe analizës së thelluar të territorit, që paraprin propozimet konkrete në nivel strategjik të PPV-së.

Në vijimësi të reformës territoriale dhe procesit kombëtar të planifikimit, konsulenti është i vetëdijshëm për nevojën mbi qasjen e integruar në shkallë rajonale dhe kombëtare. Në mënyrë që të reflektohen dhe të përmbushen më së miri objektivat zhvillimore, një analizë e hollësishme do të zhvillohet mbi dokumentacionin kryesor në shkallë kombëtare.

Dokumentet bazë mbi të cilat do të mbështetet analiza dhe vlerësimi paraprak i territorit janë:

3.2.4 Planet ekzistuese hapësinore kombëtare dhe sektoriale

3.2.4.1 Plani i Përgjithshëm Kombëtar

Në aspektin ligjor dhe teknik, dokumenti i Planit të Përgjithshëm Kombëtar "Shqipëria 2030" vendos kornizat ligjore dhe parametrat madhorë të zhvillimit, të detyrueshëm për zbatim nga organet vendimmarrëse në nivel qendror dhe lokal. Si i tillë, ky dokument ofron referencën bazë për zhvillim strategjik afatgjatë e cilësor të territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim:

- sigurimin e zhvillimit të balancuar ekonomik e social të vendit,
- menaxhimin e përgjegjshëm të burimeve natyrore të tij,

- mbrojtjen e mjedisit, ndërkohë që siguron përdorimin racional të tokës.

Bazuar në hierarkinë e vendosur nga kuadri ligjor për planifikimin e territorit, PPK do shërbejë si dokumenti kryesor orientues në procesin e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Vau-Dejës.

Propozimi i PPK-së për Polin e zhvillimit rajonal Shkodër - Lezhë, porta perëndimore e rajonit malor verior, ku përfshihet edhe bashkia e Vau-Dejës.

Ky pol përbëhet nga 5 bashki, ku bashkia Shkodër parashikohet si qendra kryesore, bashkia Lezhë si qendër e specializuar dhe bashkitë Vau-Dejës, Malësi e Madhe, Kurbin, janë qendra lokale. Bazuar në të dhënat e INSTAT-it në vitin 2001 në rajon numëroheshin 344.213 banorë, ndërsa në vitin 2011 308.797 banorë, duke shënuar një pakësim të popullatës me 10.3%. Gjithsej sipërfaqja territoriale e tij është 310.093 ha dhe përbëhet nga 37 njësi administrative. Ndonëse ky pol nuk ka sipërfaqe territoriale të konsiderueshme, ai është shumë i pasur me pasuri natyrore dhe me vlera kulturore ku vlen të përmendet plazhin i Shëngjinit, i Velipojës, liqeni i Shkodrës, lumi Mat, Buna, Drini, Alpet e thepisura, fushat e pasura bujqësore, aktivitetet agro-turistike, folklori dhe muzika karakteristike, toleranca fetare etj.




Figura 3.12 Poli i zhvillimit rajonal Shkodër – Lezhë

Ndër projektet më të rëndësishëm, që parashikohen nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar janë:

Referuar sistemit natyror, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:

- Shpallja dhe promovimi i parkut kombëtar të Alpeve si park me rëndësi rajonale dhe hartimi i politikave dhe instrumenteve financiare për nxitjen e zhvillimit të turizmit malor.

Referuar sistemit ujor, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:

- Përcaktimin e Vijës Blu dhe respektimin strikt të saj si kufiri i zonave mbrojtëse të të gjitha burimeve ujore, sipas përcaktimeve të legjislacionit sektorial në fuqi dhe Rregullores së Planifikimit të korrikut 2015, në mënyrë që të mbrohet ekosistemi natyror i zonës.

- Qendrat primare dhe sekondare duhet të pajisen me impiant të trajtimit të ujërave të ndotur, përpos 3 impianteve ekzistues/të planifikuara Shkodër, Lezhë - Shëngjin dhe Velipojë, në mënyrë që brenda vitit 2030 të mos derdhen më ujëra të zeza në lumenj, det dhe të rritet cilësia e baseneve.
- Itinerarin turistik vozitës lumor - liqenor, duke integruar vozitjen dhe lundrimin në një rrjet rekreativ: Vau-Dejës - Liqeni i Shkodrës - Pulaj - Ishulli i Bojanës.

Referuar sistemit bujqësor:

- Krijimin e një tregu rajonal bujqësor, i cili do të plotësonte zinxhirin ekonomiko-bujqësor në agro-përpunimin e produkteve bujqësore.

Në lidhje me Infrastrukturën e transportit:

- Zhvillimin e qendrës primare të Shkodrës dhe Lezhës si dy qytete-porta, nisur nga modalitetet portuale, hekurudhore dhe rrugëve kombëtare që ofrojnë, si dhe zhvillimin e qendrave Bajzë, Koplik, Laç si hub-e logjistike, për rolin kryesor, pozicionin kufitar që kanë si pika grumbullimi të produkteve bujqësore dhe stacione me rëndësi për njerëz dhe mallra.
- Përmirësimin e kushteve dhe fuqizimin e kapacitetit akomodues të portit të Shëngjinit si një shumë e rëndësishme për polin ekonomik Shkodër – Lezhë
- Integrimin dhe funksionimin me kapacitet të plotë sipas modaliteteve të stacioneve të rrjetit hekurudhor: Hani i Hotit, Bajzë, Koplik, Grilë, Milot si stacione mallrash; Shkodër, Lezhë si stacione qendrore, si dhe rigjallërimin e stacioneve për pasagjerë, Mjedë, Baqël, Laç, Gjorm, Mamurras.
- Itinerarin peizazhistik blu në këtë zonë, përgjatë qendrave: Ulqin - Velipojë - Shëngjin - Lezhë – Kune-Vain, të paraprirë nga projektet strategjike të MTI-së dhe MM-së.
- Ndërtimin e tubacionit të gazit IAP, i cili parashikohet të fillojë nga Fieri, të përshkojë këtë rajon për në Malin e Zi në dy degëzime, mbi dhe nën liqenin e Shkodrës. Përtej Malit të Zi, degëzimi IAP-it do të mundësojë lidhjen me Bosnjë - Hercegovinën dhe Kroacinë.
- Në përputhje me OST-në, ndërtimin e nënstacioneve të reja në Koman dhe Lezhë. Në këtë të fundit janë parashikuar të kalojnë edhe linjat 400 dhe 220kV që do të lidhin Shqipërinë me Kosovën dhe me Malin e Zi.
- Ndërtimin e parkut energjetik, i cili do të përbëhet nga dy parqe eolike dhe një termocentral biomasë me kapacitet vjetor prodhimi përkatësisht 1.1 Twh dhe 750 Gwh.
- Vlerësimin e potencialit natyror në aspektin e diversifikimit të energjisë alternative, duke synuar që rrezatimi prej 2700 orë/vit të shfrytëzohet në ndërtimin e parqeve fotovoltaike.

3.2.4.2 *Plani rajonal Shkodër-Lezhë (2005-2020)*

Plani rajonal për zhvillimin e rajonit Shkodër–Lezhë për periudhën 2005-2020 ka karakterin e një plani strategjik dhe përfshin territorin e Qarkut Shkodër dhe Lezhë dhe gjithashtu trajton korridoret kryesore rajonale, kryesisht me Kosovën dhe Malin e Zi.

- Përcaktimi i zonave me prioritet zhvillimin urban;
- Përcaktimi i infrastrukturave strategjike (kryesisht transporti dhe energjetika);
- Përcaktimi i një strategjie për zhvillimin ekonomik duke përfshirë element që kanë lidhje direkt me zhvillimin e territorit;
- Përcaktimin e një strategjie mjedisore që siguron një zhvillim të qëndrueshëm në lidhje me përdorimin e tokës në mënyrë sa më efektive, infrastrukturat e nevojshme dhe duke dhënë gjithashtu propozime konkrete zhvillimi ekonomik;
- Përcaktimin e instrumenteve efektiv për implementimin e kësaj strategjie, në lidhje me organizimin e institucioneve vendore, buxhetet përkatëse dhe mjetet financiare.

Disa koncepte bazë të këtij plani janë si më poshtë:

- 55

- Krijon një korridor të transportit rajonal nga Kosova tek porti i Tivarit përgjatë rajonit Shkodër - Lezhë, e deri në Malin e Zi, duke krijuar një shkallë të lartë të mundësive të zhvillimit përmes rajonit verior.
- Zgjeron zonën e rivierës së Malit të Zi, drejt jugut, në afërsi të bregut Shqiptar duke ndërtuar një urë Ulqin - Velipojë përgjatë lumit Buna, duke krijuar kështu një qendër të madhe për zhvillimin e turizmit.
- Racionon strukturën fizike dhe ekonomike të "Zonës së Largët Malore". Menaxhohet rritja e popullsisë ndërsa rritet cilësia e jetës.
- Stabilizon popullsinë e qyteteve të Pukës, Kurbinit dhe Mirditës, kështu që një produkt rajonal në rritje është në gjendje të shpërndajë të mirat në mënyrë maksimale.
- Mbron tokën bujqësore, dhe kufizon ndërtimin e fshatrave të "rajonit urban", karshi familjeve që janë pjesë autentike e ekonomisë rurale.

Harta tregon disa projekte të rekomanduara dhe interesante për fuqizimin rajonal dhe zhvillimin e ndërkufitar me vendet fqinje, si Mali i Zi dhe Kosova, ashtu si korridori kombëtar Shqiptar dhe i transportit ndërkombëtar. Më poshtë, në trajtë skematike, janë paraqitur ndërhyrjet kryesore strategjike që propozon Plani Rajonal Shkodër - Lezhë:

- Akset kryesore rrugore,
- Projektet e zhvillimit ekonomik dhe
- Zonat e rritjes urbane

3.2.4.3 *Plani Operacional i Zhvillimit Lokal për bashkinë Vau-Dejës*

Projekti i hartimit të Planit Operacional të Zhvillimit Lokal (POZHL) u iniciua nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore në bashkëpunim me projektin STAR. I përmbyllur në mars 2016, POZHL rezulton si sfidë kryesore dhe nevojë imediate për të pasur një plan të integruar të veprimeve dhe masave që bashkia e re duhet të marrë, për të siguruar kohezionin administrativ dhe territorial të të gjitha njësive administrative të saj, pas reformës territoriale. Sigurimi i kohezionit administrativ dhe territorial kërkon masa dhe veprime që mund të përfshijnë ristrukturimin administrativ, të shërbimeve administrative dhe shërbimeve publike, të infrastrukturës lidhëse të njësive administrative etj.

Konkretisht, POZHL është dokumenti kryesor që do të orientoj punën, do të bashkërendojë përpjekjet e aktorëve të ndryshëm në periudhën afatshkurtër (rreth 3 vjeçare) me qëllim sigurimin e kohezionit administrativ dhe territorial të bashkive të reja.

Kjo nismë synon të asistojë Bashkinë e Vau Dejës në planifikimin e masave dhe veprimeve, përfshirë projektet e investimeve kapitale, për periudhën afatshkurtër (2-3 vjeçare), të integruara në POZHL. Qëllimi i këtij instrumenti konsiston në analizën e situatës aktuale, duke synuar të evidentojë fillimisht përparësitë territoriale dhe problematikat kryesore dhe më pas prioritetet që adresojnë nevoja, në përgjigje të të cilave duhet të propozohen ndërhyrjet në formën e projekteve.

3.2.4.4 *Projekti STAR (Support of Territorial and Administrative Reform)*

Projekti STAR ka ardhur si një reagim i menjëhershëm i mbështetjes që donatorë të ndryshëm ofruan për Qeverinë Shqiptare në përpjekjet e ndërmarra për zbatimin e Reformës Administrative Territoriale.

Raportet e fazave të ndryshme të këtij projekti (në nivel qarku, bashkie dhe njësisë administrative), nëpërmjet një analize të thellë fiskale, financiare, ekonomike, sociale, kulturore, demografike administrative të Njësive të Qeverisjes Vendore adresojnë çështjet kryesore të procesit të decentralizimit si:

- demokratizimin e qeverisjes;
- efikasitetin në ofrimin e shërbimeve për qytetarët;
- zhvillimin ekonomik lokal;
- zhdukjen e pabarazive dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Duke konsideruar përparësitë por dhe problematikat kryesore me të cilat bashkitë “e reja” po përballen në procesin e implementimit të kësaj reforme, gjykojmë që raportet dhe analizat e Projektit STAR ofrojnë një kornizë mjaft me vlerë për njohjen e gjendjes aktuale shumëdimensionale të bashkisë Vau-Dejës por njëkohësisht dhe mundësitë dhe prioritet kryesore zhvillimore.

3.2.4.5 Planet e Përgjithshme Vendore të bashkive Lezhë dhe Shkodër

Duke konsideruar pozicionin strategjik të bashkisë Vau-Dejës mes bashkive Shkodër dhe Lezhë që janë dhe dy ndër polet kryesore të zhvillimit në gjithë rajonin verior, propozimet strategjike rajonale për sa i përket infrastrukturave kryesore dhe ndërveprimit lokal të këtyre Planeve do jenë në fokus të hartimit të PPV.

Pavarësisht se akoma të pamiratuara në instancat përkatëse, këto plane tashmë janë në fazën finale dhe si të tilla janë një ndihmë konkrete për grupin e punës për të kuptuar kontekstin zhvillimor rajonal të bashkisë Vau Dejës.

3.2.4.6 Master Plani i Alpeve të Shqipërisë

Master Plani i Alpeve të Shqipërisë i cili aktualisht, bazuar në kuadrin ligjor për planifikimin e territorit, po trajtohet si një Plan Sektorial për Zhvillimin e Turizmit të Alpeve të Shqipërisë është një tjetër dokument kryesor që do konsiderohet në hartimin e PPV të bashkisë Vau-Dejës.

Zona që studion Plani Kombëtar Sektorial i Turizmit shtrihet në pjesën Veriore të Shqipërisë. Kjo zone është identifikuar si “Zona Bërthamë” dhe do të jetë subjekti i Planifikimit Hapësinor (Planifikimi Territorial) nëpërmjet një Plani Sektorial siç përshkruhet në nenin 17 të Ligjit për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit të vitit 2014.




Figura 3.14 Kufiri i Planit Kombëtar Sektorial

Zona Bërthamë, përbëhet nga njësitë administrative vendore me karakteristika të përbashkëta territoriale lidhur me aspektin e dimensioneve gjeografike, demografike, socio-ekonomike dhe infrastrukturës, si më poshtë:

Si rezultat, zona e planifikimit, ndryshe Zona Bërthamë përbëhet nga 12 njësi administrative vendore:

- Pult, Shosh, Shalë të Bashkisë Shkodër;
- Shllak dhe Temal të Bashkisë Vau-Dejës;
- Kelmend dhe Shkrel të Bashkisë Malësi e Madhe;
- Bajram Curri, Bujan, Margegaj, Lekbibaj dhe Tropojë e Vjetër të Bashkisë Tropojë.

Konkretisht territoret e bashkisë të përfshira në këtë Master Plan janë kryesisht ato të njësisë administrative Shllak dhe Temal.

Tabela 3.3 Qendrat urbane të prekura nga Masterplani i Alpeve

Vau-Dejës	Zona bërthamë	Temal	Fshatrat: Koman, Qerret, Arrë, Vilë, Telum, Klllogjen, Malagji-Kajvall, Toplanë, Sermë, Gushtë.
		Shllak	Fshatrat: Vukjakaj-Gegaj, Palaj, Benë, Kroni i Madh, Barcollë, Vukaj, Uk-Bibaj
Zona mbështetëse		Vau-Dejës	Qytet: Vau Dejës, Fshatrat: Mjede, Spathare, Shelqet, Kaç, Naraç, Dush, Karmë, Gomsiqe
		Bushat	Fshatrat: Bushat, Shkjezë, Plezhë, Kosmaç, Stajkë, Ashtë, Rranxa, Fshat i Ri, Mali i Jushit, Plepan-Konaj, Melgush, Barbullush, Kukël, Hotën
		Vig-Mnelë	Fshatrat: Mnelë e Madhe, Mnelë e Vogël, Vig
		Hajmel	Fshatrat: Hajmel, Dheu i Lehtë, Pistull, Paçram, Nënshatë

3.2.4.7 *Plani Strategjik i Zhvillimit Ndërkomunal i Zadrimes*

Plani Strategjik i Zhvillimit Ndërkomunal i Zadrimes, i përgatitur nga FSHZH në vitin 2011, është një dokument që përfshin territorin e ish-bashkisë Vau-Dejës si dhe katër ish-komunave Hajmel, Bushat, Dajç dhe Blinisht, të cilat përbëjnë rajonin e Zadrimes.

Ky dokument përbëhet nga tri pjesë kryesore:

- Analiza e gjendjes ekzistuese, ku behet një panorame e fushave kryesore të zhvillimit të zonës si dhe të problematikave dhe potencialeve të tyre;
- Vizioni, Qëllimet Strategjike dhe Plani i Veprimit japin orientimet strategjike si dhe propozojnë projekte konkrete për secilën drejtim zhvillimi;
- në pjesën e trete parashikohen burimet e mundshme të financimit si dhe mënyrat e monitorimit të ecurisë së zbatimit të planit.

Tri nga njësitë vendore, objekt studimi, (Vau-Dejës, Hajmel dhe Bushat) janë tashme pjesë e bashkisë së re të Vau-Dejës. Për sa i përket këtij territori, ky plan do të ketë një rëndësi të veçantë gjatë procesit të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor.

3.2.4.8 *Dokumente të tjerë*

Nga komunikimi me stafin e bashkisë Vau-Dejës rezultoi që në 5 vitet e fundit janë hartuar disa dokumente planifikimi me fokus zhvillimin urban të qendrave të banuara (qytetit të Vau Dejës, fshatit Bushat, zhvillimet urbane përgjatë superstradës Lezhë - Shkodër, etj.) të cilët nuk janë miratuar në organet kombëtare sipas kërkesave të kuadrit ligjor. Pavarësisht statusit të tyre, grupi i punës do analizojë këto dokumente dhe do shfrytëzojë të dhënat e grumbulluara gjatë procesit të hartimit të tyre.

1) Detyrë Projektimi dhe Studim Urbanistik në Komunën Bushat, Qarku Shkodër.

Më datë 21.07.2009 me Vendim nr.14 miratohet n KRRTRSH "Detyrë Projektimi dhe Studim Urbanistik ne Komunën Bushat, Qarku Shkodër". Kjo detyrë projektimi ka vlerat e saj, duke na parashtruar një kuadër të përgjithshëm të gjendjes ekzistuese dhe nevojat që ka komuna Bushat për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm brenda një kuadri planifikimi. Komuna Bushat përbëhet prej 25000 banorësh, të cilët jetojnë në 14 fshatra (Bushat, Barbullush, Rranxa, Stajkë, Kosmaç, Ashtë, Melgushë, Plezhë, Shkjezë, Kukël, Sumëz, Fshatii Ri, Hoten dhe Konaj). Rritja e popullsisë në Komunën Bushat ka qenë sa rritja natyrore e saj prej 2.5%.

Detyra e projektimit bazohet në:

- Përcaktimin e vijave kufizuese të 14 fshatrave të Komunës Bushat.
- Studimin përgjatë superstradës Shkodër – Lezhë, në thellësi 240m në dy krahët e superstradës dhe studimi i rrugës nga kryqëzimi Vau – Dejës deri në fshatin Shelqet.
- Studimin në zonës nga kryqëzimi Vau – Dejës deri në kryqëzimin e fshatit Barbullush.

Vizioni zhvillimit komunës Bushat:

- Komuna do të tërheqë investime të brendshme maksimale (dhe investime lokale), në mënyrë që të krijojë numrin më të madh të arritshëm të punëve të

cilësisë më të mirë. Kjo do të bëhet në një mënyrë të qëndrueshme, duke trajtuar pengesat për një investim të tillë.

Qëllimi:

- Zhvillimi i zonës së Bushatit si një rajon i qëndrueshëm dhe i fuqishëm, duke i dhënë vlerë potencialit ekonomik të kësaj zone. Potenciali ekonomik i Shqipërisë nuk duhet të mbiqendërzohet në zonën Tiranë – Durrës.
- Krijimi i një "Zone Urbane Policentrike" duke krijuar mundësi për të lidhur ekonomitë urbane të Shkodrës, Lezhës, Podgoricës, Bar-it dhe Ulqinit në një strukturë që ndikon në rritjen ekonomike rajonale dhe rritjen e cilësisë së jetesës së popullsisë së zonës.




Figura 3.15 Kufiri i studimit

Disa nga potencialet e ndërhyrjes për zhvillimin e Komunës sipas fushave të ndryshme mund të përmbliken:

- Bujqësia, Blegtoria , Bletaria, Gjuetia dhe peshkimi, Kullimi dhe sistemimet, Ruajtja e mjedisit, Kultura , Artizanati, Infrastruktura, Shërbimet shëndetësore dhe sociale, Forcimi i kapaciteteve të Organeve të Pushtetit Vendor .

2) Detyra e projektimit, Bashkia e Vau të Dejës.

Në prill të vitit 2008, është përgatitur nga bashkia e Vau të Dejës me mbështetjen e Intercooperation, Albania dhe Zvicër "Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Tirana dhe Albania Urbaplan, Zvicër", Detyra e projektimit për Planin e Përgjithshëm Rregullues të Qytetit Vau-Dejës.

Kërkesat kryesore dhe objektivat që duhet të plotësojë Plani i Përgjithshëm Rregullues i Bashkisë Vau-Dejës.




Figura 3.16 Kufiri i planit të bashkisë Vau-Dejës

Plani i Përgjithshëm Rregullues duhet të rikonceptojë hapësirat e brendshme dhe të ardhshme të qytetit duke marrë për bazë këto elemente kryesore:

- riorganizimin e territoreve të qytetit nga pikëpamja funksionale, duke e vënë theksin tek promovimi i zonave me funksione mikse, duke krijuar kështu zona urbane me dinamike dhe me më leverdi nga pikëpamja e përdorimit të tokës dhe efijencës.
- përmirësimin e parametrave të jetës urbane duke përfshirë elementet e gjelbërimit publik, ambienteve rekreative, sportive dhe sociale si dhe duke përmirësuar nivelin e shërbimeve që ofrohen në qytet
- të krijojë një skemë efijente të qarkullimit të mjeteve dhe këmbësoreve në qytet duke u bazuar në rrjetin rrugor ekzistues, hapësirat e lira si dhe nevojën për përmirësimin e aksesit të lirë të qytetarëve në vende ku është i kushtëzuar nga elemente natyrore apo nga struktura ekzistuese urbane
- të modifikojë apo të "çlirojë" qytetin nga varësia dhe ndikimi që ka rruga ekzistuese interurbane Shkodër – Pukë, që kalon mes për mes qytetit, duke dhënë alternativa të mundshme lidhjeje si dhe duke analizuar me kujdes ndikimin që do të kenë këto alternativa në strukturën e ardhshme urbane të qytetit të Vau-Dejës.
- koordinimin e zhvillimeve të propozuara urbane dhe infrastrukturore të qytetit me propozimet e Strategjisë së Zhvillimit të Rajonit Shkodër, nga pikëpamja e tematikave të zhvillimit, ndërhyrjeve primare në infrastruktura dhe shërbime
- të ruajë fondin e tokave bujqësore përreth qytetit duke orientuar zhvillimin e ardhshëm urban në territore me të përshtatshme si dhe duke kontrolluar dhe disiplinuar tendencat e ndërtimit në këto toka bujqësore
- të përcaktojë me kujdes përdorimin e sipërfaqeve të pashfrytëzuara që gjenden në brendësi të territorit të qytetit duke marrë në konsideratë lidhjen me çështjet e pronave dhe infrastrukturave shtesë të nevojshme.
- të identifikojë njësitë strukturore të nevojshme në territorin e qytetit të cilat do të shërbejnë si instrumentet e menaxhimit të territoreve urbane të qytetit në varësi të propozimeve të Planit të Përgjithshëm Rregullues

- të integrojë në strukturën urbane të qytetit, zonat periferike informale në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues
- të koordinojë propozimet e Planit Rregullues të Përgjithshëm me propozimet e Planit të Zhvillimit Lokal të gjithë territorit të Bashkisë së Vau-Dejës, duke krijuar kështu një harmonizim të zhvillimeve urbane të qytetit me zonat rurale dhe rrjetet kryesore të infrastrukturave dhe shërbimeve.

3) Koncepti strategjik i zhvillimit rajonal (GIZ/ Këshilli i Qarkut Shkodër)

Koncepti Strategjik i Zhvillimit Rajonal është hartuar nga Këshilli i Qarkut Shkodër, me mbështetjen e GIZ, si instrumenti kryesor i planifikimit strategjik, që vendos parimet dhe prioritetet kryesore mbi të cilat do të orientohet zhvillimi i Qarkut Shkodër gjatë viteve në vijim. Fushat prioritare të përcaktuara nga KSZHR-ja janë:

- Arsimi, trajnimi dhe ndërtimi i kapaciteteve
- Infrastruktura dhe Shërbimet
- Turizmi dhe agrobiznesi
- Bashkëpunimi Ndër-rajonale dhe me partnere të tjerë
- Mbrojtja nga përmbytjet

“Skenarët e Zhvillimit Nënrajonale në Qarkun Shkodër”(2015)

Nga analiza, janë identifikuar nënrajonet e mëposhtme, me potenciale të ngjashme në zhvillimin e sektorit të bujqësisë/ blegtorisë:

- Nënraioni i Mbishkodrës: i cili përfshin pjesë të komunave Shkrel, Kastrat, Qendër
- Nënraioni i Nënshkodrës: i cili përfshin komunat Ana e Malit, Bërdicë, Dajç Bregu i Bunës, Gur i Zi, Bushat, Hajmel dhe Velipojë (Ky nënraion përmban rreth 41% të tokave bujqësore të Qarkut Shkodër, me bonitet të lartë (kategoria 1-4). Po ashtu, në këtë nënraion vërehet një përqendrim i lartë i qendrave të përpunimit të qumështit.)
- Nënraioni i Pukës: i cili përfshin pjesë nga komunat Fierzë, Iballë, Qelezë, Temal, Qerret, Rrapë, Qafë Mali, Blerim dhe Gjegjan dhe bashkitë Pukë dhe Fushë Arrëz. Në këtë nënraion shtrihen rreth 61% të kullotave të të gjithë Qarkut Shkodër.




Figura 3.17 Nënrajonet me potencialet bujqësore

3.3 Lidhja me politika dhe dokumente të tjerë

Në këtë pjesë synohet që të jepet konteksti i politikave dhe dokumenteve të tjerë brenda së cilave funksionon Plani dhe ku është bazuar hartimi i VSM-së. për këtë qëllim janë konsultuar dhe përdorur një sërë dokumentesh, përfshire konventat ndërkombëtare, Direktivat e BE-së dhe politikat në nivelin kombëtar. Tabela 3-2 me poshtë paraqet dokumentet e konsultuara.

Në Shtojcën 2 jepet një përshkrim më i detajuar i Direktivave të BE-së dhe legjislacionit përkatës shqiptar në kuadrin e përafrimit me Direktivat e BE-së.

Tabela 3.4 Përmbledhje e dokumentacionit të konsultuar

Konteksti Ndërkombëtar

Legjislacioni Horizontal

- Direktiva 2004/35/KE "Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin";
- Direktiva 2001/42/KE "Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara";
- Direktiva e Këshillit 85/337/KE "Mbi vlerësimin e efekteve të projekteve publike dhe private mbi mjedisin";
- Direktiva 2003/4/KE mbi të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor;
- Direktiva 2003/35/KE mbi "Tërheqjen e publikut në vendimmarrje në hartimin e planeve programeve në fushën e mjedisit dhe amendimet për pjesëmarrjen e publikut dhe aksesin në drejtësi";

Cilësia e Ajrit:

- Direktiva 2008/50/KE mbi cilësinë e ajrit të ambientit dhe për një ajër më të pastër për

Evropën;

- Direktiva 2001/81/KE mbi Tavanet Kombëtare të Shkarkimit për disa ndotës atmosferike;
- Direktiva 2012/33 në lidhje me përmbajtjen e squfurit në lëndet djegëse në transportin detar;
- Direktiva 2004/42/KE mbi limitimin e shkarkimeve të kompozimeve organike të avullueshme për shkak të përdorimit të tretësve organik në disa bojëra dhe llaçe të caktuara dhe produkteve për rilyerjen e automjeteve;
- Direktiva 97/68/KE mbi përafrimin e legjislacionit të Vendeve Anëtare në lidhje me masat që do të ndërmerren kundër shkarkimit të ndotësve të gazte dhe lëndes së ngurtë pezull nga motorët me djegie të brendshme që instalohen në makineritë e lëvizshme jo rrugore;
- Direktiva 2005/55/KE mbi përafrimin e legjislacionit të Vendeve Anëtare në lidhje me masat që do të ndërmerren kundër shkarkimeve të ndotësve të gazte dhe lëndes së ngurte pezull nga motorët me ndezje me kom presion dhe motorët me ndezje pozitive që djegin gaz natyral apo të lëngshëm për përdorim në automjete.

Ndryshimet Klimatike:

- Vendimi i Këshillit 2002/358/KE në lidhje me miratimin, në emër të Komunitetit Evropian, të Protokollit të Kiotos të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe përmbushjen e përbashkët të angazhimeve në përputhje me to;
- Direktiva 2003/87/KE për krijimin e një skeme të tregtimit të njësive të lejuara të gazeve me efekt serre brenda Komunitetit e cila amendon Direktivën e Këshillit 96/61/KE;
- Direktiva 2004/101/KE për krijimin e një skeme të tregtimit të njësive të lejuara të gazeve me efekt serre brenda Komunitetit, në lidhje me mekanizmat e Protokollit të Kiotos;
- Direktiva 2009/29/KE e cila amendon Direktivën 2003/87/KE në mënyrë që të përmirësojë dhe zgjerojë skemën tregtare të kompensimit të njësive të lejuara të emisioneve të gazeve me efekt serre të Komunitetit;
- Vendimi i Komisionit Nr. 2010/2/BE i cili përcakton një liste të sektorëve dhe nënsektorëve të cilët mendohet të jenë të ekspozuar ndaj një risku të konsiderueshëm të rrjedhjes së karbonit;
- Direktiva 2008/101/KE e cila amendon Direktivën 2003/87/KE në mënyrë që të përfshijë aktivitetet e aviacionit në skemën e tregtisë së njësive të lejuara të gazeve me efekt serre brenda Komunitetit;
- Direktiva 1999/94/KE në lidhje me disponueshmerinë e informacionit të konsumatorit mbi ekonominë e lëndes djegëse dhe emetimet e CO₂ në lidhje me tregtimin e makinave të reja të pasagjerëve;

Administrimi i Mbetjeve:

- Direktiva 2008/98/KE mbi mbetjet;
- Direktiva 86/278/EKE Për mbrojtjen e mjedisit dhe veçanërisht të tokës, kur llumrat e ujerave të ndotura përdoren në bujqësi;
- Direktiva 2006/66/KE Për bateritë dhe akumulatorët, mbetjet nga bateritë dhe akumulatorët;
- Direktiva 94/62/KE Për Ambalazhet dhe Mbetjet nga Ambalazhet;

- Direktiva 2000/53/KE Për automjetet në fund të jetës;
- Direktiva 2002/96/KE dhe Direktiva 2012/19/EU Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike;
- Direktiva 1999/31/KE Mbi landfillin e mbetjeve;
- Direktiva 2006/21/KE Për menaxhimin e mbetjeve nga industria nxjerrëse;
- Direktiva 2011/65/EU Për kufizimin e përdorimit të substancave të rrezikshme në pajisjet elektrike dhe elektronike.

Cilësia e Ujerave:

- Direktiva 2000/60/KE për krijimin e një kuadri në fushën e politikave të ujit;
- Direktiva 91/271/EKE për trajtimin e ujerave të ndotur urbane;
- Direktiva 2008/56/KE për krijimin e një kuadri në fushën e politikave mjedisore detare (direktiva për kuadrin e strategjisë detare);
- Direktiva 98/83/KE për cilësinë e ujit të pijshëm;
- Direktiva 91/676/KE për mbrojtjen e ujerave nga ndotja e shkaktuar nga nitratat e përdorura në bujqësi;
- Direktiva 2006/7/KE për menaxhimin e cilësisë së ujerave të largjes;
- Direktiva 2006/118/KE për mbrojtjen e ujerave nëntokësore nga ndotja dhe degradimi;
- Direktiva 2013/39/BE për sa i përket substancave prioritare në fushën e politikave të ujit;
- Direktiva 2009/90/KE që parashtron specifikimet teknike për analizat kimike dhe monitorimin e statusit të ujit;
- Direktiva 2007/60/KE për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmbytjet.

Mbrojtja e Natyrës:

- Direktiva 2009/147/KE Për ruajtjen e shpendëve të egër;
- Direktiva 92/43/KE Për ruajtjen e habitateve natyrore, florën dhe faunën e egër;
- Direktiva 83/129/KE lidhur me importin në shtetet anëtare të lëkurës së disa llojeve të vegjëlsh të fokave dhe produkteve të derivuara prej tyre;

Zhurmat:

- Direktiva 2002/49/KE 2 Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis.
- Direktiva 70/157/EKE mbi përfrimin e legjislacionit të shteteve anëtare në lidhje me nivelin e lejueshëm të zhurmës dhe të shkarkimeve nga mjetet motorike;
- Direktiva 97/24/KE mbi disa komponentë dhe karakteristika të mjeteve motorike me dy ose tri rrota;
- Direktiva 2001/43/KE mbi gomat e mjeteve motorike dhe të rimorkiove të tyre si dhe montimi i tyre;
- Direktiva 2009/40/KE mbi kontrollet e përshtatshmërisë rrugore për mjetet motorike dhe rimorkiot e tyre.

Konventat:

- UNESCO Konventa e UNESCO-s për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (2003);
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore;
- Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC);

- Konventa e Bernes (1976): Ruajtja e Faunës së Egër dhe Mjedisit Natyror Evropian;
- Konventa e Biodiversitetit (Diversiteti Biologjik) (1992);
- Konventa e Ramsarit për Ligatinat (1971);
- Konventa e Aarhusit (Konventa mbi të Drejtën për Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendim- marrje dhe të Drejtën për t'ju drejtuar Gjykatës për Çështjet Mjedisore) (1998);
- Konventa e Bonit (1979); Konventa për Mbrojtjen e Specieve Shtegtuese të Kafshëve të Egra;
- Konventa CITES (1975): Konventa mbi Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër;
- Konventa e Barcelonës (1976); Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe Zonës Bregdetare të Detit Mesdhe;
- Konventa e Espoos (1991): Konventa për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekst Ndërkufitar së bashku me Amendimet dhe Protokollet;
- Konventa për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Nënujore (2001).

Konteksti Rajonal

- Strategjia e Evropës Juglindore 2020 (SEJ 2020);
- Kuadri i Investimeve në Ballkanin Perëndimor (KIBP);
- Strategjia e Bashkimit Evropian për Rajonin Adriatiko - Jonian (SBERAJ);
- Programi IPA II;
- Samiti i Ballkanit Perëndimor – rrjeti i korridoreve kyç rajonale të transporti.

Konteksti Kombëtar

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020;
- Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural 2014-2020;
- Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014-2020;
- Strategjia e Furnizimit me Ujë & Kanalizimet 2014-2020;
- Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Administrimin e Mbetjeve 2010-2025;
- Plan i Kombëtar për Administrimin e Mbetjeve 2010-2025;
- Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit 2015-2020 (draft);
- Plan i Përgjithshëm Kombëtar për Territorin (draft);
- Legjislacioni përkatës mbi ekologjinë, ajrin, mjedisin detar, zonat e mbrojtura, VSM dhe VNM, administrimin e mbetjeve, trashëgiminë kulturore, zhurmat, ujin, bujqësinë, pyjet, etj. (një liste e detajuar e ligjeve, përshkrimit të tyre dhe sektorëve të zbatimit është dhënë në Shtojcën 2)
- Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversiteti (miruar 01.20.2016).

Burimi: Shqipëria – Plan i Kombëtar për Integrimin Evropian.

SEKSIONI 4: PËRSHKRIMI I GJENDJES AKTUALE

4.1 Analiza mjedisore

4.1.1 Burimet natyrore

Burimet natyrore, flora dhe fauna, zënë vendin kryesor në mjedisin ku jetojmë. Duke qenë se Shqipëria ka një larmi relievi, të klimës e mikroklimës, kjo larmi ka favorizuar rritjen e një game të gjerë bimësh dhe specesh shtazore. Vlerësohet se rreth 30 % e të gjithë florës europiane është e pranishme në Shqipëri, ndërsa pyjet e larta janë strehë për komunitetet e kafshëve të egra, si dhe për komunitetet karakteristike të shpendëve të lidhur me pyjet e virgjër.

Shqipëria është një urë kalimi e rëndësishme e migracionit floristik dhe faunistik, sidomos të disa shpendëve dhe insekteve. Njohja e biodiversitetit në territorin e Shqipërisë është ende e pamjaftueshme. Grupe të tëra të botës bimore dhe shtazore janë ende të panjohura e të pastudiuara. Edhe për grupet e studiuara relativisht mirë, ende nuk është arritur njohja e plotë e pasurive llojore.

4.1.1.1 Flora dhe fauna

Territori i Bashkisë Vau-Dejës është i ndërthurur dhe është pjesë e këtij areali, ku janë të gjitha kushtet për zhvillimin e faunës dhe të florës mjaft të larmishme, për ruajtjen e të cilës duhet të kujdeset e të kontribuojë i gjithë komuniteti.

Në këtë territor, takohen një sërë ekosistemesh si ato ujore, shkurre mesdhetare përherë të blerta dhe gjetherënëse, pyje gjethegjere e halorë dhe të përziera, livadhe e kullota.

Fauna

Sipas studimeve dhe monitorimeve të institucioneve të ndryshme shkencore dhe akademike, për sa u përket shpendëve, mund të thuhet se këta përbëjnë një pjesë të konsiderueshme me vlera për llojet e ekosisteme të cilat takohen brenda këtij territori.

Në ujërat e ekosistemeve ujore (lumenjve dhe liqeneve) kemi një shumëllojshmëri të popullatave të peshqve ku si më me vlera mund evidentohen këto lloje kryesore: Krapë (*Cyprinus carpio*), Ngjala (*Anguilla anguilla*), Kavalli i lumit (*Lampetra fluviatilis*).

Në llojet që përmendem më sipër, duhet të theksojmë se Kavalli i lumit (*Lampetra fluviatilis*), është specie e rrezikuar dhe duhet që të merret në mbrojtje.

Shpendët dhe gjitarët, janë elementët më tërheqës dhe më të rëndësishëm në përbërje të biodiversitetit tonë. Në ekosistemet pyjore të territorit të bashkisë Vau-Dejës, rriten dhe strehohen gjitarë e shpendë nën mbrojtje të veçantë. Në kafshët më të rralla dhe që janë me statusin e llojeve të keqësuar apo në rrezik zhdukjeje mund të përmenden: Derri i egër (*Sus scrofa*) dhe Macja e egër (*Felis silvestris*).

Por përveç këtyre, takohen edhe gjitarë të mëdhenj si: Ujku (*Canis lupus*), Çakalli (*Canis aureus*), Dhelpra (*Vulpes vulpes*), Kunadhja (*Martes faina* Ekl.), Zardafi (*Martes martes* L.), Baldosa (*Meles meles*), Qelbësi (*Mustela putorius* L.), Ketri (*Sciurus vulgaris*), Lepuri i egër (*Lepus Capensis*), Nuselala (*Mustela nivalis*), Lundërza (*Lutra lutra*), Rriqebulli (*Lynx*), etj.

Ndërsa në llojet e rralla të shpendëve që kanë këto statuse dhe që hasen në pyjet e rajonit tonë janë: Thëllëza e fushës (*Perdix perdix*), Kumuria (*Streptopelia decaocto*), Skifteri (*Acipiter nisus*), Gakthi (*Botaurus stelloris*), Shkaba (*Gyps fulvus*), Gjeraqina (*Accipiter gentilis*), Huta me kalca (*Butea lagopus*).

Gjithashtu, takohen dhe një sërë zvarranikësh, ku për vlera të veçanta përmendim, nepërkën me brirë (*Vipera amodytes*), Bolla leopard (*Eiapha situla*), etj.

Probleme mjedisore të lidhura me biodiversitetin, florën e faunën

Flora dhe fauna janë të kërcënuara si pasojë e keqmenaxhimit të biodiversitetit, florës dhe faunës dhe lidhen së pari me densitetin e lartë të popullsisë dhe lëvizjet demografike të dy dekadave të fundit. Çështjet në vijim janë identifikuar si shqetësime strategjike në planin lokal:

- Humbje dhe fragmentim të habitateve;
- Dëmtim, varfërim, dhe degradim të ekosistemeve dhe habitateve;
- Shqetësim, persekutim i kafshëve të egra në natyrë;
- Zhdukje llojesh të rrezikuara apo kërcënim për zhdukje;
- Prishje të specieve autoktone dhe erozion gjenetik;
- Fragmentizim masiv i ekosistemeve dhe humbje habitatesh për specie të rëndësishme faunistike;
- Humbje direkte e habitateve si pasojë e përmbytjeve dhe erozionit.

Duke qenë se në fund të fundit, thelbin e termit biodiversitet e përbëjnë llojet, habitatet dhe ekosistemet, kriteret e përdorura për t'u mbajtur në konsideratë, pa dyshim nxisin nevojën e mbrojtjes dhe sigurimit të mbijetesës së atyre më të kërcënuarave dhe që kanë rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kriteret kryesore të cilat duhen mbajtur më në konsideratë janë si më poshtë:

- Lloje dhe habitate të kërcënuara në mënyrë kritike me rëndësi globale, rajonale e kombëtare;
- Habitata/ekosisteme që shquhen për endemizëm apo biodiversitet të lartë;
- Habitata ose lloje në rrezik zhdukje të pakthyeshme;
- Habitata ose lloje, ruajtja dhe menaxhimi i përshtatshëm i të cilëve do të rezultonte me përfitime ekonomike dhe edukative lokale apo kombëtare;
- Lloje ose habitate të kërcënuara nga tregtia apo praktikata e papërshtatshme, të cilat mund të kontrollohen nëpërmjet rregullimit të politikave.

4.1.1.2 Pyjet dhe kullotat

Mjediset pyjore

Në sistemin natyror përfshihen edhe pyjet dhe kullotat që zënë një sipërfaqe të konsiderueshme me vlera ekonomike, mjedisore, rekreative, turistike. Pyjet shpërndahen në të gjithë territorin e bashkisë, por veçanërisht në zonën malore, ku gjenden pyjet e lartë dhe me vlera të larta peizazhistike.

Ekosistemet pyjore luajnë një rol të rëndësishëm në aspektin ekonomik për prodhimin e lëndës drusore dhe druve të zjarrit, ku veçanërisht në zonat rurale, druri mbetet burim i

rëndësishëm i energjisë për ngrohje, ku për këtë arsye nga ana e qeverisë dhe pushtetit lokal duhet të mbështeten sisteme dhe metoda që udhëzojnë përmirësimin e prodhimtarisë dhe shfrytëzimin e resurseve pyjore që janë optimale për prodhim të energjisë.

Sipërfaqet pyjore shërbejnë si rezervuar karboni, ndaj shtimi apo përmirësimi i këtyre sipërfaqeve do të ndihmonte në reduktimin e dioksidit të karbonit në atmosferë. Në kuadër të protokollit të Kiotos ku bën pjesë edhe Shqipëria, shtetet kanë rënë dakord të luftojnë efektin sere nëpërmjet uljes së sasisë së karbonit, nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit. Nëse ky objektivi arrihet, krijohen kapacitete të lira karboni (kredite karboni), të cilat mund të shiten tek vendet me teprica karboni.

Duke u bazuar në ndarjen e re territoriale dhe në ligjin për administrimin e pyjeve dhe kullotave, rezulton se pjesa më e madhe e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore të territorit të Bashkisë Vau-Dejës janë nën administrimin e saj.

Me VKM nr. 433, datë 08.06.2016, Bashkisë Vau-Dejës i është transferuar një sipërfaqe e konsiderueshme prej rreth 28.465 ha, nga e cila:

- Sipërfaqe pyjore 18.478.22 ha;
- Sipërfaqe kullimore 2.349 ha;
- Sipërfaqe djerrë, joproduktive dhe bimësi pyjore 7.581.01 ha.

Përsa i takon diversitetit biologjik, mund të thuhet se territori i Bashkisë Vau-Dejës është mjaft i pasur në lloje bimësh dhe drurësh pyjorë që gjejnë kushte të përshtatshme për rritje e zhvillim, që nga 30 e deri në lartësinë 1.800 m mbi nivelin e detit. Ato janë natyrore dhe të kultivuara.

Grupet kryesore të llojeve të drurëve janë:

- Llojet halore, 2.319.6 ha;
- Llojet fletor, 16.158.62 ha.

Në grupin e parë bëjnë pjesë:

Pisha e butë (*Pinus pinea*), Pisha e egër (*Pinus halepensis*), Pisha e zezë (*Pinus nigra*), Pisha radiata (*Pinus radiata*), Selvia (*Cupressus sempervirens*), Hartina (*Pinus sylvestris*), etj.

Në grupin e dytë bëjnë pjesë:

Lisi (*Quercus pubescens*), Bunga (*Quercus Petraea*), Qarri (*Quercus cerris*), Ilqja (*Quercus ilex*), Akacia, Plepi i bardhë (*Populus alba*), Plepi i zi (*Populus nigra*), Shelgjet (*Salix alba*, *Salix purpurea*, *Salix fragilis*), Shkozat (*Carpinus betulus* dhe *Carpinus orientalis*), Frashëri gjethengushtë (*Fraxinus angustifolia*), Frashëri i bardhë (*Fraxinus ornus*), Gështenja (*Castanea sativa*), Arra (*Juglans regia*), Lajthia (*Corylus avellana*), Bliri (*Tilia ophissinalis*), Panja (*Acer platanoides*), Rrapi (*Pistacia orientalis*), Verri (*Alnus cortex*), Verri i zi (*Alnus glutinosa*), Dafina (*Laurus nobilis*), Bushi (*Buxus sempervirens*), Shqopa (*Erica arborea*), Mareja (*Arbutus unedo*), Thana (*Cornus mas*), Shqeme (*Rus coriaria*), etj.

Shpërndarja në bazë të sipërfaqes për speciet kryesore pyjore jepet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 4.1 Shpërndarja e sipërfaqes për llojet kryesore pyjore. Burimi: (Drejtoria e Pyjeve, Mjedisit, Veterinarisë dhe Bujqësisë, Bashkia Vau-Dejës)

Nr.	Lloji	Spërfaqja (ha)
1.	Dushk	7.756.71
2.	Pisha e zezë	568.05
3.	Ah	3.210.65
4.	Shkozë	2.460.18
5.	Mare	741
6.	Pishë mesdhetare	1.751.55
7.	Lajthi	13.5
8.	Gështenjë	455.55
9.	Shqopë	374.97
10.	Panjë	5.5
11.	Akacie	59
12.	Frashër	482.7
13.	Bimësi pyjore	245.35
14.	Bli	30.7
15.	Shkurre	568.16
16.	Të tjera	
	Totali	18.723.57

Në kushtet e terrenit të pjerrët në zonën malore, pyjet janë faktori kryesor i mbrojtjes së tokës nga rrëshqitjet dhe erozioni, mbrojtjen e brigjeve të lumenjve dhe vijës bregdetare për mbrojtjen nga ndryshimet morfologjike.

Shfrytëzim i qëndrueshëm ekonomik, mjedisor dhe social i pyjeve, me theks të veçantë në pyllëzimin e tokave të braktisura dhe të abandonuara, do të ndihmojë në pyllëzimin dhe krijimin e sistemeve agro-pyjore. Zbatimi i këtyre aktivitete, do të mbrojë mjediset pyjore, do të rrikthejë potencialet prodhuese pyjore, si dhe do të veprojë kundër prerjeve ilegale.

Gjithashtu sipërfaqet pyjore dhe kullosore të Bashkisë Vau-Dejës, janë mjaft të pasura edhe me një grup tjetër të rëndësishëm sikurse janë bimët mjekësore, eterovajore e tanifere si: Trëndafili i egër (*Rosa canina*), Agulicja (*Primula veris*), Trumza (*Saturea montana*), Zhumbrika (*Thimus spargillum*), Çikorja (*Cichorium intybus*), Grami (*Cynodon dactylon*), Barpate (*Polygonum aviculare*), Thundërmushkë (*Tussilago farfara*), Luleshtrydhe (*Fragaria vesca*), Netulla (*Verbascum thapsiforme*), Njëmijëfletëshi (*Aquillea miliefolium*), Lulekuqja (*Papaver rhoeas*), Sherebela (*Salvia officinalis*), Lisna (*Thymus longicaulis*), Mjedra (*Rubus idoeus*), Xina (*Pistacia lentiscus*), Bari i gjarpërit (*Teucrium chamaedrys*), Zogela (*Frangula alnus*), Shpendra (*Helleborus edours*), Gjuhëusja (*Ononis spinosa*), Lulebasani (*Hypericum perforatum*), Rigoni i kuq (*Origanum vulgare*), Veronika mjekësore, (*Veronica officinalis*), Boronica (*Vaccinium myrtillus*), Xherrokulli (*Colchicum autumnale*), Murrizi (*Crataegus monogyna*), Gjineshtra (*Spartium junceum*), Driza (*Paliuris aculeatus*), Rrushkulli (*Ruscus aculeatus*), Vjeshtull lisi (*Viscum album*), Salepi (*Orchis mascula*), Bliri, Dëllinjat, Hithra (*Urtica dioica*), etj.

Mjedisi i kullotave

Kullotat natyrore përbëjnë bazën e të ushqyerit të bagëtive dhe për këtë arsye në periudhën komuniste, u ndoq një politikë shkatërruese e hapjes së tokave të reja e mishëruar në parullën

“T’u qepemi kodrave e maleve e t’i bëjmë ato pjellore si dhe fushat”. Kjo gjë i solli një dëm të jashtëzakonshëm fondit pyjor dhe kullosor në Shqipëri, duke prekur dhe dëmtuar rëndë një ansambël të vërtetë kullosor natyror. Qindra e mijëra ha pyje, kullota, livadhe e muzha me florë shekullore të mrekullueshme u shkatërruan duke u kthyer në mënyrë krejt të papërshtatshme, në sipërfaqe të kultivuara me bimë të ndryshme bujqësore.

Kullotat natyrore brenda territorit të Bashkisë Vau-Dejës, sipas të dhënave të marra nga Kadastra e Fondit Pyjor dhe Kullosor, kanë një sipërfaqe të përgjithshme prej 2.349 ha, e cila sipas periudhës të shfrytëzimit të tyre jepet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 4.2 Kullotat natyrore brenda territorit të Bashkisë Vau-Dejës

Tipi i kullotës	Sipërfaqja (ha)
Dimërore	779.6
Verore	1.569.4
Totali	2.349

Sigurimi në realizimin e reformës së decentralizimit të kompetencave në administrimin e pyjeve dhe kullotave publike dhe dixhitalizimi i hartave të fondit pyjor nën administrim mbeten pikënisjet drejt suksesit për përmirësimin e situatës aktuale. Njësitë Administrative nevojitet që nëpërmjet planeve të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave t’u ofrojnë banorëve të tyre mundësi punësimi në periudha ku ka aktivitete të punimeve pyjore. Njësitë Administrative, nëpërmjet mbjelljes dhe rimbjelljes së drurëve të lartë, mund të përfitojnë më shumë të ardhura, mbështetje financiare në realizimin e projekteve si dhe të ardhura të vazhdueshme e të sigurta nga shitja e kapaciteteve të lira të karbonit.

Probleme mjedisore dhe të menaxhimit të pyjeve

- Inventarizimi i pyjeve dhe kullotave dhe pasqyrimi i gjendjes reale të tyre;
- Hartimi i planeve të reja për menaxhimin e të gjithë fondin pyjor dhe kullosor bashkiak;
- Regjistrimi i pyjeve dhe kullotave pranë Z.V.R.P.P Shkodër;
- Dëmtime të pyjeve nga prerjet e paligjshme dhe zjarret;
- Mungesa e punimeve përmirësuese të pyjeve në zonat me bimësi të dëmtuar;
- Mungesa e mbjelljeve të reja në zonat e zhveshura;
- Mungesa e planifikimit të sipërfaqeve të cilat mund të shfrytëzohen për dru zjarri;
- Mbetjet urbane të shpërndara në tokat pyjore duke shkaktuar ndotje të tokës dhe të ujërave;
- Mungesa e punimeve përmirësuese në sipërfaqet kullosore, ku mbrojtja nga erozioni i kullotave kërkon disa punime shtesë me qëllim që të garantohet kapaciteti maksimal kullosor;
- Mungesë e planifikimit të sistemimeve malore në pellgjet ujëmbledhës malorë.

Rekomandime

Për të rritur cilësinë e shërbimeve të ekosistemeve pyjore dhe kullosore deri në vitin 2020 mund të propozohet:

- Të pyllëzohen sipërfaqet e pyjeve të prera e të djegura në rreth 3.100 ha;

- Të ndërhyet me punime përmirësuese në 6.200 ha, këto të shpërndara në ekonomitë pyjore Gjadër-Mnelë, Vig, Gomsiqe, Bushat, Shllak 1, Shllak 2, Toplanë, Karmë;
- Të fillohet me programe të gjera për përkujdesje ndaj pyjeve të reja dhe atyre të dendura që do të rezultojë në: (i) përmirësimin e strukturës së pyjeve; (ii) ngritjen e prodhimtarisë së drurit për djegie dhe drurit me dimension të vogël, që është i përshtatshëm për përpunim nëpër industri të dizenuara për këtë lloj madhësie dhe (iii) ofrim i mundësive për punësim të popullatës rurale;
- Që të sigurohet përdorimi i mirëfilltë i mjeteve buxhetore dhe i resurseve të tjera për planifikim intensiv të operacioneve, duhet të merren parasysh faktorët, si: vlera e llojit të pyllit, rolet e shumëfishta dhe potencialet e pyllit e të tokave pyjore, nevojat për masa mbrojtëse etj;
- Krijimi i një fidanishteje për prodhimin e fidanave pyjore me lloje të zonës;
- Përmirësimi i rreth 2.349 ha kullota me taban të cekët;
- Ndërhyrje emergjente me investime në ndërtimin dhe riparimin e pritave malore për frenimin e erozionit të tokës, në përrrenjtë e ekonomive pyjore Hajmel-Nenshat, Gomsiqe, Karmë, Gjadër-Mnelë, Vig, Shllak të cilët kanë një regjim rrjedhjeje të rrëmbyeshëm.

Këto propozime mbështeten në objektivat e PKK për pyjet:

- Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve pyjore dhe kullosore;
- Gjithëpërfshirja e aktorëve lokalë në menaxhimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori;
- Vendosja e skemave për pagesa në ekosistem;
- Sigurimi i kuadrit rregullator, institucional dhe ekonomik për zbatimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve;
- Të arrihet transpozimi i plotë (100 %) i legjislacionit evropian në fushën e pyjeve;
- Mbulimi 100 % me plane mbarështimi për të gjitha ekonomitë pyjore në nivel kombëtar;
- Ulja me 40 % të prerjeve të paligjshmeve të fondit pyjor;
- Rehabilitimi nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzim të sipërfaqeve të djegura si dhe rehabilitimi i kullotave me mbjellje foragjerë e drusore në masën deri 15 % të sipërfaqes pyjore dhe kullosore deri në vitin 2020;
- Parandalimi i gërryerjes së mëtejshme të tokës pyjore dhe kullosore në 25 % të sipërfaqes deri në 2020.

4.1.1.3 Rezervatet

Një nga resurset më të rëndësishme të bashkisë Vau-Dejës është sipërfaqja e konsiderueshme ujore. Si rrjedhojë sektori i peshkimit paraqet mundësi mjaft të mëdha zhvillimi, e parë kjo në aspektin e aftësive ushqyese të këtij baseni dhe sipërfaqen e madhe të tij. Mjafton të përdoren praktikatat e viteve 1980-1990, ku me një shfrytëzim mesatar është arritur një rendiment prej 50 ton në vit.

Për sektorin e rritjes së peshkut (akuakulturën), në Vau-Dejës ekziston një ekonomi rritje peshku, e cila vite më parë ka prodhuar rasat peshku për popullimin e ujërave të liqeneve si dhe peshk për konsum. Në liqenin e Vaut-Dejës është ndërtuar një rezervat peshku.



Figura 4.1 Rezervat peshku, liqeni i Vau-Dejës

Në këto liqene hasen edhe një sërë problematikash. Peshkimi i theksuar dhe abuziv deri me lëndë plasëse e helmuese, e theksuar kjo metodë peshkimi në Vau-Dejën dhe Koman, ka cenuar si rezervat ashtu edhe strukturën peshkore.

Në liqenet e Vau-Dejës dhe Komanit vazhdon peshkimi i pakontrolluar i cili cenon qëndrueshmërinë e prodhimit të peshkut si dhe zvogëlon rezervën e tij. Shfaqja e peshqve grabitqarë si luçioperka dhe perka, struktura e prodhimit po pëson ndryshime të theksuara në liqenin e Vau-Dejës.

4.1.2 Topografia dhe klima;

Bashkia e Vau-Dejës bën pjesë në Qarkun e Shkodrës, me distance 20 km nga Shkodra, 92 km nga Tirana dhe 81 km nga Aeroporti i Rinasit. Ajo ka një sipërfaqe prej 496 km² ku 11677 ha janë tokë bujqësore. Bashkia e Vau-Dejës kufizohet në veri dhe në perëndim me bashkitë Shkodër dhe Tropojë, në lindje me bashkitë Fushë-Arrëz dhe Pukë ndërsa në jug me bashkinë Lezhë.

Bashkia Vau-Dejës shtrihet midis gjerësive gjeografike: 42° 15' 4.6368" N – veri, 41° 52' 51.189" N – jug dhe midis gjatësive gjeografike 19° 53' 54.2112" E – lindje, 19° 25' 39.165" E – perëndim.



Figura 4.2 Pozita gjeografike e Vau-Dejës

Vau-Dejës është i vetmi qytet në këtë bashki. Ai pozicionohet në pjesën veriore të Zadrimës, në ndërprerjen e lumit Drin dhe Gjadër dhe shtrihet përgjatë rrugës nacionale që lidh Shkodrën me Pukën dhe ndodhet rreth 20 km nga deti Adriatik.

E veçantë për këtë bashki është ekzistenca e sipërfaqeve të konsiderueshme ujore, që përbën një pasuri natyrore të vlefshme për zonën, ku dominojnë liqeni i Vaut të Dejës, liqeni i Komanit, lumi Drin dhe lumi Gjadër. Mbi lumin Drin janë ndërtuar disa hidrocentrale si: hidrocentrali i Vau-Dejës, i Komanit, si dhe Ashta 1 e Ashta 2.

Territori i bashkisë është i larmishëm, me një reliev kryesisht fushor në pjesën jug-perëndimore dhe malor në pjesën veri-lindore. Duke filluar nga mali i Kakarriqit i cili shërben edhe si një kufi natyror me bashkinë e Lezhës me pikën e tij më të lartë maja e Kamberit (392 m), kodra e Zefjanës (249 m), kodra e Melgushës (162 m) kodra e Barbullushit (79 m), kodra Plezhë-Shkjezë (kodra e Hoxhës 100 m - Kodërlec 78m), maja e Shitit 614 m në vargun jug-lindje (pjesë e njësisë administrative Vig-Mnelë), duke vazhduar me kodrën e Dushkakuqit (256 m), malin e Bardhë (323 m), mali i Laçit (367m), mali i Bokes (464 m) maja e Gzhoprës (846m) në pjesën qendrore të territorit. Pjesa veri-lindore e bashkisë dallohet kryesisht për terrenin e thyer malor, maja e Zbuçit 835 m, e Darcit (944 m), e Mëgullës (955 m), e Vilës 1514 m, për të arritur në majën e Cukalit me lartësinë më të madhe mbi nivelin e detit 1721 m.



Figura 4.3 Mali i Cukalit 1722 m (Burimi: <httpwww.panoramio.com>)




Figura 4.4 Harta topografike e Vau-Dejës

Një rëndësi të madhe në këtë territor ka edhe ultësira e Zadrimes, e cila është e vendosur në anën lindore të malit të Kakarriqit dhe të kodrave Barbullush-Bushat-Bërdicë deri në anën perëndimore të vargmaleve të Velës, Kreshtës, Shitës dhe të Bokave të Naraçit. Në jug kufizohet me qytetin e Lezhës, ndërsa në veri me lumin Drin.

Ajo ka shtrirje në dy qarqe veriore të vendit, Shkodër (Bushat, Vau i Dejës, Hajmel) dhe Lezhë (Dajç dhe Blinisht). I gjithë rajoni shtrihet në një sipërfaqe rreth 349 km², ku sipërfaqja më e madhe e tij ndodhet në qarkun Shkodër (68% e territorit) dhe vetëm 32% në qarkun e Lezhës.



Figura 4.5 Ulqësira e Zadrimës

4.1.2.1 Veçoritë e përgjithshme klimatike

Në përputhje me rajonizimin klimatik të territorit të Republikës së Shqipërisë, zona ku shtrihet territori i Bashkisë Vau-Dejës, bën pjesë në zonën me klimë mesdhetare fushore. Veçoria bazë e përgjithshme klimatike e kësaj zone janë dimrat e butë dhe të lagët dhe vera të nxehta e të thata.




Figura 4.6 Harta e zonave klimatike

Në kuadrin e elaborimit të PPV, përveç veçorive të përgjithshme klimatike të zonës, është kryer dhe vlerësimi i detajuar i elementëve meteorologjikë kryesorë dhe të rëndësishëm. Ky vlerësim është bazuar në analizën e informacionit shumvjeçar arkival të vendmatjeve meteorologjike, si stacioni meteorologjik i Bushatit, Shkodrës dhe Lezhës.

4.1.2.2 Rrezatimi diellor

Energjia diellore, e shprehur nëpërmjet rrezatimit diellor dhe diellzimit, studiohet jo vetëm për rëndësinë e saj, si një ndër faktorët kryesorë klimëformues, por edhe si një element me vlera të veçanta që ndikon konsiderueshëm në procese e dukuri biokimike. Për këtë arsye, bazuar në trajtimin e të dhënave shumëvjeçare të rrezatimit të përgjithshëm diellor dhe diellzimit është vlerësuar shpërndarja brendavjetore e sasisë së energjisë diellore (në pjesën valëshkurtër të saj), e orëve me diell si dhe pjesa ultraviolette e energjisë diellore. Nga kjo analizë, rezulton se sasia vjetore e rrezatimit të përgjithshëm diellor që merr kjo zonë është mjaft e lartë. Konkretisht, gjatë një viti sasia e këtij rrezatimi arrin vlerën 1.486 kWh/m^2 . Sasia e nxehtësisë që merr sipërfaqja horizontale e kësaj zone paraqet një variacion brendavjetor të shprehur qartë me një maksimum në muajt e verës dhe një minimum në muajt e dimrit (Figura 1). Nga shpërndarja brendavjetore e rrezatimit diellor, rezulton se vlera më e lartë arrihet në korrik ($6.735 \text{ Wh/m}^2/\text{ditë}$), ndërsa më e ulëta në dhjetor ($1.565 \text{ Wh/m}^2/\text{ditë}$).

Një komponent i rëndësishëm i rrezatimit të përgjithshëm diellor është edhe energjia e ardhur në diapazonin spektral që i përket rrezatimit ultraviolett. Energjia e ardhur në këtë diapazon spektral ka ndikim të veçantë në proceset e dekompozimit të mbetjeve urbane. Ashtu si dhe rrezatimi i përgjithshëm diellor, edhe rrezatimi UV paraqet një ecuri brendavjetore të shprehur qartë, me një maksimum në muajt e verës ($350 \text{ Wh/m}^2/\text{ditë}$) dhe një minimum në muajt e dimrit ($63 \text{ Wh/m}^2/\text{ditë}$).

Forma pothuajse sinusoidale e shpërndarjes brendavjetore e energjisë diellore, përveç të tjerash, shpreh efektin e lidhjes së drejtpërdrejtë me ecurinë vjetore të diellzimit (të orëve me diell). Diellzimi është një tregues tjetër i rëndësishëm i cili plotëson kuadrin e vlerësimit të sasisë së energjisë që merr sipërfaqja e tokës. Edhe në bazë të këtij treguesi, kjo zonë karakterizohet nga vlera të larta. Mesatarisht gjatë vitit, kjo zonë merr rreth 2.492 orë me diell. Sasia më e madhe e orëve me diell arrihet në korrik (350 orë) dhe ajo më e ulët në janar (104 orë). Në figurën në vijim jepet shpërndarja brendavjetore e diellzimit për këtë zonë.




Figura 4.7 Shpërndarja brendavjetore e rrezatimit të përgjithshëm diellor dhe rrezatimit UV




Figura 4.8 Ecuria brendavjetore e diellzimit

4.1.2.3 Temperatura e ajrit

Evidentimi i veçorive të regjimit termik të zonës në fjalë është kryer nëpërmjet shqyrtimit të disa prej treguesve kryesorë klimatologjikë të temperaturës së ajrit, si temperatura mesatare, temperatura maksimale, temperatura minimale, numri i ditëve me temperaturë mbi apo nën një prag të dhënë, që kanë kontribut të dukshëm në zhvillimin dhe intensifikimin e dukurive dhe proceseve biofizike në mjedise të caktuara.

Temperatura mesatare vjetore e ajrit në këtë zonë është relativisht e lartë, prej 14.7 °C. Ndërkohë duhet të vëmë në dukje që temperatura mesatare e ajrit ndryshon në mënyrë të konsiderueshme duke kaluar nga një stinë në tjetrën. Për të evidentuar këtë fakt, në figurën në vijim, jepet shpërndarja brendavjetore e temperaturës së ajrit.




Figura 4.9 Ecuria brendavjetore e temperaturës së ajrit

Siç shihet edhe nga ky grafik, ecuria brendavjetore e temperaturës karakterizohet nga një kurbë me formë të funksioneve trigonometrike, me një maksimum në muajt e verës, korrik/gusht dhe nga një minimum në muajt e dimrit, janar/shkurt. Muaji më i ftohtë për këtë zonë është muaji janar me temperaturë mesatare të ajrit 6.2°C , ndërsa muaji më i ngrohtë është muaji korrik me temperaturë mesatare 24.2°C .

Me interes për njohjen e regjimit të temperaturës së një zone është edhe shqyrtimi i temperaturave maksimale dhe minimale të ajrit ku rëndësinë më të madhe e kanë përkatësisht temperaturat mesatare maksimale dhe ato mesatare minimale. Për këtë arsye, në grafikun e figurës 3, bashkë me temperaturën mesatare të ajrit, janë paraqitur edhe kurbat e ecurisë vjetore për temperaturat mesatare maksimale e ato minimale.

Siç shihet, ecuria brendavjetore e këtyre temperaturave është krejtësisht e ngjashme me atë të temperaturës mesatare të ajrit. Konkretisht, temperatura mesatare e maksimumeve luhet nga 9.6°C në muajin janar, deri në 30.4°C në muajin korrik, ndërsa temperatura mesatare e minimumeve luhet përkatësisht nga 2.6 deri në 18.1°C në korrik. Diferenca ndërmjet temperaturës mesatare maksimale dhe asaj mesatare minimale në fund të fundit shpreh shkallën e luhatjes së temperaturave gjatë ditës për një muaj të dhënë, apo e thënë ndryshe, amplitudën mesatare ditore të temperaturës për muajin përkatës. Në përgjithësi, vihet re një vlerë më e vogël e amplitudës së temperaturës gjatë muajve të dimrit në krahasim me ato të muajve të verës.

Një tregues tjetër, në regjimin e temperaturës është edhe vlera absolute e temperaturave ekstreme e vrojtuar në këtë rajon. Kështu, temperatura minimale absolute e kësaj zone është -10.0°C , ndërsa temperatura maksimale absolute është 39.0°C .

Janë evidentuar në mënyrë të veçantë ditët që karakterizohen nga këto temperatura. Konkretisht, numri i ditëve në të cilat termometri ka zbritur nën 0°C është 24 ditë/vit, ndërsa numri i ditëve me temperaturë nën -5°C është 9 ditë/vit. Në këtë zonë numri i ditëve, në të cilat temperatura e ajrit, kalon kufirin prej 30°C është 47 ditë/vit. Ndërsa numri i ditëve me temperaturë ekstreme mbi pragun 35°C është mjaft i vogël, mesatarisht, jo më shumë se 5 ditë në vit.

4.1.2.4 Reshjet atmosferike

Në kuadër të evidentimit të veçorive të regjimit klimatik, reshjet atmosferike përbëjnë një ndër elementët më të rëndësishëm të tij. Në këtë zonë, reshjet atmosferike kanë një regjim të pastër mesdhetar, i cili karakterizohet nga një maksimum në muajt e dimrit dhe një minimum në muajt e verës. Duhet shënuar që kjo zonë karakterizohet nga sasi e konsiderueshme reshjesh. Brenda një viti në këtë zonë bien mesatarisht 1528 mm reshje.

Në figurën në vijim është paraqitur shpërndarja brendavjetore e reshjeve që bien në këtë zonë. Ashtu siç u përmend edhe më lart, reshjet janë të përqendruara kryesisht në periudhën e ftohtë të vitit gjatë të cilës bien mesatarisht 66 % e reshjeve vjetore. Muaji me më shumë reshje është muaji nëntor në të cilin bien mesatarisht 206 mm, ndërsa muaji më i thatë është muaji korrik në të cilin bien mesatarisht 35 mm.




Figura 4.10 Shpërndarja brendavjetore e reshjeve atmosferike

Në kuadër të evidentimit të veçorive të regjimit të reshjeve atmosferike interes të veçantë paraqet dhe njohja e numrit të ditëve me shi (në praktikën meteorologjike ditë me shi konsiderohen ditët me reshje të matshme 0.1 mm). Në studimin konkret, janë marrë në konsideratë të dhënat shumëvjeçare të ditëve me sasi reshjesh mbi pragjet 1 mm dhe 10 mm. Në këtë zonë regjistrohen mesatarisht 96 ditë në vit me reshje që tejkalojnë 1 mm. Ndërkohë, në këtë zonë janë vrojtuar mesatarisht 47 ditë në vit ku sasia e reshjeve të rëna është më e madhe se 10 mm. Shpërndarja brendavjetore e vlerave të këtij treguesi, është e njëjtë me atë të sasisë së reshjeve të rëna. Pra, numri më i madh i ditëve me shi vrojtohet gjatë periudhës së ftohtë të vitit, ndërsa gjatë periudhës së verës numri i ditëve të tilla është shumë i vogël. Në muajin nëntor vrojtohen mesatarisht 12 ditë me reshje > 1 mm, ndërsa në muajin korrik vrojtohen mesatarisht vetëm 3 ditë të tilla.

Intensiteti me të cilin bien reshjet është një tjetër tregues i regjimit të reshjeve atmosferike, i cili paraqet interes për projektimin e veprave hidroteknike, veprave të trajtimit të efluentëve urbanë dhe depozitimit të mbetjeve urbane. Reshjet intensive bëhen shkak për intensifikimin e shpëlarjes së mbetjeve të depozituara dhe për funksionimin jo normal të veprave të trajtimit të ujit.

Sasia më e madhe e reshjeve të rëna brenda 24 orëve është treguesi bazë dhe më i rëndësishëm i cili përdoret jo vetëm në llogaritjet e ndryshme hidroteknike, por njëkohësisht ai shërben edhe për llogaritjen e intensitetit të reshjeve për intervale më të vogla kohore, në ato stacione ku nuk disponohen pluviografë. P.sh, zona e Bushatit karakterizohet nga vlera relativisht të larta të intensitetit të reshjeve. Madje në raste të veçanta ato arrijnë vlera mjaft të larta, si p.sh, në datën 23.09.1963, në Bushat kanë rënë 330 mm shi, etj. Prandaj njohja e vlerave të intensitetit të reshjeve me një siguri të dhënë do të shërbente jo vetëm për të siguruar funksionimin normal të veprave, por njëkohësisht do të shërbente edhe për përcaktimin e masave që duhen marrë në ruajtjen e ekosistemit të territorit të bashkisë. Në tabelën e mëposhtme paraqiten vlerat e intensitetit të reshjeve për periudha të ndryshme përsëritjeje për intervale të ndryshme kohore.

Tabela 4.3 Intensiteti i reshjeve (mm) për disa intervale orare

Intervali (orë)	Periudha e përsëritjes (vjet)				
	100	50	20	10	5
24	246	222	190	166	140
12	223	200	169	146	121
6	203	183	157	137	115
3	143	129	111	97	82
1	59	53	45	40	33

4.1.2.5 Era

Njohja e karakterit të drejtimit dhe shpejtësisë së lëvizjes së ajrit mbi zonë dhe afër saj ka interes të madh në pikëpamje të studimit të ndikimit të veprave në zonën përreth. Në praktikën meteorologjike lëvizja e ajrit shprehet nëpërmjet elementit erë me treguesit e saj: drejtim dhe shpejtësi.

Siç dihet, era është një element që varet në mënyrë të konsiderueshme nga forma e relievit. Për këtë arsye, për të ndërtuar trëndafilin e erës për zonën territoriale të Bashkisë Vau-Dejës, u morën në konsideratë jo vetëm të dhënat arkiviale mbi këtë element në vendmatjet klimatologjike të Shkodrës dhe Lezhës, por edhe morfologjia lokale e relievit në vende të caktuara, si p.sh në zonën ku është ndërtuar venddepozitimi i mbetjeve urbane në Njësinë Administrative Bushat, që ndikon konsiderueshëm në modifikimin si të shpejtësisë ashtu edhe të drejtimit të erës.

Ndërkohë, duke qenë se kjo zonë ndodhet në një distancë jo të madhe nga deti, është e kuptueshme që ndikimi i këtij të fundit luan një rol të konsiderueshëm në regjimin e erës. Konsideruar të gjithë faktorët e mësipërm janë ndërtuar trëndafilët e erës për 2 muajt karakteristike të vitit, muajin janar dhe muajin korrik. Me shikimin e parë, vërehet një ndryshim i theksuar ndërmjet trëndafilave të këtyre 2 muajve (Figura 5). Ndërsa në muajin janar predominojnë erërat që fryjnë nga drejtimi i veriut dhe verilindjes, në muajin korrik predominojnë erërat që fryjnë nga kuadranti i perëndimit.




Figura 4.11 Trëndafilin e erës për dy muajt karakteristike të vitit

Konkretisht, gjatë muajit janar, erërat që fryjnë nga drejtimi i veriut, kanë një rastisje prej 23 %, ato që fryjnë nga verilindja një rastisje prej 13 %. Duke ardhur nga brendësia e territorit, këto erëra bien masa ajrore të ftohta dhe për rrjedhojë krijojnë kushte për shfaqjen e

temperaturave të ulëta. Gjatë këtij muaji, rastisja e erërave që fryjnë nga kuadranti i perëndimit, është mjaft e vogël, duke arritur deri në 1 % të të gjitha rasteve.

Në muajin korrik, që pranohet si muaji përfaqësues për stinën e verës, rastisjen më të madhe e ka drejtimi i erës që fryn nga perëndimi me 13 % të rasteve dhe ai i jugperëndimit me 7 %. Megjithatë, rastisja e erës që fryn nga drejtimi i veriut dhe verilindjes në këtë muaj është përsëri i dallueshëm. Drejtimi i veriut ka një rastisje prej 9 %, ndërsa ai i verilindjes 5 %.

Një regjim i tillë i erës gjatë këtij muaji është rezultat i drejtpërdrejtë i ndikimit të brizës detare e cila gjatë ditës fryn nga deti për në tokë ndërsa gjatë natës nga toka në det.

Për studimin konkret ka vlerë të veçantë treguesi tjetër i lëvizjes së masave ajrore, ai i shpejtësisë së kësaj lëvizjeje. Shpejtësia mesatare vjetore e erës në këtë zonë është 2.5 m/s. Në muajin janar shpejtësia e erës arrin në 3.3 m/s, ndërsa në korrik 2.1 m/s. Një rastisje të konsiderueshme në këtë zonë ka edhe qetësia, apo rastet pa erë. Qetësia gjatë vitit zë rreth 48 % të të gjithë kohës.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë mbi rastisjen e shpejtësisë së erës, me poshtë po paraqesim një tabelë në të cilën jepet rastisja e erës me shpejtësi për pragje të ndryshme.

Tabela 4.4 Rastisja e erës sipas intervaleve

Intervali (m/s)	0 - 1	2 - 5	6 - 10	11 - 15	> 15
Rastet (%)	50	35	10	3	2

Siç shihet, edhe nga kjo tabelë, rastet më të shumta i takojnë intervalit 0 - 1 m/s (50 %), por në të njëjtën kohë, nuk janë të neglizhueshme edhe rastet me shpejtësi ere mbi 15 m/s. Këto raste përbëjnë 2 % të të gjithë kohës.

4.1.2.6 Problematika lidhur me kushtet klimatike

Kushtet klimatike të zonës së marrë në analizë, krijojnë disa probleme mjedisore, për shkak të ndryshueshmërisë të treguesve klimatikë midis zonave. Disa prej këtyre impakteve, si pasojë e vlerave ekstreme të elementëve të klimës, janë:

- Reshjet intensive shkaktojnë përmbytje, erozion të tokës, erozion të brigjeve të lumenjve, dëmtim të cilësive të tokës, vartësi të prodhimit bujqësor, vështirësi për kafshët dhe sektorin e blegtorisë.
- Temperaturat ekstreme dhe dëbora dëmtojnë infrastrukturën rrugore, erozion të shkëmbinjve në saj të alterimit nga ndryshimi i temperaturës, vonesa të proceseve bujqësore, kërkesa më të larta për ngrohje gjë e cila çon në rritjen e shkarkimeve të gazeve të ndryshme në mjedis.

Për të përballuar riskun e faktorëve ekstreme klimatikë si përmbytjet, zjarret, erozionin, menaxhimi kërkon:

- Planifikimin e masave, si vënia në efijencë të plotë e sistemeve të kullimit, parandalimin e efekteve nga veprimtaritë ekonomike si menaxhimi i hidrocentraleve për të kryer shkarkime të parashikuara, masat për parandalimin e erozionit etj.
- Projektimin e rrugëve dhe ndërtesave duke marrë parasysh faktorët klimatikë për rritjen e qëndrueshmërisë nga dëmtimi.

- Ndërtimin e brezave të gjelbër mbrojtës nga era, veçanërisht në zonat tipike të erërave të Shirokës dhe Nënshkodrës. Brezat e gjelbër krijohen me kate të kombinuara të drurëve të lartë me brezin e shkurreve.

4.1.3 Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës

Në territorin e bashkisë Vau-Dejës, ndodhen disa monumente të natyrës të cilët kanë një rëndësi të veçantë për vlerat e tyre historike, shkencore, estetike dhe turistike. Sipas klasifikimit të IUCN, këto monumente bëjnë pjesë në kategorinë e III dhe të V të zonave të mbrojtura.

Në vijim është bërë një përshkrim i shkurtër i karakteristikave kryesore të tyre:

- **Zona e Mbrojtur Lumi i Bunës-Velipojë (peizazh i mbrojtur)**

Peizazh Ujor Tokësor i Mbrojtur Lumi Buna-Velipojë bën pjesë në Kategorinë V të, të zonave të mbrojtura.

P.U.T.M Lumi Buna-Velipojë u shpall me V.K.M 682 datë 2.11.2005 dhe ka një sipërfaqe prej 23 027 ha.

Kufijtë e zonës përfshijnë:

Në Veri: Grykëderdhja e lumit Buna, përgjatë rrjedhjës së lumit Buna deri te pika e bashkimit me lumin Drin, kalon pranë Kosmaçit, Kuçit, argjinaturës, kodra e Vukatanës (48.0 m), në argjinaturë, pranë urës së Drinit deri te maja Kalaja Xhdatit (217.0 m);

Në Lindje: Maja Kalaja Xhdatit (217.0 m), vazhdon në krah të rrugës automobilistike Bushat-Barbullush, në kanalin kullues (Pekesenës), pranë fshatit Ranxë, përgjatë rrugës së Fshatit të Ri, anës kodrës, përgjatë argjinaturës, me vijën ndarëse të kodrave me fushën e Torrovicës deri te kuota 107.0 m;

Në Jug: Kuota 107.0 m (4381470.11L/4636550.15V), kuotat 339.0 m, 386.0 m, 384.0 m, 332.0 m deri te pika me koordinata (4379344.18L/4633806.87V);

Në Perëndim: Pika me koordinata (4379344.18L/4633806.87V), gjatë vijës bregdetare të detit Adriatik deri te Grykëderdhja e lumit Buna.

Rrugët që të dërgojnë në destinacion janë: Shkodër Velipoje, Shkodër Dajç-Velipoje, Shkodër Bushat-Mali Jushit Velipoje, Lumi Buna Grykë derdhja në det me rruge ujore.



Figura 4.12 Pamje ajrore e peizazhit të mbrojtur

- **Fusha e Liqethit**

84

- Fragment i thyerjes tektonike Shkodër - Pejë

Është ndër thyerjet më të mëdha tektonike në truallin shqiptar, që përshkon territorin nga Shkodra në perëndim deri në Pejë (Kosovë) në lindje. Përgjatë saj bëhet kontakti verior tektonik i shkëmbinjve ofiolitikë të zonës tektonike " Mirdita " me flishin e paleogenit (Pg 1-2) të zonës tjetër tektonike të " Krastë - Cukalit ". Për shkak të riaktivizimit të saj, rigjenerohen shpesh tërmete të fuqishëm. Në planin tektonik ka shumë vizime horizontale, të cilat janë rezultat i shtytjeve të djathta të thyerjes Shkodër – Pejë. Shprehja më e qartë e kësaj thyerjeje është në fshatin Karmë të Pukës. Ai është një monument gjeologjik (gjeomonument) me vlera të mëdha shkencore, gjeologjike e gjeomorfologjike. Vizitohet duke ndjekur rrugën automobilistike Vau-Dejës – Koman.

- Shpella e Malagjisë

Ndodhet në afërsi të fshatit Malagji të rrethit të Shkodrës, në faqen verilindore të malit të Cukalit; në lartësinë 1.300 m mbi nivelin e detit. Është 180 m e gjatë, përbëhet nga disa galeri, që ndërthuren me hapësira më të gjera dhe puse të shumtë dhe mjaft të thellë; ka liqene të vegjël dhe konkrecione të shumta. Gjendja e saj është mjaft mirë e ruajtur, por rrezikohet nga banorët vendas dhe pseudospeleologët e huaj.

Ka vlera shkencore, didaktike dhe turistike. Për të vajtur tek kjo shpellë, duhet të merret rruga automobilistike Shkodër - Cukal dhe pastaj të vazhdohet më këmbë në drejtim të shpatit verilindor të Cukalit.




Figura 4.14 Shpella e Malagjisë. (Burimi: AKZM)

4.1.3.1 Zonat e mbrojtura të propozuara

Në territorin e bashkisë Vau-Dejës, PPV ka parashikuar shtimin dhe zgjerimin e zonave të mbrojtura. Zonat e propozuara janë: krijimi i Parkut Natyror Rajonal të Fushës së Liqethit dhe Parkut Natyror Rajonal të Lumit Drin. Propozimi që kjo zonë me vlera të larta ekologjike dhe natyrore të marrë këtë status ka ardhur si rrjedhojë e konsultimit me kornizën ligjore dhe propozimeve nga përfaqësuesit e specialistët e bashkisë Vau-Dejës dhe njësive administrative gjatë konsultimeve për hartimin e PPV-së dhe VSM-së.

Propozimi për shtimin sipërfaqeve të zonave të mbrojtura, siguron konservimin e natyrës, biodiversitetit dhe peizazhit, mbrojtjen e trashëgimisë tradicionale, historike, kulturore dhe shpirtërore, me pjesëmarrjen e komunitetit. Gjithashtu Parku Natyror Rajonal i lumit Drin do të shërbeje për mbrojtjen e peizazhit të lumit Drin dhe lidhjen e Alpeve me peizazhin e Bunës dhe Velipojës.

Ky propozim vjen gjithashtu nisur dhe nga potenciali i madh që ka për zhvillimin e ekoturizmit duke e gërshetuar këtë edhe me përfshirjen e një komuniteti të gjallë dhe aktiv, duke siguruar një përvojë të veçantë për vizitorët e shumtë të tij.

Shpallja e kësaj zone Park Natyror Rajonal do të kërkojë angazhimin maksimal të Bashkisë së Vau-Dejës, nëpërmjet kryerjes së të gjitha procedurave ligjore si dhe përgatitjes së një projekti për të garantuar këtë mbrojtje ligjore.

Propozimi për shpalljen e këtyre zonave "park natyror rajonal" ka ardhur duke mbajtur parasysh kriteret e mëposhtme:

- a) Ndodhet brenda territorit administrativ të qarkut;
- b) është jo më i vogël se 50 ha;
- c) siguron mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit natyror e të biodiversitetit në shkallë lokale; ç) është zonë e gjelbër natyrore, ose e kultivuar, që shërben për plotësimin e nevojave të komunitetit për veprimtari ekonomike tradicionale, duke respektuar kërkesat e parimit të përdorimit të qëndrueshëm të territorit;
- d) është i populluar me lloje të florës dhe faunës, kryesisht të karakterit lokal;
5. dh) ofron mundësi për komunitetin të ushtrojë veprimtari shoqërore, edukative, argëtuese, sportive, kulturore, rekreative dhe turistike;
- e) nuk është i përfshirë në rrjetin ekzistues të zonave të mbrojtura;
6. ë) nuk ka habitate të llojeve të rrezikuara, të kërcënuara, të rralla dhe endemike, të cilat mbrohen në nivel kombëtar, me një akt të veçantë normativ.



Figura 4.15 Harta e zonave të mbrojtura ekzistuese dhe të propozuara për zgjerim

4.1.4 Zonat e trashëgimisë kulturore dhe historike

Bashkia e Vaut të Dejës, përfshin në juridiksionin e saj një territor mjaft të gjerë dhe të pasur me objekte të trashëgimisë kulturore, të shpallura me status "monument kulture" si dhe objekte të tjera me vlerë pa status.

Objekte të Trashëgimisë Kulturore të shpallura me status "Monument Kulture" :

- Kalaja e Sapës, shek. VII p.e.s., vendndodhja Nënshat
- Kalaja e Vigut, shek. I, vendndodhja Vig.
- Zona Arkeologjike "A" dhe "B" e Vendbanimit të Komanit shek.I vendndodhja Koman
- Varrezat e Lashta të Komanit, shek.VI-IX, vendndodhja Koman.
- Kalaja e Dalmacës, shek. V / VIII-IX, vendndodhja Koman
- Kisha e Shën Mërisë, shek.VIII, vendndodhja Vau Dejës.

- Kalaja e Vau Dejës, shek. XIV, vendndodhja Vau Dejës
- Rrënojat e Kishës së Shën Markut, shek.VIII-IX, vendndodhja Vau Dejës.
- Kalaja e Shurdhahut, shek. XI, vendndodhja Vau-Dejës
- Kompleksi Ndre Mjeda dhe Zona Mbrojtëse, shek. XX, vendndodhja Kukël

Pjesa më e madhe e këtyre vlerave të trashëgimisë kulturore për shkak të rrethanave historike, kanë meritur deri në ditët tona në gjendje rrënojë, ardhur si pasojë e shkatërrimeve të bëra nga pushtuesit osman. Njoftimet më të vjetra edhe pse të pakta për këto monumente, gjenden ndër burime historike të periudhës mesjetare. Në këto dokumente ka të dhëna me mjaft vlerë për numrin dhe vendndodhjen e monumenteve, madhësinë dhe mënyrën e ndërtimit të tyre. Studimet e para të arkitekturës së këtyre ndërtimeve janë të fundit të shekullit XIX, nga konsulli i atëhershëm austriak në Shkodër Teodor Ippen.

Gjatë luftërave për nënshtrimin e Ilirisë dhe Epirit romakët u dogjën dhe u shkatërruan një numër i madh qytetesh të fortifikuar dhe kështjellash. Në shekujt e parë të erës sonë vihet re një ndërprerje e veprimtarisë fortifikuese që përkon me të ashtuquajturën “paqe romake”, por më tej për të përballuar dyndjet e “barbarëve” dhe lëvizjet e brendshme, ajo rinis sërish. Veprimtaria e ndërtimit të fortifikimeve në periudhën e vonë antike fillon nga fundi i shek. III dhe fillimi i shek. IV.

Ndërtimet e kultit të Shqipërisë së Veriut, në drejtim të arkitekturës së tyre paraqesin një sërë veçantish të kushtëzuara nga lidhja gjithnjë e peshkopatave të kësaj zone me kishën e Perëndimit. Në këto rrethana, kemi krijimin e trajtave të veçanta, të kushtëzuara nga influencat arkitekturale të Bizantit apo perëndimit.

Mangësitë e burimeve të shkruara nga Mesjeta e hareshme shqiptare ndikuan që t’u jepej përparësi kërkimeve arkeologjike shqiptare si një nga mundësitë parësore për të ndriçuar këtë periudhë të hershme ku ndërthuren tre kultura të ndryshme të të gjithë trevës së Veriut, Malësisë, Mirditës dhe Zadrimës.

KALAJA E SAPËS

Monument kulture kat. I, shpallur me Vendimin R.U.SH. Nr. 6, datë 15.01.1963.

Koordinatat Gjeografike: 41°56'37.00"N 19°40'2.93"E

Fusha: Arkeologji; Gjinia: Vendbanim; Tipologjia: Kala. Shek. VII p.e.s.

Njësia administrative Hajmel, vendndodhja: Nënshat

Përdorimi : Kala. DRKK Shkodër.



Figura 4.16 Pamje nga Kalaja e Sapës

Pozita gjeografike.

Qyteti ngrihej në brendësi të malit të Shën Mëhillit (sot mali i Nënshatit) në një tarracë natyrore rreth 30 m pa mbërritur në majën e malit, duke i dhënë një mbrojtje të sigurt ndaj sulmeve.

Të dhëna historike.

Dioqeza e Sapës ka një histori 950 vjeçare dhe ajo ndodhej brenda qytetit me të njëjtin emër i cili ishte dhe i fortifikuar. Pikërisht ky sistem mbrojtës njihej si Kalaja e Sapës. Të dhënat e para për këtë qytet i kemi nga Annuali i Selisë së Shenjtë që në vitin 1062. Me rënien e perandorisë bizantine nën sundimin e feudalëve latin në vitin 1204, në territoret e Shqipërisë së mesme e të veriut krijohen një serë peshkopatash të reja të lidhura me perëndimin katolik, ku ato të veriut lidhen nëpërmjet kryepeshkopatës së Tivarit. Kështu kemi themelimin e peshkopatës së Sapës në vitin 1291 e cila njihet nga burimet historike dhe si një fortifikim. Prej tyre mësojmë se selia e peshkopatës së Sapës ndodhej në malin e lartë të mbiemëruar dhe mali i Shën Mëhillit nga emri i katedrales së saj. Sistemi mbrojtës i kësaj peshkopate njihej si Kalaja e Sapës, ku vendndodhja e saj transmetohej dhe nga relacionet e udhëtarëve prej shekulli XVII e këtej.

Me interes të veçantë është e dhëna e peshkopit të Sapës së Zadrimës, Frang Bardhit në relacionin e tij mbi gjendjen në Zadrimë dërguar Romës në vitin 1641, sipas së cilës në këtë vend bashkëbanuan dikur zotërinjtë Dukagjinas me peshkopin e Zadrimës.

Arkitektura dhe teknika e ndërtimit.

Kalaja e ardhur në gjendje rrënojë, bashkë me rrënojat e qytetit brenda saj, ngihet në lartësinë 580 m mbi nivelin e detit tashmë mes një vegjetacioni të dendur dhe të vështirë për tu evidentuar. Porta nga ana jugore ruan vetëm portikun. Në terren vërehen përqendrimet e qeramikës mesjetare të fragmentuar. Mbetjet e murit rrethues janë të përmasave të mëdha në ndryshim nga pjesa e sipërme ku përdoren gurë të vegjël të lidhur mes tyre me llaç. Kjo ndërthurje në kohë, me lëkundje të influencave dhe të administratës kishtarë lindore dhe perëndimore ndikoi dhe në arkitekturën e kishave të kësaj krahine. Në lartësinë 30-40 cm ruhen ende disa struktura banimi, si dhe në lindje pjesë të strukturës së kishës së Shën Mëhillit. Kjo periudhë për studiuesit e arkitekturës së kultit: mesjeta e hershme, përbën një periudhë ku mungojnë dëshmitë e drejtpërdrejta për monumentet.

Ndërhyrjet restauruese.

Nuk është bërë asnjë ndërhyrje restauruese si në drejtim të monumentit ashtu dhe të mjedisit rrethues.

Nga ana e DRKK Shkodër propozohet: Pastrimi nga vegjetacioni i bimësisë për hapjen e shtegut dhe evidentimin e sitit. Gjithashtu propozohet konservim dhe konsolidim i kreut të mureve për të ndaluar degradimin e mëtejshëm të tyre, si dhe mundësia e vendosjes së sinjalistikës orientuese dhe informuese në lidhje me këtë monument dhe objektet e tjera në zonë.

Infrastruktura.

Kalaja e Sapës ndodhet në rrugën Lezhë - Vau Dejës. Rruga automobilistike për të shkuar në objekt është në gjendje të keqe dhe paraqet nevojën e ndërhyrjes.

Turizmi.

Vendndodhja e Kalasë së Sapës në një tarracë natyrore rreth 30 m pa mbërritur në majën e malit të Shën Mëhillit (sot mali i Nënshatit), krijon mundësi të mira për zhvillimin e turizmit malor në këtë zonë.

Nga ana e Bashkisë së Vau Dejës duhet:

- Të futet në planet e saj, rikonstruksioni i rrugës që të çon te kalaja.
- Të organizohen me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme ekspedita për pastrimin e bimësisë rreth e qark monumentit si dhe hapjen e shtigjeve drejt objekteve me vlera përreth tij si një mundësi kjo, e njohjes së vlerave të objektit.
- Të punohet për vendosjen e sinjalistikës së duhur.
- Të kërkohet pranë IMK aplikimi i fondeve për restaurimin dhe konsolidimin e mureve ekzistuese.

KALAJA E VIGUT

Monument kulture kat. I, shpallur me Vendimin Nr. 586, datë 17.03.1948/Nr. 4874, datë 23.09.1971, aprovuar me Ligjin Nr. 609, datë 24.05.1948

Fusha: Arkeologji; Gjinia: Vendbanim; Tipologjia: Kala. Shek. I.

Njësia administrative: Vig-Mnelë, vendndodhja: Vig.

Përdorimi: Kala. DRKK Shkodër.



Figura 4.17 Pamje nga Kalaja e Vigut

Pozita gjeografike.

Kalaja e Vigut është një ndër tri kalatë (castrumet) ushtarake romake në territorin shqiptar. Gjendët në një kryqëzim rrugësh antike mes Lezhës e Mirditës. Ajo është një kështjellë ushtarake dhe me funksion ekonomik ku një veçori e saj është dhe komunikimi si rezultat i kontrollit të vijave të qarkullimit gjë që faktohet me pozicionimin e vendosjes së saj në nyjet kryesore të lëvizjes.

Kalaja e Vigut ndodhet në terren të rrafshët në luginën e lumit Gjadër , në vendin ku bashkohet lumi i Vomës me lumin e Gjadrit në kuotën 151. Në veri kufizohet me lumin Gjadër dhe në perëndim e jug me zallishten e këtij lumi.

Të dhëna historike.

Kalaja fushore romake, siç janë edhe disa të tjera të tilla në Shqipëri, në atë kohe ishte pjesë e rrugëve të rëndësishme tregtare që kalonin përmes këtij kryqëzimi Shkodër - Orosh dhe Lezhë - Pukë - Prizren. Ajo mendohet të jetë ngritur diku mes fundit të shekullit të tretë dhe fillimit të atij të katërt siç zbulon eksperti dhe studiuesi i njohur i fortifikimeve, profesor Gjerak Karaiskaj.

Arkitektura dhe të dhëna teknike.

Kalaja e Vigut ka një sipërfaqe 0.6 ha dhe formë trapezi të çrregullt me mure 2.20 m të gjerë të punuar me teknikën e muraturës së përzier. Në gjendjen e sotme, kalaja vjen në formë rrënojë me mure pothuaj gjatë gjithë perimetrit të saj të ngritura në lartësitë që variojnë 0.5 m-2.5 m ku dallohet mjaft qartë teknika e ndërtimit të mureve.

Teknika e ndërtimit të mureve karakterizohet me përdorimin e gurëve të zallit të lidhura me llaç, fugaturat e gjera mes mureve kanë të vendosura copa tjegullash ose tullash për të mbushur boshllëqet. Kështjella përforcohet prej 12 kullash të fuqishme: drejtkëndëshe në meset, me ballë të lakuar në hyrjet dhe në formë freskoreje në anët e mureve.

Në zonën e Kalasë së Vigut , pranë varrezave ndodhen një kishë e vjetër, ku thuhet se ka shërbyer Ndre Mjeda.

Ndërhyrja restauruese.

Gjatë viteve 1980-1985 është ndërhyrë me punime mirëmbajtjeje në kala. Janë kryer punime si konsolidim të mureve. Prej vitesh tashmë, një pjesë të kalasë vazhdojnë ta marrin prurjet e përroit të Vomit dhe lumi të Gjadrit që kalojnë shpesh në këtë vend sidomos gjatë periudhës së dimrit. Një pjese muresh kanë rënë, të tjerët po gërryhen gjithnjë e më shumë.

Nga ana e Drejtorisë Rajonale Shkodër është propozuar planifikimi i fondeve për ndërhyrje në restaurimin, konsolidimin e mureve si dhe marrja e masave ndaluese si rezultat i gërryerjeve të lumenjve.

Infrastruktura.

Rruga drejt fshatit Vig, është rreth 99 km nga Tirana. Ka rrugë automobilistike për të shkuar në objekt, po gjendja e saj është pjesërisht e keqe dhe duhet ndërhyrë në infrastrukturën e saj.

Turizmi.

Kalaja e Vigut shihet si një potencial për zhvillimin e turizmit në këtë zonë duke përmirësuar dukshëm infrastrukturën e rrugës, restaurimin e monumentit si dhe ndërhyrjen në mjedisin rrethues.

Banorët tregojnë se hera-herës vijnë edhe turistë shqiptarë e të huaj, ngrenë kampingje e qëndrojnë këtu disa ditë. Në kushtet e një situatë tjetër Kalaja e Vigut do të ishte një resurs i jashtëzakonshëm për fshatin që sot është tkurrur nga 300 shtëpi në vetëm rreth 35 të tilla.

Nga ana e Bashkisë së Vau Dejës duhet:

- *Të futet në planet e saj, rikonstruksioni i rrugës që të çon te kalaja.*
- *Të organizohen me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme ekspedita për pastrimin e bimësisë së mjedisit rreth e qark monumentit si dhe hapjen e shtigjeve drejt objekteve me vlera përreth tij si një mundësi e mirë kjo për njohjen dhe promovimin e vlerave të monumentit.*
- *Të punohet për vendosjen e sinjalistikës së duhur.*
- *Të kërkohet pranë IMK aplikimi i fondeve për restaurimin dhe konsolidimin e mureve ekzistuese.*

ZONA ARKEOLOGJIKE "A" dhe "B" E VENDBANIMIT TE KOMANIT (DALMACA E VJETER) DHE RREGULLORJA E ADMINISTRIMIT

Monument kulture kat. I, shpallur me V.K.M. Nr. 786, datë 22.09.2015

Fusha: Arkeologji; Gjinia: Vendbanim; Tipologjia: Vendbanim; Shek. I.

Njësia administrative: Temal, vendndodhja: Koman.

Përdorimi: Zonë arkeologjike. DRKK Shkodër.






Figura 4.18 Zona arkeologjike A dhe B

Pozita gjeografike.

Komani, i cili ndodhet rreth 32 kilometër në lindje të qytetit të Vaut të Dejës, është një zonë e thellë malore mes Pukës, Tropojës dhe Shkodrës ku ndodhet hidrocentrali i Komanit si dhe fshati me të njëjtin emër.

Të dhëna historike.

Vendbanimi i Komanit i ka dhënë emër një qytetërimi të tërë mesjetar në Ballkanin Perëndimor, ku pothuajse e gjithë shtrirja përkon në territorin shqiptar. Për ti paraprirë studimit është ndërtuar një projekt i madh arkeologjik që do të zgjasë me vite pikërisht për zbulimin e këtij vendbanimi të rrallë. Zbulimet tregojnë se bëhet fjalë për një qendër të shtrirë minimumi në 35 ha më një vitalitet ndërtimor dhe dendësi banimi të jashtëzakonshme të paktën përgjatë 1000 viteve.

Rregullorja e Administrimit.

Qeveria shqiptare ka shpallur zonat e vendbanimit të Komanit, si zona arkeologjike. "Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2, të nenit 30, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave vendosi: 1. Shpalljen e zonave arkeologjike "A" dhe "B" të Vendbanimit të Komanit (Dalmaca e Vjetër), sipas hartës dhe koordinatave gjeografike bashkëlidhur këtij vendimi. 2. Miratimin e rregullores "Për administrimin e zonave arkeologjike "A" dhe "B" të Vendbanimit të Komanit (Dalmaca e Vjetër)", e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi", thotë vendimi.

Me këtë akt, qeveria zyrtarizon mbrojtjen sipas ligjit të këtij vendbanimi, shumë i rëndësishëm për historinë e antikitetit të vonë dhe mesjetës së hershme në Shqipëri. Komani si vendbanim, i ka dhënë emrin Kulturës së Komanit, përdorur nga historiografia shqiptare dhe arkeologjia, si përkufizues i hipotezës së kalimit nga ilirët tek arbrit. Në zonën arkeologjike "A", të Vendbanimit të Komanit (Dalmaca e Vjetër), lejohet: rikonstruksioni i rrugëve dhe punimet për rrjetet e infrastrukturës, mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë, në vazhdim "KKA", dhe nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në vazhdim "KKR".

Restaurimi e konservimi i monumenteve dhe strukturave arkeologjike, kryerja e formave të testimit, të përcaktuara me vendim të KKA-së, projektet kërkimore shkencore, të miratuara nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë, pas shqyrtimit dhe miratimit nga KKA-ja dhe KKR-ja. Konstruksionet, të cilat vendosen dhe përdoren nga institucionet shtetërore të specializuara, duhet të jenë të lëvizshme (të çmontueshme). Projekti për këto ndërhyrje miratohet nga KKA dhe KKR. Në zonën arkeologjike "B", të Vendbanimit të Komanit lejohen zhvillimet ndërtimore, pas miratimit me shkrim nga KKA dhe KKR. Punime zhvillimore, vetëm pas kryerjes së formave të testimit. Format e testimit përcaktohen nga KKA-ja. Për çdo ndërhyrje në zonën arkeologjike "B" subjekti ndërtues i interesuar duhet të marrë konfirmimin nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, në vazhdim "DRKK", përgjegjëse për Vendbanimin e Komanit.

VARREZAT E LASHTA TE KOMANIT.

Monument kulture kat.I, shpallur me Vendimin e R.U.Sh. Nr.6, datë 15.01.1963

Fusha: Arkeologji; Gjinia: Vendbanim; Tipologjia: Banesa; Shek. VI-IX

Fshati: Koman . Njësia administrative: Temal.

Përdorimi: Rrënoja varrezash. DRKK Shkodër.




Figura 4.19 Pamje nga Varrezat e Komanit

Pozita gjeografike.

Varrezat e Lashta të Komanit nga emri i fshatit ku ndodhen, ndryshe njihen dhe si Kultura e Komanit. Ato shtrihen në një kodër të lartë 586 m mbi nivelin e detit, në pjesën më të butë të saj me drejtimin Lindje - Perëndim. Varrezat përfshijnë një sipërfaqe prej 1 ha dhe deri më sot janë gërmuar dhe nxjerrë në dritë mbi 150 varre.

Të dhëna historike.

Kjo varreze u gërmua për herë të parë në vitin 1898 nga Degrand e më pas në vitin 1902 nga Han dhe T.Ippen. Interesi për këtë kulturë u shtua edhe gjatë gjysmës së parë të shek. XX,

gjë që duket nga numri i shumtë i studiuesve, që u morën me interpretimin e lëndës arkeologjike të grumbulluar nga zbulimet e bëra në varrezën e Komanit (S.Reinah, T.Ipen, P.Treger, Fr.Nopça, L.Ugolini, L.Rei, H.Bule, D.Mustili, M.Garasanin, J.Kovačević, J.Koroshec etj.). Edhe pse gjatë gjysmës së parë të shek. XX u bënë kërkime e studime të shumta rreth kulturës së Komanit, problemet themelore të saj mbeten të pazgjidhura.

Kultura arbërore daton në dy faza, e para nga shekulli i VI deri në atë të VIII pas Krishtit, është faza kur gjithë territori Ilirisë së asaj kohe ishte i krishterë. Kjo është faza kur gjithë Iliria e asaj kohe kishte marrëdhënie administrative me Bizantin dhe Romën, pra kemi një miksazh të disa kulturave që kalojnë në territorin e Shqipërisë. Faza e dytë lidhet me shekujt IX dhe XIII-XIV dhe është koha kur territoret tona kanë qenë të pushtuar nga Bullgarët, por këtu vërejmë elemente të fortë të krishterë, që tregojnë në mënyrë të qartë për prezencën e kësaj kulture dhe për lidhjet e saj me trashëgiminë kulturore arbërore.

Punimet e gërmimit.

Pas vitit 1944 filluan dhe kërkimet e rregullta arkeologjike në kala, ku u zbulua për herë të parë varreza që përmban trashëgiminë kulturore të asaj që u quajt kultura arbërore. Zbulimi i një sërë vendbanimeve prej guri, përdorimi i metalit, ndërtimi i shumë kishave dhe varrimet e të vdekurve të cilat kryheshin me veshje e stoli, si dhe gjetja e monedhave, flasin qartë për zhvillim ekonomik tejet të lulëzuar, një zhvillim i cili nuk është hasur më parë në asnjë vendbanim të hershëm në Shqipëri, e madje as në Ballkanin Perëndimor.

Ndërkohe një fushatë e gjerë gërmimesh nga arkeologë shqiptar, janë zhvilluar gjatë viteve 1956, 1962, 1978-1979, 1986. Ne bazë të gjetjeve dhe inventarëve të varreve kjo varrezë daton mes shek. VI-IX.

KALAJA E DALMACES

Monument kulture kat. I, shpallur me Vendimin R.U.SH. Nr.6, datë 15.01.1963.

Koordinatat Gjeografike: 42° 5'35.58"N, 19°49'44.84"E

Fusha: Arkitekturë; Gjinia: Fortifikime; Tipologjia: Kala. Shek. V- VIII-IX.

Njësia administrative: Temal, vendndodhja: Koman.

Përdorimi: Kala. DRKK Shkodër.



Figura 4.20 Pamje nga Kalaja e Dalmacës

Pozita gjeografike.

Kalaja e Dalmacës ndodhet në majë të malit, 600 m mbi nivelin e detit brenda zonës së banuar. Siti shtrihet në një territor që ka një sipërfaqe prej 2 ha dhe përbëhet nga niveli i mesëm i habitatit dhe ai i poshtëm. Siti shtrihet pothuajse paralel në vijë ajrore me nekropolin e vendbanimit.

Të dhëna historike.

Kalaja e Dalmacës u gjurmua për herë të parë nga konsulli francez në Shkodër Degrand në 1899. Gërmimet e para aty u bënë nga albanologu i njohur J.Han.

Kalaja e Dalmacës i përket zonës së Komanit ku falë zbulimeve arkeologjike me tepër vlerë të këtyre ditëve të fundit, po klasifikohet si qendra e qytetërimit të Shqipërisë në Mesjetën e hershme.

Zona po kthehet në një pikë referimi për studimin e qytetërimit të Ballkanit Perëndimor kontinental në periudhën e Mesjetës së hershme, atyre që quhen shekujt e errët të historisë. Sipas arkeologëve, zbulimet dëshmojnë për herë të parë një informacion të mjaftueshëm për atë periudhë të qytetërimit.

Arkitektura dhe të dhëna teknike.

Në kalanë e Dalmacës, shohim nivelin e mesëm të vendbanimit i cili ka në përbërje të tij dhe zonën më intensive të gërmuar deri më sot. Ky nivel përfaqëson një zonë të dendur ndërtimesh të dokumentuara dhe një seri të konsiderueshme muresh e strukturash. Si fazë e parë e nivelit të mesëm të vendbanimit është fundi i periudhës antike. Ky vendbanim zë një sipërfaqe prej 105 m². Muret ruhen në lartësinë nga 0,60 m deri në 1,20 m.

Niveli i poshtëm i vendbanimit zë një sipërfaqe prej 230 m². Muret ruhen deri në lartësinë 1,42 m. Trashësia e tyre shkon në 60 cm. Këto mure janë të punuar mirë me llac dhe të fugatuar në mënyrë të rregullt. Ky nivel i vendbanimit mendohet të jetë më i voni ose i fundit, që shkon aty mes shekujve VIII-XII.

Zbulimi i një sërë vendbanimeve prej guri, përdorimi i metalit, ndërtimi i shumë kishave dhe varrimet e të vdekurve të cilat kryheshin me veshje e stoli, si dhe gjetja e monedhave, flasin qartë për zhvillim ekonomik tejet të lulëzuar, një zhvillim i cili nuk është hasur më parë në asnjë vendbanim të hershëm në Shqipëri, e madje as në Ballkanin Perëndimor.

Punimet e gërmimit.

Gërmimet në kalanë e Dalmacës në vitet e fundit janë financuar nga Ministria e Jashtme Franceze. Gërmimet kanë nisur prej disa vitesh. Veç disa monedhave të shekullit XI janë zbuluar shtëpi prej guri, objekte metali dhe një territor me rreth një mijë varreza. E gjithë sipërfaqja me banesa mendohet të jetë rreth 20 hektarë. Fakti që këtu ndodhen pesë kisha si dhe ndërtimet e gjetura që ruajnë teknikën romake të ndërtimit, flasin se këtu ka qenë një qytetërim tepër i lulëzuar në Mesjetën e hershme. Mendohet që në Koman të ketë qenë qendra e zhvillimit ekonomik dhe kulturor jo vetëm e Shqipërisë, por edhe e Ballkanit Perëndimor.

Prezenca e toponimeve të katër kishave në kalanë e Dalmacës në Koman, si ajo e Shën Gjergjit, Zonja e Mirë, Shën Mëhillit dhe e Shën Nikollit, tregon jo vetëm për shtrirjen e madhe të këtij qytetërimi, por dhe zhvillimin kulturor e kishtar të zonës, që njihej si krahina

e Pultit të Sipërm. Zona e Pultit të Sipërm, që korrespondon me kalanë e Dalmacës, në bazë të fakteve dhe toponimeve të mbledhura ka qenë një ndër qendrat më të mëdha të krishterimit. Pamja nga ku gjenden rrënojat është madhështore. Nga njëra anë shihet rrugëtimi i Drinit që vjen nga malet e larta të Tropojës dhe vazhdon rrugën drejt Shkodrës, ndërsa nga ana tjetër malet.

Tani ky rajon po kthehet në një referencë për studiuesit dhe arkeologët, sepse jep informacion të bollshëm dhe me tepër vlerë për periudhën e errët të historisë që ka mungesë të plotë informacioni. Kjo zonë ka vlera të rralla arkeologjike dhe historike dhe puna do vazhdojë edhe në vitet në vijim. Për gjithë këto vlera, kjo zonë duhet të ruhet nga shteti, në të ardhmen pasi është një thesar për qytetërimin e Mesjetës.

Ndërhyrja restauruese.

Në këtë objekt nuk është kryer në vite, asnjë punim të karakterit restaurues të monumentit ashtu dhe punime me karakter konservues e konsolidues të muraturave si dhe të mirëmbajtës të mjedisit rrethues.

Nga ana e DRKK Shkodër propozohet: Pastrim nga vegjetacioni, konservim dhe restaurim muresh. Hapje shtegu dhe vendosje e sinjalistikës orientuese.

Infrastruktura.

Nuk ka rrugë automobilistike për të shkuar deri te monumenti.

Turizmi.

Sot ky vendbanim historik, Kalaja e Dalmacës e ndodhur në majë të malit, 600 m mbi nivelin e detit brenda zonës së banuar, me shumë rrënoja të objekteve të së kaluarës, duhet të shfrytëzohet për turizëm kulturor dhe historik. Vendndodhja e tij në një peizazh të bukur natyror, në luginën e Liqenit të Komanit, i shton mundësitë për t'u vizituar nga turistët sidomos në periudhën verore.

Nga ana e Bashkisë së Vau Dejës duhet:

- Të ndërtohet rruga që të çon te monumenti.
- Të organizohen me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme ekspedita për pastrimin e mjedisit rreth e qark monumentit si dhe hapjen e shtigjeve drejt objekteve me vlera përreth tij të cilat gjenden në formë rrënojash.

KALAJA E VAUT TE DEJES

Monument kulture kat. I, shpallur me Vendimin Nr. 586, datë 17.03.1948/Nr. 4874, datë 23.09.1971, aprovuar me Ligjin Nr. 609, datë 24.05.1948

Koordinatat Gjeografike: 42° 0'46.85"N, 19°37'25.86"E

Fusha: Arkeologji; Gjinia: Vendbanim; Tipologjia; Kala. Shek. XIV

Njësia administrative: Vau Dejës, vendndodhja: Vau Dejës.

Përdorimi: Kala. DRKK Shkodër.



Figura 4.21 Pamje nga Kalaja e Vaut të Dejës

Pozita gjeografike.

Kalaja e Vaut të Dejës ndodhet 18 km në jug-lindje të Shkodrës, në anën e majtë të grykës ku Drini del nga malet e derdhet në fushë në kuotën 206. Ajo ndodhet mbi një kodër shkëmbore rreth 120 m mbi nivelin e detit dhe përfshin të gjithë terrenin brenda mureve dhe jashtë duke u kufizuar nga veriu me lumin Drin, nga lindja me arat e punuara, nga jugu te Qafa dhe në perëndim deri te shtëpia e parë. Pozicioni i saj strategjik, krijon mundësinë e kontrollit të gjithë fushës së Zadrimës dhe rrugët kryesore që vinin nga Shkodra dhe Lezha të cilat bashkoheshin te dogana e Danjës.

Të dhëna historike.

Kalaja e Vau Dejës përmendet në dokumentet e shek. XII, kur ajo ishte një qendër episkopale dhe një nga qendrat më të rëndësishme të kohës që kontrollonte rrugën Shkodër-Prizren.

Gjatë viteve 1980` të shekullit të fundit janë bërë disa gërmime arkeologjike që tregojnë vendndodhjen e sundimtarëve të familjes Zaharia. Kjo familje luante një rol të rëndësishëm në ngjarjet që i përkasin periudhës së Skenderbeut. Sipas dokumenteve veneciane kjo kala është ndërtuar në vitin 1400.

Arkitektura dhe të dhëna teknike.

Kalaja mesjetare ishte pjesë e një sistemi fortifikimi të luginës së Shkodrës dhe luginës së Drinit. Teknika e ndërtimit të mureve të kalasë së Dejës, respekton përgjithësisht teknikat e kalave mesjetare, me gurë të përmasave të vogla, të skuadruara dhe të punuara me kujdes. Gurët lidhen mes tyre me llaç duke ruajtur linjat e rregullta.

Ndërhvrijet restauruese.

Në vitin 2009 është organizuar një ekspeditë njohjeje në zonën Vau Dejës pranë Kalasë së Vau Dejës.

Nga ana e DRKK Shkodër propozohet: Pastrim nga vegjetacioni i lartë dhe i ulët. Fugatim dhe konservim muresh kryesisht në kreun e tyre.

Infrastruktura.

Ka rrugë automobilistike për të shkuar në objekt, po gjendja e saj është e keqe.

Turizmi.

Kalaja e Vaut të Dejës e ndodhur vetëm 18 km larg qytetit të Shkodrës, e vendosur mbi një kodër shkëmbore rreth 120 m mbi nivelin e detit, është një mundësi shumë e mirë e zhvillimit të turizmit malor në këtë zonë.

Nga ana e Bashkisë së Vau Dejës duhet:

- *Të futet në planet e saj, rikonstrukcioni i rrugës që të çon te kalaja.*
- *Të organizohen me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme ekspeditave për pastrimin e bimësisë rreth e qark monumentit, hapjen e shtigjeve drejt objekteve me vlera përreth tij si një mundësi kjo e njohjes së vlerave të monumentit.*
- *Të punohet për vendosjen e sinjalistikës së duhur.*
- *Të kërkohet pranë IMK aplikimi i fondeve për restaurimin dhe konsolidimin e mureve ekzistuese.*
- *Të kërkohet pranë ASHA aplikimi i fondeve për ekspedita gjurmimi në zonë.*

KISHA E SHEN MERISE

Monument kulture kat. I, shpallur me Vendimin R.U.SH. Nr.6, datë 15.01.1963.

Fusha: Arkitekturë; Gjinia: Objekt kulti-kishë; Tipologjia: Kishë. Shek. VIII.

Njësia administrative: Vau Dejës, vendndodhja: Vau Dejës.

Përdorimi: Objekt kulti-kishë. DRKK Shkodër.



Figura 4.22 Pamje nga Kisha e Shën Mërisë (përpara shembjes)

Pozita gjeografike

Kjo kishë është ndërtuar në këmbë të malit të Dejës ku ndodhen rrënojat e qytezës dhe fortesës mesjetare të Danjës, që për herë të parë përmendet si qendër peshkopale në vitin 361.

Të dhëna historike.

Sipas Marlin Barletit, në kishën e vogël të ndodhur në krah të kishës së madhe, Selisë Ipeshkvore, Gjergj Kastriot Skënderbeu ka pranuar Sakramentin e martesës. Këto dy kishat u hodhën në erë me dinamit në vitin 1967 në kuadrin e luftës kundër fesë duke shkaktuar një

humbje të madhe të vlerave të trashëgimisë sonë kombëtare. Kisha e Shën Mërisë mendohet se është ndërtuar nga mbretëresha Helene.

Arkitektura dhe të dhëna teknike.

Kisha e Shën Mërisë së Vaut të Dejës paraqiste një kishë një nefshe me planimetri drejtkëndëshe dhe absidë rrethore në anën lindore. Në kishë hyhej nga porta e vetme e saj e vendosur në anën perëndimore. Muret e kishës ishin të ndërtuar me gurë gëlqeror të gdhendur të lidhur me llaç gëlqereje me fuga të holla. Brendësia e kishës paraqiste një vëllim mbuluar me qemer cilindrikë me prerje harqesh të mprehtë, që mbështeteshin në një sistem harqesh mbajtës, harqesh të verbër dhe pilastrash. Me ritmin e tyre kjo tërësi pilastrash dhe harqesh me një qëndrueshmëri statike, përcaktonte dhe organizimin hapësinor të brendësisë së kishës e ndriçuar nga gjashtë dritare dhe e mbuluar me çati dyujse me tjegulla vendi.

Kisha kishte pësuar ndërtime në faza të ndryshme. Nga ndërtimi i parë që ruhej, ishte dritarja nga lindja e faqes jugore. Ajo ishte e ndërtuar me mermer të bardhë, pragu i saj zbukurohej me motive bimore të stilizuara dhe përbënte një dëshmi me vlerë për zbukurimet e përdorura në kishë dhe shijen arkitekturore të ndërtuesve të saj.

Formulimi arkitektonik i anës së jashtme të kishës paraqiste interes dhe vlera. Ajo shquhej për një ndërtim mjaft kompakt e simetrik, me përpjesëtimet e goditura karakteristike të elementeve arkitektonik si muret e rrafshëta, dritaret e vogla, pilastrat dhe harkadat e harqet. Tiparet dalluese të kishës si në trajtimin e pamjeve të jashtme ashtu dhe në organizimin dhe trajtimin e brendësisë të saj, janë karakteristike për arkitekturën romanike-gotike të ndërtuar në vendit tonë.

Kisha e Shën Mërisë është plotësisht e prishur, në vitin 1967 ajo është shkatërruar me dinamit në kuadrin e luftës kundër fesë. Pranë këtij objekti, nga ana e bashkëfshatarëve dhe diasporës është ndërtuar një kishë e re me tendencën e ripërtëritjes së kishës së vjetër.

Ndërhyrjet restauruese

Kisha është propozuar nga IMK të hiqet nga lista e monumenteve të kulturës.

Nga ana e DRKK Shkodër propozohet: Pastrim nga vegetacioni dhe ndërhyrje drenazhuese në mbetjet e themeleve të kishës së vjetër.

Infrastruktura.

Ka rrugë automobilistike për të shkuar në objekt, po gjendja e saj është e keqe.

Turizmi

Në kuadrin e Konkursit "Arkitektët e rinj për Zhvillimin Urban", i organizuar nga Ministria e Zhvillimit Urban në vitin 2015 janë hedhur idetë e para për zbatimin e projekteve në terren siç është rasti i rindërtimit të Kishës së Shën Mërisë së Vaut të Dejës.

Ideja e projektit nis me rrugëtimin e Shën Palit në tokën Ilire, ndaj lidhet ngushtë me origjinën e hershme të Kishës Apostolike Shqiptare. Propozohet një vlerësim monumental i rrënojave të kishës, pa fshehur kishën e re të ndërtuar aty pranë në vitet '90.

Nga ana e Bashkisë së Vau Dejës duhet:

- Të futet në planet e saj, rikonstrukcioni i rrugës që të çon te kisha.

- Të organizohen me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme ekspedita për pastrimin e mjedisit rreth e qark monumentit, hapjen e shtigjeve për qarkullimin pranë monumentit duke shërbyer kështu me njohjen e vlerave të objektit dhe historinë e zonës.
- Të punohet për vendosjen e sinjalistikës së duhur.
- Të kërkohet pranë IMK aplikimi i fondeve për restaurimin dhe konsolidimin e mureve ekzistuese.

RRENOJAT E KISHES SE SHEN MARKUT NE KALANE E VAUT TË DEJES

Monument kulture kat. I, shpallur me Vendimin e M.A.K. Nr. 786, datë 05.11.1984

Koordinatat Gjeografike: 42° 0'46.31"N, 19°37'27.33"E

Fusha: Arkitekturë; Gjinia: Objekt kulti-kishë; Tipologjia: Kishë. Shek. VIII-XV.

Njësia administrative: Vau Dejës, vendndodhja: Vau Dejës.

Përdorimi: Objekt kulti-kishë. DRKK Shkodër.



Figura 4.23 Pamje nga Kisha e Shën Markut

Pozita gjeografike

Kisha e Shën Markut ndodhet në majën e malit të Dejës buzë murit lindor rrethues të kalasë së Vaut të Dejës, qyteza e dikurshme e Danjës.

Të dhëna historike.

Kisha përmendet së pari në dokumentacionin historik në vitin 1400. Kështu Gjergj Bardhi në vizitën e tij të viteve 1631-1632, flet për ripërtëritjen e kishës në atë periudhë. Kjo kishë është e lidhur me gojëdhënën se e ka ndërtuar Skënderbeu si kujtim për fitoret e tij ndaj

venecianëve për kalanë e Danjës. Thujse të gjitha burimet historike, deri vonë, deri në shekullin XX, përmendin dy gjëra të rëndësishme të qytezës mesjetare: kështjellën që i ishte blatur Shën Markut, shenjtit mbrojtës të Venedikut dhe kisha e Shën Mërisë, një kishë që dukej se ishte ndërtuar në shekullin XIV, duket e vetmja me stil gotik në krejt Ballkanin.

Arkitektura dhe te dhëna teknike.

Kisha e Shën Markut është një monument kulture me një arkitekturë të veçantë në zonën e Veriut. Monumenti ruhet me muret tërësisht në këmbë dhe pa çati. Ai paraqet në plan një drejtkëndësh të zgjatur me absidën rrethore në anën e lindore. Në kishë hyhet nga dy dyer. Njëra ndodhet në anën perëndimore e mbuluar me arkitra prej gurësh sipas një harku të ulët dhe tjetra në anën lindore, një derë e vogël e mbuluar me hark gjysme rrethor.

Ndërtesa u është nënshtruar disa rindertimeve në kohë, të cilat në vija të përgjithshme mund të dallohen për nga ndryshimet në teknikën e ndërtimit. Muri lindor me absidën i takon ndërtimit të parë, ndërtuar me gurë të çrregullt lidhur me shumë llaç gëlqeror e mbushës rëre të trashë ku mbizotërojnë grimcat me ngjyrë të errët. Po ashtu i kësaj periudhe duhet të jetë dhe muri perëndimor i mbështetur shkëmbit deri në gjysmën e lartësisë së tij. Fundit të shek. XIV dhe fillimit të shek. XV që është faza e dytë, duhet ti takojë përdorimi i teknikës së gurëve të skuadruar në faqen veriore, rreshtuar drejt e lidhur me llaç dhe me fugaturë të rregullt. Po i kësaj faze duhet të jetë dhe rindërtimi i portës kryesore.

Ndërhyrjet restauruese.

Në vitin 2006 janë kryer punime restaurimi të karakterit mirëmbajtës në pamjet e jashtme të kishës si punime rivlerësime dhe lysterje të fasadave. Po ashtu janë kryer punime në sistemin e jashtëm të monumentit.

Nga ana e DRKK Shkodër propozohet: ndërhyrje restauruese në fugat e muraturës së kishës në anën e pasme të absidës.

Infrastruktura.

Ka rrugë automobilistike për të shkuar në objekt, po gjendja e saj është e keqe.

Turizmi.

Në rrënojat e Kishës së Shën Markut, në fshatin Skuraj si rezultat i gërmimeve arkeologjike kanë dalë varre të vjetra, që tregojnë hershmërinë e këtyre vendbanimeve. Gërmimet dhe studimet e mëtejshme në këtë zonë krijojnë kushte të favorshme për vlerësimin e trashëgimisë kulturore në këtë zonë.

Në kuadrin e projektit "Arkitektët e rinj për Zhvillimin Urban", i organizuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, në vitin 2015, janë hedhur idetë e para për zbatimin e projekteve në terren siç është rasti i rindërtimit të Rrënojave të Kishës së Shën Markut.

Nga ana e Bashkisë së Vau Dejës duhet:

- Të futet në planet e saj, rikonstrukcioni i rrugës që të çon te kalaja.
- Të organizohen me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme ekspeditave për pastrimin e mjedisit rreth e qark monumentit si dhe hapjen e shtigjeve drejt objekteve me vlera përreth tij.
- Të punohet për vendosjen e sinjalistikës së duhur.

- Të kërkohet pranë IMK aplikimi i fondeve për restaurimin dhe konsolidimin e mureve ekzistuese.

KALAJA E SHURDHAHUT

Monument kulture kat. I, aprovuar me Ligjin Nr. 609, datë 24.05.1948 me Vendimin Nr. 586, 4874 datë 17.03.1948, datë 23.09.1971

Fusha: Arkeologji; Gjinia: Fortifikim; Tipologjia: Kala. Shek. XI.

Njësia administrative: Vau-Dejës (ishulli i Shurdhahut)

Përdorimi: Kala. DRKK Shkodër.



Figura 4.24 Pamje nga Kalaja e Shurdhahut

Pozita gjeografike.

Kalaja e Shurdhahut, ngrihet mbi një kodër shkëmbore në bregun e djathtë të lumit Drin, rreth 8 km në jug të qytetit të Shkodrës. Dikur kjo kodër lidhej nëpërmjet një qafe të ulët me vargun e kodrave që shtriheshin në bregun jugor të këtij lumi, por me krijimin e liqenit artificial të hidrocentralit të Vaut të Dejës, kodra e Shurdhahut u kthye në ishull. Në gërmadhat e kësaj kalaje ndodhej dikur qyteti i Sardës, i cili përmendet shpesh në dokumentet mesjetare të kohës.

Të dhëna historike.

Lulëzimin më të madh qyteti i Sardës (Shurdhahu) e pati në shek. XI. Rreth viteve 1184 ai u pushtua nga Serbët, më vonë ka qenë nën juridiksionin e familjes feudale shqiptare të Dukagjinëve dhe më 1491 u pushtua nga turqit. Në këtë periudhë qyteti pëson një rënie të vazhdueshme deri sa, pas shek. XVII, emri i tij nuk përmendet më. Dikur Sarda një qytezë gjithë gjallëri përbri lumit Drin, si një gadishull strategjik, ishte një pikë ndërlidhëse me rrugën e vjetër Gjakovë – Shkodër – Ulqin. Sarda është një nga zonat më të rëndësishme arkeologjike dhe historike ku ndërthuren tre kultura të ndryshme të të gjithë trevës së Veriut, Malësisë, Mirditës dhe Zadrimës.

Arkitektura dhe të dhëna teknike.

Muret mbrojtës e ndajnë qytetin në dy pjesë: në qytetin e sipërm që zë majën e kodrës dhe në të poshtmin që zë shpatin e saj nga veriu, lindja dhe jugu. Si muri rrethues i sipërm ashtu dhe ai i poshtëm janë pajisur me kulla që kanë formën e germës U, trekëndëshe dhe katërkëndëshe të vendosura jo në distanca të barabarta. Krejt kalaja e Shurdhahut rrethon një sipërfaqe prej 4.7 ha. Gjithsej ruhen dy hyrje, njëra që të fut në qytetin e poshtëm dhe tjetra në të sipërmin. Që të dyja hyrjet mbrohen nga dy kulla anësore në formën e shkronjës U, të vendosura pranë njëra tjetrës. Kullat e Shurdhahut në përgjithësi janë të vogla dhe me mure të hollë 0.60-0.70 m, muri rrethues nuk e kalon gjerësinë 0.90 m. Njëra nga kullat që ruhet mirë arrin lartësinë 5 m.

Muret, harqet dhe elementet e tjerë të fortifikimit janë ndërtuar me gurë pa u forcuar me breza druri dhe pa përdorime tullash. Kullat kanë qenë të pajisura me frëngji. Një veçori e kullave të Shurdhahut, sidomos e atyre në formë U –je , është se ato lidhen me murin rrethues vetëm në pjesën e poshtme.

Ndërhyrja restauruese.

Gjatë viteve 1978-1980 është ndërhyrë me punime mirëmbajtjeje në kala. Janë kryer punime plotësuese të mureve dhe konsolidim të tyre. Po ashtu janë bërë punime në mjedisin përreth.

Nga ana e DRKK Shkodër në bashkëveprim me kooperacionin austro-zvicerian dhe shoqatën "Sarda" , krahas nivelimit dhe sistemimit të terrenit janë bërë dhe hapjet e shtigjeve udhëzuese për të vizituar monumentet e shumtë në këtë zonë, të cilat i shtojnë vlerat kalasë së Shurdhahut.

Nga ana e DRKK Shkodër propozohet: Ndërhyrje në restaurimin dhe konsolidimin e mureve.

Infrastruktura.

Në monument shkohet nëpërmjet liqenit të Vau Dejës. Nuk ka linjë detare të rregullt direkt për këtë monument, po rruga devijon për në vendqëndrimin e duhur.

Turizmi.

Ishulli i Shurdhahut është kthyer në një destinacion interesant dhe në një pikë të rëndësishme turistike. Uji i liqenit, malet dhe kodrat përreth me gjelbërimin e tyre gjithëvjetor krijojnë një peizazh me bukuri të rrallë, duke i dhënë këtij ishulli vlera të mëdha ekoturistike.

Këtu përveç vizitoreve të shumtë vendas dhe të huaj me ardhjen e pranverës vijnë për ta vizituar nxënës dhe studentë të cilët njihen me vlerat kulturore, historike dhe arkeologjike, njihen me vlerat mjedisore, ku të gjitha në kompleks përbëjnë një perlë turistike.

Jo shumë larg nga ishulli i Shurdhahut ndodhet vendlindja e shkrimtarit dhe albanologut të madh i vlerësuar me titullin “Nderi i Kombit” Martin Camaj.

Prej vitesh në këtë vend zhvillohen veprimtari të shumta kulturore dhe turistike nga Shoqata “Sarda”, e cila ka krijuar tradita për shumë aktivitete duke promovuar vlerat ekoturistike të kësaj treve.

- Festivali Folklorik me nxënësit e shkollave tetëvjeçare të gjithë trevës së veriut në çdo 3 vjet.
- Konkursi i fjalës artistike për çmimin “Martin Camaj” me të gjithë nxënësit e shkollave të mesme të Qarkut Shkodër çdo vjet.
- Garat e kanotazhit në liqen me të rinj nga gjithë trevat Shqiptare.
- Në bashkëpunim me komunitetin fetar është krijuar traditë, organizimi i festës popullore të 15 gushtit ku marrin pjesë me mijëra të rinj.
- Konkursi i zënies së peshkut me grep etj.
- Organizimi i guidave me grupe të ndryshme turistike vendas dhe të huaj.

KOMPLEKSI NDRE MJEDA DHE ZONA MBROJTESE

Monument kulture kat. II, shpallur me Vendimin M.T.K.R.S. Nr.53, datë 22.02.2012.

Zona Mbrojtëse: 41S53”58”N19

Fusha: Arkitekturë; Gjinia: Kompleks; Tipologjia: Kishë-Qelë; Shek.XX 1906-1913

Njësi administrative: Bushat, vend ndodhje: Kukël.

Përdorimi Kishë-Qelë. DRKK Shkodër.



Figura 4.25 Pamje nga Kompleksi Ndre Mjeda

Pozita gjeografike

Kompleksi “Ndre Mjeda” ndodhet në fshatin Kukël diku ndërmjet Lezhës dhe Shkodrës i cili shtrihet në fushën e Zadrimës deri në shpatin e këndejmë të malit të Kakarriqit. Fshati është një zonë fushore mjaft e gjelbëruar me bimësi të shumtë e banesa për qark, me burime

ujore ku pranë kompleksit kalon dhe një kanal uji. Kompleksi është i ngjitur pak në shpat prej ku "lahet" me shikim krejt fusha.

Të dhëna historike.

Kompleksi "Ndre Mjeda" i ndodhur në fshatin Kukël, njihet që si Cucculi qysh në mesjetë. Ai lidhet ngushtë me figurën e Dom Ndre Mjedës, njeri prej personazheve më të rëndësishëm të kulturës shqiptare të gjysmës së parë të shekullit XX, njeri prej protagonistëve më të zellshëm të saj, kontribuues i spikatur i ruajtjes dhe shpërndarjes së identitetit tonë kombëtar. Rreth tridhjetë vite të jetës së vet kreative ai i kaloi në Kukël dhe kjo ka qenë një shtysë e arsyeshme për ta kthyer këtë vend në një pikë nderimi e pelegrinazhi për Mjedën dhe veprën e tij në dobi të kombit.

Pikërisht në Kukël famullitari shkroi e lëvroi lirikat dhe tingëllimat e tij perla të letërsisë shqipe. Si poemat "Andra e Jetës", "Lissus", "Shkodra". Po ashtu shkroi librat e gjuhës shqipe për nxënësit: aty ka vijuar të këmbëjë korrespondencën me Gustav Majerin e albanologë e gjuhëtarë, e miq të tij evropianë. Banonte e shërbente atje me petkun e meshtarit dhe përgjatë viteve 1921-1924 kur qe deputet i parlamentit të parë shqiptar.

Arkitektura dhe teknika e ndërtimit.

Në vitin 1906 është projektuar dhe ka nisur ndërtimi i Kompleksit, fillimisht ai i Kishës dhe më pas ai i Qelës që kanë përfunduar në vitin 1913 prej famullitarit të atëhershëm të katundit, Dom Ndre Mjeda. Kompleksi është unik në llojin e tij në Shqipëri. Banesa është e ndërtuar sipas stilit neoklasik, me mur guri dhe e mbuluar me çati me konstruksion druri e tjegulla vendi. Të bie në sy përkujdesja në trajtimin e jashtëm arkitektonik si të kishës ashtu dhe të qelës.

Në brendësinë e tyre, si në Kishë ashtu edhe në shtëpinë e Dom Ndre Mjedës ndodhen shumë simbole me të cilat poeti ka dashur të tregoj ngjarjet historike të kohës si dhe veprimtarinë e tij të shumanshme.

Ndërrhyrja restauruese.

Me shpalljen e kompleksit "monument kulture" dhe realizimin e procesit të restaurimit, në sajë të punës këmbëngulëse të famullitarit Dom Nikë Ukgjini, të mbështetur financiarisht nga Arqipeshkvia e Shkodrës, komuna e Bushatit si dhe nga një numër i madh dashamirësish e dhuruesish me kompleksin muzeor "Ndre Mjeda", u arrit që Kukli të përjetojë një periudhë përtëritjeje të vërtetë.

Në këtë objekt në vitin 2014 janë kryer punime restaurim në kishë dhe në qelë. Në vitin 2016 janë kryer punime në dy mjediset ndihmëse, pjesë të kompleksit si dhe në mjedisin rrethues. Restaurimit ju nënshtroa dhe tavolina 100 vjeçare e punës së Dom Ndre Mjedës si një objekt origjinal, përfaqësues i asaj periudhe.

Nga ana e DRKK Shkodër: Propozohet mirëmbajtja e vazhdueshme e kompleksit.

Infrastruktura.

Ka rrugë automobilistike për të shkuar në objekt dhe gjendja e saj është shumë e mirë.

Turizmi.

Kisha e vjetër dhe qela e Ndre Mjedës, krahas plotësimit të shërbesave dhe funksioneve meshtarë janë shndërruar tashmë në një kompleks arkitekturor e muzeor, sa tërheqës për

nga forma aq të pasur dhe nga përmbajtja. Në qendër të këtij kompleksi me shikimin e çliruar mbi hapësirën e Zadrimës, ngrihet skulptura monumentale e Ndre Mjedës në formën e një kambane që duket se mbledh gjithë tingujt e fushës e ua kthen njerëzve si dikur poeti tingëllimat e tij harmonike. Statuja e Mjedës është zemra e këtij kompleksi, i cili tashmë është kthyer në një pikëtakim të rëndësishëm festash, kremtimesh e veprimtarish kulturore. Çdo 1 gusht që përkon me datën e lindjes së Ndre Mjedës, aktorë të shumtë kulturorë nga Shkodra, Lezha, Kosova e troje të tjera shqiptare, mbledhen në këtë vend për të kremtuar "Ditët e Mjedës". Nuk mungojnë emigrantët e shumtë që kthehen në vendlindje për të mos humbur rastin e një takimi të përvitshëm me miqtë dhe me gjërat e shtrenjta të vendlindjes. Kukli po kthehet dita ditës në një vend pelegrinazhi kulturor, kryefjala e të cilit mbetet Ndre Mjeda, ajo figurë që në vetëdijen kolektive përfaqëson njëherazi meshtarin, atdhetarin dhe poetin.

4.1.5 Sipërfaqet ujore

Liqeni i Vau-Dejës

E veçantë për Bashkinë Vau-Dejës është ekzistenca e sipërfaqeve të konsiderueshme ujore, ku dominon liqeni i Hidrocentralit të Vau-Dejës, lumi Drin që vazhdon në shtratin e tij të vjetër që nga pengesa e digës së hidrocentralit si dhe lumi Gjadër që shpëputet nga lumi i parë, rreth 1 km në juglindje të qytetit të Vau-Dejës. Pasuria e madhe ujore e bën gjithashtu zonën të prekur nga përmytjet.



Figura 4.26 Liqeni i Vau-Dejë

Hidrocentrali i Vau-Dejë është hidrocentrali i parë që është ndërtuar mbi lumin Drin, në rrjedhën e poshtme të tij, rreth 18 km nga qyteti i Shkodrës. Duke qenë se ai është hidrocentrali më i poshtëm me digë dhe liqen në kaskadën e Drinit, rëndësia e tij, përveç prodhimit të energjisë elektrike, lidhet edhe me ndikimin që luan liqeni i Vau-Dejë në Ultësirën e Nënshkodrës. Shkarkimet e ujit nga ky liqen kanë ndikim kryesor në përmytjet që ndodhin në pellgun liqeni i Shkodrës - lumi i Bunës, si edhe në Ultësirën e Lezhës dhe Shkodrës.



Figura 4.27 HEC i Vau-Dejës

Punimet për ndërtimin e hidrocentralit filluan në vitin 1967 dhe përfunduan në vitin 1971. HEC-i i Vau-Dejës është i tipit me digë dhe liqen. Për krijimin e liqenit, janë ndërtuar tri diga të veçanta:

- Diga e Qyrsaqit, me lartësi 46.4 m dhe gjatësi 440 m, e tipit pjesërisht gravitacionale prej betoni dhe pjesërisht me mbushje me material lokal prej formacioni gëlqeror. Në pjesën prej betoni të digës janë vendosur 4 shkarkues sipërfaqësorë me porta radiale, si dhe vepra e marrjes me dy porta me segmente, nga të cilat dalin 5 tubacionet e prurjes së ujit në agregatet e centralit. Kapaciteti maksimal i shkarkuesve është 3.500 m³/s, ndërsa kapaciteti i përpunimit të ujit është 4 x 113 m³/s.
- Diga e Zadejës, me lartësi 60 m dhe gjatësi 390 m është e tipit me mbushje me material vendi prej formacioni gëlqeror. Në këtë digë ndodhet edhe një shkarkues me tunel dhe portë me segmente me kapacitet 3.200 m³/s.
- Diga e Rragamit me një lartësi 34 m dhe gjatësi 320 m. Kjo digë është e tipit me mbushje me material vendi prej formacioni gëlqeror dhe flish. Në këtë digë nuk ndodhen vepra hidrike, ajo shërben vetën si barrierë për mbajtjen e ujit.

Vëllimi maksimal i liqenit të Vau-Dejës është 500 milion m³, sipërfaqja e tij 25 km² dhe ai ngjitet nga gryka e Vau-Dejës për rreth 27 km në luginën e lumit Drin, deri në afërsi të hidrocentralit të Komanit. Niveli maksimal i lejuar i ujit në liqen është 76 m m.n.d, ndërsa niveli minimal i operimit është 61 m m.n.d. Vëllimi aktiv i liqenit është 263 milion m³ ujë.

HEC-i i Vau-Dejës është parashikuar si vepër e klasit të parë përse i përket rrezikshmërisë ekonomike, sociale dhe mjedisore. Diga është projektuar për një prurje maksimale llogaritëse në periudhën e reshjeve 1 herë në 10.000 vjet (10.000 m³/s). Aftësia maksimale e shkarkuese e HEC-it është 7.500 m³/s në kuotën 76 m.

Zhvillimi i turizmit natyror është një mundësi e rritjes ekonomike të kësaj zone, pasi në liqenin e Vau-Dejës gjenden kështjella dhe kisha ndër më të vjetrat në Ballkan, të cilat ende

sot mbartin vlera historike dhe arkeologjike. Liqeni i Vau-Dejës mund të kthehet gjithashtu në një burim të rëndësishëm turistik, në rast se rikthehet transporti për qëllime turistike nga Vau-Dejës deri në Koman.

Liqeni i Komanit

Liqeni i Komanit, i cili ndodhet 30 km larg qytetit të Shkodrës, është formuar nga ujëmbledhësi i lumit Drin, ku është ngritur hidrocentrali i Komanit me fuqi të instaluar 4 x 150 MW. Liqeni ka sipërfaqe 12 km², gjatësi 34.5 km dhe gjerësi 50 - 60 m. Rreth liqenit lartësohen male të pyllëzuara me lartësi 1000 - 1200 m mbi nivelin e detit. Ky rajon, veç vlerës turistike, ruan edhe vlera historike. Aty pranë ndodhet fshati Koman, ku është zbuluar një varrezë e shekullit 6 - 8 p.K., e cila lidhet me kulturën e shoqërisë së hershme shqiptare. Mungesa e një organizimi, qoftë prej autoriteteve lokale, qoftë prej agjensive turistike, e ka lënë krejtësisht në hije shfrytëzimin turistik të kësaj zone me potenciale të fuqishme, që po të shfrytëzoheshin edhe në mënyrë të pjesshme, do të ndikonin drejtpërdrejt në të ardhurat ekonomike të të gjithë zonës.



Figura 4.28 Diga e Komanit

HEC-i i Komanit është hidrocentrali i dytë dhe më i fuqishmi i kaskadës së lumit Drin. Për nga fuqia e instaluar, pozicioni dhe vëllimi i rezervuarit, ky HEC luan rol kyç për prodhimin dhe shfrytëzimin e të gjithë kaskadës. HEC-i i Komanit është hidrocentrali me kapacitetin e prodhimit më të lartë në Shqipëri.

Punimet për ndërtimin e tij filluan në vitin 1980. Turbina e parë filloi punën në vitin 1985, ndërsa me kapacitet të plotë, HEC-i filloi punën në vitin 1988.

Hidrocentrali është i tipit me liqen dhe rezervuar. Diga është e tipit me mbushje me gurë dhe ekran betoni të armuar. Ajo ka një lartësi prej 133 m dhe gjatësi 290 m. Kjo digë është ndër 10 digat më të larta të këtij lloji në Europë. Vëllimi total i saj arrin në 5 milion m³. Vëllimi i rezervuarit të krijuar prej saj është jo shumë i madh, rreth 500 milion m³ ujë, ndërsa vëllimi i dobishëm është rreth 90 milion m³ ujë (kuota 169.0 - 176.0 m m.n.d). Vëllimi i vogël i rezervuarit, si dhe shkarkimet e shpejta të reshjeve nga Alpet dhe malësia e Pukës, bën të nevojshëm një monitorim dinamik të situatës hidrike dhe një operim proaktiv të HEC-it në përputhje me zhvillimet e kushteve hidrometeorologjike të pellgut ujëmbledhës specifik të Komanit.

HEC-i i Komanit është parashikuar si vepër e klasit të parë përse i përket rrezikshmërisë ekonomike, sociale dhe mjedisore. Diga e Komanit është projektuar për një prurje maksimale llogaritëse në periudhën e reshjeve 1 herë në 1.000 vjet ($7.245 \text{ m}^3/\text{s}$) dhe për prurje maksimale kontrolluese në periudhën e reshjeve 1 herë në 10.000 vjet ($10.560 \text{ m}^3/\text{s}$).

Shkarkimi i prurjeve në Koman është parashikuar të realizohet nëpërmjet tuneleve të shkarkimit; tuneli 3 me kapacitet mbi $1.800 \text{ m}^3/\text{s}$ dhe tuneli 4 me kapacitet mbi $1.600 \text{ m}^3/\text{s}$. Kapaciteti total i shkarkimit në kuotën 176 m është $3.400 \text{ m}^3/\text{s}$. Për kalimin e ujit nga liqeni në central është ndërtuar sistemi i marrjes, i cili, nëpërmjet dy tuneleve, përcjell ujin nga portali i marrjes drejt kullave të ekuilibrit, dhe prej këtej, drejt 4 turbinave në ndërtesën e centralit me ndihmën e tubacioneve përkatëse. Kapaciteti përcjellës i sistemit është $720 \text{ m}^3/\text{s}$.



Figura 4.29 Liqeni i Komanit

Prodhimi vjetor i Komanit arrin në 1.800 GWh mesatarisht, i cili përbën rreth 45 % të prodhimit të kaskadës.

4.1.6 Hidrogeologjia dhe hidrologjia;

4.1.6.1 Hidrogeologjia dhe basenet

Për studimin e situatës hidrogeologjike të Qarkut të Shkodrës, është bërë interpretimi i të dhënave hidrogeologjike të marra nga harta hidrogeologjike e Shqipërisë.

Nga pikëpamja hidrogeologjike, territori i Shqipërisë ndahet në disa zona: zona e përhapjes së shkëmbinjve të shkrifët porozë, e shkëmbinjve karbonatikë, e shkëmbinjve molasikë, e shkëmbinjve magmatikë, e shkëmbinjve flishoidalë dhe flishorë, e shkëmbinjve metamorfikë dhe e shkëmbinjve evaporitë.

Për shkak të relievit të larmishëm që ndodhet në territorin e qarkut Shkodër, kemi shpërhapjen e shkëmbinjve me veti të mira kolektore (zhavorrë, gelqerorë), si dhe shkëmbinj pa porozitet të mjaftueshëm ndërkokrrizor ose çarjesh (argjila, flish, gipse).




Figura 4.30 Harta hidrogjeologjike e qarkut Shkodër - Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

Bazuar në të dhënat e Hartës Hidrogjellogjike të Shqipërisë kemi disa lloje akuiferësh prezent në zonë:

- Me porozitet ndërkokrrizor dhe ujëpërcjellshmëri shumë të lartë/të lartë (rërë + zhavorr, rërë + zhavorr + surargjila). Këto lloje shkëmbinjsh janë të shpërhapur kryesisht në pjesën perëndimore të territorit. Veçanërisht në zonën pranë liqenit si dhe në zonat përgjatë shtretërve të lumenjve. Rezervat ujore që ndodhen në këto lloje shkëmbinjsh, kanë rëndësi të madhe pasi shërbejnë edhe për furnizimin me ujë të qendrave të banimit, për industri dhe për ujitje.

- Me porozitet ndërkokrrizor dhe ujëpërcjellshmëri mesatare/të ulët (argjila + rërë + surargjila). Këto lloje shkëmbinjsh kanë një përhapje të kufizuar në territorin e qarkut. Gjenden kryesisht pranë zonave bregdetare dhe liqenore. Përfaqësohen me depozitimet proluviale të konuseve të derdhjes dhe nga koluvionet shpatore me çimentim të dobët.
- Me porozitet çarje-karst dhe ujëpërcjellshmëri tepër të ndryshueshme, shumë e lartë/shumë e ulët (gëlqerorë, dolomite). Shpërhapja e tyre është në të gjithë territorin e Bashkisë, megjithatë më e theksuar bëhet në pjesën veriore të saj. Ujërat karstike shfrytëzohen kryesisht me anën e burimeve. Në pjesët e zbuluara të gëlqerorëve karstike ujërat nëntokësorë kanë një cilësi të mirë, janë të ëmbël me një mineralizim të përgjithshëm 0.2 - 0.4 g/l. Në pjesët ku këto ujëra ndodhen më në thellësi dhe janë të mbuluar nga depozitime flishore dhe molasike, shpesh janë termominerale të ngopura me H₂S.
- Me porozitet çarjesh dhe ujëpërcjellshmëri të ndryshueshme, mesatare/e ulët. (shkëmbinj magmatikë, metamorfikë). Shpërhapja e tyre është shumë e vogël në territorin e qarkut.

Gjithashtu nga harta hidrogeologjike vihet re që të shpërhapur në territorin e qarkut ka edhe jo akuiferë:

Shkëmbinj pa porozitet të mjaftueshëm ndërkokrrizor ose çarjesh (argjila, flish, gipse). Këto lloje shkëmbinjsh janë të përhapur në të gjithë territorin e Bashkisë, veçanërisht në pjesën veri-lindore. Burimet që dalin nga këto lloje shkëmbinjsh kanë prurje të vogël, 0.01 - 0.1 l/s, për shkak se kanë çashmëri dhe porozitet të ulët si dhe shkallë të lartë çimentimi.

Pjesa më e madhe e burimeve që gjenden në zonë janë të vegjël (1 - 10 l/s) dhe mesatarë (10 - 100 l/s), megjithatë në disa zona të caktuara, veçanërisht aty ku akuiferët janë porozë dhe kanë ujëpërcjellshmëri të lartë, vihet re prezenca e burimeve të mëdhenj me prurje mesatare 100 - 1000 l/s.

Akuiferët me porozitet ndërkokrrizorë dhe karstikë, vlerësohen me ujëmbajtje shumë të lartë/të lartë, dhe paraqesin rëndësi të madhe në furnizimin e qendrave të mëdha të banuara me ujë të pijshëm.

Në Dobraq shfrytëzohen me puse shpimi një sasi uji me prurje totale 1000 - 1100 l/sek.

Shpime të tjera që shfrytëzohen për furnizimin e fshatrave me ujë si më poshtë:

- Stacioni i pompimit të Bërdicës (100 l/sek, 2 shpime);
- Stacioni i pompimit të Bushatit (Q = 2 l/sek);
- Stacioni i pompimit të Bahçallëkut (Q = 100 l/sek);
- Stacioni i pompimit të Dajçit (Q = 11 l/sek);
- Stacioni i pompimit të Oblikës (Q = 2 l/sek);
- Shpime të tjerë (Q = 80 - 100 l/sek).

Sasia e përgjithëshme e ujit që shfrytëzohet nga pellgu i Shkodrës është rreth 1200 - 1300 l/s. Koeficienti i shfrytëzimit të pellgut kuaternar varion nga 0.33 në 0.50. Nga të dhënat e studimeve të mëparshme të relacioneve janë marrë debitet e puseve.

Nga këto studime rezulton se nga shpimet me vetëderdhje dhe me stacione pompimi të veçanta apo ujësjellësa, merren nga fusha e NënShkodrës afërsisht 900 - 1000 l/s. Këtu përfshihen edhe burimet në zonën e studimit, që dalin nga gëlqerorët që janë të lidhura me reshjet atmosferike, kurse nga zona e Zadrimës merren afërsisht 300 l/s me gjithë burimet për rreth. Nga kjo sasi uji që merret hyjnë:

- $Q = 100$ l/s që merren nga stacionet e pompimit të zonës NënShkodrës (aktualisht disa prej tyre janë jashtë funksioni);
- $Q = 300$ l/s merren nga privatët me puse shpimi dhe puse fshati edhe për vaditje,
- $Q = 50$ l/s merren nga burimet.
- Gjithsej: $Q = 450$ l/s.

Qarku ka resurse ujore të mëdha të cilat janë të lidhura kryesisht me akuiferet aluvialë dhe karbonatikë.

- Akuiferët me porozitet ndërkokrrizor (të shkrifët) e ujëmbajtje shumë të lartë/të lartë;
- Akuiferet me ujëpërcjellshmëri shumë të lartë/të lartë lidhen me depozitimet e zhavoreve dhe zhureve me madhësi të ndryshme, të cilat formojnë horizonte ujëmbajtëse pa presion dhe që kanë përhapje të gjerë në të gjithë zonën e Shkodrës. Akuiferët janë të pasur me resurse ujore nëntokësore dhe shërbejnë për furnizim me ujë të pijshëm të komunitetit.

Prurja totale e këtyre dy akuifereve është rreth 1050 l/s ($Q = 1000$ l/s + 50 l/s), prurje e cila shfrytëzohet për që ujësjellësat e fshatrave, me sipërfaqe shtrirjeje rreth 391 km².

- Akuiferët me porozitet poroçarje. Në qark ato kanë përhapje të kufizuar dhe të shpërndarë në hartë dhe shtrihen në një sipërfaqe rreth 228.04 km², Prurjet e puseve janë 0.2 - 1 l/s, ndërsa prurjet specifike variojnë $q = 0.07 - 1$ l/s/m.
- Akuiferët e çarë dhe karstikë. Tipi i këtij akuiferi ka përhapjen më të gjerë në qarkun e Shkodrës dhe shtrihen në një sipërfaqe prej 1189 km². Në zonat karstike koeficienti mesatar i infiltrimit të dobishëm shkon deri në 0.5 - 0.6.
- Akuiferët me çarje zenë një sipërfaqen rreth 762 km² dhe ndërtohen nga shkëmbinj magmatikë e metamorfikë dhe që shtrihen kryesisht në territorin e Pukës. Për këtë kompleks interes paraqet vetëm masivi i Krrabit ku ndodhen burime me debite që variojnë nga 5 në 25 l/s.

Menaxhimi integruar i resurseve ujore në qark kërkon një vendimmarrje në nivele të ndryshme qeverisje, metodologji shkencore të përparuara për ruajtjen e bilancit sasiar dhe cilësor të ujërave. Është më se e nevojshme që të bëhen studime më të detajuara të shkallëve më të mëdha për nevojat të furnizimit me ujë të komuniteteve në kuadër të bashkisë si njësi vendore.

4.1.6.2 *Akuiferi i Nënshkodrës*

Ka një përhapje mjaft të gjerë në luginat dhe fushat e formuara nga lumenjtë Drini e Buna. Në jug ky akuifer kufizohet me fushën e Zadrimës, ndërsa në veri me akiferin e Mbishkodrës. Ai shtrihet në gjithë pjesën e ulët fushore dhe është formuar me aktivitetin akumulativ të

materialit të shkrifët aluvional të depozitimeve kuaternare të lumenjve Buna e Drin. Akuiferi përbëhet nga shtresa të fuqishme zhavorresh e zhuresh me veti të larta filtruese, të cilat grumbullojnë sasira të konsiderushme rezervash të ujrave nëntoksore të freskëta.

Zhavorret e zhuret ujëmbajtëse dominojnë në prerje dhe zenë 60-80 % të saj. Trashësitë e shtresave luhaten nga 5-10 deri 60m e në zona të veçanta edhe më tepër.

Mbulesa subrërore lëviz nga 2-3m deri 25-30m. Në zonën e Mjedës, Kaç-Naraçit e Stajkës, zhavorret dalin në sipërfaqe të tokës. Mbulesa subrërore subargjilore rritet nga veriu në jug dhe nga lindja drejt perëndimit, si dhe në drejtim të rrjedhjeve të lumenjeve Buna e Drin.

Ujërat nëntokësore të zhavorre të këtyre luginave aluviale kanë lidhje të mira hidraulike, me ujërat sipërfaqësore të lumenjeve Buna e Drin, prandaj janë të pasura dhe përmbajnë rezerva të konsiderushme, gjë e cila është vërtetuar nga shpimet e kryera.

Në pjesën lindore e veriore të këtij pellgu, ujërat nëntokësore janë pa presion, ndërsa në sektorët jugorë e perëndimorë, si rezultat i rritjes së mbulesës subrërore e subargjilore dhe si rezultat i pozicionit hipsometrik më të lartë të zonës së ushqimit, ato fitojnë presion dhe në disa zona shpimet kanë dhënë ujë me vetërrjedhje si në Trush të Poshtëm, Pistull, Paçram, Gocaj etj. Megjithatë nivelet e ujërave nëntokësore, në pjesën më të madhe të akuiferit janë nën sipërfaqen e tokës, por jo në thellësi të madhe si në zonën e Mbishkodrës.

Nivelet luhaten nga 1.0 m deri 3-3.5 m, rrallë shkojnë deri 5.0 m nën sipërfaqen e tokës. Luhatjet e niveleve lidhen drejtpërsëdrejti me regjimin hidrogeologjik të lumenjeve Buna e Drini, çka vërteton edhe marrëdhëniet e mira hidraulike të tyre në ujërat nëntokësore. Ujëdhënia dhe ujëpërshkueshmëria e zhavorreve është shumë e lartë në përgjithësi, megjithatë ka edhe zona të kufizuara me vlera mesatare e të vogla.

Koeficientet e filtrimit luhaten nga 30-50 m/ditë dhe prurjet specifike nga 5-10 lit/sek/m, në zonat e ekstremeve perëndimore, jugperëndimore e jugore të pellgut deri në 400-700 m/ditë dhe 100-150 lit/sek/m respektivisht në pjesën më të madhe të tij e sidomos në sektorët më afër lumenjeve Buna e Drini. Në shpimet e kryera në afërsi të Bahçallëkut në Dajç të Bregut të Bunës, Shirqe, në Trush të Poshtëm, Bërdicë, Melgush, Kozmaç, Stojkë, Mjedë, Qendër Bushat, etj. koeficientët e filtrimit luhaten nga 100-150 m/ditë deri 400 - 750 m/ditë, ndërsa prurjet specifike nga 40-60 lit/sek/m, deri 100-150 lit/sek/m, e në puse të veçantë edhe më tepër.

Ushqimin kryesor ujërat nëntokësore e marrin nga lumenjtë Buna e Drin dhe pjesërisht nga reshjet atmosferike, në seksionet ku zhavorret dalin në sipërfaqe të tokës. Përsa i përket përbërjes fiziko kimike të ujërave të zonës Mbishkodrës, mund të themi se kemi të bëjmë me ujëra me veti fiziko-kimike të mira.

Mineralizimi i përgjithshëm lëkundet nga 0.17 gr/l në 0.5 gr/l. Mbetjet e thata më të vogla takohen si në pjesën lindore të zonës, ashtu edhe atë perëndimore në afërsi të liqenit, ndërsa më të mëdhatë në pjesën qendrore në fshatin Omaraj. Fortësitë më të vogla takohen në afërsi të lumit Kiri dhe liqenit të Shkodrës, ndërsa më të mëdhatë në pjesën veri dhe veriperëndimore të zonës.

Ujërat nëntokësore të këtij pellgu janë në përgjithësi të freskëta dhe veti të mira fiziko-kimike, temperaturë nga 12 -16°C, mineralizim të përgjithshëm nga 0.2 deri 0.5 gr/l. Në disa sektorë mineralizimi arrin deri 0.7 gr/lit vetëm në një zonë të Barbullushit kemi Mp mbi

1gr/l. Fortësia e përgjithshme lëviz nga 7 deri 20 gradë gjermane. Me mineralizim dhe fortësi më të vogël janë ujërat në pjesën lindore të pellgut dhe afër lumenjeve Buna e Drin.

Në drejtimin perëndimor, duke filluar prej fshatit Pentar e deri në derdhjen e lumit Buna në detin Adriatik dhe në të gjithë zonën e Velipojës, ujërat nëntokësore janë nën ndikimin e intruzionit të detit dhe janë të kripur. Mineralizimi i përgjithshëm shkon nga 2 gr/l deri në 16 gr/l në bregdetin e Adriatikut.

Nga punimet e kryera deri tani, del qartë se zonat më me perspektivë dhe më të pasura me ujëra nëntokësore, janë ato të krahut të majtë të rrjedhjes së lumit Buna, duke filluar prej urës së Bahçallëkut dhe deri në Dajç të Bregut të Bunës, me një front prej 8-10 km dhe në të dy krahët e lumit Drin prej Shkodrës e deri në Mjedë, me front 18-20 km (për të dy krahët së bashku).

4.1.6.3 Akuiferi i fushës së Zadrimës

Akuiferi është formuar me aktivitetin grumbullues të materialit të shkrifët aluvional të lumenjeve Drin e Gjadër. Ai nuk është shumë i pasur me ujëra nëntokësorë, pasi vetë depozitimet aluviale në fushën e Zadrimës janë të kufizuara në shtrirje dhe kanë trashësi të vogël. Trashësia e depozitimeve aluviale të kuaternarit nuk e kalon madhësinë 25-30 m në fushë dhe deri në 50 m, në zonat afër lumenjeve. Edhe shtresat ujëmbartëse zhavorore kanë trashësi të vogël 2-3 m, dhe nuk takohen kudo në shtrirje. Një farë interesi paraqesin vetëm sektorë të vecantë të kufizuar në afërsi të lumenjve si në Mabë, Dajç.

Në zonën e Mabës e të Dajçit janë takuar zhavore ujëmbajtëse, me trashësi deri 20 m dhe me ujëdhënie e ujëpërshkueshmëri deri diku të lartë. Në këta sektorë koeficienti i filtrimit arrin nga 35 deri 60 m/ditë, ndërsa prurja specifike 5-14 lit/sek/m.

Në lindje këto zhavorre kontaktojnë me formacionet rrënjësore, siç janë gëlqerorët e karstëzuar të Triasikut, Jurasikut dhe Kretakut. Rolin kryesor në ushqimin e këtij akuiferi e luajnë drenimet e ujrave nëntokësore që dalin nga formacionet rrënjësore dhe infiltrimet nga përrenjtë Rrjoll, Vrakë dhe Kir.

4.1.6.4 Resurset dinamike të ujërave nëntokësore

Në shfrytëzimin racional të çdo pellgu ujëmbajtës, sidomos për perspektivën ku pritet marrja e sasive më të mëdha uji, rëndësi merr vlerësimi i resurseve, resurset dinamike (Q_{din}), që kalojnë prerjen tërthore të rrjedhjes në njësinë e kohës. Mbi bazën e krahasimit të tyre përcaktohet dhe bilanci ujqor i shtresës ujëmbajtëse të zhavorreve.

4.1.6.5 Resurset e shfrytëzueshme të ujërave në Pellgun e Qarkut të Shkodrës

Ujërat nëntokësore të zhavorreve ujëmbajtëse në pellgun e Qarkut të Shkodrës janë kapur me një numër të madh shpimesh. Sikurse është përmendur edhe më sipër, shpimet shfrytëzojnë horizontin e zhavorreve, që përmbajnë ujëra të ëmbla të pijshëm. Këto shpime ndodhen në disa zona;

Zona e Liqenit të Shkodrës, Dobraç e lindje, zona e ish-ndërmarrjes zooteknike, si edhe zonat e tjera më në lindje e aftësisë ujëdhënëse (gjithmonë me shpime), ku merren nga 80 - 100 l/s në zonën e Dobraçit deri në 10 - 15 l/sek më në lindje. Në veri të Dobraçit, duke u spostuar më në lindje për shkak të trashësisë së reduktuar (prerje efektive më e vogël), debitet janë mbi 5 l/s, në Dragoç, Vrakë, Gril, Grunjë e më në veri.

Zona tjetër me perspektivë është pa dyshim kontakti i karbonateve me depozitimet e kuaternarit në gjithë gjatësinë Shkodër - Demiraj, ku karbonatet shkarkojnë me intensitet për shkak të nivelit më të ulët të këtij kontakti në raport me nivelin e ujërave nëntokësore të zhavorreve.

4.1.6.6 Rrjedhja e ujërave nëntokësore (Resurset dinamike)

Rrjedhja e ujërave nëntokësore ose resurset dinamike formohet për llogari të rrjedhjes së ujërave nëntokësore të infiltruar nga karbonatet që qarkojnë gjithë krahun lindor të Pellgut Shkodër. Për llogaritjen e resurseve dinamike, është llogaritur sipërfaqja mesatare tërthore e zhavorreve, e cila rezulton rreth 572.500 m², koeficienti mesatar i filtrimit (m/d), që në pusët e Dobraçit rezulton rreth 150 m/d, si dhe gradienti hidraulik që rezulton në vlerën 0.005 m/m. Gjithë kjo sasi uji kuptohet se vjen nga infiltrimi i ujit nga karbonatet në zhavorret e kuaternarit në gjithë gjatësinë e kontaktit të këtyre formacioneve. Nga përlllogaritjet e pellgut ujëndarës të tyre, i cili rezulton me një sipërfaqe rreth 270 x 10⁶ m², dhe koeficientit të filtrimit të reshjeve në gëlqeror, i cili pranohet rreth 0.6, rezulton që nga 2000 m/m shi në vit filtrojnë në gëlqeror 1200 m/m ose 1.2 m/vit.

Infiltrimi i dobishëm në gjendje ekuilibri të bilancit, pra sasia e ujit që infiltron në masiv (I_w) rezulton:

$$I_w = S \times l = 270 \times 10^6 \times 1.2 \text{ m/d} = 7.13 \text{ m}^3/\text{s} \text{ ose } 7.130 \text{ l/s.}$$

Nga sa shihet nga përlllogaritjet, sasia e ujit që futet në zhavorret e kuaternarit në raport me atë që del dhe shkarkon në liqen, është rreth 1.000 l/sek më shumë.

Nga pellgu ujëmbajtës sot për sot merren rreth 1.100 l/sek (ujësjellësi Shkodër + bashkitë në këtë pellg).

Nga sa shikohet sot për sot shfrytëzohen rreth 18 - 20 % e aftësisë rrjedhëse të pellgut. Sasia e ujit që shkarkohet nga gëlqerorët duhet marrë me rezervë për faktin se kërkon studime e llogari më të sakta, pasi ajo përbën rreth 2 % të sasisë që shkarkon Buna nga liqeni (320 m³/s).

Në këto kushte, kuptohet që infiltrimi në gëlqerorë mund të jetë më i madh, por mungesa e studimeve në këtë drejtim nuk lejon të bëhen llogari të sakta. Në përgjithësi, nga sa shihet, kapaciteti ujëdhënës i pellgut nuk mund të jetë më i madh se 6 m³/sek. Në rast se do të rriteshin sasitë e ujit në shfrytëzim, do të ndodhte devijimi i rrjedhjes së ujërave nga drejtimi i tanishëm PL në drejtimin LP (liqeni – zhavorre të pellgut, një fenomen tepër i dëmshëm). Resurset dinamike për fushën NënShkodër - Zadrimë janë për llogari të infiltrimit të ujit nga lumi Drin dhe Buna me një front ushqimi prej 20 km, trashësi të shtresës së zhavorreve prej 10 - 60 m, $K = 100 - 150 \text{ m/d}$ dhe $i = 0.002$.

Prurja nëntokësore natyrore (Q_w), e përcaktuar me formulën Darcy rezulton rreth 600 l/s në pjesën e profilin në bregun e Bunës dhe 400 l/s për bregun e lumit Drin, pra rreth 1.000 l/s.

4.1.6.7 Hidrografia dhe cilësia e ujërave sipërfaqësore

Lumi Drin

Drini është lumi më i gjatë i trojeve shqiptare me 160 kilometra gjatësi. Ai derdhet në Detin Adriatik, afër Lezhës dhe në lumin e Bunës, degë që u formua pas një përmytjeje në shekullin XIX.



Figura 4.31 Baseni ujëmbledhës i lumit Drin

Drini formohet afër qytetit të Kukësit me bashkimin e dy degëve kryesore të tij:

- Drini i Bardhë që buron afër Pejës, Kosovë, nga Malet e Zhlebit, e më pas përshkon lugun e Dukagjinit dhe derdhet në liqenin e Fierzës;
- Drini i Zi që buron në Strugë, Republika e Maqedonisë, nga pjesa veriore e Liqenit të Ohrit, i cili siç dihet furnizohet me ujë nga Liqeni i Prespës, duke marrë edhe disa degë si p.sh. Radikën (Treva e Dibrës).

Degët kryesore të Drinit janë lumi i Shalës, lumi Valbona nga Alpet Shqiptare, Drini i Bardhë në Kosovë dhe Drini i Zi në Maqedoni. Në pjesën fundore Drini derdhet në lumin Kir, i cili buron nga Dukagjini, e pastaj bashkë derdhen në Bunë.

Drini i madh është shumë i gjerë dhe sjell një sasi të madhe uji ($330 - 340 \text{ m}^3/\text{s}$), i dyti për nga kapaciteti pas Bunës, por ky i fundit, duke qenë i shkurtër, disa harta e shënojnë si liqen. Pas Vaut të Dejës, krahut i gjatë shkon drejt jugut për nga Bushati, Maba, Gjadri, Lezha. Në jug të Lezhës hyn në një zonë moçalore e më tej derdhet në Adriatik.

Nga Kukësi, Drini rrjedh në Shqipërinë veriore, së pari nga Hasi, në vazhdim, dhe është kthyer në një zinxhir liqenesh artificiale (i Fierzës, i Komanit dhe i Vaut të Dejës), që furnizojnë me ujë tre hidrocentralet e mëdha. Prurja mesatare vjetore e Drinit arrin $352 \text{ m}^3/\text{sek}$, kurse maksimalja e regjistruar është mbi $5.100 \text{ m}^3/\text{sek}$. Duke kaluar në fshatrat Sipas, Msi dhe Fierzë, e mandej, pasi mbërrin në krahinën e Dukagjinit, ai shkon drejt jugut, kalon nga Apripë e Gurit, Toplanë, Dushman, Koman, Vjerdhë, Mazrrek, Rragam, dhe Pale

Lalej. Në Vau-Dejë, hyn në ultësirat e NënShkodrës dhe ndahet në dy krahë: një që derdhet në gjirin e Drinit në Adriatik në jug-perëndim të Lezhës, dhe tjetri që derdhet në lumin Kir e më tej në Bunë afër Kalasë së Shkodrës. Edhe pse është dega më e shkurtër prej 15 km, kjo ndarje që derdhet në Bunë quhet Drini i Madh, sepse bie më shumë ujë se krahë tjetër që derdhet drejtpërdrejt në det. Drini i Madh gjithashtu derdhet në det, por ka ndryshuar rrjedhën e vet pas një përmblytjeje të madhe në vitin 1858 duke ardhur drejt Shkodrës.

Lumi i Gjadrit

Lumi i Gjadrit është degë e majtë e Drinit, që shtrihet në perëndim të rrethit të Pukës e në verilindje të rrethit të Lezhës. Ka gjatësi 40.5 km, sipërfaqe 199 km² dhe lartësi mesatare 422 m. Fillon nga shpatet veriperëndimore të Bjeshkëve të Tërbunit. Në pjesën e sipërme të rrjedhjes, ka formuar një luginë tipike me shpate shumë të pjerrëta e fund të ngushtë. Që nga Kalivaçi e deri në Hajmel, lugina merr pamjen e një pellgu. Gjadri, pasi mbledh ujërat e pjesës veriperëndimore të përroit të Dibrës dhe atij të Kakrit, kthen në veriperëndim dhe derdhet në Drin.

Cilësia e ujërave të lumit Drinit

Lumi Drin monitorohet nga AKMP në dy stacione: Topojan dhe Bahçallëk.

Stacioni i Topojanit jep mundësinë e vlerësimit të cilësisë së ujit të Drinit të bashkuar: Drinit të Zi dhe Drinit të Bardhë, ndërsa monitorimi i stacionit në Bahçallëk jep mundësinë e vlerësimit të cilësisë së ujërave para derdhjes në detin Adriatik.

Në mënyrë periodike kryhet kampionizimi i ujit dhe kryerja e 8 analizave kimike në dy periudha të vitit: prill dhe tetor.

Temperatura e ujit për lumin Drin varion 23.2 – 24.1 °C në fazën e parë (muaji prill) deri në 16.4 °C në fazën e dytë të monitorimit në muajin tetor.

pH i ujit për lumin Drin varion nga 7.74 – 8.56 respektivisht për stacionet në Urën e Topojanit dhe Bahçallëk. Ndryshimet stinore nuk e kalojnë vlerën 1.0 (0.15, 0.37 dhe 0.82). Sipas vlerave limite të Direktivës Kuadër të Ujit (DKU), normës për mjedis ujor acid dhe alkaline, ujërat e lumit Drin kanë gjendje të mirë. Ata janë neutrale (*pH* = 6.5 - 9.0).

Alkaliniteti - Nga matjet e kryera gjatë periudhës vjetore, vërehet se vlerat luhaten nga 123 - 140 mol/l në fazën e parë dhe 128 - 143 mol/l në fazën e dytë sipas stacioneve, respektivisht Ura e Bahçallëkut dhe Ura e Topojanit. Luhatjet stinore janë të ulta, nga 0 – 5 mol/l. Rritja e alkalinitetit në fazën e dytë shoqërohet me rritjen e *pH* dhe të lëndëve të tretura në ujë.

Përcjellshmëria elektrike - Luhatet në vlerat 277 - 285 µS/cm respektivisht Ura e Bahçallëkut dhe Ura e Topojanit. Luhatjet stinore janë të ulta 2 – 7 - 9 e deri 49 µS/cm në urën e Topojanit. Në normat europiane nuk jepen kufij të cilësisë së ujërave për përcjellshmërinë elektrike. Megjithatë shihet se vlerat e marra në këtë fazë janë të ulta.

Përmbajtja e oksigjenit të tretur në lumin Drin varion në vlerat 7.33 – 8.86 mg/l. Luhatjet sezonale të oksigjenit janë të ulëta, rreth 0.8 mg/l. Uljet e përmbajtjes së oksigjenit në fazën e dytë lidhen me shkarkimet e mbetjeve si dhe pikën kritike në prurjet e lumit. Lumi klasifikohet në gjendje shumë të mirë për nivelet e oksigjenit.

Vlerat e përmbajtjes së NKO₅ kanë luhatje të vogla si dhe vlera të ulëta nga 0.59 në 1.02 mg/l për stacionet e lumit Drin, duke u klasifikuar në gjendje shumë të mirë, ku NKO₅ ≤ 2

mg/l. Vihet re një rritje e vlerave në fazën e dytë që përkon me minimumin e reshjeve, prurjeve si dhe me shkarkimet max si pasojë e turizmit në periudhën e verës.

Vlerat e përmbajtjes të nevojës kimike për oksigjen *NKO* luhatet në 0.44 - 0.8 mg/l në fazën e parë dhe 0.8 – 0.36 mg/l për fazën e dytë. Luhatjet sezonale janë të lehta.

Përmbajtja e fosforit total luhatet në vlerat 0.02 – 0.19 mg/l, duke u klasifikuar në gjendje shumë të mirë, ku $P_t < 0.1$ mg/l.

Amoniakut është tregues i ndotjes bakteriale të ujërave. Në stacionet e lumit Drin, gjatë monitorimit të vitit 2015, në fazën e parë nuk është takuar prania e amoniakut në ndryshim nga faza e dytë ku përqendrimi i amoniakut luhatet në vlerat 0.03 – 0.05 mg/l, si pasojë e ndikimit të shkarkimeve të ndryshme. Stacionet paraqesin të njëjtën ecure nga faza në fazë me tendencë rritje pasi dhe periudha e marrjes së kampioneve, ka përkuar me minimumin e periudhës ujëpaktë. Sipas standardit për ujërat e ëmbla, ujërat e lumit Drin klasifikohen si të cilësisë shumë të mirë.

Vlerat e përmbajtjes së nitrateve luhaten nga 0.3 - 0.8 - 2.0 mg/l për stacionet e lumit Drin. Ujërat e lumit Drin janë të gjendjes së mirë deri në të moderuar. Lumi Drini është nën ndikimin e shkarkimeve urbane të qytetit të Shkodrës dhe zonave përreth.

Vlerat e përmbajtjes së nitriteve luhaten nga 0 - 0.02 - 0.05 mg/l. Sipas vlerave limite të përcaktuara nga DKU, ujërat e lumit Drin i përkasin gjendjes shumë të mirë.

Lëndët pezull kanë luhatje të vogla si dhe vlera të ulëta nga 1.4 në 10.8 mg/l për të dy stacionet e lumit Drin. Luhatjet sezonale janë relativisht të ulta. Vihet re një ulje e vlerave në fazën e dytë që përkon me minimumin e reshjeve.

(Burimi i të dhënave: Raporti i gjendjes së mjedisit, AKMP 2015).

4.1.7 Landfill-i i Bushatit

Landfill-i i Bushatit ndodhet rreth 13 km në jug të qytetit të Shkodrës, rreth 2.5 km në lindje të fshatit Bushat dhe rreth 1.5 km në lindje të fshatit Shkëzë.

Rreth 1 km në lindje të tij, ndodhet një numër i kufizuar banesash të veçuara të fshatit Paçram. Disa kodrina të buta me lartësi rreth 60 - 70 m mund të ndajnë këto shtëpi nga landfill-i.

Landfill-i është i vendosur në një terren kodrinor që ngrihet në pjesën qendrore të fushës së Zadrime. Kodrat kanë orientim veri-perëndim dhe jug-lindje. Më me saktësi, ai shtrihet në një "depresion" të ngjashëm me një amfiteatër, i cili hapet drejt jug-perëndimit, në drejtim të fushave të kultivuara.

Në landfill depozitohen mbetjet urbane të të gjitha llojeve dhe një listë e hollësishme e tyre është dhënë në dokumentin fillestar të këtij landfilli. Nuk lejohen të depozitohen mbetjet spitalore, bateri dhe akumulatorë, vajra industriale dhe mbetje të tjera të përcaktuara si të rrezikshme nga legjislacioni mjedisor.



Figura 4.32 Pamje nga landfill-i i Bushatit

Praktika e operimit parashikon mbajtjen e statistikave të rregullta që lidhen me sasitë e mbetjeve dhe origjinën e tyre, datën e hyrjes në venddepozitim, inspektimin vizual të tyre në momentin e shkarkimit, si dhe verifikimin e dokumentacionit kur transporti i tyre bëhet nga të tretë.

Ujërat e ndotura dhe ujërat e tjera të mbledhura trajtohen në një impiant teknikisht të përshtatshëm me qëllim që të garantohen shkarkime në përputhje me normativat e lejuara. Llumi i krijuar nga pastrimi i liksivateve kthehet në masën e mbetjeve në venddepozitim.

Ndikimet kryesore dhe më problematike gjatë fazës operative sipas raportit të VNM, parashikohen:

- Erozioni: Territori ku është ndërtuar venddepozitimi i mbetjeve urbane i nënshtrohet faktorëve gërryes. Për shkak të përbërjes së formacioneve dhe morfologjisë, relievi i objektit është relativisht i ekspozuar ndaj proceseve erozive. Trashësia e mbulesës dhe infiltrimi sipërfaqësor i ujërave, në kohë shirash intensive, bëjnë që të ketë premisa zhvillimi të erozionit. Shirat e rrëmbyeshëm mund të sjellin edhe gërryerje të skarpatës dhe grumbullimin e formacioneve argjilore dhe alevrolitore. Për këtë, në projektin teknik janë parashikuar masat e nevojshme për evitimin e këtij fenomeni. Ndërtimi i një kanali mbi objekt për mbledhjen e ujërave gjatë reshjeve ndihmon jo vetëm në drejtim të erozionit, por edhe për të pakësuar në minimumin e mundshëm sasinë e ujërave nga reshjet që infiltrojnë në objekt dhe formojnë liksiviatet.
- Erërat e pakëndshme që janë karakteristike të venddepozitimeve të mbetjeve urbane. Projekti parashikon mbulimin ditor me materiale të përshtatshme të venddepozitimit dhe djegien e biogazit për të minimizuar, ndër të tjera, edhe erërat e pakëndshme që gjenerohen.

Edhe pse vendi ndodhet në një zonë ku predominon argjila, janë realizuar edhe barriera artificiale, si realizimi i shtresave të argjilës me trashësi 1 m, me përshkueshmëri më të vogël se 1×10^{-7} cm/s dhe përdorimi i bentonitit gjeosintetik me papërshkueshmëri të

barasvlershëm me ato të garantuara nga shtresat argjilore artificiale të sipërpërmendura. Kjo ka krijuar mundësinë për të kompensuar deficitet eventuale të përshkueshmërisë hidraulike. Si në pjesën fundore, ashtu edhe në paretet e venddepozitimit, garantohej një përshkueshmëri hidraulike $\leq 1 \times 10^{-7}$ cm/s, trashësi ≥ 1 m, siç përcaktohet edhe nga Direktiva e Bashkimit Europian 1999/31/ KE në lidhje me shkarkimet e mbetjeve.

Për më tepër, është shtuar edhe një sistem barriere artificiale në pjesën fundore dhe në parete, një membranë PEAD (polietilen me densitet të lartë) me spesor 2,5 mm, ashtu siç kërkohet edhe nga normativa e sipërpërmendur.

Përsa i përket mbledhjes dhe trajtimit të lëksiviateve të formuara nga mbetjet, është parashikuar në brendësi të basenit (në afërsi të pjesës fundore të venddepozitimit) një shtresë drenuese me spesor rreth 50 cm, e përbërë nga material inert, dhe një rrjet grumbullimi (i përbërë nga tubacione PEAD me vrima) i cili dërgon lëksiviatet e formuara nga venddepozitimi drejt pusit të grumbullimit në vendin e caktuar në brendësi të venddepozitimit. Me pas lëksiviatet në brendësi të pusit dërgohen me pompë drejt impiantit të trajtimit. Sasia ditore e tyre është mesatarisht 50 m³/ditë.

VKM nr. 177, datë 31.03.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse", nuk parashikon limite të lejuara për tregues të shkarkimeve nga impiante që trajtojnë ujërat e ndotura të venddepozitimeve urbane. Për këtë arsye, janë pranuar limitet e lejuara italiane për shkarkimet në ujërat sipërfaqësorë.

4.1.8 Rreziqet mjedisore si pasojë e pranisë së landfill-it

Duke qenë se procesi i eliminimit të mbetjeve të ngurta urbane, në disa raste mund të afektojë shëndetin publik, rezultojnë domosdoshme vendosja e një sistemi korrekt kontrolli dhe parandalimi me karakter higjieno-sanitar lidhur me operacionet që zhvillohen në landfill.

Për rrjedhojë, është e nevojshme që të evitohet transferimi i ndotjes nga një sektor në tjetrin në territor duke eliminuar vektorët e përhapjes së ndotjes mjedisore.

Aspekti sanitar duhet të përfshijë të gjithë sektorët fizikë, kimikë, biologjikë të cilët mund të kenë ndikim mbi shëndetin njerëzor dhe që bëhet shkaktar i një përkeqësimi të mirëqenies psikofizike dhe sociale.

Kur mbetjet grumbullohen në landfill, ndodhin transformime të natyrës kimiko-biologjike, të cilët kanë si produkte lëndë të ngurta, të lëngëta dhe të gazta. Metalet e rëndë pësojnë një oksidim, ndërsa lënda organike dhe inorganike atakohen nga flora bakteriale e larmishme, në varësi të kushteve në të cilat ndodhet landfill-i. Lëksiviatet që prodhohen gjatë fermentimit, përmbajnë kryesisht acide organike.

Reaksionet kimike që lidhen me materialin e depozituar në landfill, janë të lidhura me dy faza:

- Faza aerobike, e cila karakterizohet nga prania e gazit karbonik, ujit dhe nitrateve;
- Faza anaerobike, ku përveç ujit dhe gazit karbonik, formohet metan, amoniak, azot, acide organike, gas sulfhidrik, etj.

Gazi metan mund të formojë me ajrin përzierje shpërthyes, ndërsa gazi karbonik, duke formuar acidin karbonik, mund të ndikojë në mineralizimin e ujërave nëntokësore. Duke qenë se reaksionet e oksidimit janë ekzotermike, në brendësi të landfill-it mund të gjenerohet një sasi nxehtësie, e tillë që mund të çojë në një rritje të konsiderueshme të temperaturës edhe në sipërfaqe. Kjo është më e dukshme sidomos në zonat e rrafshëta ku komprimimi është më i madh. Skarpatet e landfill-it, të cilat përgjithësisht mbulohen me material evakuimi, paraqesin kryesisht probleme erozioni.

Si përfundim, rreziqet potencialisht të gjenerueshme nga prania e një landfill-i mund të përmbledhen si më poshtë vijon:

- Ndotje atmosferike: djegia e mbetjeve të ngurta mund të gjenerojë një emetim të substancave ndotëse të padëshiruara (si pluhura, NO_x, SO_x, acid klorhidrik, hidrokarbure, etj.) të dëmshme për shëndetin. Ekziston gjithashtu problemi i përhapjes së erërave të krijuara nga dekompozimi i substancave organike ose nga proceset fiziko-kimikë: procese të tilla mund të kufizohen duke përcaktuar pozicionin më të përshtatshëm të landfill-it në raport me drejtimin e erës. Përgjithësisht, përdoren barriera erëthyes të tipit fiks (pemë, etj) ose të lëvizshëm, të cilat kufizojnë efektin eolik të shpërhapjes.
- Shpërthimi i zjarreve: për shkak të shkëndijave ose flakëve të prodhuara nga mjetet mekanike që operojnë në landfill, nga pakujdesia e vetë personelit, ose nga prania e materialeve të ndezshëm në mbetjet (p.sh. thëngjij) mund të lindë një djegie e gazeve të djegshëm të prodhuar në landfill (metan, etj). Më tej, për shkak të një kompaktimi të paktë të materialit, i cili ka si pasojë praninë e oksigjenit në boshllëqet, mund të krijohet rreziku i vetëndezjes së gazeve të djegshëm të prodhuar nga fermentimi i mbetjeve. Për këtë arsye, duhen përdorur teknologji të përshtatshme për kryerjen e kontroleve të vazhduar të landfill-it për të sinjalizuar praninë e mundshme të fenomeneve të vetëndezjes.
- Ndotje ujore: rreziku i përhapjes në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore i substancave toksike ose mikroorganizmave patogjenë që ndeshet shpesh në mbetjet, nxjerr një problematikë sanitare, edhe përsa i përket zinxhirit ushqimor.
- Përhapja e agjentëve patogjenë: landfill-i i mbetjeve urbane, të cilat janë të pasura me lëndë organike, përbën një habitat ideal për kafshët potencialisht mbartëse të sëmundjeve infektive. Brejtësit, zogjtë dhe insektet janë ndër frekuentuesit më të zakonshëm të landfill-eve. Po ashtu, si pasojë e pranisë së vendstrehimeve të brejtësve, funksioni i strukturave të papërshtatshme dhe i mbulesës mund të cenohet, duke çuar në krijimin e rrugëve preferenciale të infiltrimit të ujërave atmosferike ose të daljes së lixiviateve.

Impakti negativ i një landfill-i, nga pikëpamja higjieno-sanitare, nuk ka të bëjë vetëm me aspektin toksikologjik, por me të gjitha lidhjet që ekzistojnë midis mjedisit human, trullit, ajrit dhe ujit.

Për të vlerësuar një impakt të tillë, duhen vlerësuar shumë parametra mjedisorë, të cilët në varësi të referimit (tipit të mbetjeve ose mjedisit pritës) mund të ndahen në dy grupe:

- Parametra që lidhen me mbetjen: këtu bëhet fjalë për toksicitetin ndaj njeriut, ndaj jetës ujore, ndaj qëndrueshmërisë, bioakumulimit mjedisor dhe tretshmërisë në mjedise ujore;
- Parametra që lidhen me mjedisin: përhapja në mjedis e substancave toksike është funksion invers i ngarkesës bakteriale të truallit, i ngarkesës aktive dhe pranisë së agjentëve kompleksues, ndërsa është drejtpërdrejt e lidhur me përcjellshmërinë, me shpejtësinë e infiltrimit, porozitetin, pH dhe potencialin e oksido-reduktimit.

4.1.9 Vendgrumbullimet e mbetjeve të paligjshme në territorin e bashkisë

Kemi të bëjmë me një vendgrumbullim mbetjesh abuziv (ilegal) kur verifikohen elementët e mëposhtëm:

- Hedhja e mbetjeve bëhet në mënyrë të përsëritur dhe jo rastësore dhe kjo në një zonë të caktuar;
- Masa e mbetjeve të grumbulluara është heterogjene;
- Braktisja e tyre është përfundimtare dhe jo e përkohshme;
- Degradim i gjendjes mjedisore të zonës në mjaft raste edhe e qëllimshme.

Përkufizimi teknik i vendgrumbullimit abuziv i referohet një aktiviteti menaxhimi ilegal të mbetjeve, të planifikuar dhe të zakonshëm, kryer me vetëdije nga subjekte të ndryshëm dhe në marrëveshje me njëri-tjetrin, i finalizuar me zhdukjen e mbetjeve të gjeneruara nëpërmjet trajtimit jashtë normave dhe përfitimit ekonomik të paligjshëm.



Figura 4.33 Pamje e një vendgrumbullimi të paligjshëm.

Këto aktivitete duhen dalluar nga braktisja e mbetjeve heterogjene, e kryer në mënyrë rastësore dhe jo të vazhduar nga ana e subjekteve të ndryshëm, në një zonë të caktuar, përgjithësisht në zona pak të frekuentuara. Gjithsesi, këto zona, me kalimin e kohës, mund të zmadhohen dhe të kthehen në vendgrumbullime të mirëfillta ilegale.

Në Hartën e Rajonizimit Sizmik të Shqipërisë janë dalluar tre kategori zonash: zonat me intensitet bazë të lëkundjeve VIII, VII e VI ballë; brënda zonave VIII ballëshe për kushte të këqija trualli, të përmendura më lart, janë dalluar zona me intensitet të pritshëm IX ballë si në Vlorë, në afërsi të Lushnjës, në Durrës, në Korçë, në Pogradec, në Gollobordë e në Shkodër (kufijtë e këtyre zonave paraqiten me izovija të ndërprera).

Në vitet '90, me zhvillimin teorik të analizës së rrezikut sizmik dhe mundësitë kompjuterike, në Shqipëri u realizuan një sërë analizash të rrezikut sizmik duke përdorur si përqasjen deterministike ashtu dhe atë probabilitare.

Në vitet 1998-2003, në kuadrin e projektit të NATO-s "Sizmotektonika dhe rreziku sizmik i Shqipërisë", në bashkëpunim me Departamentin e Gjeofizikës të Universitetit Aristotel të Selanikut, u realizua për herë të parë një analizë e plotë e rrezikut sizmik të vendit duke përdorur metodën probabilitare.

Gjithashtu vitet e fundit është botuar materiali teknik "Sizmiciteti, sizmotektonika dhe vlerësimi i rrezikut sizmik në Shqipëri"¹, në të cilin përfshihet përvoja mbi 40 vjeçare e studimeve në fushën e sizmologjisë, jepen përfundime të arritura nëpërmjet debatit shkencor e hulumtimit të thellë dhe kulmohet me formën më të plotë të rrezikut sizmik të vendit, një dokumentacion me rëndësi praktike për ndërtimet në Shqipëri. Vlerësimi i rrezikut sizmik probabilitar për Shqipërinë (2010) duhet të shërbejë si bazë për kodin e ri antisizmik të ndërtimeve në vendin tonë.

Për vlerësimin e potencialit sizmik të territorit të Bashkisë të Vau-Dejës është përdorur metoda probabilitare. Për llogaritjen probabilitare të rrezikut sizmik të Shqipërisë kemi aplikuar metodologjinë Cornell-McGuire (McGuire, 1993)². Sizmiciteti i vendit tonë është karakterizuar nëpërmjet modelit të zonave të burimeve sizmike.

Sipas EC 8, strukturat në rajonet sizmike duhet të projektohen dhe ndërtohen në mënyrë të tillë që të kënaqin këto dy kërkesa themelore:

- Kërkesa e mos-shembjes, dhe
- Kërkesa e kufizimit të dëmtimeve.

Pra, për të plotësuar këto dy kërkesa të Eurokodit 8, llogaritjet e rrezikut sizmik të Shqipërisë janë kryer për dy nivele probabiliteti:

- 10% probabilitet tejkalimi në 50 vjet (10%/50), ose 0,0021 në vit, që i korrespondon një tërmeti me periudë përsëritje 475 vjet, dhe
- 10% probabilitet tejkalimi në 10 vjet (10%/10), ose 0,0105 në vit, që i korrespondon një tërmeti me periudë përsëritje 95 vjet.

Pra, në llogaritjet e rrezikut sizmik për truall shkëmbor, shpejtimi (akseleracioni) maksimal i truallit - PGA si dhe shpejtimet spektrale - SA për shuarje 5 % përcaktohen për dy perioda të përsëritjes të tërmeteve: 475 e 95 vjet, për të cilat ndërtohen edhe hartat përkatëse të rrezikut sizmik. Bazuar në këtë metodikë është bërë edhe vlerësimi i rrezikut sizmik të territorit të Bashkisë të Vau Dejës që paraqitet në vijim.

¹ Sizmiciteti, sizmotektonika dhe vlerësimi i rrezikut sizmik në Shqipëri" Sh. Aliaj, S. Koçiu, Betim Muço, Eduard Sulstarova, 2010, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

² Për këtë qëllim është përdorur softi EZ-FRISK 7.12, produkt i Risk Engineering Inc.Colorado, USA

4.1.10.2 Sizmiciteti i Shqipërisë dhe veçanërisht i territorit të bashkisë të Vau-Dejës

Në zonimin sizmik mbarëbotëror, Shqipëria zë vend në brezin sizmik Alpin-Mesdhetar, i cili është ndër me aktive në botë. Në këtë brez, pjesa më aktive nga pikëpamja sizmike është Egjeu dhe zona rrethuese e tij, ku bëjnë pjesë Greqia, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Bullgaria Jugore dhe Turqia Perëndimore. Çdo vit në këtë rajon ($34-43^{\circ}$ N; $18-30^{\circ}$ E), ndodh të paktën një tërmet me $M > 6.5$ (Papazachos, 1989).

Shqipëria është një ndër vendet më sizmoaktive në Evropë. Shumica e tërmeteve të fortë ndodhin në 3 breza sizmike mirë të përcaktuar, si vijon (shih. Figurën në vijim):

- Brezi tërmetor Adriatiko-Jonik në buzën lindore të mikroplakës së Adrias me shtrirje veriperëndim-juglindje;
- Brezi tërmetor Peshkopi-Korçë me shtrirje veri-jug, dhe
- Brezi tërmetor Lushnjë-Elbasan-Dibër me shtrirje veri-lindore³.

Epiqendrat e tërmeteve përqendrohen kryesisht gjatë shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive⁴



Sizmiciteti i Shqipërisë karakterizohet nga një mikroaktivitet sizmik intensiv ($1.0 < M \leq 3.0$), nga shumë tërmete të vegjël ($3.0 < M \leq 5.0$), nga tërmete të rrallë me madhësi mesatare ($5.0 < M \leq 7.0$) dhe shumë rrallë nga tërmete të fortë ($M > 7.0$). Përgjithësisht tërmetet e Shqipërisë dhe rajoneve përreth kanë vatra të cekëta, thellësia e të cilave shkon nga 10-25 km.

Territori i Bashkisë Vau-Dejës zë vend në shtrirje përgjatë të brezit tërmetor Adriatiko-Jonik, tërmetet e fuqishëm të të cilit kanë kushtëzuar potencialin sizmik të saj. Më poshtë po japim përshkrime të shkurtra për disa nga tërmetet më të fortë që kanë goditur Shqipërinë nga rajoni i Durrësit deri në Shkodër e nga deti Adriatik në kufirin lindor; tërmetet që kanë influencë më të drejtpërdrejtë me Bashkinë Vau Dejës.

4.1.10.3 Zona sizmoaktive joniko-adriatike - bashkia e Vau Dejës

Sizmotektonika analizon lidhjen midis shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive dhe tërmeteve të gjeneruar prej tyre. Epiqendrat e tërmeteve përqendrohen kryesisht gjatë shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive (Aliaj, 1988).

Në hartën sizmotektonike të Shqipërisë janë paraqitur shkëputjet aktive me tipin e deformacionit dhe kronologjinë e aktivitetit të tyre, epiqendrat e tërmeteve sipas magnitudës, si dhe izovijat e intensiteteve maksimale të vërtetuara (Fig. 3.22).

Dy zona gjatësore dhe dy zona tërthore të shkëputjeve aktive evidentohen mirë në orogjenin Shqiptar, si vijon:

- Zona Joniko-Adriatike e shkëputjeve mbihipëse me shtrirje VP deri afërsisht VVP,
- Zona Peshkopi-Korçë e shkëputjeve normale grabenore me shtrirje V-J,
- Zona Shkodër-Tropojë e shkëputjeve normale me shtrirje VL,
- Zona Elbasan-Dibër e shkëputjeve normale me shtrirje VL.

Zona Joniko-Adriatike e shkëputjeve mbihipëse ku zë vend Bashkia e Vau-Dejës është zona më e gjatë, që ndiqet për shumë qindra km përgjatë bregdetit Adriatik e Jonian, edhe jashtë territorit tonë, dhe ndahet në tre segmente nëpërmjet tërthoreve Shkodër-Pejë pranë Vau Dejës dhe Vlorë-Tepelenë, si vijon:

- Segmenti verior me shtrirje perëndimore-veriperëndimore përmban shkëputje para-Pliocenike mbihipëse në shtypje të pastër të zonës Kruja (Dalmate).
- Segmenti qendror me shtrirje veriore deri veri-veriperëndimore përbëhet nga shkëputje pas-Pliocenike mbihipëse në shtypje oblike të Ultësirës Pranadriatike dhe të zonës Kruja. Pikërisht këtu zë vend bashkia Vau Dejës.
- Segmenti jugor me shtrirje VP përbëhet nga shkëputje para-Pliocenike mbihipëse në shtypje të pastër kryesisht të zonës Jonike.

Zonat e shkëputjeve aktive janë pikërisht zonat sizmoaktive (zonat ku gjenerohen herë pas here tërmetet), të konfirmuara nga fakti se epiqendrat e tërmeteve përqendrohen gjatë shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive.

⁵ Nga Aliaj, 1979




Figura 4.36 Harta sizmotektonike e Shqipërisë

Në hartën sizmotektonike përvijohen qartë zonat e shkëputjeve kryesore sizmoaktive në Shqipëri me potencialin e pritshëm sizmik. Dy nga zonat e shkëputjeve sizmoaktive gjatësore: Joniko-Adriatike dhe Peshkopi-Korçë (zona sizmoaktive e Drinit, siç quhet ndryshe), dhe zona e shkëputjeve tërthore Lushnjë-Elbasan-Dibër paraqesin zonat sizmoaktive me potencialin sizmik më të lartë (shih figurën më sipër).

Zona e Bashkisë Vau-Dejës, që bën pjesë në zonën sizmoaktive Joniko-Adriatike, vlerësohet me potencial sizmik me magnitudë 6.0-7.0 ballë shkalla Rihter dhe intensitet epiqendror 8-9 ballë MSK-64.


4.1.10.4 Vlerësimi i rrezikut sizmik probabilitar i bashkisë Vau-Dejës

Vlerësimi i rrezikut sizmik probabilitar i zonës ku zë vend Bashkia e Vau-Dejës është bazuar në studimin e rrezikut sizmik probabilitar për Shqipërinë, i botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë në vitin 2011.

Vlerat e shpejtimit maksimal të truallit - PGA janë llogaritur për truall shkëmbor, për dy nivele probabiliteti:

- 10 % probabilitet tejkalimi në 10 vjet
- 10 % probabilitet tejkalimi në 50 vjet

Rezultatet e rrezikut sizmik probabilitar për Shqipërinë janë llogaritur me relacionin e shuarjes të lëkundjeve të forta të Sadigh etj., për zonat perëndimore të burimeve sizmike me regjim shtypës dhe me relacionin e Spudich etj., për zonat lindore me regjim zgjerues, dhe janë paraqitur në hartat e rrezikut sizmik.



Në Hartën e Rrezikut Sizmik probabilitar për periodë përsëritje 475 vjet (shih figurën më sipër), konstatohet që vlerat e shpejtimit maksimal të truallit - PGA shkojnë nga 0.4g në pjesën përendimore deri në 0.22g në skajin veri-lindor të bashkisë.

Nga vlerësimi probabilitar i rrezikut sizmik i Bashkisë Vau-Dejës, i kryer për truall shkëmbor dhe për probabilitet 10%/50 vjet ose 475 vjet periodë përsëritje të tërmeteve, janë përfutur parametrat e rrezikut sizmik të paraqitura në tabelën në vijim. Vlerat e shpejtitit maksimal të truallit – PGA (mesatar) për periodë përsëritje 475 vjet në truall shkëmbor në territorin e Bashkisë të Vau-Dejës variojnë nga 0.251 g në Temal, në 0.389 g në Bushat që është dhe zona me rrezikun më të lartë.

Bashkia Vau Dejës Njësitë Administrative	PGA (g)	PGA (g)	PGA (g) mesatare	
	minimal	maksimal	10%/50vjet	10%/10vjet
Bushat	0.357	0.402	0.389	0.215
Vau Dejës	0.268	0.375	0.317	0.190

Vig-Mnelë	0.289	0.364	0.331	0.167
Hajmel	0.349	0.385	0.370	0.199
Temal	0.226	0.266	0.251	0.145
Shllak	0.250	0.288	0.264	0.145
Shënim: Kjo tabelë jep vlerat e rrezikut sizmik (PGA) për Bashkinë Vau Dejës me probabilitet 10%/10 vjet (95 vjet periudhë përsëritje) dhe 10%/50 vjet (475 vjet periudhë				

PGA mesatare sipas njësive administrative




Figura 4.38 Paraqitje grafike e rrezikut sizmik për njësitë administrative

Këto vlera të parametrave të rrezikut sizmik kanë rëndësi praktike për ndërtimet në secilën Njësi Administrative të bashkisë Vau Dejës dhe mund të përdoren nga inxhinierët e ndërtimit për projektimin e ndërtesave. Gjithsesi ato mbeten vlera referencë për objektet shumë katëshe dhe ato të rëndësisë së veçantë, pasi në këto raste është i domosdoshëm një vlerësim i detajuar sizmik dhe konsiderimi i amplifikimit nga depozitimet (studimi gjeologjik i truallit).

4.1.10.5 Përfundime dhe rekomandime

Nga studimi për vlerësimin e rrezikut sizmik të Bashkisë Vau-Dejës, nxjerrim këto përfundime dhe rekomandime:

Vlerësimi i rrezikut sizmik probabilitar i territorit të bashkisë të Vau-Dejës, është kryer duke u bazuar në metodologjinë probabilitare të rrezikut sizmik për Shqipërinë, që jepet në punimin shkencor "Sizmiciteti, Sizmotektonika dhe Vlerësimi i rrezikut Sizmik në Shqipëri", i botuar në vitin 2010 nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe i përgatitur nga Profs. Shyqyri Aliaj, Siasi Koçiu, Betim Muço e Eduard Sulstarova. Vlerat e shpejtimit (akseleracionit) maksimal horizontal të truallit - PGA janë llogaritur për truall shkëmbor, për dy nivele probabiliteti: 10 % probabilitet tejkalmi në 10 vjet dhe 10 % probabilitet tejkalmi në 50 vjet (koha e ekspozimit ose e jetëgjatësisë ekonomike), që u korespondojnë dy periodave të përsëritjes të tërmeteve: 95 vjet dhe 475 vjet, në përputhje të plotë me Eurokodin 8.

Për bashkinë Vau-Dejës, si kudo në Shqipëri, rekomandohet të merren në konsideratë rezultatet e parametrave të rrezikut sizmik për probabilitet 10%/50 vjet ose 475 vjet periodë

përsëritje të tërmeteve, çka dëshmohet nga studimet për rrezikun nga tërmetet në Shqipëri, ku një tërmet me magnitudë 7.0 ballë shkalla Rihter (tërmeti më i fortë i mundshëm në Shqipëri) mund të përsëritet çdo 500 vjet.

Zona e Bashkisë Vau-Dejes edhe në të ardhmen pritet të preket nga tërmete të fortë me magnitudë 6.0-7.0 ballë shkalla Rihter dhe intensitet epiqendror 8-9 ballë MSK-64.

Vlerat e shpejtimit maksimal të truallit – PGA për periudë përsëritje 475 vjet në truall shkëmbor në territorin e bashkisë Vau-Deës variojnë nga 0.251 g në Temal, në 0.389 g në Bushat (shih Tabelën).

Vlerat e parametrave të rrezikut sizmik të paraqitura në kanë rëndësi praktike për ndërtimet në bashkinë Vau Dejës dhe duhet të merren në konsideratë për zhvillimin urban të saj, në veçanti për ndërtimet e ardhshme, por edhe për vlerësimin e vulnerabilitetit të strukturave ekzistuese (kryesisht ato me karakter publik-social, si spitale, shkolla etj.).

4.2 Analiza metabolike

4.2.1 Hyrje

Sipas përcaktimeve të VKM 671 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", analiza metabolike është pjesë e hartimit të strategjisë territoriale të PPV-së dhe një model për analizën dhe identifikimin e flukseve të materialeve dhe energjisë brenda territoreve të caktuara. Në një vështrim të përgjithshëm, qyteti shihet si një organizëm i gjallë që ka nevojë për energji dhe burime për të funksionuar dhe që nga funksionimi i tij prodhohen mbetjet. Modeli krijon mundësinë e studimit të ndërveprimit midis sistemeve natyrore dhe njerëzore në një rajon. Kjo analizë studion flukset në territorin urban. Analiza zhvillohet përmes identifikimit të hyrjeve dhe daljeve kryesore në sistemin urban. Metabolizmi mund të përcaktohet si tërësia funksionale e proceseve sociale, ekonomike dhe teknike që ndodhin në qytete, si pasojë e rritjes së tyre, prodhimit të energjisë si dhe asgjësimit të mbetjeve. Analiza i shërben VSM-së duke ndihmuar identifikimin e ndotjes së ujërave dhe ajrit, shpërdorimin e burimeve, humbjen dhe degradimin e tokës, energjinë e nevojshme që harxhohet, si dhe lidhjen që kanë qytetet me periferinë. Ky është në thelb një bilanc i ndikimit të qytetit në mjedis që përcakton masa përmirësuese apo neutralizuese të ndikimit negativ. Praktikisht, metabolizmi i një sistemi urban është një përmbledhje e numrit të hyrjeve dhe daljeve (input-output) dhe mënyrës së përdorimit të ujit, energjisë, ushqimit, mbetjeve etj. në të.

Hyrjet në sistemin urban (toka, uji, ajri, energjia, burimet e tjera) ndryshojnë pasi kalojnë në të, duke u transformuar në dalje (mbetje dhe shkarkime në ajër, ujë dhe tokë). Nëpërmjet analizës kryhet bilanci i burimeve natyrore të shfrytëzuara (hyrjet), mënyrës së përdorimit të tyre dhe ndotjeve e humbjeve që shkaktohen në sistemin urban (daljet). Hyrjet dhe daljet e secilit fluks krijojnë një tablo të plotë të mënyrës së funksionimit të territorit, duke evidentuar potencialet dhe burimet që mundësojnë funksionimin e territorit si një i tërë. Strategjia e mbështetur në analizën metabolike, mbështetet mbi parimet e qëndrueshmërisë dhe ka për qëllim përmirësimin e sistemit urban.

Metabolizmi konsiderohet si një proces dinamik fluksesh në një vend të dhënë, në një moment të dhënë, në një stad të dhënë të zhvillimit urban, dinamikë e cila shpjegohet me konceptin e vazhdimësisë ekologjike. Me "vazhdimësi ekologjike" kuptohen proceset e

ndryshimeve në strukturën e specieve të një bashkësie ekologjike përgjatë kohës; ky proces varet nga kushtet klimatike, tokës dhe ndërhyrjet njerëzore.

Fluksi i energjisë dhe ujit do të kenë një analizë paraprake në shkallë rajoni e më pas në shkallë bashkie meqenëse këto burime menaxhohen në rang kombëtar dhe nuk gjenerohen tërësisht në territorin e bashkisë. Sidomos burimet ujore, kalojnë në disa sisteme urbane (lumenjtë) duke mbartur me vete edhe ndotjen që shkaktohet nga këto sisteme.

Për matjen e flukseve është përzgjedhur metoda LCA (Life Cycle Assessment) e cila mundëson vlerësimin e ciklit të jetës së burimeve. Gjithashtu, LCA vlerëson ndikimet e mundshme mjedisore, që nga shkaku (fillimi) deri në eliminimin total të tyre.

4.2.2 Energjia dhe uji në rajon

Bashkia Vau-Dejës shtrihet në Rajonit Verior të vendit dhe në aspektin gjeografik dhe zhvillimor lidhet dhe kufizohet me bashkitë Shkodër, Tropojë, Fushë- Arrëz, Pukë, Lezhë, Krujë, Tiranë. Në bilancin e energjisë dhe burimeve për bashkinë Vau-Dejës na duhet të konsiderojmë një rajon më të gjerë që mundëson një vlerësim të plotë e të qartë të flukseve dhe ndërveprimit në shkallë territoriale. Në këtë kuadër, rajoni në analizën metabolike nënkupton bashkinë Vau-Dejës si dhe njësitë e tjera administrative dhe territoriale që bashkëveprojnë në mënyrë të ndërsjellë me këtë territor.




Figura 4.39 Harta e flukseve në territorin e Bashkisë Vau-Dejë Tabela

Energjia

Shqipëria ka një potencial të madh hidroenergjetik, prej të cilit është shfrytëzuar vetëm 35.4 % e tij. Në shkallë vendi, kapaciteti i fuqisë së instaluar është 1,466 MW dhe prodhimi mesatar i energjisë arrin në 5.283 GWh. Rezervat totale hidroenergjetike lejojnë instalimin e një rrjeti energjetik prej 4,500 MW dhe prodhimi vjetor i energjisë mund të arrijë deri në 16 TWh. Në mbarë vendin janë 107 kontrata koncesionare në proces me një kapacitet total prej 1,386 MW që do të mundësojnë rritjen e burimeve energjetike të rajonit. Energjia hidrike në rajon shfrytëzohet përmes HEC-eve kryesisht në lumin Drin dhe Mat.

Hidrocentralet e mëdha

Numri i hidrocentraleve në funksionim është 7 hidrocentrale të mëdha dhe 38 të vogla.

Mbi lumin Drin ndodhen tre hidrocentrale në funksionim me një fuqi të instaluar në total prej 1,350 MW: në Vaun e Dejës, në Koman dhe Fierzë. Një kontratë koncesionare është nënshkruar për ndërtimin e një hidrocentrali tjetër në Ashtë, mbi lumin Drin, midis Qeverisë Shqiptare dhe kompanisë austriake "Österreichische Elektrizitätswirtschafts - Aktiengesellschaft", me një kapacitet të instaluar 48.2 MW.

Tabela 4.6 Fuqia dhe kapaciteti i hidrocentraleve në vend

Nr.	Hidrocentrali	Fuqia e instaluar (kW)	Kapaciteti prodhues vjetor (kWh)
1.	Ulëza (Mat)	25.000	120.000.000
2.	Shkopeti (Mat)	24.000	90.000.000
3.	Bistrica i (Sarandë)	22.500	100.000.000
4.	Vau i Dejës (Shkodër)	250.000	1.000.000.000
5.	Fierza (Tropojë)	500.000	1.800.000.000
6.	Komani (Shkodër)	600.000	2.000.000.000

Hidrocentralet e vogla

Në shkallë vendi numërohen 70 hidrocentrale të vogla me kapacitete që renditen midis 20 dhe 9,200 kW. Vetëm 38 prej tyre janë funksionale, ndërsa të tjerët janë jo operacionale. Midis tyre, 32 hidrocentrale funksionojnë në bazë të kontratave koncesionare (kapacitet i instaluar 24.4 MW), 16 janë privatizuar dhe operojnë me një kapacitet të instaluar 2,047 MW dhe 22 janë pronë shtetërore me një kapacitet të instaluar 11 MW.

Qëllimi i ndërtimit të këtyre hidrocentraleve të vogla është furnizimi me energji i zonave të thella malore. Ato janë të tipit me derivacion dhe përdorin ujin e rrjedhave ujore në afërsi të tyre.

Burimet alternative




Figura 4.40 Ndarja në zona sipas shpejtësisë së erës dhe orëve vjetore

Burimet energjetike alternative janë shumë pak të shfrytëzuara. Energjia diellore apo ajo e erës nuk kanë gjetur ende përdorim të gjerë.

Energjia diellore në rajon është lehtësisht e shfrytëzueshme. Numri i orëve me diell në bashki arrin deri në (2300-2500 orë/vit) dhe mundëson rendiment mjaft të lartë në përdorimin e këtij burimi.

Shfrytëzimi i burimeve alternative të energjisë do të mund të nxisë modelet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të garantojë ruajtjen e mjedisit dhe ekosistemit.




Figura 4.41 Energjia diellore në Shqipëri

Uji

Rajoni është i pasur me ujëra nëntokësore dhe sipërfaqësore. Territori i rajonit përshkohet nga lumenj të rëndësishëm si Drini dhe Gjadri. Shfrytëzimi i lumenjve për prodhimin e energjisë është potenciali kryesor me impakt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e rajonit. Në zonën veriore të rajonit ndodhen edhe HEC-et kryesore të cilat furnizojnë me energji një pjesë të konsiderueshme të territorit të Shqipërisë (Ulëza, Shkopeti, Fierza, Komani, Vau-Dejës, si dhe Ashta 1 e 2).

Hidrografia e rajonit përbëhet prej ujërave sipërfaqësore dhe ujërave nëntokësore që gjenden në akuiferët kryesorë të zonës në studim. Rrjeti hidrografik i rajonit përbëhet prej disa lumenjve, ku ndër më kryesorët është Lumi Drin.

Drini është lumi më i gjatë i trojeve shqiptare me 160 kilometra gjatësi. Degët kryesore të Drinit janë lumi i Shalës, lumi Valbona që buron nga Alpet Shqiptare, Drini i Bardhë në Kosovë dhe Drini i Zi në Maqedoni. Në pjesën fundore Drini derdhet në lumin Kir, i cili buron nga Dukagjini, e pastaj bashkë derdhen në Bunë. Drini i madh është shumë i gjerë dhe sjell një sasi të madhe uji ($330 - 340 \text{ m}^3/\text{s}$), i dyti për nga kapaciteti pas Bunës, por ky i fundit, duke qenë i shkurtër, në mjaftë harta shënohet edhe si liqen. Pas Vaut të Dejës, krah i gjatë shkon drejt jugut për nga Bushati, Maba, Gjadri, Lezha. Në jug të Lezhës hyn në një zonë moçalore e më tej derdhet në Adriatik.

Drini rrjedh në pjesën verior dhe është kthyer në një zinxhir liqenesh artificiale (i Fierzës, i Komanit dhe i Vaut të Dejës) që furnizojnë me ujë tre hidrocentralet e mëdha. Prurja mesatare vjetore e Drinit arrin $352 \text{ m}^3/\text{sek}$, kurse maksimalja e regjistruar është mbi $5.100 \text{ m}^3/\text{sek}$. Duke kaluar në fshatrat Sipas, Msi dhe Fierzë, e mandej, pasi mbërrin në krahinën e Dukagjinit, ai shkon drejt jugut, kalon nga Apripë e Gurit, Toplanë, Dushman, Koman, Vjerdhë, Mazrrek, Rragam, dhe Pale Lalej. Në Vaun e Dejës, hyn në ultësirat e Nënshkodrës dhe ndahet në dy krahë: një që derdhet në gjirin e Drinit në Adriatik në jug-perëndim të Lezhës, dhe tjetri që derdhet në lumin Kir e më tej në Bunë afër Kalasë së Shkodrës. Edhe pse është dega më e shkurtër prej 15 km, kjo ndarje që derdhet në Bunë quhet Drini i Madh, sepse bie më shumë ujë se krah i tjetër që derdhet drejtpërdrejt në det. Drini i Madh gjithashtu derdhet në det, por ka ndryshuar rrjedhën e vet pas një përmbytjeje të madhe në vitin 1858 duke ardhur drejt Shkodrës.

Lumi i Gjadrit është degë e majtë e Drinit, që shtrihet në perëndim të rrethit të Pukës e në verilindje të rrethit të Lezhës. Ka gjatësi 40.5 km, sipërfaqe 199 km^2 dhe lartësi mesatare 422 m. Fillon nga shpatet veriperëndimore të Bjeshkëve të Tërbunit. Në pjesën e sipërme të rrjedhjes, ka formuar një luginë tipike me shpate shumë të pjerrëta e fund të ngushtë. Që nga Kalivaçi e deri në Hajmel, lugina merr pamjen e një pellgu. Gjadri, pasi mbledh ujërat e pjesës veriperëndimore të përroit të Dibrës dhe atij të Kakrit, kthen në veriperëndim dhe derdhet në Drin.

Akuiferi i Nënshkodrës ka një përhapje mjaft të gjerë në luginat dhe fushat e formuara nga lumenjtë Drini e Buna. Në jug ky akuifer kufizohet me fushën e Zadrimesë, ndërsa në veri me akuiferin e Mbishkodrës. Ai shtrihet në gjithë pjesën e ulët fushore dhe është formuar me aktivitetin akumulativ të materialit të shkrifët aluvional të depozitimeve kuaternare të lumenjve Buna e Drin. Akuiferi përbëhet nga shtresa të fuqishme zhavorresh e zhuresh me veti të larta filtruese, të cilat grumbullojnë sasi të konsiderueshme rezervash të ujërave nëntokësore të freskëta. Zhavorret e zhuret ujëmbajtëse dominojnë në prerje dhe zënë 60-

80 % të saj. Trashësitë e shtresave luhaten nga 5-10 deri 60 m e në zona të veçanta edhe më tepër. Mbulesa subrërore lëviz nga 2-3 m deri 25-30 m. Në zonën e Mjedës, Kaç-Naraçit e Stajkës, zhavorret dalin në sipërfaqe të tokës. Mbulesa subrërore subargjilore rritet nga veriu në jug dhe nga lindja drejt perëndimit, si dhe në drejtim të rrjedhjeve të lumenjve Buna e Drin. Ujërat nëntokësore të zhavorreve të këtyre luginave aluviale kanë lidhje të mira hidraulike, me ujërat sipërfaqësorë të lumenjve Buna e Drin, prandaj janë të pasura dhe përmbajnë rezerva të konsiderueshme, gjë e cila është vërtetuar nga shpimet e kryera. Në pjesën lindore e veriore të këtij pellgu, ujërat nëntokësore janë pa presion, ndërsa në sektorët jugorë e perëndimorë, si rezultat i rritjes së mbulesës subrërore e subargjilore dhe si rezultat i pozicionit hipsometrik më të lartë të zonës së ushqimit, ato fitojnë presion dhe në disa zona shpimet kanë dhënë ujë me vetërrjedhje si në Trush të Poshtëm, Pistull, Paçram, Gocaj etj. Megjithatë nivelet e ujërave nëntokësore, në pjesën më të madhe të akuiferit janë nën sipërfaqen e tokës, por jo në thellësi të madhe si në zonën e Mbishkodrës.

Nivelet luhaten nga 1.0 m deri 3-3.5 m, rrallë shkojnë deri 5.0 m nën sipërfaqen e tokës. Luhatjet e niveleve lidhen drejtpërsëdrejti me regjimin hidrogeologjik të lumenjve Buna e Drini, çka vërteton edhe marrëdhëniet e mira hidraulike të tyre në ujërat nëntokësore. Ujëdhënia dhe ujëpërshkueshmëria e zhavorreve është shumë e lartë në përgjithësi, megjithatë ka edhe zona të kufizuara me vlera mesatare e të vogla. Koeficientët e filtrimit luhaten nga 30-50 m/ditë dhe prurjet specifike nga 5-10 lit/sek/m, në zonat e ekstremeve perëndimore, jugperëndimore e jugore të pellgut deri në 400- 700 m/ditë dhe 100-150 lit/sek/m respektivisht në pjesën më të madhe të tij e sidomos në sektorët më afër lumenjve Buna e Drini. Në shpimet e kryera në afërsi të Bahçallëkut në Dajç të Bregut të Bunës, Shirqe, në Trush të Poshtëm, Bërdicë, Melgush, Kosmaç, Stajkë, Mjedë, Qendër Bushat, etj. koeficientët e filtrimit luhaten nga 100-150 m/ditë deri 400 - 750 m/ditë, ndërsa prurjet specifike nga 40-60 lit/sek/m, deri 100-150 lit/sek/m, e në puse të veçantë edhe më tepër. Ushqimin kryesor ujërat nëntokësore e marrin nga lumenjtë Buna e Drin dhe pjesërisht nga reshjet atmosferike, në seksionet ku zhavorret dalin në sipërfaqe të tokës. Përsa i përket përbërjes fiziko kimike të ujërave të zonës Mbishkodrës, mund të themi se kemi të bëjmë me ujëra me veti fiziko-kimike të mira. Mineralizimi i përgjithshëm lëkundet nga 0.17 gr/l në 0.5 gr/l. Mbetjet e thata më të vogla takohen si në pjesën lindore të zonës, ashtu edhe atë perëndimore në afërsi të liqenit, ndërsa më të mëdhatë në pjesën qendrore në fshatin Omaraj. Fortësitë më të vogla takohen në afërsi të lumit Kiri dhe liqenit të Shkodrës, ndërsa më të mëdhatë në pjesën veri dhe veriperëndimore të zonës. Ujërat nëntokësore të këtij pellgu janë në përgjithësi të freskëta dhe veti të mira fiziko-kimike, temperaturë nga 12 - 16°C, mineralizim të përgjithshëm nga 0.2 deri 0.5 gr/l. Në disa sektorë mineralizimi arrin deri 0.7 gr/lit vetëm në një zonë të Barbullushit kemi Mp mbi 1gr/l. Fortësia e përgjithshme lëviz nga 7 deri 20 gradë gjermane. Me mineralizim dhe fortësi më të vogël janë ujërat në pjesën lindore të pellgut dhe afër lumenjve Buna e Drin. Nga punimet e kryera deri tani, del qartë se zonat më me perspektivë dhe më të pasura me ujëra nëntokësore, janë ato të krahut të majtë të rrjedhjes së lumit Buna, duke filluar prej urës së Bahçallëkut dhe deri në Dajç të Bregut të Bunës, me një front prej 8-10 km dhe në të dy krahët e lumit Drin prej Shkodrës e deri në Mjedë, me front 18- 20 km (për të dy krahët së bashku).

4.2.3 Analiza e bashkisë Vau-Dejës

Analiza e metabolizmit të territorit të Bashkisë Vau-Dejës merr në konsideratë disa faktorë kryesorë që ndikojnë në flukset e energjisë, ujit, ushqimit dhe mbetjeve. Bashkia e Vau-

Dejës ka një sipërfaqe prej 496 km² dhe një popullsi prej 49 399 banorë. Flukset e analizuar në kuadër të analizës së metabolizmit janë energjia, uji, ushqimi dhe mbetjet. Analiza për secilën rrymë ndjek të njëjtën metodologji në parim, por për shkak të mungesës së informacioneve të caktuara, analiza pëson modifikime nga fluksi në fluks. Për të analizuar flukset janë vëzhguar hyrjet dhe daljet për secilin prej tyre, për të kuptuar problemet mjedisore dhe humbjet.

4.2.4 Fluksi i energjisë

Fluksi i energjisë tregon raportet midis sasisë së energjisë së prodhuar dhe asaj të konsumuar në territorin e bashkisë Vau-Dejës. Këtu trajtohen edhe burimet potenciale që mund të shfrytëzohen duke balancuar burimet e mbishfrytëzuara.

Energjia hidrike e lumenjve brenda territorit të bashkisë Vau-Dejës shfrytëzohet në nivele të larta pasi edhe lumenjtë që kalojnë në këtë territor janë me prurje të konsiderueshme. Në territorin e bashkisë, mbi lumin Drin janë ndërtuar disa hidrocentrale: hidrocentrali i Vau-Dejës, i Komanit, si dhe Ashta 1 e 2. Hidrocentrale këto me një kapacitet që shkon deri në 600 MW në hidrocentralin e Komanit. Një sërë hidrocentralesh janë parashikuar të ndërtohen edhe mbi lumin Gjadër.

Një burim alternativ energjie që ka potencial për t'u përdorur në territorin e Vau-Dejës, është energjia diellore. Vau-Dejës ndodhet ndërmjet izolinjave 1300 – 1450 kWh/m² në vit. Shpërndarja e mesatares ditore për rrezatimin ditor në territorin e bashkisë Vau-Dejës varion nga 3.56-3.97 kWh/m². Energjia diellore shfrytëzohet në nivel kombëtar 0.1 % dhe shfrytëzohet për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar dhe në mënyrë individuale me kolektorë diellorë. Energji tjetër potenciale në Vau-Dejë mund të jetë energjia e erës. Shpejtësia maksimale e erës në territorin e Bashkisë Vau-Dejës arrin nga 3 m/s deri në 3.5 m/s.

Energjia elektrike është një nga burimet primare të energjisë në Shqipëri. Për të llogaritur konsumin e energjisë për familje/vit jemi mbështetur mbi të dhënat INSTAT, Censusi 2011 (Grid). Duke iu referuar numrit të banorëve që gjenden për çdo km² në të gjithë territorin e Bashkisë Vau-Dejës dhe duke marrë parasysh që konsumi total i energjisë në Shqipëri për vitin 2011, është 2,587,907 MWh, mund të llogarisim sa energji elektrike konsumon mesatarisht një familje në vit.

Për vitin 2011 sipas INSTAT numri mesatar i personave në një familje është përafërsisht 4 anëtarë. Numri total i Njësive Ekonomike Familjare është: 722,262 familje (CENSUS 2011). Konsumi mesatar i energjisë elektrike për familje në vit është: Konsumi i energjisë elektrike nga familjet (2,587,907)/nr. e familjeve (722,262) = Energjia elektrike që konsumon një familje për një vit (3.6 MWh). Për të gjeneruar energjinë e konsumuar për çdo km², shumëzojmë numrin e familjeve në atë sipërfaqe me vlerën mesatare vjetore të konsumit të energjisë.

Bashkia Vau-Dejës: (49,399 banor/4)familje x 3.6 MWh = 44459.1 MWh në vit

Tabela 4.7 Popullsia banuese në Shqipëri (INSTAT, 2011)

Popullsia banuese gjithsej	2,821,977
Numri gjithsej i njësive ekonomike familjare	722,262

Në hartën e mëposhtme paraqitet në mënyrë grafike konsumi i energjisë.




Figura 4.42 Potenciali dhe konsumi i energjisë

Tabela 4.8 Njësitë ekonomike familjare në Shqipëri sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohje në zonat urbane dhe rurale (INSTAT, 2011)

Lloji kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje	Zona urbane dhe rurale		
	Gjithsej	Urbane	Rurale
Gjithsej	722,262	409,309	312,953
Dru	414,982	148,567	266,415
Energji elektrike	111,020	98,226	12,794
Gaz	150,321	127,945	22,376
Panele diellore	305	224	81
Lloj tjetër energjie (panele diellore, qymyr, naftë, etj.)	2,679	1,901	778
Pa ngrohje	42,955	32,446	10,509

Një sasi e konsiderueshme e energjisë së konsumuar shkon për ngrohje. Sipas të dhënave të INSTAT, burimi kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje në Bashkinë Vau-Dejës, nga njësi ekonomike familjare (NjEF), vazhdon të jetë energjia e përfutur nga drutë e zjarrit. Bazuar në tabelën më sipër: 57.46 % të NjEF përdorin drutë e zjarrit për t'u ngrohur, ndjekur nga gazi (20.81 %) dhe më pas nga energjia elektrike (15.37 %). Mënyrat e tjera të ngrohjes janë në përqindje shumë të vogla.

Tabela 4.9 Bilanci i energjisë elektrike, në rang vendi (INSTAT, 2011)

Emërtimi	Energjia (MWh)
Energji në dispozicion (Burimi)	7,532,055
Prodhimi neto vendas	4,057,089
Termocentrale	0
Hidrocentrale	4,057,089
Importi bruto (energji në marrje)	3,474,966
Eksporti bruto (energji në dhënie)	300,544
Humbje në rrjet	2,179,157
Familjet	2,587,907
Të tjera	2,443,667




Figura 4.43 Hidrocentralet në territorin e Shqipërisë

4.2.5 Fluksi i ujit

Fluksi i ujit tregon për bilancin e prodhimit të ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor në territorin e Bashkisë Vau-Dejës dhe sasinë e konsumuar të tij. Uji përdoret për qëllime teknologjike, për pirje, shpërndarje nëpërmjet rrjetit të ujësjellësit dhe përdoret për banorët, bizneset, industrinë, institucionet etj.

Për të bërë një llogaritje të përafërt të sasisë së ujit që ndodhet në organizmin urban (në territorin e Bashkisë Vau-Dejës, në këtë rast) mund të nxjerrim sasinë totale të ujërave në territor (ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore) dhe sasinë e përdorimit të ujërave. Sasia e ujërave nëntokësore llogaritet nga burimet që shfrytëzohen në territor. Ujërat sipërfaqësore zënë një sipërfaqe prej 24.22 km² në të gjithë territorin e Bashkisë Vau-Dejës. Pjesë të rëndësishme në territorin e bashkisë, nga pikëpamja e ujërave sipërfaqësore, zënë kanalet ujitëse.

Shtresat nëntokësore ujëmbajtëse ndodhen kryesisht në akuiferin e Nënshkodrës, i cili furnizohet nga lumenjtë Buna dhe Drin. Sasia e ujit që mund të shfrytëzohet nga burimet ujore është nga 900 - 1000 l/sek. Këto ujëra nëntokësore përdoren për pirje, për t'u shpërndarë në sistemin e ujësjellësit, për qëllime teknologjike etj.

Bashkia Vaut-Dejës, pavarësisht burimeve të shumta ujore, ende nuk garanton mbulim tërësor të territorit më këtë shërbim publik. 19 rrjete sistemi të ujësjellësve operojnë gjithsej në bashki, ku vetëm 9 operojnë në Bushat, që përfaqëson edhe njësinë administrative që paraqitet më mirë me furnizimin me ujë të pijshëm të popullatës. Nga 19 rrjetet e ujësjellësit, 13 prej tyre janë me rrjete me ngritje mekanike, pra që kanë edhe sistemet përkatëse të pompimit (respektivisht 15 sisteme pompimi). 5 rrjete ujësjellësi janë me rrjedhje të lirë, çka do të thotë se janë sisteme me kosto të reduktuara të funksionimit. Vetëm 4 prej tyre, funksionojnë në njësinë administrative Shllak. Një pjesë e konsiderueshme e familjeve në fshatra sigurojnë ujin e pijshëm nëpërmjet burimeve natyrore (krua) si dhe nëpërmjet përdorimit të puseve. Problematik mbetet furnizimi me ujë higjienikisht të pastër për 24 orë të familjeve në zonën urbane të Vaut të Dejës. Kjo zonë ka një numër të madh të familjeve, që aktualisht nuk u sigurohet ujë i pijshëm nëpërmjet rrjetit të ujësjellësit. Nga të dhënat e marra nga UK sh.a. Vau-Dejës, aktualisht sistemi i furnizimit dhe shpërndarjes së ujit në njësinë administrative Vau-Dejës ka në përbërjen e vet katër rezervuarë. Vepra e marrjes ndodhet brenda territorit të qytetit. Prurjet që merren nga pusshpimi janë përkatësisht 45 l/sek (minimale) dhe 75 l/sek (maksimale). Furnizimi i linjës së jashtme kryhet nëpërmjet stacionit të pompimit në Vaun e Dejës, prurja e të cilit, në varësi të sezonit, varion nga 50 - 70 l/sek. Sasia ditore e ujit të prodhuar arrin deri në 2.066 m³. Për njësinë administrative Bushat, rrjeti i furnizimit me ujë për qytetin nuk ka pasur asnjë rehabilitim apo ndërhyrje që nga ndërtimi i tij. Furnizimi i linjës së jashtme kryhet nëpërmjet stacionit të pompimit, prurja e të cilit është rreth 30 m³/h. Sasia ditore e ujit të prodhuar arrin në 300 - 360 m³/ditë. Për njësitë e tjera administrative mund të themi se furnizimi me ujë realizohet kryesisht nëpërmjet puseve private. Aktualisht mund të themi se rreth 50% e territorit të bashkisë Vau-Dejës ka mbulim nga rrjeti i furnizimit dhe shpërndarjes së ujit.



Figura 4.44 Fluksi i ujit




Figura 4.45 Konsumi i ujit

Për të llogaritur konsumin e ujit të pijshëm në nivel bashkie jemi mbështetur në të dhënat e UK sh.a. Vau-Dejës dhe në të dhënat e INSTAT, Censusi 2011 (Grid) për popullsinë dhe numrin e banorëve për çdo km² në të gjithë territorin e Bashkisë Vau-Dejës. Konsumi mesatar i ujit të pijshëm për konsumatorët familjarë (banorë) është 100 litra/banorë/ditë. Burimet ujore që gjenden në bashki janë mjaft më të larta sesa shkalla e shfrytëzimit të tyre.

4.2.6 Fluksi i ushqimit

Fluksi i ushqimit, analizon të dhënat për importin, prodhimin, përpunimin, konsumin, humbjen dhe eksportin e ushqimeve. Për sa i përket fluksit të ushqimit në Bashkinë Vau-Dejës do të analizojmë të dhënat bujqësore dhe blegtorale, që prodhohen në territor, pasi zënë një peshë kryesore në fluksin e ushqimit. Importet realizohen në nivel kombëtar dhe nuk ka shifra të sakta për thithjen e tyre në nivel vendor. Të dhënat për përthithjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale janë në nivel qarku. Në këtë rast, për të llogaritur fluksin e ushqimit mund të fokusohemi më tepër në të dhënat mbi produktet bujqësore dhe blegtorale si dhe infrastrukturën ndihmëse, siç janë pikat e grumbullimit dhe të përpunimit të këtyre produkteve, sasinë e produkteve që shkon në treg dhe sasinë e produkteve që shkon për eksport.

Sipas të dhënave nga Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) në territorin e Vau-Dejës prodhohet një sasi e lartë e produkteve bujqësore dhe blegtorale, të cilat kanë ndikim në rang kombëtar e jo vetëm për territorin e kësaj bashkie.

Sipërfaqja totale e tokave bujqësore në Bashkinë Vau-Dejës është 11753.33 ha. Sipërfaqja e ultësirës së Zadrimës shquhet si një nder zonat më të përshtatshme dhe pjellore në mbjelljen dhe kultivimin e kulturave bujqësore.

Për të llogaritur fluksin e ushqimit janë përdorur të dhënat e INSTAT (prodhimet) dhe të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit dhe Administrimit të ujërave (sasia që shkon në treg dhe eksport). Fluksi i ushqimit është realizuar vetëm për disa kultura, pasi të dhënat nuk janë të plota dhe nuk mund të kuptohen hyrjet dhe daljet. Siç mund të kuptojmë nga fluksi, hyrjet (prodhimet) janë më të larta sa daljet (treg dhe eksport) sepse një pjesë e këtyre produkteve shkon për konsum vetjak, një sasi e caktuar është humbje dhe një pjesë tjetër shkon për shitje në mënyrë informale.

Tabela 4.10 Fermat në Bashkinë Vau-Dejës (QTTB dhe MBZHRAU, 2014)

Njësitë administrative	Ferma gjithsej	Ferma Bujqësore		Ferma Blegtorale	
		Nr.	Ha	Nr.	Nr. Krerë
Vau-Dejës	2803	1823	1132	980	426
Bushat	8746	4996	6502	3750	3414
Hajmel	2137	1187	1848	950	832
Vig-Mnelë	1210	771	183	430	60
Shllak	1064	659	101	405	25
Temal	1121	821	116	300	18
Total	17081	10257	9882	6815	4775
Burimi: Fermat Bujqësore dhe Blegtorale në Shqipëri - Q.T.T.B. Vau-Dejës (botim i vitit 2014)					

Tabela 11: Fermat bujqësor dhe blegtoral në Bashkinë Vau-Dejës

Ferma bujqësore																	
Nr.	Njesia administrative	Ferma Bujqësore gjithsej		Ferma me bimë arash		Ferma me bimë foragjere		Ferma me perime në sera		Ferma me drejtum frutikuturë		Ferma me drejtum vreshta		Ferma me drejtum ullishte		Ferma me bimë aromatike mjeksore	
		Nr.	Ha	Nr.	Ha	Nr.	Ha	Nr.	Ha	Nr.	Ha	Nr.	Ha	Nr.	Ha	Nr.	Ha
1	Vau Dejës	1823	1132	1650	960.8	980	426	8	0.8	21	14.5	28	32.4	85	89	0	0
2	Bushat	4996	6504	4400	5886	3950	3414	190	46	25	12.5	19	12.8	22	15	1	0.8
3	Hajmel	1187	1848	1010	1584	950	832	2	0.2	16	15.5	52	66.1	104	105	0	0
4	Vig-Minelë	771	183	500	119	430	60	0	0	4	8.9	0	0	54	42	0	0
5	Shllak	659	101	470	69	405	25	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
6	T emal	821	116	515	71	414	18	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Totali		10257	9884	8545	8689.8	7129	4775	200	47	66	51.4	99	111.3	265	251	1	0.8

Ferma blegtorale																	
Nr.	Njesia administrative	Ferma me gjedh		Ferma me të leshia		Ferma me të dhirta		Ferma me Stipend		Ferma me Derra Majmërie		Ferma me Derra riprodhimi		Ferma me Njethundrakë		Ferma me blejë	
		Nr.femave	Nr.Krejtëve	Nr.femave	Nr.Krejtëve	Nr.femave	Nr.Krejtëve	Nr.femave	Nr.Krejtëve	Nr.femave	Nr.Krejtëve	Nr.femave	Nr.Krejtëve	Nr.femave	Nr.Krejtëve	Nr.femave	Nr.Krejtëve
1	Vau Dejës	980	2340	176	2020	58	2500	3	4000	1446	1800	35	150	54	60	29	530
2	Bushat	3750	5500	250	3800	60	750	43	7000	1706	7500	205	450	450	500	165	200
3	Hajmel	950	2015	40	1500	54	1300	2	220	1254	6130	100	294	25	30	14	450
4	Vig-Minelë	430	450	30	1300	45	2100	0	0	731	1285	13	27	22	25	11	500
5	Shllak	405	450	100	1000	226	1600	0	0	268	300	10	10	35	35	29	350
6	T emal	300	290	150	100	170	1100	0	0	439	600	10	20	28	30	190	500
Totali		6815	11045	746	9720	613	9350	48	11220	5844	17615	373	951	614	680	438	2530

Tabela 4.12 Prodhimi bujqësor dhe blegtoral në Bashkinë Vau-Dejës

Njësitë administrative	Grurë	Misër	Perim e gjithsej	Patate	Fasule	Foragjere gjithsej	Fruta	Ullinj	Rrush
Vau-Dejës	531	2310	2086	396	44	13630	425	95	260
Bushat	1634	10624	22012	425	219	121183	1130	94	569
Hajmel	1264	2471	1109	473	28	24276	311	36	500
Vig-Mnelë	42	184	103	310	18	1800	109	15	67
Shllak	-	138	133	160	-	700	67	-	25
Temal	-	35	260	205	-	450	89	-	53
Total (në ton)	3471	15762	25703	1969	309	162039	2131	240	1474

Shënim: Të dhënat u morën nga bashkia Vau-Dejës, Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtës së Konsumatorit




Figura 4.46 Prodhimet bujqësore



Figura 4.47 Fluksi i ushqimit

4.2.6.1 Fluksi i mbetjeve

Fluksi i mbetjeve analizon sasinë e mbetjeve që importohen, prodhohen, riciklohen dhe përpunohen. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve urbane ofrohet për territorin e qytetit (Bashkia Vau-Dejës). Në territorin e Vau-Dejës shërbimi ofrohet në nivel 70-80%.

Ndërkomunalja e Zadrimes lehtëson ofrimin e shërbimit për një pjesë të madhe të territorit të bashkisë Vau-Dejës. Mbetjet organike, bimore apo shtazore, kompostohen pranë shtëpive me qëllim ripërdorimin e tyre për pleh për kulturat bujqësore, ndërsa mbetjet inerte depozitohen në venddepozitime të caktuara. Një organizim i tillë ka ulur ndjeshëm kostot e depozitimit dhe transportimit të mbetjeve. Megjithatë, ende ky shërbim nuk ofrohet në të gjithë territorin, si në Temal e Shllak. Sfidë mbetet që një organizim i tillë të ofrohet në të gjithë territorin e bashkisë, të paktën në qendrat urbane të dy njësive më të largëta.

Aktualisht, në territorin e bashkisë, në Bushat, gjendet edhe landfilli i grumbullimit të mbetjeve urbane, që ka një periudhë shërbimi për 20 vjet. Tashmë që bashkitë kanë territor më të gjerë dhe popullsi më të madhe, mund të krijohen premiset e duhura që ky landfill të përdoret në kapacitetin e tij të plotë.

Landfill-i i Bushatit ndodhet rreth 13 km në jug të qytetit të Shkodrës, rreth 2.5 km në lindje të fshatit Bushat dhe rreth 1.5 km në lindje të fshatit Shkjezë. Landfill-i është i vendosur në një terren kodrinor që ngrihet në pjesën qendrore të fushës së Zadrimes. Kodrat kanë orientim veri-perëndim dhe jug-lindje. Në landfill depozitohen mbetjet urbane të të gjitha

llojeve. Nuk lejohen të depozitohen mbetjet spitalore, bateri dhe akumulatorë, vajra industriale dhe mbetje të tjera të përcaktuara si të rrezikshme nga legjislacioni mjedisor. Duke qenë se procesi i eliminimit të mbetjeve të ngurta urbane, në disa raste mund të ndikojë shëndetin publik, rezulton e domosdoshme vendosja e një sistemi korrekt kontrolli dhe parandalimi me karakter higjieno-sanitar lidhur me operacionet që zhvillohen në landfill. Në territorin e bashkisë janë evidentuar edhe një seri pikash të jashtë ligjshme ku depozitohen mbetje nga banorët.

Në Shqipëri, në vitet 2012-2015 është venë re ky raport import/eksport mbetjesh, sipas INSTAT:

Tabela 4.13 Importi dhe eksporti i mbetjeve në Shqipëri

Mbetjet	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
	Njësia ton			
Importi	4,192	207,690	333,553	60,194
Eksporti	99,683	34,744	53,798	33,413

Për të llogaritur gjenerimin e mbetjeve bashkiake në territorin e Bashkisë Vau-Dejës, jemi mbështetur në metodologjinë e INSTAT për të dhënat e popullsisë në çdo km². Sasia mesatare e mbetjeve që gjeneron një person në ditë është 0.7 kg (qytete) dhe 0.4 kg (fshatra). Sasia më e madhe e mbetjeve të gjeneruara ndodh normalisht në zonat më të populluara siç janë njësitë administrative Vau-Dejës dhe Bushat. Sasia e gjeneruar në këto dy zona që kanë dhe numrin më të madh të banorëve, arrin vlera 185 - 385 ton/ për km² në vit.

Në bashkinë Vau-Dejës trajtimi dhe riciklimi i mbetjeve është ende në hapat e parë.

Raporti i ARM-së mbi gjendjen e mjedisit tregon që zonat rurale nuk janë të mbuluara akoma nga shërbimet e menaxhimit të mbetjeve. Pjesa më e madhe e mbetjeve të këtyre zonave depozitohen nëpër lumenj ose në anë të rrugëve të cilat pastrohen nga ujërat dhe në këtë mënyrë zhvendosen në një pjesë tjetër toke dhe në fund në rrjedhjet ujore.

Megjithatë, vitet e fundit, vihet re një rritje e numrit të firmave private të cilat operojnë në fushën e riciklimit, por mungojnë të dhënat e sakta në lidhje me sasinë e mbetjeve të ricikluara

zona të caktuara, në këtë mënyrë sigurohet edhe një mbulim më i mirë i shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm.

Duke pasur parasysh potencialin që ka Bashkia Vau-Dejës për fluksin e ujit, duhet që shërbimi i furnizimit me ujë të ofrohet në të gjithë territorin, jo vetëm në qendrat kryesore.

Nga fluksi i ushqimit mund të kuptojmë që Bashkia Vau-Dejës është e specializuar në prodhimin e foragjerëve, misrit, grurit. Duke iu referuar edhe Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, kulturat më të përshtatshme për Vau-Dejën janë: foragjeret dhe drithërat. Kulturat blegtorale me prodhimin më të lartë janë mishi dhe nënproduktet qumështit.

Duhet që mbetjet të diferencohen patjetër që në burim ose në qendrën e përzgjedhjes të integruar brenda venddepozitimit; në këtë mënyrë do të ketë një nivel më të lartë riciklimi. Për këtë pushteti vendor duhet të përdorë stimuj që nxisin procesin e diferencimit të mbetjeve që në burim. Venddepozitimi që ndodhet në njësinë administrative Bushat duhet të mbahet nën kontroll të vazhdueshëm në mënyrë që ndikimi i tij në mjedis dhe tek banorët e zonës të jetë sa më i vogël. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve duhet të ofrohet në të gjithë territorin e Bashkisë Vau-Dejës dhe jo vetëm në disa qendra urbane.

Në përfundim, bashkia Vau-Dejës, shfrytëzon në nivele mjaft të ulëta burimet që ka. Këtu i referohemi kryesisht burimeve energjetike dhe hidrike që ofrojnë mundësi zhvillimi të mëtejshëm të sistemit urban dhe ekonomisë. Gjithashtu, prodhimi bujqësor i tejkalon nevojat për ushqim, duke garantuar bazën e zhvillimit të një territori që klasifikohet ndër më pjellorët në rang vendi. Në raport me mbetjet, duhet pasur kujdes që zhvillimi të jetë i balancuar dhe të mirëmenaxhohen kapacitetet e mbledhjes dhe përpunimit të mbetjeve urbane duke nxitur gjithmonë e më tepër riciklimin. Në të njëjtën kohë, duhet pasur kujdes në shmangien e shndërrimit të territorit në venddepozitim për qendrat e mëdha urbane (Shkodra e Lezha) nëse nuk është i mundur përpunimi i plotë i prurjeve nga to dhe nëse kjo nuk gjeneron të ardhura për bashkinë (që do të shkonin në mbrojtjen e mjedisit dhe në zhvillimin ekonomik).

SEKSIONI 5: TENDENCAT E MUNDSHME NË TË ARDHMEN, PA PLANIN (ALTERNATIVA "0")

5.1 Toka

Përdorimi i tokës bujqësore dhe pyjeve

Në qofte se Plani nuk adaptohet, vëllimi i përdorimit aktual të tokës bujqësore dhe pyjeve do të mbetet në nivelin aktual. Infrastruktura përkatëse nuk do të rikonstruhet apo ndërtohet mbi bazën e një analize të nevojave dhe mundësive, prandaj krijimi i kësaj infrastrukture mund të jetë i paplanifikuar, gjë e cila do të ketë një efekt negativ në përdorimin aktual të hapësirës, si dhe në vëllimin e përdorimit aktual tokës bujqësore dhe pyjeve.

Përdorimi i burimeve natyrore

Në qoftë se Plani nuk adaptohet, infrastruktura përkatëse nuk do të ndërtohet apo modernizohet në mënyre të tilla që dheu i gërmuar dhe mbetet nga ndërtimet të trajtohen, në mënyre që shumica e tyre të ripërdoret në një kantier ndërtimi të infrastrukturës apo të riciklohet në materiale ndërtimi. Ndërhyrjet infrastrukturore të paplanifikuara apo të rastit, pengojnë gjithashtu përdorimin e sasive të mëdha të materialeve të ndërtimit të prodhuara nga riciklimi i këtyre materialeve në kantieret e tjera të ndërtimit apo nga përpunimi i llojeve të tjera të mbetjeve të cilat përdoren për të prodhuar materiale ndërtimi të cilësisë së njëjtë me materialet e ndërtimit që merren direkt nga burimet natyrore.

Ndonëse pa planin, ndryshme pritet të ndodhin (pra konvertimi i tokës nga një kategori në një tjetër) bazuar në parashikimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar

5.2 Ajri

Në qofte se Plani nuk adaptohet, infrastruktura përkatëse, duke marrë parasysh rritjen e parashikuar të disa sektorëve specifike, si transporti (veçanërisht ai rrugor) dhe industria, nuk do të planifikohet dhe rregullohet në mënyre që të eliminojë dyndjet dhe bllokimet në rruge, të cilat pengojnë trafikun e qetë dhe me barrë më të vogël ndaj mjedisit apo të eliminojë shkarkimet e pakontrolluara në ajër prej impianteve industriale.

Pavarësisht nga fakti se kontributi më i madh në arritjen e objektivit mjedisor në lidhje me tavanin e emetimeve të ndotësve nga ndërhyrjet infrastrukturore pritet të vije nga sektori i transportit, dhe me konkretisht nga përdorimi i automjeteve me më shumë efience energjetike, trafiku i organizuar dhe kongjestuar i rrjetit rrugor zhbën të gjitha efektet e përdorimit të automjeteve të prodhuara në përputhje me standardet teknike. Pavarësisht automjeteve të përmirësuara teknikisht, bllokimet e trafikut në rrjetin rrugor dhe shpejtësia e udhëtimit, e reduktuar gjithnjë e më shumë në qendrat urbane, do të sillte si pasojë tejkalimin e maksimumit të emetimeve të ndotësve, sidomos të NOx dhe CO.

Përmirësimi i cilësisë së ajrit të ambientit në zonat urbane dhe arritja e standardeve të përshkruara në lidhje me cilësinë e ajrit të ambientit janë objektivat kryesore të cilat bazohen në masat për mbrojtjen e mjedisit në Plan.

Në qoftë se Plani nuk adaptohet, infrastruktura përkatëse nuk do të planifikohet dhe rregullohet dhe në këtë mënyrë nuk do të mundësohet ulja e nivelit të emetimit të ndotësve që kontribuojnë në shfaqjen e grimcave PM₁₀ dhe PM_{2.5}. Kështu që nuk do të realizohet objektivi i përcaktuar mjedisor në lidhje me cilësinë e ajrit deri në vitin 2020.

5.3 Faktorët Klimatike

5.3.1 Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike

Në qoftë se Plani nuk adaptohet, zbatimi i masave për të reduktuar ndjeshmërinë e infrastrukturës ndaj ndryshimeve klimatike nuk do të trajtohet në mënyrë sistematike gjatë planifikimit dhe rregullimit. Theksi kryesor është vendosur në reduktimin e ndjeshmërisë ndaj përmbytjeve, bores dhe ngricave. Çdo ndërtim i ri apo rikonstrukcion i infrastrukturës duhet të analizohet në lidhje me ndjeshmërinë e tij ndaj fenomeneve ekstreme të motit, ndërsa kostot financiare të dëmtimit të mundshëm të infrastrukturës duhet të vlerësohen paraprakisht. Bazuar në analizën e ndjeshmërisë së infrastrukturës ndaj fenomeneve ekstreme të motit, duhet të planifikohen masa të qëndrueshme për të reduktuar efektet negative të ndryshimeve klimatike në infrastrukturë në nivele ekonomikisht dhe shoqërisht të pranueshme.

Në mungesë të politikave, investimeve në infrastruktura mbrojtëse dhe të menaxhimit të fragmentuar të burimeve natyrore në pellgjet ujëmbledhëse, do të kenë efekte negative si: (i) humbje në token bujqësore dhe në disa territore të banuara afër bregdetit/në ultësirë; (ii) rritje e presionit ndaj qendrave urbane për strehim, punësim dhe infrastruktura; (iii) tendenca për të lëvizur më në thellësi të territorit malor, por kushtet e vështira gjeografike dhe klimatike, si dhe mungesa e masave institucionale ndaj efekteve të ndryshimit klimatik, do të frenojnë dëshirën që këto zhvendosje të ndodhin në mase dhe të organizuara. Si rezultat, zhvendosjet sporadike do të fragmentojnë më tej territorin duke rrezikuar burimet me të vlershme që do të pakësohen gjithnjë e më shumë. Njerëzit do të zgjedhin të vendosen në zonat më lehtësisht të arritshme dhe me burime më lehtësisht të vjelshme.

5.3.2 Masat zbutëse ndaj ndryshimeve klimatike

Në qoftë se Plani nuk adaptohet, infrastruktura përkatëse, duke marrë parasysh rritjen e parashikuar të disa sektorëve specifike, si transporti (veçanërisht ai rrugor) dhe industria, nuk do të planifikohet dhe rregullohet në mënyrë që të eliminojë dyndjet dhe bllokimet në rrugë, të cilat pengojnë trafikun e qete dhe me barre më të vogël ndaj mjedisit apo të eliminojë shkarkimet e pakontrolluara në ajër prej impianteve industriale. Zbatimi i masave për zbutjen e ndryshimeve klimatike duke ulur emetimet e gazit serre në sektorët që mbulon Vendimi Nr. 406/2009/KE do të jetë dukshëm në rrezik.

Edhe në rastin e emisioneve të gazrave me efekt serre, kontributi më i madh në arritjen e objektivit mjedisor në lidhje me tavanin e emetimeve të ndotësve nga ndërhyrjet infrastrukturale pritet të vije nga sektori i transportit, dhe me konkretisht nga përdorimi

i automjeteve me më shumë efikasitet energjetike. Megjithatë, trafiku i çorganizuar dhe i kongjestuar i rrjetit rrugor zhbën të gjitha efektet e përdorimit të automjeteve të prodhuara në përputhje me standardet teknike. Pavarësisht automjeteve të përmirësuara teknikisht, bllokimet e trafikut në rrjetin rrugor dhe shpejtësia e udhëtimit e reduktuar gjithnjë e më shumë në qendrat urbane, do të sillte si pasoje tejkalimin e maksimumit të emetimeve të gazrave me efekt serra të përcaktuara deri në vitin 2020.

5.4 Uji

Në qoftë se Planit nuk adaptohet, infrastruktura dhe politika përkatëse nuk do të planifikohet dhe rregullohet në mënyrë gjithëpërfshirëse. Infrastruktura nuk do të rikonstruhet apo ndërtohet mbi bazën e një analize të nevojave dhe mundësive. Prandaj, ndërtimi i infrastrukturës së re mund të mos marrë në konsideratë karakteristikat ekzistuese natyrore (sipërfaqet mbrojtëse, përshkueshmërinë e tokës dhe ndikimin në cilësinë e ujerave nëntokësore, etj.).

Rreziku i aksidenteve që përfshijnë rrjedhje të cilat ndikojnë në statusin kimik të ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësore është dukshëm më i madh në sektorin e transportit. Planit parashikon edhe rivitalizimin e transportit hekurudhor. Në qoftë se Planit nuk adaptohet, transporti i mallrave me i shpejtë është në infrastrukturën rrugore, do të rrisë mundësinë e ndotjes për shkak të aksidenteve që përfshijnë rrjedhje të substancave të rrezikshme.

5.5 Biodiversiteti

Me adaptimin e Planit, infrastruktura përkatëse do të planifikohet dhe rregullohet në mënyrë gjithëpërfshirëse. Infrastruktura do të rikonstruhet apo ndërtohet mbi bazën e një analize të nevojave dhe mundësive. Për shkak të sipërpërmendura, infrastruktura do të planifikohet, që do të thotë gjithashtu më pak nevojë për të kryer ndërhyrje të reja infrastrukturore. Si rezultat, hapësira nuk do të fragmentohet në mënyrë të panevojshme dhe nuk do të preken rrugët migratore të kafshëve të egra. Masat e aktiviteteve të Planit duhet të përfshijë krijimin e kalimeve të përshtatshme për kafshët e egra nëse fragmentet ekzistuese provojnë se janë të papërshtatshme apo të pakalueshme (vendkalimet janë penguar nga gardhet ose vdekshmëria e kafshëve në rrugë është rritur). Nëse masat e Planit nuk zbatohen, vdekshmëria e kafshëve në rrugë dhe lidhjet midis popullatave mund të përkeqësohen, gjë e cila mund të ndikojë në biodiversitetin e zonave përkatëse.

Masat e parashikuara përfshijnë masa për të reduktuar nivelin e zhurmës në mjedisin natyror, të cilat do të kenë një ndikim lokal pozitiv të përhershëm të kafshët e egra. Nëse masat nuk zbatohen, zhurma në mjedisin natyror do të rritet për shkak të ndërhyrjeve infrastrukturore të pakontrolluara dhe të paplanifikuara.

5.6 Mbetjet

Sektori i grumbullimit/trajtimit/riciklimit të mbetjeve është një ndër sektorët më problematike në Bashkinë Vau-Dejës. Aktualisht ky sektor ka një sërë problematikash, të cilat kanë gjetur reflektim dhe adresim në Plan.

Këto problematika përfshijnë: venddepozitime të hapura (të ligjshme dhe të paligjshme), kapacitet i pamjaftueshëm i landfilleve ekzistues tani që territori i bashkisë është zgjeruar; menaxhimi i mbetjeve është akoma në nivele të ulëta; mbetjet inerte, mbetjet e rrezikshme, mbetjet spitalore dhe mbetjet e kafshëve nuk trajtohen sipas kërkesave ligjore; ndarja në burim e mbetjeve/riciklimi akoma nuk praktikohet. Kuadri ligjor, megjithëse i përgjigjet kërkesave të BE-së, nuk mund të ndryshojë realitetin për shkak të mungesës në investime.

Nëse Plani nuk adoptohet kjo situatë jo vetëm që do të vijoje të mbetet problematike, por do të përkeqësohet me tej për shkak të zhvillimeve të pakontrolluara në të gjithë sektorët përfshirë edhe planifikimin hapësinor/urban.

5.7 Zhurma

Nëse aktivitetet e parashikuara në Plan nuk zbatohen apo përfshihen në programet e detajuara të masave për zvogëlimin e ndotjes nga zhurma, niveli i zhurmës do të rritet, veçanërisht më shumë për shkak të zhvillimeve të pakontrolluara infrastrukturore. Prandaj, objektivi i arritjes së standardit të BE-së mbi zhurmën (LAeq/ditën në 55dB (A) dhe LAeq/natën në 45 dB (A)) nuk do të realizohet.

Politikat dhe aktivitetet infrastrukturore të parashikuara në Plan do të sigurojnë kohezion, efikasitet dhe qëndrueshmëri, dhe rritjen e përfitimeve për përdoruesit e kësaj infrastrukture. Nëse masat e politikave të Plani nuk zbatohen, ekspozimi i banoreve ndaj zhurmës do të rritet. Në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe direktivat e BE-së, menaxheret e burimeve individuale të zhurmës duhet të rehabilitojnë zonat me ndotje akustike të tepërt. Megjithatë, përmirësimet e efektshme të mjedisit mund të kryhen vetëm nëpërmjet masave të kombinuara, logjistike dhe organizative.

5.8 Popullsia dhe asetet materiale

Pavarësisht nga disa investime të fundit në rrjetin e rrugëve lokale dhe rajonale, cilësia e infrastrukturës së transportit në bashkinë Lezhë mbetet e ulët dhe ka dallime të konsiderueshme rajonale në aspektin e qasjes ndaj tregjeve dhe shërbimeve themelore. Cilësia e ofrimit të shërbimeve në zonat rurale është ende e ulët dhe pjesa me pak e pasur e popullatës ka qasje të kufizuar në shërbimet sociale, veçanërisht shëndetësi dhe arsim. Kufizimet e transportit publik dhe kostot e larta ndikojnë në lëvizshmërinë e njerëzve dhe qasjen ndaj mundësive (d.m.th. të punësimit) jashtë fshatrave. Menaxhimi i vazhduar i aseteve, mirëmbajtja rutine e rrugëve dhe qasja më e besueshme në transportin publik mund të zvogëlojë shpenzimet dhe të sjellë përfitime të rëndësishme njësoj si për familjet, fermerët dhe firmat.

Edhe pse shkalla e aksidenteve fatale është në rënie (kjo shkallë është pothuajse përgjysmuar gjatë dekadës së fundit), siguria rrugore është një problem i madh social dhe i shëndetit publik. Qeveria është fokusuar në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve të sigurisë rrugore, në vend që t'i japë vëmendje auditimeve të sigurisë dhe përmirësimit të pikave të errëta, inkorporimit të standardeve të sigurisë në projektimin dhe ndërtimin e infrastrukturës, si dhe rritjes së ndërgjegjësimit të publikut.

Në qoftë se Plani nuk do të adoptohet dhe masat nuk do të zbatohen, aksesueshmëria do të mbetet një shqetësim i rëndësishëm, dhe çështjet e sigurisë do të vazhdojnë të

jenë një problem serioz. Si pasojë nuk priten efekte pozitive në mënyrën dhe kushtet e jetesës në qendrat e banuara.

5.9 Trashëgimia Kulturore

Në qoftë se Plani nuk adaptohet dhe nuk zbatohen aktivitetet infrastrukturore, integriteti dhe karakteristikat e zonave dhe njësive të trashëgimisë kulturore, sidomos të peizazheve kulturore, peizazheve historike, zonave të trashëgimisë urbane dhe zonave të tyre të ndikimit, dhe vendeve arkeologjike, do të ruhen në një mase më të madhe. Nga ana tjetër, zhvillimi i infrastrukturës dhe politikave përkatëse nuk do të planifikohet dhe rregullohet në mënyre gjithëpërfshirëse, dhe infrastruktura nuk do të rikonstruktohet apo ndërtohet mbi bazën e një analize të nevojave dhe mundësive. Prandaj zhvillimet e paplanifikuara do të kenë një efekt negativ në trashëgiminë kulturore.

5.10 Peizazhi

Në qoftë se Plani nuk adaptohet dhe aktivitetet infrastrukturore nuk zbatohen, integriteti dhe tiparet e peizazheve të jashtëzakonshëm dhe zonave të peizazhit me karakteristika të dallueshme në nivel kombëtar, do të ruhen. Imazhi i peizazheve me cilësi të larta i zonave të ruajtura mire dhe me elemente të rëndësishëm kulturor, do të ruhet. Nga ana tjetër, zhvillimi i infrastrukturës dhe politikave përkatëse nuk do të planifikohet dhe rregullohet në mënyre gjithëpërfshirëse, dhe infrastruktura nuk do të rikonstruktohet apo ndërtohet mbi bazën e një analize të nevojave dhe mundësive. Prandaj zhvillimet e paplanifikuara do të ndikojnë në mënyre të konsiderueshme në degradimin e peizazhit.

SEKSIONI 6: BAZA PËR PËRGATITJEN E VLERËSIMIT MJEDISOR

6.1 Përcaktimi i Objektivave Mjedisore

Bazuar në analizën e gjendjes ekzistuese të mjedisit, në ndikimet potenciale që mund të shkaktohen në mjedis nga aktivitetet e parashikuara në PPV dhe në detyrimeve të specifikuar në konventat e ratifikuara dhe në direktivat respektive të BE-së, raporti i VSM-së përcakton sektorët më të rëndësishëm mjedisore dhe objektivat mjedisore si më poshtë:

➤ Toka

Objektiva Mjedisore 1 (OM 1): Garantimi i menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të tokës dhe mbrojtja e saj.

Objektiva Mjedisore 2 (OM 2): Parandalimi i shfrytëzimit të burimeve natyrore, duke rritur nivelin e përdorimit të materialeve të riciklueshme nga mbetjet që gjenerohen gjatë ndërtimit/rehabilitimit të infrastrukturës.

➤ Ajri

Objektiva Mjedisore 3 (OM 3): Garantimi i arritjes së objektivave afatgjata për sasinë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, për të arritur përputhshmërinë me kufijtë maksimale të lejueshëm nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferike.

➤ Faktorët klimatike

Objektiva Mjedisore 4 (OM 4): Adoptimi i infrastrukturës në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve serë në nivelet e përcaktuara në SKZHI II.

➤ Uji

Objektiva Mjedisore 5 (OM 5): Kufizimi i efekteve negative mbi ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ujërat e njelmët, ujërat bregdetare dhe burimet e ujit të pijshëm.

➤ Mjedis natyror

Objektiva Mjedisore 6 (OM 6): Garantimi i kohezionit të popullatave dhe mbrojtjes së biodiversitetit.

Objektiva Mjedisore 7 (OM 7): Ruajtja e zonave që kanë një status të veçantë mbrojtjeje, prej aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme.

➤ Mbetjet

Objektiva Mjedisore 8 (OM 8): Kompletimi tërësor i infrastrukturës së landfillëve e incineratoreve dhe njëkohësisht reduktim i sasisë së depozitimit të mbetjeve në landfill nëpërmjet proceseve të reduktimit dhe rritjes së riciklimit e ripërdorimit.

➤ Zhurma

Objektiva Mjedisore 9 (OM 9): Reduktimi i ndotjes së zhurmës/akustike dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE dhe OBSH.

➤ ***Popullsia dhe asetet materiale***

Objektiva Mjedisore 10 (OM 10): Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme.

➤ ***Trashëgimia Kulturore***

Objektiva Mjedisore 11 (OM 11): Ruajtja e shtrirjes, përmbajtjes dhe veçorive të zonave dhe strukturave të trashëgimisë kulturore.

➤ ***Peizazhi***

Objektiva Mjedisore 12 (OM 12): Garantimi i ruajtjes së peizazheve të veçanta dhe zonave peizazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar dhe krijimi i një imazhi peizazhi me cilësi të lartë.

Shpjegimi i përcaktimit të objektivave mjedisore jepet në seksionet në vijim.

6.1.1.1 Detyrimet e specifikuara në konventat e ratifikuara dhe në direktivat respektive të BE-së, si dhe në dokumentet strategjike të Shqipërisë

Për të përcaktuar objektivat e rëndësishme specifike, janë përdorur detyrimet e specifikuara në konventat e ratifikuara dhe në direktivat respektive të BE-së, si dhe në dokumentet strategjike të Shqipërisë. Lidhja mes sektorëve të mjedisit dhe objektivave mjedisore si dhe dokumentet përkatës të planeve, programeve apo politikave mjedisore janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Tabela 6.1- Lidhja mes sektorëve të mjedisit dhe objektivave mjedisore si dhe dokumentet përkatës të planeve, programeve apo politikave mjedisore

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin përkatës të mjedisit	Lidhja me objektivat mjedisore
Strategjia tematike për Mbrojtjen e Tokës – COM (2006)231. Referenca në Shqipëri gjendet në Ligjin nr. 10431 datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” (neni 18);	Duhen marrë në konsideratë pozitat mbi të cilat është bazuar hartimi i Direktivës që përcakton kuadrin për mbrojtjen e tokës dhe amendon Direktiven 2004/35/EC. Strategjia merr në konsideratë një sërë funksionesh, diversitetin dhe kompleksitetin e tokës si dhe një sërë procesesh degradimi të cilave ajo (toka) u nënshtrohet. Objektivi strategjik është mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i tokës, bazuar në parimet e mëposhtme udhëzuese: - parandalimi i degradimit të mëtejshëm dhe ruajtja e funksioneve të tokës kur toka përdoret dhe kur funksionet e tokës shfrytëzohen, si dhe kur toka shërben si mjedis pritës për efektet e aktivitetit të njeriut apo fenomeneve mjedisore; - Rikthimi i tokës së degraduar në një nivel funksionaliteti konsistent të paktën me përdorimin aktual apo të synuar, duke pasur parasysh kostot e restaurimit të tokës.	Toka	OM 1

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin përkatës të mjedisit	Lidhja me objektivat mjedisore
Direktiva 2008/50/EC mbi cilësinë e ajrit dhe për ajër me të pastër për Evropën. Direktiva 2004/107/CE lidhur me arsenikun, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin e mjedisit. Shqipëria i ka përfruar plotësisht këto direktiva përmes: - Ligjit nr. 162/2014, datë 12.04.2014 "për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit" dhe VKM nr. 594, datë 10.09.2014" Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit.	Direktiva 2008/50/EC përcakton masat që synojnë si vijon: Përkufizimin dhe përcaktimin e objektivave për cilësi të ajrit të ambientit hartuar në mënyrë të tillë që shmangin, parandalojnë apo reduktojnë efektet e dëmshme në shëndetin e njerëzve dhe në mjedisin në tërësi; 1. Përlogaritjen e cilësisë së ajrit të ambientit në Vendet Anëtare me baze metoda dhe kritere të përbashkëta; Sigurimin e informacionit mbi cilësinë e ajrit të ambientit në mënyrë që të ndihmojë luftën kundër ndotjes dhe shqetësimit të ajrit dhe të monitorojë prirjet dhe përmirësimet që vijnë si rezultat i masave kombëtare dhe të Komunitetit; 3. Garantimin e informacioni të tillë mbi cilësinë e ajrit do t'i behet i disponueshem publikut; 4. Mirëmbajtjen e cilësisë së ajrit atje ku është e mirë dhe përmirësimin e saj në raste të tjera; 5. Nxitjen e rritjes së bashkëpunimit midis Vendeve anëtare për reduktimin e ndotjes së ajrit. Objektivat e Direktivës 2004/107/CE janë: (a) - të përcaktojë një vlerë të synuar për përqendrimin e arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo (a) pirenit në ajrin e ambientit me qëllim shmangjen, parandalimin ose reduktimin e efekteve të dëmshme të arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike në shëndetin e njeriut dhe në mjedisin në tërësi; (b)- të sigurojnë, në lidhje me arsenikun, kadmiumin, nikelin dhe hidrokarburet policiklike aromatike, që cilësia e ajrit të ambientit është ruajtur atje ku ajo është e mirë dhe është përmirësuar në raste të tjera;	Ajri	OM 3

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin përkatës të mjedisit	Lidhja me objektivat mjedisore
Strategjia e BE për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike (COM (2013) 216 final).	(c) - të përcaktoje metodat e përbashkëta dhe kriteret për vlerësimin e përqendrimeve të arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike në ajrin e ambientit si dhe për depozitimin e arsenikut, kadmiumit, merkurit, nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike; (d) - të sigurojë që informacioni i duhur mbi përqendrimeve të arsenikut, kadmiumit, merkurit, nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike në ajrin e ambientit si dhe mbi depozitimet e arsenikut, kadmiumit, merkurit, nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike është marre dhe të siguroje se ajo është vënë në dispozicion të publikut. SKZHI II përcakton objektivat për nivelet e emetimeve në ajër si më poshtë: për NO_x – $40 \mu\text{g}/\text{m}^3$, për PM_{10} - $40 \mu\text{g}/\text{m}^3$, për $\text{PM}_{2.5}$ – $25 \text{ g} / \text{m}^3$ dhe $20 \text{ g}/\text{m}^3$ dhe SO_2 - $125 \mu\text{g}/\text{m}^3$.		
	Objektiva e përgjithshme e Strategjisë së BE për adaptimin është të kontribuojë në një Evropë më elastike ndaj klimës. Kjo do të thotë rritjen e punës përgatitore dhe të kapacitetit për t'ju përgjigjur ndikimeve nga ndryshimet klimatike në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar, duke zhvilluar një përafrim logjik dhe duke përmirësuar koordinimin. Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Vjenës dhe Protokollin e Montrealit, në Tetor 1999, si dhe është anëtare e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), që nga Janari 1995. Shqipëria ka përgatitur dy komunikime Kombëtare në 2002 dhe 2009, si dhe ka finalizuar me sukses vetëvlerësimin për përgatitjen e Komunikimit të Tretë Kombëtar të UNFCCC. Në vitin 2016 është parashikuar të përfundoje hartimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Ndryshimet Klimatike, me kohëzgjatje 2016-2030.	Faktorët klimatike	OM 4

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin përkatës të mjedisit	Lidhja me objektivat mjedisore
Vendimi 406/2009/EC për përpjekjet e Shteteve Anëtare të zvogëlojnë emetimet e gazeve "sere" që t'i plotësojnë detyrimet e Komunitetit për zvogëlimin e gazeve sere deri me 2020.	Vendimi 406/2009/EC përcakton kontributin minimal të vendeve anëtare për të arritur detyrimin për zvogëlimin e emetimit të gazeve "sere" për periudhën nga 2013 deri në 2020 për emetimet e gazeve "sere" që mbulojnë nga ky vendim si dhe rregullat për arritjen e këtyre kontributeve dhe Vlerësimin e tyre. Angazhimi për reduktimin e emetimeve të gazeve "sere" i referohet: • emetimeve nga përdorimi i lendeve djegëse në shtëpi dhe në sektorin e shërbimeve; • emetimeve nga përdorimi i lendeve djegëse në sektorin e transportit; • emetimeve nga përdorimi i lendeve djegëse në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe në sektorin e energjisë; • emetimet që çlirohen nga sektori i energjisë; • emetimet nga proceset industriale; • përdorimi i tretësve dhe produkteve të tjerë; • emetimet nga bujqësia; • emetimet nga administrimi i mbetjeve. Shqipëria akoma nuk e ka transpozuar këtë vendim, është parashikuar të behet në vitin 2018. Pra bie brenda afateve kohore të realizimit të Planit, kështu që dispozitat e këtij vendimi lidhur me faktorët klimatike, duhet të adresohen përpara në kohe. Për më tepër, SKZHI-II përcakton kufijtë e synuar për emetimet e gazeve "sere" në 2020 si më poshtë: • Një reduktim i synuar prej 8% i GHG-vë krahasuar me skenarin bazë6 dhe • Një reduktim i synuar prej 40% në sasinë e HCFC-vë (hidroklorfluorkarbon).	Faktorët klimatike	OM 4

⁶ Projekcioni aktual i emetimeve të GHG në 2020 tregon 18,000 Gg CO₂ ek. Ky projekcion do të rishikohet në kuadër të Komunikimit të Tretë Kombëtar të UNFCCC. Në rast të financimit të huaj për NAMA (masat adaptuese kombëtare për reduktimin e GHG) reduktimi i GHG mund të rritet me 16% krahasuar me skenarin bazë.

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin përkatës të mjedisit	Lidhja me objektivat mjedisore
Direktiva 2000/60/EC (Direktiva Kuadër e Ujit) (transpozuar në legjislacionin shqiptar përmes VKM nr. 246, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore") Direktiva 2008/56/EC që vendos kuadrin për veprimin e komunitetit në fushën e politikës mjedisore të detit (Direktiva Kuadër e Strategjisë Detare). Shqipëria planifikon ta adoptojë plotësisht këtë strategji gjatë tremujorit të fundit të vitit 2016 përmes një VKM-je specifike "për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Mjedisore Detare". Direktiva 2008/105/EC për standardet e cilësisë mjedisore në fushën e politikave ujore (transpozuar në legjislacionin shqiptar përmes VKM nr. 246, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore")	Direktiva përcakton masat për arritjen e objektivit strategjik të statusit të mire ekologjik për ujërat në vitin 2015. Direktiva përcakton kuadrin brenda së cilit vendet anëtare duhet të marrin masat e nevojshme për të arritur apo mbajtur një gjendje të mirë mjedisore në mjedisin detar deri në vitin 2020. Në përputhje me këtë Direktive janë hartuar dhe zbatuar strategjitë detare, me qëllim që të: - mbrojnë mjedisin detar, parandalojnë degradimin e tij, apo, nëse është e mundur, rivendosin ekosistemet detare në zonat e prekura nga efektet e dëmshme; - parandalojnë dhe pakësojnë ndërhyrjet në mjedisin detar me qëllim eliminimin gradual të ndotjes dhe kështu garantojnë se nuk ka pasoja të mëdha për biodiversitetin detar, ekosistemet detare dhe shëndetin e njeriut dhe se këto nuk janë të kërçnuara. Kjo Direktive përcakton standardet e cilësisë mjedisore për substancat prioritare dhe ndotësit e tjerë, siç përcaktohet në Direktivën 2000/60/EC me objekte arritjen e një gjendjeje të mirë kimike të ujërave sipërfaqësorë dhe në përputhje me parashikimet dhe objektivat e Direktivës 2000/60/EC mbi parandalimin e emetimit të substancave në ujë, duke ndare ujërat e zeza. VKM-ja që transponon Direktivën 2008/105/EC në legjislacionin shqiptar përcakton normativën të detajuar dhe gjithëpërfshirëse për Vlerësimin e gjendjes kimike të ujërave sipërfaqësore.	Uji	OM 5

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin përkatës të mjedisit	Lidhja me objektivat mjedisore
Direktiva 2006/7/EC për Menaxhimin e Cilësisë së Ujit për Larje (transpozuar në legjislacionin shqiptar përmes VKM nr. 246, datë 30.04.2014 "për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësorë"). Direktiva e Këshillit 98/83/EC në lidhje me cilësinë e ujit të caktuar për konsumim njerëzor (transpozuar në legjislacionin shqiptar përmes VKM nr. 246, datë 30.04.2014 "për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësorë").	Direktiva përcakton masat për të: a) monitoruar dhe klasifikuar sipas cilësisë ujin për larje; b) menaxhuar cilësinë e ujit për larje; dhe c) informuar publikun mbi cilësinë e ujit për larje. Qëllimi (objektiva) i kësaj Direktive është "të ruajë, mbrojë dhe përmirësojë cilësinë e mjedisit dhe të mbrojë shëndetin e njerëzve, duke plotësuar Direktivën 2000/60/EC". Direktiva e Këshillit 98/83/EC rregullon cilësinë e ujit që përdoret për konsum nga njerëzit. Uji është i shëndetshëm dhe i pastër nëse ai nuk përmban mikroorganizma, parazitë dhe çdo substancë tjetër, të cilat në sasi apo përqendrime të caktuara përbejnë një rrezik potencial për shëndetin e njerëzve.	Uji	OM 5
Direktiva 2006/118/EC për mbrojtjen e ujërave nëntokësorë nga ndotja dhe përkeqësimi (transpozuar në legjislacionin shqiptar përmes VKM nr. 246, datë 30.04.2014 "për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësorë"). Direktiva 2000/59/EC për mjediset e pritjes në porte të mbetjeve që gjenerohen nga anijet dhe tepriat e mbetura prej kargove. Shqipëria ka miratuar një rregullore respektive për këtë qellim.	Direktiva 2006/118/EC për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe përkeqësimi përcakton masa specifike për të parandaluar dhe kontrolluar ndotjen e ujërave nëntokësore në përputhje me Direktivën 2000/60/EC. Këto masa kryesisht përfshijnë: - kriteret për Vlerësimin e statusit kimik të ujit nëntokësor, dhe - kriteret për identifikimin dhe kthimin mbrapsht të tendencave të konsiderueshme dhe të qëndrueshme të rritjes, dhe për përcaktimin e pikënisjeve për tendencat e kundërta. Objektiva: "Deri në vitin 2015 duhet të arrihet një status i mire kimik i ujit nëntokësor".	Uji	OM 5

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin përkatës të mjedisit	Lidhja me objektivat mjedisore
Direktiva 2007/60/EC për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmbajtjet (Direktiva e Përmbajtjeve). Shqipëria e ka përfshirur pjesërisht këtë direktivë përmes:	Direktiva ka përcaktuar negociatat ndërkufitare lidhur me menaxhimin e rreziqeve nga përmbajtjet, dhe përfshin angazhime të rëndësishme për të rritur transparencën dhe integritimin e qytetareve. Objektiva e direktivës së menaxhimit të rreziqeve nga përmbajtjet është të reduktojë rreziqet dhe pasojat negative të përmbajtjeve në BE. Direktiva ka përcaktuar negociatat ndërkufitare lidhur me menaxhimin e rreziqeve nga përmbajtjet, dhe përfshin angazhime të rëndësishme për të rritur transparencën dhe integritimin e qytetareve.	Uji	OM 5
- Ligji nr. 9860, datë 21.01.2008 që amendon Ligjin nr. 8518, datë 30.7.1999 "Për Ujijtën dhe Kullimin" - VKM nr. 835, datë 3.12.2004 "Për Planin Kombëtar të Emergjencave Civile" - VKM nr. 267 datë 07.05.2014 "për miratimin e listës së substancave prioritare në mjediset ujore".	Direktiva ka përcaktuar negociatat ndërkufitare lidhur me menaxhimin e rreziqeve nga përmbajtjet, dhe përfshin angazhime të rëndësishme për të rritur transparencën dhe integritimin e qytetareve. Objektiva e direktivës së menaxhimit të rreziqeve nga përmbajtjet është të reduktojë rreziqet dhe pasojat negative të përmbajtjeve në BE. Përsa i përket Shqipërisë, në fund të 2015 dhe gjatë tremujorit të parë të 2016, është parashikuar miratimi i dy VKM-ve: - VKM "Për kushtet dhe kriteret e nevojshme për krijimin, mbajtjen, menaxhimin dhe përditësimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore" - VKM "Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Ujrat, planet e menaxhimit të baseneve të lumenjve dhe planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbajtjet". Kjo përpjekje do të garantojë përafrim të plotë të legjislativës shqiptare me këtë direktivë.	Uji	OM 5

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin përkatës të mjedisit	Lidhja me objektivat mjedisore
Direktiva 2009/147/EC për mbrojtjen e zogjve të egër. Shqipëria e ka përfshirë pjesërisht këtë direktivë, përmes ligjeve: - Ligji nr. 68/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, "për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar"; - Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008; "për mbrojtjen e faunës së egër" - Ligji nr. 10253, datë 11.3.2010 "Për Gjuetinë". Direktiva e Këshillit 92/43/EEC për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës e faunës së egër. Shqipëria e ka përfshirë pjesërisht këtë direktivë përmes ligjeve:- Ligji nr. 68/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, "për mbrojtjen e biodiversitetit", të ndryshuar"; - Ligji nr.81, datë 04.05.2017 "Për zonat e mbrojtura".	Direktiva ofron një kornizë të plotë për mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e të gjithë zogjve të egër që ndodhen në BE. Direktiva udhëzon shtetet anëtare të marrin masa për të mbajtur popullatën e të gjitha llojeve të zogjve të egër që ndodhen në shtetet e BE-së. Masa të tilla mund të përfshijnë mirëmbajtjen dhe/ose rikrijimin e vendbanimeve në mënyrë që të mbajnë këto popullata të zogjve. Për të gjitha speciet e zogjve që referohen në Shtojcën I të Direktivës si dhe për të gjitha speciet e rregullta migratore, që kanë nevojë për mbrojtje, vendet anëtare duhet të krijojnë Zona të Veçanta të Mbrojtjes (ZVM), apo të quajtura zonat "Natura 2000". Në këto ZVM duhet garantuar që popullatat e specieve gjenden në një situatë të favorshme. SKZHI II përcakton si objektive strategjike "Ngritjen e rrjetit ekologjik "Natura 2000". Gjatë periudhës 2015 – 2016 është parashikuar amendimi i ligjit "Për gjuetinë", gjë që do të sigurojë përfshirjen e plotë të kësaj Direktive në legjislacionin shqiptar. Direktiva e habitateve kërkon që Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e duhura për të menajuar në zonat e veçanta të ruajtjes shkatërrimin e habitateve natyrore dhe të habitateve të specieve si dhe shqetësimin e specieve për të cilat janë përcaktuar zonat e "Natura 2000", në rastet kur ky shqetësim është dukshëm i lidhur me objektivat e kësaj Direktive. Kjo dispozite aplikohet për ZVM-të e propozuara, siç përcaktohet në përputhje me procedurat dhe kriteret e direktivës së habitateve. SKZHI II përcakton si objektiva strategjike: - Një rritje e sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura në gjithë territorin, përmes zgjerimit dhe menaxhimit të integruar të zonave të mbrojtura;	Mjedis natyror	OM 6

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin përkatës të mjedisit	Lidhja me objektivat mjedisore
- Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 "për mbrojtjen e faunës së egër"; - VKM nr. 866, datë 10.12.2014 "për miratimin e listës së habitateve natyrore, florës, faunës dhe zogjve me interes për komunitetin evropian" Miratimi i Urdhërimit Nr. 62, datë 04.04.2016 të Ministrit të Mjedisit "për Miratimin e Listës së llojeve të shpendëve të egër, veçanërisht vulnerabël"	- Garantimi i statusit të mbrojtur për 5% të specieve dhe habitateve të kërcënuara. Në vitin 2014 është miratuar Ligji nr.9868, datë 4.2.2008 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura", i cili ka siguruar përafrimin e plote të kësaj Direktive në legjislacionin shqiptar	Mjedis natyror	OM 6
Konventa e Bernës (Bern, 1979) (ratifikuar nga parlamenti i Shqipërisë me Ligjin nr. 8294, datë 2.3.1998)	Për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror evropian. Objektiva kryesore është ruajtja e florës dhe faunës së egër dhe habitateve natyrore.	Mjedis natyror	OM 6
Konventa Ramsar (Ramsar, 1971) (ratifikuar në 29.3.1996)	Shtetet pale kanë rënë dakord që të: • përcaktojnë ligatinat e territorit të tij të përshtatshme për tu përfshirë në listën e ligatinave me rendësi ndërkombëtare; • formulojnë dhe zbatojnë plane për promovimin dhe mbrojtjen e ligatinave të përfshira në Listë, si dhe për përdorimin sa më racional të ligatinave në territorin e tyre • promovojnë ruajtjen e ligatinave dhe shpendëve ujore duke krijuar rezervate natyrore në ligatina, të përfshira ose jo në Listë dhe siguron ruajtjen e tyre në mënyrën më të përshtatshme; • marrin në konsideratë përgjegjësinë e tij ndërkombëtare për ruajtjen, menaxhimin dhe përdorimin racional të grupeve shtegtare të shpendëve ujore, si kur përcakton një hyrje në Listë ashtu dhe kur ushtron të drejtat e tij për ndryshim në këtë Listë në lidhje me ligatinat në territorin e tij; konsultojnë njëra-tjetrën rreth zbatimit të detyrimeve të dala nga kjo Konvente veçanërisht në rastet kur një ligatine shtrihet në territorin e me shume se të një shteti pale ose kur një sistem ujor ndahet mes disa Shteteve Pale.	Mjedis natyror	OM 6

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin përkatës të mjedisit	Lidhja me objektivat mjedisore
Direktiva 2002/49/EC për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis. Shqipëria e ka përfshirë pjesërisht këtë Direktive përmes Ligjit 39/2013 Për disa ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 "për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis".	Objektivi kryesor është menaxhimi i qëndrueshëm i zhurmës me qëllim respektimin e niveleve të lejuara dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve. Përcaktojnë kërkesa specifike për zhurmat e gjeneruara nga sektorë të tjerë, siç është transporti rrugor, ajror, hekurudhor, zhurmat e gjeneruara nga pajisjet dhe makineritë. Në tremujorin e fundit të vitit 2017 është parashikuar miratimi i dy VKM-me: - "Për kriteret, procedurat dhe rregullat për certifikim, pezullimin dhe heqjen e certifikatës së ekspertit të zhurmës në mjedis" dhe - Për përbërjen dhe organizimin e Komitetit Teknik të Zhurmave (KTZH)" - Kjo gjë do të sigurojë përafrimin e plotë të kësaj Direktive në legjislationin shqiptar.	Zhurmat	OM 9
Direktiva 2008/96/EC mbi sigurinë e infrastrukturës rrugore (e përfshirë plotësisht nëpërmjet Udhëzimit Nr. 9, datë 3.07.2012 "Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurisë rrugore"	Objektiva e kësaj Direktive është "garantimi i infrastrukturës së sigurt rrugore për të gjithë përdoruesit e rrugës".	Popullsia dhe asetet materiale	OM 10
Konventa Europiane për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike – Konventa e Maltës (MEKVAD) (Shqipëria ka aderuar përmes miratimit të Ligjit nr. 9806 datë 17.9.2007)	Konventa i referohet konceptit gjithëpërfshirës të ruajtjes së trashëgimisë arkeologjike. Ajo përcakton lidhjen mes ruajtjes së trashëgimisë arkeologjike dhe planifikimit hapësinor. Konventa kërkon që çdo palë firmosëse: - të kërkojë të pajtojë dhe ndërthurë kërkesat përkatëse të arkeologjisë me planet hapësinore duke siguruar që arkeologjet marrin pjesë në hartimin e politikave të planifikimit hapësinor dhe në faza të ndryshme të zbatimit të këtyre politikave; - të sigurojë që arkeologjet, planifikuesit urbane dhe ata hapësinore konsultohen sistematikisht me njëri-tjetrin me qëllim lehtësimin e modifikimit të atyre planeve hapësinore që kanë të ngjarë të dëmtojnë trashëgiminë arkeologjike; - sigurojë kohe dhe burime të mjaftueshme për një studim të duhur shkencor që duhet të behet në zonën përkatëse dhe që të publikohen rezultatet e atij studimi.	Trashëgimia kulturore	OM 11

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin përkatës të mjedisit	Lidhja me objektivat mjedisore
	- sigurojë që vlerësimi për ndikimin në mjedis dhe vendimet rezultuese përfshijnë konsideratën e plotë mbi zonat arkeologjike dhe shtrirjet e tyre - garantojë konservimin <i>in situ</i>, kur është e mundur, të elementëve të trashëgimisë arkeologjike që janë gjetur gjatë kryerjes së aktiviteteve hapësinore; - sigurojë që zonat arkeologjike janë të arritshme nga publiku, dhe se rrugët hyrëse për pranimin e një numri të madh vizituesh, nuk dëmtojnë veçoritë arkeologjike dhe shkencore të këtyre zonave dhe mjedisit përreth. Objektiva: "Zonat arkeologjike dhe pozicionimi i tyre duhen marrë plotësisht në konsideratë gjatë hartimit të planeve e programeve dhe integritetit të aktiviteteve. Elementet e trashëgimisë arkeologjike që janë gjetur gjatë kryerjes së aktiviteteve në zonë duhet të konservohen <i>in situ</i>, kur është e mundur".		
Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkitektonike të Europës – Konventa e Granades (Shqipëria ka aderuar përmes miratimit të Ligjit nr. 9806 datë 17.9.2007)	Konventa përforcon konceptin gjithëpërfshirës në ruajtjen e trashëgimisë arkitektonike (monumente, njësi arkitektonike, zona apo struktura memoriale). Konventa kërkon që çdo palë pjesëmarrëse të: - zbatojë mbikëqyrje dhe procedurat e autorizimeve të duhura në përputhje me kërkesat e paracaktuara për mbrojtje ligjore të strukturave në fjalë; - parandalojë dëmtimin, rrënimin ose shkatërrimin e strukturave të mbrojtura. Politika e ruajtjes gjithëpërfshirëse të trashëgimisë arkitektonike i detyron të gjitha palët firmose që të: - përfshijnë mbrojtjen e trashëgimisë arkitektonike si objektiv të rëndësishëm në planifikimin hapësinor dhe atë urban; - nxitin programet për restaurimin dhe mirëmbajtjen e trashëgimisë arkitektonike; - mundësojnë që ruajtja, rivitalizimi dhe përmirësimi i trashëgimisë arkitektonike të bëhet një karakteristike e rëndësishme e politikave	Trashëgimia kulturore	OM 11
Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin	Lidhja me objektivat

		përkatës të mjedisit	mjedisore
	në fushën e kulturës, mbrojtjes së mjedisit dhe planifikimit hapësinor; - aty ku është e mundur brenda procesit të planifikimit urban dhe hapësinor, të nxitin ruajtjen dhe përdorimin e disa strukturave, të cilat individualisht nuk e justifikojnë statusin e ruajtjes, por që janë të rëndësishme si pjesë e zhvillimit urban apo rural dhe si element i cilësisë së jetës; - nxitin përdorimin dhe zhvillimin e aftësive dhe materialeve tradicionale, të cilat janë të rëndësishme për të ardhmen e trashëgimisë arkitektonike. Objektiva: "Ruajtja e Trashëgimisë Arkitektonike si një qellim i rëndësishëm i planifikimit hapësinor dhe atij urban".		
Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, drafti i 2-të, 2015 – 2020. Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversiteti 2016-2020.	Strategjia e dytë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI-II) paraqet vizionin e Shqipërisë për zhvillimin e saj social, demokratik dhe ekonomik për periudhën 2015-2020, si dhe aspiratën për integrimin evropian. SKZHI-II shpjegon se si do të arrihet ky vizion përmes politikave dhe strategjive të qeverisë, duke synuar në: ▪ Shndërrimin e Shqipërisë në një vend të denjë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian, ▪ Arritjen e standardeve që i shërbejnë qytetareve, rritjes së mirëqenies së tyre dhe ▪ garantimit të mbrojtjes së të drejtave të tyre, dhe ▪ Hartimit të politikave që nxitin konkurrencë dhe prosperitetin ekonomik në Shqipëri si dhe krahasuar me vendet e rajonit dhe më gjere. SKZHI-II është një komponent kyç i Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) në Shqipëri. SPI përbëhet nga një komplet parimesh operacionale, të cilat garantojnë se planifikimi dhe zbatimi i politikave të qeverisë behën në një mënyrë koherente, efektive dhe të integruar. Kuadri kohor 2015-2020 i SKZHI-II është harmonizuar me periudhën vijuese 2014-2020 të planifikimit financiar të BE-së, me Strategjinë e Lisbonës deri në 2020, dhe me tre ciklet vijues Kuadrit Afatmesëm Buxhetor.	Toka Ajri Faktorët klimatike Uji Mjedi natyror Mbetjet Zhurma Popullsia dhe asetet materiale Trashëgimia kulturore Peisazhi	OM 1 OM 2 OM 3 OM 4 OM 5 OM 6 OM 7 OM 8 OM 9 OM 10 OM 11 OM 12
Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me sektorin	Lidhja me objektivat

	përkatës të mjedisit	mjedsore
	Përveç këtyre proceseve, SKZHI-II është harmonizuar edhe me procese dhe dokumente të tjerë kyç të zhvillimit dhe reformimit strategjik, si më poshtë: ▪ Dokumenti Tregues Strategjik për Shqipërinë (2014-2020), referuar gjithashtu edhe si Dokumenti Strategjik i Komisionit Evropian për Vendlind; ▪ Programi Kombëtar i Reformave Ekonomike (PKRE) 2015-2017, përfshirë Strategjinë e Zhvillimit të Bizneseve dhe Investimeve 2014-2020; ▪ Strategjia e Administrimit të Financave Publike 2014-2020; ▪ Strategjia e Europës Jug-Lindore 2020 (SEE2020) – Punësimi dhe Prosperiteti në Perspektivën Evropiane; ▪ Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2014-2020; ▪ Raportet e progresit të BE dhe Bankës Botërore (siç është Kuadri i Financimit të Vendlindit 2015-2020); dhe ▪ Raporte të hartuara nga partnerët e Shqipërisë që kanë lidhje me strategjitë për zhvillim kombëtar dhe integrimin në BE. Integrimi në BE është qëllimi madhor. Mirëqeverisja, demokracia dhe sundimi i ligjit përbejnë themelet mbi të cilat do të arrihet vizioni i SKZHI-II. Kjo do të mbështetet nga katër shtylla: ▪ Rritja përmes stabilitetit makroekonomik dhe fiskal përben Shtyllën 1 të mbështetjes për arritjen e vizionit të SKZHI-II. ▪ Rritja përmes rritjes së konkurrencës përben Shtyllën 2. ▪ Investimi tek njerëzit dhe kohezioni social përben Shtyllën 3. ▪ Rritja përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve Shtyllën 4. Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit (DPSMB) identifikon qartë fushat kryesore të punës, përkatësisht: rritjen e sipërfaqes së zonave të mbrojtura, hartimin e planeve të menaxhimit dhe zbatimin e tyre; plotësimin e kuadrit ligjor në përputhje me BE-në për natyrën dhe mjedisin; eliminimin e prerjeve dhe gjuetisë së paligjshme, duke zbatuar kuadrin ligjor, si dhe aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve dhe të zbatimit të planeve të veprimit për llojet dhe habitatet e rrezikuara. Përditësimi i Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit, ka marrë në konsideratë këto çështje si pjesë të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim deri në vitin 2020.	

Burimi: Plani Kombëtar për Integrimin Evropian – Shqipëri, Strategjia Kombëtare për Integrimin Evropian

6.1.2 Identifikimi i ndikimeve mjedisore

Tabela 6.2 Identifikimi i ndikimeve potenciale mjedisore

Spektori i mjedisit	Përcaktimi i ndikimeve që mund të vlerësohen në raportin e VSM-së	Vlerësimi PO/JO
Toka	- fragmentimi i zonave me aktivitet të dendur bujqësor apo zona pyjore - përdorimi i burimeve të energjisë së rinovueshme dhe karburanteve "bio" - administrimi i mbetjeve të gjeneruar nga aktivitetet e ndërhyrjeve infrastrukturore	PO
Ajri	- emetimi i ndotësve në ajër, të cilët kanë ndikime të dëmshme tek ekosistemet dhe biodiversiteti - emetimi i ndotësve për të cilët janë përcaktuar kufijtë e sipërm në nivel kombëtar - ndikimi në shëndet (sistemi respirator) në rastet e një pranie të lartë të ndotësve në ajër	PO
Faktorët klimatike	- ndjeshmëria e rrjeteve dhe strukturave ndaj situatave ekstreme të motit - emetimet e gazrave "sere" që shkaktohen nga djegia e karburanteve	PO
Uji	- siguria nga përmytjet - ndikimet e substancave të rrezikshme në cilësinë e ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësore, në rast të derdhjeve aksidentale të tyre - ndikimet tek ujësjellësit dhe cilësia e ujit të pijshëm - ndikimet mbi ujerat që përdoren për larje (plazh)	PO
Mjedi natyror (biodiversiteti, habitatet, zonat e mbrojtura)	- fragmentimi i habitateve - ndikim në linjat e migrimit të kafshëve - ndikim në integritetin dhe funksionalitetin e zonave të mbrojtura dhe të zonave të Natura 2000 - ndikime mbi tipologjinë dhe cilësitë e veçorive të çmuara natyrore	PO
Mbetjet	- ndikimet nga zona të ndotura të njohura si Hot-Spote (mbetje kimike, materiale të rrezikshme) që akoma nuk janë sistemuar - ndikimet nga vend depozitime të hapura (të ligjshme dhe të paligjshme) - kapacitet i pamjaftueshëm i landfilleve ekzistues / mungesa e tyre - mbetjet inerte, mbetjet e rrezikshme, mbetjet spitalore dhe mbetjet e kafshëve nuk trajtohen sipas kërkesave ligjore - ndarja në burim e mbetjeve/riciklimi (kuadri ligjor është plotësuar që prej vitit 2011, por nuk zbatohet në praktike).	PO
Zhurma	- ndotja akustike që shkaktohet gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të infrastrukturës përkatëse dhe ndikimi tek shëndeti i njerëzve	PO
Popullsia dhe asetet materiale	- ndikime mbi asetet materiale për shkak të nevojës për hapësirë - aksesibiliteti dhe lidhjet mes zonave/rajoneve të ndryshme - ndikimet që lidhen me sigurinë rrugore	PO
Trashëgimia kulturore	- ndikime në elementet e trashëgimisë kulturore	PO
Peizazhi	- ndryshimi i peizazhit dhe i veçorive pamore të hapësirës	PO

6.2 Metodika e Vlerësimit të ndikimit në mjedis

Vlerësimi i paraqitur në Seksionin 9 është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, ku jepet edhe përvijimi dhe përmbajtja e raportit të VSM-së. Ndikimet e rëndësishme të Planit në mjedis dhe objektivat mjedisore janë analizuar dhe vlerësuar sipas shkalleve të mëposhtme:

A – s’ka ndikim/ndikim pozitiv

B – ndikim i parëndësishëm

C – ndikimi behet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse

D – ndikim i rëndësishëm

E – ndikim shkatërrues

X – Vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur

Vlerësimi i ndikimeve të Planit sipas shkallës A, B dhe C do të thotë që ndikimet e zbatimit të Planit ndaj arritjes së objektivave mjedisore janë të pranueshme. Ndikimet e parëndësishme janë vlerësuar me B, ndërsa ndikimet që behën të pranueshme vetëm pas zbatimit të masave zbutëse përkatëse, janë vlerësuar me C. Shkallët D dhe E nënkuptojnë se ndikimet e zbatimit të Planit ndaj arritjes së objektivave mjedisore janë të papranueshme. Më poshtë janë përshkruar indikatorët dhe kriteret e Vlerësimit si dhe shkallët përkatëse të Vlerësimit për secilën objektivë mjedisore.

Përshkrimi i kriterëve dhe metodologjisë së Vlerësimit për objektivat mjedisore.

➤ Toka

Në tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e Vlerësimit dhe metodologjia për OM 1: **Garantimi i menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të tokës dhe mbrojtja e saj.**

Indikator/kriteri i Vlerësimit	Shkalla e Vlerësimit
- ndryshimi i strukturës aktuale të përdorimit të tokës dhe pyjeve (zbatimi i aktiviteteve që lidhen me ndërhyrjet infrastrukturore në toka bujqësore dhe zona pyjore do të çojë në humbjen dhe/ose ndryshimin e përhershëm të kategorisë së përdorimit të tyre (nga toke bujqësore apo zone pyjore në truall ndërtimi apo ndonjë kategori tjetër)); - ndryshimi i strukturës së përdorimit të tokës bujqësore me potencial të mirë prodhues (zbatimi i aktiviteteve që lidhen me ndërhyrjet infrastrukturore në toka bujqësore me potencial të mirë prodhues do të çojë në humbjen e përhershme të tokës bujqësore me cilësi të lartë) - probabiliteti i zbatimit të aktiviteteve që lidhen me ndërhyrjet infrastrukturore në zona pyjore me status të veçantë	A – s’ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet e parashikuara nuk prekin zonat pyjore apo token bujqësore, sipas ndarjes aktuale të përdorimit të tokës. B – ndikim i parëndësishëm: Nëse zbatohen dispozitat ligjore, ndikimi mbi përdorimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore dhe pyjeve do të jetë i parëndësishëm, pavarësisht faktit se aktivitetet do të zbatohen në toka bujqësore me potencial të mirë prodhues, apo në zona pyjore me një funksion të mirëpërcaktuar të prodhimit të lëndës drusore. C – ndikimi behet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse: Probabiliteti i ndryshimit të strukturës aktuale të përdorimit të tokës bujqësore dhe pyjeve është i lartë. Infrastruktura do të shtrihet në toka bujqësore me potencial të mirë prodhues, apo në zona pyjore me një funksion të mirëpërcaktuar të prodhimit të lëndës drusore. Duhet

(zbatimi i aktiviteteve që lidhen me ndërhyrjet infrastrukturore në zona pyjore me status të veçante mbrojtjeje/konservimi mund të prekë në mënyre të konsiderueshme ato cilësi për të cilat zona është vene nën këtë status) - probabiliteti i zbatimit të aktiviteteve që lidhen me ndërhyrjet infrastrukturore në zona pyjore me një funksion të mirëpërcaktuar të prodhimit të lëndës drusore (zbatimi i aktiviteteve që lidhen me ndërhyrjet infrastrukturore në zona pyjore me një funksion të mirëpërcaktuar të prodhimit të lëndës drusore do të çojë në humbjen e përhershme të këtyre zonave);	parashikuar masa zbutëse për të reduktuar ndikimin. D – ndikim i rëndësishme: Probabiliteti i ndryshimit të strukturës aktuale të përdorimit të tokës bujqësore dhe pyjeve është shumë i lartë. Ndikimi mbi përdorimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore dhe të pyjeve do të jetë i konsiderueshëm. Infrastruktura do të shtrihet në toka bujqësore me potencial të mirë prodhues, apo në zona pyjore me një funksion të mirëpërcaktuar të prodhimit të lëndës drusore. Nuk mund të merren masa zbutëse për të reduktuar ndikimin. E – ndikim shkatërrues: Probabiliteti i ndryshimit të strukturës aktuale të përdorimit të tokës bujqësore me potencial të mirë prodhues, apo të zonave pyjore me një funksion të mirëpërcaktuar të prodhimit të lëndës drusore është kaq i madh sa që ndikimi në bujqësi dhe pyje do të ketë pasoja shkatërruese.
---	--

Në tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e Vlerësimit dhe metodologjia për OM 2: **Parandalimi i shfrytëzimit të burimeve natyrore, duke rritur nivelin e përdorimit të materialeve të riciklueshme nga mbetjet që gjenerohen gjatë ndërtimit/rehabilitimit të infrastrukturës.**

Indikatori/kriteri i Vlerësimit	Shkalla e Vlerësimit
- niveli i riciklimit të mbetjeve që gjenerohen gjatë ndërtimit/rehabilitimit të infrastrukturës fizike (aktivitetet që lidhen me ndërtimin/rehabilitimin e infrastrukturës fizike duhet të garantojnë se të paktën 55% e mbetjeve që gjenerohen duhet të riciklohen, dhe materiali që gërmohet duhet, sa me shume të jete e mundur të riciklohet duke u përdorur në mbushjet gjatë ndërtimeve);	A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet e parashikuara nuk do të shkaktojnë mbetje nga punimet e ndërtimit apo gërmimet. B – ndikim i parëndësishëm: Zbatimi i aktiviteteve do të gjen erojë mbetje nga ndërtimi. Megjithatë, ato do të përpunohen totalit, ndërkohe që 55% e tyre do të ripërdoren si mbetje ndërtimore të riciklueshme. C – ndikimi behet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse: Zbatimi i aktiviteteve do të gjenerojë mbetje nga ndërtimi. Megjithatë, për shkak të veçorive cilësore të mbetjeve,

	ato nuk mund të përpunohen dhe nuk mund të garantohet se 55% e tyre do të ripërdoren, në rast se nuk zbatohen masat zbutëse. D – ndikim i rëndësishme: Zbatimi i aktiviteteve do të gjenerojë mbetje nga ndërtimi. Megjithatë, për shkak të veçorive cilësore të mbetjeve, të paktën 55% e tyre nuk mund të përpunohen dhe ripërdoren. Nuk mund të merren masa zbutësi për të rritur sasinë e mbetjeve të ricikluara. E – ndikim shkatërrues: Zbatimi i aktiviteteve do të gjenerojë mbetje nga ndërtimi, për të cilat duhet të organizohet procesi i largimit. X – Vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur: Ndikimi nuk mund të vlerësohet për shkak të mungesës së të dhënave.
--	---

• Ajri

Në tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e Vlerësimit dhe metodologjia për OM 3: Garantimi i arritjes së objektivave afatgjata pre sasinë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, për të arritur përputhshmërinë me kufijtë maksimale të lejueshëm nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferike.

Indikatori/kriteri i Vlerësimit	Shkalla e Vlerësimit
-sasia vjetore e emetimeve të ndotësve në ajër, d.m.th. e oksideve të squfurit, oksideve të azotit, lendes organike volatile pa përmbajtje metani, amoniakut dhe pjesëzave <i>(përmirësime të matshme të cilësisë së ajrit duke arritur nivelet e synuara të ndotësve e ajrit në lidhje me shëndetin e njerëzve, sipas vlerave respektive: për NOx - 40 μm^3, për PM₁₀- 40 μm^3, për PM_{2.5}- 25 g/m3 dhe 20 g/m3 dhe SO₂- 125 μm^3.</i> - numri vjetor i ditëve kur tejkalohet niveli i ndotjes së ajrit me pjesëza, i matur në pikat e monitorimit, të cilat janë të ekspozuara ndaj emetimeve të ndotësve	A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet e parashikuara nuk do të shkaktojnë emetime të ndotësve në ajër (përfshire edhe pjesëzat), për të cilat janë përcaktuar kufijtë maksimale të emimit në nivel kombëtar. Zbatimi i aktiviteteve do të reduktoje emimet e ndotësve. B – ndikim i parëndësishëm: Zbatimi i aktiviteteve do të shkaktojë emetime të ndotësve në ajër (përfshire edhe pjesëzat), për të cilat janë përcaktuar kufijtë maksimale të emimit në nivel kombëtar, por jo deri në atë masë sa të tejkalohen kufijtë e përcaktuar në SKZHI-II. C – ndikimi behet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse: Zbatimi i aktiviteteve do të shkaktojë

<i>(duhet të reduktohet me 40% numri i ditëve kur tejkalohe nivelin e ndotjes së ajrit me pjesëza; sa me pak dite me ndotje të lartë të ajrit, aq më i ulët është ndikimi tek shëndeti i njerëzve dhe kostojat për shoqërinë, për shkak të numrit relativisht të lartë të njerëzve të ekspozuar, shëndeti i të cilëve preket nga ky faktor);</i>	emetime të ndotësve në ajër (përfshirë edhe pjesëzat), për të cilat janë përcaktuar kufijtë maksimale të emetimit në nivel kombëtar deri në atë masë sa do të tejkalohe kufijtë e përcaktuar në SKZHI-II. për të reduktuar emetimet duhet të parashikohen dhe zbatohen masa zbutëse në mënyrë që niveli maksimal i emetimeve të zbresë në kufijtë e parashikuar në SKZHI-II. D – ndikim i rëndësishëm: Zbatimi i aktiviteteve do të shkaktojë emetime të ndotësve në ajër (përfshirë edhe pjesëzat), për të cilat janë përcaktuar kufijtë maksimale të emetimit në nivel kombëtar deri në atë masë sa do të tejkalohe kufijtë e përcaktuar në SKZHI-II. Nuk mund të merren masa zbutëse për të reduktuar nivelin e emetimeve nën kufijtë e përcaktuar dhe për të mbajtur ndikimin nën nivelin e përcaktuar të ndotjes së ajrit me pjesëza. E – ndikim shkatërrues: Zbatimi i aktiviteteve do të shkaktojë emetime të ndotësve në ajër (përfshirë edhe pjesëzat), për të cilat janë përcaktuar kufijtë maksimale të emetimit në nivel kombëtar deri në atë masë sa kufijtë e përcaktuar në SKZHI-II do të tejkalohe në mënyrë të konsiderueshme dhe ndotja e ajrit me pjesëza do të jetë në nivel të tillë që do të ketë një efekt të konsiderueshëm dhe të dëmshëm mbi shëndetin e njerëzve. X – Vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur: Ndikimi nuk mund të vlerësohet për shkak të mungesës së të dhënave
---	---

- Faktorët klimatike

Në tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e Vlerësimit dhe metodologjia për OM 4: Adoptimi i infrastrukturës në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve sere në nivelet e përcaktuara në SKZHI II.

Indikatori kriteri i Vlerësimit	Shkalla e Vlerësimit
- adaptimi i infrastrukturës përkatëse ndaj ndryshimeve klimatike <i>(aktivitetet që lidhen me ndërtimin/ rehabilitimin e infrastrukturës përkatëse duhet të përfshijnë aktivitete që zvogëlojnë apo parandalojnë pasojat e ndryshimeve klimatike, veçanërisht të përmbytjeve, dëborës dhe ngricave)</i> - -sasia vjetore e emetimeve të gazeve "sere" <i>(sasia maksimale e emetimeve të gazeve "sere" nuk duhet të tejkalojë sasinë e synuar vjetore prej 18,000 Gg CO₂ekuivalent në 2020⁷)</i> <i>Ndikimet kumulative të të gjithë aktiviteteve të Planit nuk duhet të shkaktojnë një sasi vjetore nga të gjitha burimet e emetimeve të gazeve "sere" që të tejkalojë vlerat e synuara që jepen në SKZHI-II lidhur me Reduktimin e Emetimeve të Gazeve "Sere" në 2020.)</i>	A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet e parashikuara garantojnë adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, apo një gjë e tillë s'ka nevojë të garantohet; aktivitetet e parashikuara nuk do të shkaktojnë rritje të emetimeve të gazeve "sere". Zbatimi i aktiviteteve do të reduktojë emetimet e gazeve "sere". B – ndikim i parëndësishëm: Aktivitetet e parashikuara garantojnë adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, apo një gjë e tillë s'ka nevojë të garantohet. Emetimeve e gazeve "sere" do të rriten, por jo deri në atë masë sa të tejkalohen kufijtë e përcaktuar në SKZHI-II. C – ndikimi behet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse: Aktivitetet e parashikuara garantojnë adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, apo një gjë e tillë s'ka nevojë të garantohet. Emetimeve e gazeve "sere" do të rriten deri në atë masë sa do të tejkalohen kufijtë e përcaktuar në SKZHI-II. për të reduktuar emetimet duhet të parashikohen dhe zbatohen masa zbutëse, të cilat do të garantojnë që niveli i emetimeve nuk do të kalojë kufijtë e parashikuar në SKZHI-II. D – ndikim i rëndësishme: Aktivitetet e parashikuara garantojnë adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, apo një gjë e tillë s'ka nevojë të garantohet. Emetimeve e gazeve "sere" do të rriten deri në atë masë sa do të tejkalohen kufijtë e përcaktuar në SKZHI-II. Nuk mund të merren masa zbutëse për të reduktuar nivelin e emetimeve nën kufijtë e përcaktuar. E – ndikim shkatërrues: Aktivitetet e parashikuara nuk garantojnë adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, apo zbatimi i

⁷ Projektioni aktual i emetimeve të GHG në 2020 tregon 18,000 Gg CO₂ ek. Ky projektion do të rishikohet në kuadër të Komunikimit të Trete Kombëtar të UNFCCC. Në rast të financimit të huaj për NAMA (masat adaptuese kombëtare për reduktimin e GHG) reduktimi i GHG mund të rritet me 16% krahasuar me skenarin baze.

	aktiviteteve do të rrite emetimet e gazeve “sere” deri në atë masë sa kufijtë e përcaktuar në SKZHI-II do të tejkalohen në mënyre të konsiderueshme. X – Vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur: Ndikimi nuk mund të vlerësohet për shkak të mungesës së të dhënave
--	---

• Uji

Në tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e Vlerësimit dhe metodologjia për OM 5: **Kufizimi i efekteve negative mbi ujerat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ujerat e njelmët, ujerat bregdetare dhe burimet e ujit të pijshëm.**

Indikatori/kriteri i Vlerësimit	Shkalla e Vlerësimit
- mundësi ndërhyrjeje në zonat me burime ujore të mbrojtura <i>(zbatimi i aktiviteteve jashtë zonave me burime ujore do të thotë më pak mundësi për ndotjen e ujit nëntokësor që përdoret si burim furnizimi me ujë).</i> - mundësi ndërhyrjeje në zonat me burime ujore për larje <i>(zbatimi i aktiviteteve në zonat me burime ujore për larje do të thotë më shumë mundësi për ndotjen e ujerave që përdoren për larje).</i> - mundësi ndërhyrjeje në zonat me rrezik përmbajtjeje <i>(zbatimi i aktiviteteve në zonat me rrezik përmbajtjeje redukton zonat mbrojtëse dhe rrit mundësinë për dëme nga përmbajtjet).</i> - mundësi ndërhyrjeje në zonat ujëmbajtëse me një nivel të lartë të prekshmërisë <i>(zbatimi i aktiviteteve në zonat ujëmbajtëse me një nivel të lartë të prekshmërisë do të thotë më shumë mundësi për ndotjen e ujerave nëntokësore).</i>	A – s’ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet nuk do të ushtrojnë trysni shtese mbi ujerat nëntokësore dhe sipërfaqësorë, ujerat e njelmët, ujerat bregdetare dhe burimet e ujit të pijshëm, apo ndikimi do të jete pozitiv. B – ndikim i parëndësishëm: Nëse zbatohen dispozitat përkatëse ligjore, ndikimi mbi ujerat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ujerat e njelmët, ujerat bregdetare dhe burimet e ujit të pijshëm do të jete i parëndësishëm, pavarësisht faktit se aktivitetet mund të zbatohen në zona me burime ujore të mbrojtura, në zona ujëmbajtëse me një nivel të lartë të prekshmërisë, në zona me burime ujore për larje apo në zona me rrezik përmbajtjeje. C – ndikimi behet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse: Me gjithë zbatimin e dispozitave ligjore, trysnia mbi ujerat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ujerat e njelmët, ujerat bregdetare dhe burimet e ujit të pijshëm mund të jetë e madhe, sidomos për shkak se probabiliteti i zbatimit të aktiviteteve në zona me burime ujore të mbrojtura, në zona ujëmbajtëse me një nivel të larte të prekshmërisë, në zona me burime ujore për larje apo në zona me rrezik përmbajtjeje, është i larte. Duhet parashikuar dhe

	zbatuar masa zbutëse për të reduktuar ndikimin. D – ndikim i rëndësishme: Me gjithë zbatimin e dispozitave ligjore, trysnia mbi ujerat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ujerat e njelmët, ujerat bregdetare dhe burimet e ujit të pijshëm do të jetë e madhe, sidomos për shkak së probabiliteti i zbatimit të aktiviteteve në zona me burime ujore të mbrojtura, në zona ujëmbajtëse me një nivel të lartë të prekshmërisë, në zona me burime ujore për larje apo në zona me rrezik përmytjeje, është shumë i lartë. Nuk mund të merren masa zbutëse për të reduktuar ndikimin. E – ndikim shkatërrues: Me gjithë zbatimin e dispozitave ligjore, trysnia mbi ujerat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ujerat e njelmët, ujerat bregdetare dhe burimet e ujit të pijshëm do të jetë jashtëzakonisht e madhe, sidomos për shkak se probabiliteti i zbatimit të aktiviteteve në zona me burime ujore të mbrojtura, në zona ujëmbajtëse me një nivel të lartë të prekshmërisë, në zona me burime ujore për larje apo në zona me rrezik përmytjeje, është shumë i lartë. Megjithatë nuk mund të merren masa zbutëse për të reduktuar ndikimin. X – Vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur: Ndikimi nuk mund të vlerësohet për shkak të mungesës së të dhënave.
--	--

• **Mjedisi natyror**

Në tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e Vlerësimit dhe metodologjia për OM 6: Garantimi i kohezionit të popullatave dhe mbrojtjes së biodiversitetit

Indikatori / kriteri i Vlerësimit	Shkalla e Vlerësimit
- mundësia e ndërhyrjes në zonat Qendrore të habitatëve të mishngrënësve të mëdhenj <i>(zbatimi i aktiviteteve që lidhen me ndërhyrjet infrastrukturore në zonat e rëndësishme ekologjike të habitoreve të mishngrënësve të mëdhenj do të</i>	A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv: Nuk do të ketë ndikim në kohezionin e popullatave dhe në mbrojtjen e biodiversitetit, apo ndikimi do të jetë pozitiv. B – ndikim i parëndësishëm: Nëse zbatohen dispozitat përkatëse ligjore, ndikimi në kohezionin e popullatave dhe në mbrojtjen e

<i>sjellë një trysni më të madhe mbi këta lloje dhe do të ndërpresë linjat e migrimit; ka mundësi potenciale për ndikim tek biodiversiteti në nivel rajonal dhe ndërkufitar)</i> - mundësia e ndërhyrjes në zonat me pyje të dendura <i>(planifikimi i infrastrukturës së re në zona me pyje të dendura do të sjellë ndikime negative mbi kafshët e egra dhe do të ndërpresë linjat e migrimit; ka mundësi potenciale për ndikim tek biodiversiteti në nivel lokal dhe rajonal)</i>	biodiversitetit do të jete i parëndësishëm. C – ndikimi behet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse: Me gjithë zbatimin e dispozitave ligjore, nuk mund të garantohej kohezioni i popullatave dhe mbrojtja e biodiversitetit. Duhet parashikuar dhe zbatuar masa zbutëse për të reduktuar ndikimet e rëndësishme. D – ndikim i rëndësishëm: Me gjithë zbatimin e dispozitave ligjore, nuk mund të garantohej kohezioni i popullatave dhe mbrojtja e biodiversitetit. Nuk është e mundur të merren masa zbutëse për të reduktuar ndikimin. E – ndikim shkatërrues: Me gjithë zbatimin e dispozitave ligjore, ndikimi mbi kohezionin e popullatave dhe mbrojtjen e biodiversitetit është shkatërrues. Nuk është e mundur të merren masa zbutëse për të reduktuar ndikimin. X – Vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur: Ndikimi nuk mund të vlerësohet për shkak të mungesës së të dhënave.
---	--

Në tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e Vlerësimit dhe metodologjia për OM 7:
Ruajtja e zonave që kanë një status të veçantë mbrojtjeje, prej aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme.

Indikatori/kriteri i Vlerësimit	Shkalla e Vlerësimit
- sasia e mbetjeve që gjëndërohen dhe depozitohen në landfill <i>(zhvillimet e reja do të rritin sasinë e mbetjeve që gjenerohen, përfshire mbetjet e ngurta, të lëngëta dhe të rrezikshme, dhe ky fakt bën që të priten ndikime negative në cilësinë e tokës, të ujërave nëntokësore, të ajrit dhe në shëndetin e njerëzve)</i> - sasia e mbetjeve që riciklohen <i>(SKZHI II deklaron se deri në 2020 sasia e mbetjeve urbane të ricikluara do të jetë 55%)</i> - ndërtimi i landfilleve të reja	A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet e pritshme nuk do të rritin sasinë e mbetjeve të gjeneruara. Zbatimi i aktiviteteve do të përmirësojë procesin e grumbullimit/trajtimit të mbetjeve. B – ndikim i parëndësishëm: Zbatimi i aktiviteteve do të rrite sasinë e mbetjeve të gjeneruara, por jo deri në atë masë sa të influencojë procesin e grumbullimit/trajtimit të mbetjeve dhe të preke mjedisin natyror dhe njerëzor. C – ndikimi behet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse: Zbatimi i aktiviteteve do të rritë sasinë e mbetjeve të gjeneruara, gjë që do të shkaktojë ndotje të tokës, ujit, ajrit dhe

<i>(kjo gjë do të ndikojë pozitivisht në procesin e trajtimit dhe riciklimit të mbetjeve; megjithatë gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të tyre priten disa ndikime, të cilat do të jenë të parëndësishme nëse aplikohet strategjia e duhur e zbutjes)</i>	rreziqe për shëndetin e njerëzve. Duhet parashikuar dhe zbatuar masa zbutëse për të reduktuar ndikimin, të cilat garantojnë se procesi i grumbullimit/trajtimit të mbetjeve i përgjigjet sasisë së rritur të mbetjeve dhe se niveli i ndotjes ulet deri në kufijtë e vlerave të pranueshme/përcaktuara. D – ndikim i rëndësishëm: Zbatimi i aktiviteteve do të rritë sasinë e mbetjeve të gjeneruara, gjë që do të shkaktojë ndotje të tokës, ujit, ajrit dhe rreziqe për shëndetin e njerëzve. Nuk ka mundësi të merren masa zbutëse për ta mbajtur ndikimin nën kufijtë e vlerave të pranueshme/përcaktuara. E – ndikim shkatërrues: Zbatimi i aktiviteteve do të rritë sasinë e mbetjeve të gjeneruara, dhe ndotja e tokës, ujit, ajrit dhe rreziqet për shëndetin e njerëzve janë në një masë të tillë që kanë efekt të konsiderueshëm dhe të dëmshëm për shëndetin e njerëzve. X – Vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur: Ndikimi nuk mund të vlerësohet për shkak të mungesës së të dhënave.
---	---

• **Zhurma**

Në tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e Vlerësimit dhe metodologjia për OM 9: Reduktimi i ndotjes së zhurmës/akustike dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE dhe OBSH.

Indikatori/kriteri i Vlerësimit	Shkalla e Vlerësimit
- ekspozimi ndaj zhurmës së shkaktuar prej ndërhyrjeve në infrastrukture <i>(sa me pak shqetësime që të ketë mjedisi nga zhurma, aq me i ulet është ndikimi në cilësinë e mjedisit, shëndetin e njerëzve dhe kostot e shoqërisë, për shkak të numrit të njerëzve të ekspozuar, shëndeti i të cilëve preket direkt)</i>	A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet e pritshme nuk do të rritin ekspozimin ndaj zhurmës. Përkundrazi këto aktivitete do ta ulin këtë ekspozim. B – ndikim i parëndësishëm: Zbatimi i aktiviteteve do të rrite pak ekspozimin ndaj zhurmës, por nëse zbatohen dispozitat përkatëse ligjore, ndikimi do të jete i parëndësishëm. C – ndikimi behet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse: Zbatimi i aktiviteteve do të rrite ekspozimin ndaj zhurmës. Me gjithë zbatimin e dispozitave ligjore, ndikimi do të jete i rëndësishëm.

	Duhen parashikuar dhe zbatuar masa zbutëse shtese për të reduktuar ndikimin. D – ndikim i rëndësishëm: Zbatimi i aktiviteteve do të rrite ekspozimin ndaj zhurmës. Me gjithë zbatimin e dispozitave ligjore, ndikimi do të jete i rëndësishëm. Duhen parashikuar dhe zbatuar masa zbutëse shtese për të reduktuar ndikimin. Nuk ka mundësi të merren masa zbutëse për të reduktuar ndikimin. E – ndikim shkatërrues: Zbatimi i aktiviteteve do të rritë ekspozimin ndaj zhurmës deri në një masë të tillë që kjo gjë do të ketë një efekt të konsiderueshëm dhe të dëmshëm për shëndetin e njerëzve e me tej. X – Vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur: Ndikimi nuk mund të vlerësohet për shkak të mungesës së të dhënave.
--	---

• **Popullsia dhe asetet materiale**

Në tabelën me poshtë janë përshkruar kriteret e Vlerësimit dhe metodologjia për OM 10: Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme.

Indikatori / kriteri i Vlerësimit	Shkalla e Vlerësimit
- lidhja mes vendbanimeve dhe qendrave rajonale (një lidhje më e shpejte dhe më e mirë përmirëson kohezionin social: lidhja më e shpejte me qendrat e qyteteve përben një baze më të mirë për zhvillimin e turizmit dhe aktiviteteve ekonomike, të cilat nga ana e tyre sjellin ndikime pozitive në të ardhurat individuale dhe komunitare, në mënyrën e jetesës dhe në vlerën e aseteve materiale – pasuritë e paluajtshme) - përfshirja e aktiviteteve për të përmirësuar sigurinë e trafikut (më shumë aktivitete të kësaj natyre sjellin përmirësim të sigurisë rrugore dhe më pak aksidente) - përfshirja e aktiviteteve për të rritur efektivitetin e transportit publik	A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet nuk do të ndikojnë në arritjen e objektivës, ose zbatimi i tyre do të përmirësoje lidhjet mes zonave të veçuara me qendrat rajonale, do të përmirësoje sigurinë e trafikut dhe lëvizshmërinë e qëndrueshme. B – ndikim i parëndësishëm: Zbatimi i aktiviteteve do të garantoje lidhjet mes zonave të veçuara me qendrat rajonale, sigurinë e trafikut dhe lëvizshmërinë e qëndrueshme, por krahasuar me gjendjen aktuale këto lidhje do të jenë disi më të dobëta. C – ndikimi behet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse: Zbatimi i aktiviteteve do t'i beje me të dobëta lidhjet mes zonave të veçuara me qendrat rajonale, sigurinë e trafikut dhe lëvizshmërinë e qëndrueshme, krahasuar me gjendjen aktuale.

<i>(përdorimi sa me i madh i transportit publik sjell një lëvizshmëri më efektive dhe të qëndrueshme; një transport publik më efektiv sjell uljen e ngarkesë së trafikut në rrugë dhe ruan vlerën e aseteve materiale siç është toka dhe pasuritë e paluajtshme; gjithashtu një transport publik më efektiv redukton sforcon financiare për familjet, pasi redukton nevojën për të pasur apo përdorur makina personale)</i> - përfshirja e aktiviteteve për të rritur mundësitë për një mënyrë të shëndetshme të jetesës <i>(aktivitetet që lidhen me lëvizshmërinë e qëndrueshme, kërkojnë një organizim të mirë të infrastrukturës çlodhëse/ argëtuese (për shembull koristë e biçikletave, monopetet e ecjes me këmbë, përfshire edhe mbërritjen deri aty); çlodhja/argëtimi ndikon pozitivisht në gjendjen mendore dhe fizike të njerëzve dhe në këtë mënyrë redukton kostot e shoqërisë, pasi shfrytëzohet një mënyrë e shëndetshme e jetesës)</i>	Duhen parashikuar dhe zbatuar masa zbutëse për të reduktuar ndikimin. D – ndikim i rëndësishëm: Zbatimi i aktiviteteve do t'i beje konsiderueshëm më të dobëta lidhjet mes zonave të veçuara me qendrat rajonale, sigurinë e trafikut dhe lëvizshmërinë e qëndrueshme, krahasuar me gjendjen aktuale. Nuk ka mundësi të merren masa zbutëse. E – ndikim shkatërrues: Zbatimi i aktiviteteve do t'i shkatërrojë plotësisht lidhjet mes zonave të veçuara me qendrat rajonale, sigurinë e trafikut dhe lëvizshmërinë e qëndrueshme, krahasuar me gjendjen aktuale. X – Vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur: Ndikimi nuk mund të vlerësohet për shkak të mungesës së të dhënave.
---	--

• Trashëgimia kulturore

Në tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e Vlerësimit dhe metodologjia për OM 11: Ruajtja e shtrirjes, përmbajtjes dhe veçorive të zonave dhe strukturave të trashëgimisë kulturore.

Indikatori/kriteri i Vlerësimit	Shkalla e Vlerësimit
probabiliteti që infrastruktura të shtrihet në njësitë e regjistruara të trashëgimisë kulturore <i>(zbatimi i aktiviteteve që lidhen me ndërhyrjet infrastrukturore në njësitë e trashëgimisë kulturore mund të rrezikojnë seriozisht integritetin e trashëgimisë dhe të modifikojë veçoritë e saj cilësore. Veçanërisht të rrezikuar janë peizazhet kulturore dhe peizazhet historike të zonave të trashëgimisë</i>	A – s'ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet e parashikuara nuk shtrihen në njësitë e regjistruara të trashëgimisë kulturore. Përderisa hapësira nuk do të cenohet, edhe mbetjet arkeologjike nuk do të dëmtohen. B – ndikim i parëndësishëm: Ka mundësi potenciale që aktivitetet të shtrihen në njësitë e regjistruara të trashëgimisë kulturore. Përderisa aktivitetet shtrihen pranë apo përgjatë infrastrukturës ekzistuese, probabiliteti që aktivitetet të shtrihen në

<i>arkitektonike dhe arkeologjike)</i> - probabilitet i shkatërrimit të mbetjeve arkeologjike (zbatimi i aktiviteteve që lidhen me ndërhyrjet infrastrukturore në njësitë e trashëgimisë kulturore nënkupton cenimin e tokës dhe si pasojë mbart një probabilitet të lartë për shkatërrimin e mbetjeve arkeologjike)	njësite e regjistruara të trashëgimisë kulturore dhe që mbetjet arkeologjike të dëmtohen, është i ulët. Duke zbatuar dispozitat përkatëse ligjore, ndikimi mbi veçoritë cilësore të njësive të regjistruara të trashëgimisë kulturore do të jete i parëndësishëm. C – ndikimi behet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse: Probabiliteti që aktivitetet të shtrihen në njësitë regjistruara të trashëgimisë kulturore, dhe për pasojë të zvogëlojnë përmasat e tyre, është i lartë. Me gjithë zbatimin e parashikimeve ligjore, ndikimi i aktiviteteve mbi trashëgiminë kulturore do të jetë i rëndësishëm. për shkak se aktiviteti shtrihet në zonë të gjerë, probabiliteti i dëmtimit të mbetjeve arkeologjike është i lartë. Duhet parashikuar dhe zbatuar masa zbutëse për të reduktuar ndikimin. D – ndikim i rëndësishëm: Probabiliteti që aktivitetet të shtrihen në njësite e regjistruara të trashëgimisë kulturore, dhe për pasojë të zvogëlojnë përmasat e tyre, është shumë i lartë. Me gjithë zbatimin e parashikimeve ligjore, ndikimi i aktiviteteve mbi trashëgiminë kulturore do të jetë i konsiderueshëm. për shkak se aktiviteti shtrihet në zonë të gjerë, probabiliteti i dëmtimit të mbetjeve arkeologjike është shumë i lartë. Nuk mund të merren masa zbutëse për të reduktuar ndikimin. E – ndikim shkatërrues: Ndikimi i aktiviteteve mbi veçoritë cilësore të njësive të regjistruara të trashëgimisë kulturore, do të jetë shkatërrues. Edhe ndikimi mbi mbetjet arkeologjike do të jete shkatërrues. X – Vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur: Ndikimi nuk mund të vlerësohet për shkak të mungesës së të dhënave.
---	---

• **Peizazhi**

Në tabelën më poshtë janë përshkruar kriteret e Vlerësimit dhe metodologjia për OM 12: Garantimi i ruajtjes së peizazheve të veçanta dhe zonave peizazhistike

me veçori dalluese në nivel kombëtar dhe krijimi i një imazhi peizazhi me cilësi të lartë.

Indikatori / kriteri i Vlerësimit	Shkalla e Vlerësimit
- probabiliteti që infrastruktura të shtrihet në peizazhe të veçanta dhe zona peizazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar <i>(zbatimi i aktiviteteve që lidhen me ndërhyrjet infrastrukturore në njësitë e peizazhit mund të rrezikojnë seriozisht integritetin e peizazheve të veçanta dhe zonave peizazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar, dhe të shkatërrojnë veçoritë e tyre cilësore)</i> - probabiliteti që infrastruktura të shtrihet në zonat peizazhistike me elemente të mbrojtur të natyrës dhe në zonat me peizazhistike kulturore jashtëzakonisht të ekuilibruara, të cilat mbartin edhe simbolika të veçanta <i>(zbatimi i aktiviteteve që lidhen me ndërhyrjet infrastrukturore në njësitë e peizazhit mund të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme imazhin ekzistues të peizazhit. Ndikimi është veçanërisht i dukshëm në zonat peizazhistike me elemente të mbrojtur të natyrës dhe në zonat me peizazhistike kulturore jashtëzakonisht të ekuilibruara)</i>	A – s’ka ndikim/ndikim pozitiv: Aktivitetet e parashikuara nuk shtrihen në peizazhe të veçanta dhe zona peizazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar. Do të ruhet imazhi i peizazhit me cilësi të lartë, pasi aktivitetet do të integrohen në zona me një shkallë të lartë të degradimit të peizazhit. B – ndikim i parëndësishëm: Ka mundësi potenciale që aktivitetet të shtrihen në peizazhe të veçanta dhe zona peizazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar, apo në zona peizazhistike imazhi i të cilave është në prishje e sipër. Ndikimi mbi imazhin ekzistues të peizazhit do të jetë i parëndësishëm, pasi shumica e aktiviteteve do të integrohen në zona me një shkallë të lartë të degradimit të peizazhit. C – ndikimi behet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse: Probabiliteti që aktivitetet të shtrihen në peizazhe të veçanta dhe zona peizazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar, është i lartë. Ndikimi mbi veçoritë cilësore të këtyre zonave është i madh. Aktivitetet do të shtrihen në zona të konservuara peizazhistike natyrore apo kulturore, kështu që ndikimi në peizazhet me cilësi të lartë të imazhit të tyre, do të jetë i rëndësishëm. Duhet parashikuar dhe zbatuar masa zbutëse për të reduktuar ndikimin. D – ndikim i rëndësishëm: Probabiliteti që aktivitetet të shtrihen në peizazhe të veçanta dhe zona peizazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar është i madh, kështu që edhe ndikimi është i konsiderueshëm. Aktivitetet do të shtrihen në zonat peizazhistike me elemente të mbrojtur të natyrës dhe në zonat me peizazhistike kulturore jashtëzakonisht të ekuilibruara, kështu që ndikimi në peizazhet me cilësi të lartë të imazhit të tyre, do të jetë i rëndësishëm. Nuk mund të merren masa

	zbutëse për të reduktuar ndikimin. E – ndikim shkatërrues: Ndikimi i aktiviteteve mbi veçoritë cilësore të peizazheve të veçanta dhe zonave peizazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar do të jetë shkatërrues. Peizazhet me cilësi të lartë të imazhit të tyre dhe që përmbajnë elementë të jashtëzakonshëm natyrore dhe kulturore, do të shkatërrohen. X – Vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur: Ndikimi nuk mund të vlerësohet për shkak të mungesës së të dhënave
--	--

SEKSIONI 7: VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISE SË OBJEKTIVAVE

Objektivat e përcaktuara mjedisore duhet të jenë në përputhje me Ligjin 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, objektivat e përcaktuara në SKZHI II dhe Direktivën 2001/42/KE, të cilat janë të rëndësishme për të vlerësuar politikat dhe projektet që parashikon Planin për të arritur objektivat e tij. Për të përcaktuar rëndësinë e objektivave mjedisore, duhet të vlerësohet përputhshmëria e objektivave dhe politikave të Planit me objektivat e përcaktuara mjedisore. Vlerësimi i përputhshmërisë krijon konflikte apo veprime të ndërsjellta mes objektivave dhe politikave të ndryshme, si dhe konflikte të theksuara interesi mes objektivave. Të gjitha këto duhen vënë në dukje veçanërisht në pjesën e Vlerësimit të projekteve specifike të Planit.

Përputhshmëria e politikave të Planit është vlerësuar duke i kombinuar këto politika me objektivat mjedisore të kësaj VSM-je. Vlerësimi është bërë duke përdorur përafrimin standard në formë matrice. për të kryer Vlerësimin numerik të nivelit të përputhshmërisë është përdorur grafiku i vlerësimit që jepet në Tabelën 7.1 më poshtë.

Tabela 7.1 Grafiku i Vlerësimit të nivelit të përputhshmërisë mes objektivave

Niveli i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë
Objektivat përputhen plotësisht	3	2.00-3.00
Objektivat përputhen pjesërisht	2	1.00 – 1.99
Lidhja mes objektivave është e zbehtë	1	0.00 – 0.99
Nuk ka lidhje mes objektivave	0	0
Objektivat nuk përputhen	-1	negativ

7.1 Vlerësimi i përputhshmërisë së objektivave dhe politikave të Planit me objektivat mjedisore

Rezultatet e Vlerësimit të përputhshmërisë së politikave të Planit me objektivat mjedisore janë paraqitur në Tabelën 7-2 më poshtë. Tabela tregon se, në parim, të gjitha politikat e Planit janë në përputhje me objektivat mjedisore.

Tabela 7.2 Vlerësimi i përputhshmërisë së politikave të Planit me Objektivat Mjedisore

Objektiva Mjedisore	OM 1	OM 2	OM 3	OM 4	OM 5	OM 6	OM 7	OM 8	OM 9	OM 10	OM 11	OM 12	
Objektivat dhe politikat e Planit	Toka – Përdorimi i qëndrueshëm i tokës	Toka – Shfrytëzimi i burimeve natyrore	Ajri – Emetimet e ndotësve	Faktorët Klimatikë – Adaptimi ndaj ndryshimeve	Uji – Kufidimi i efekteve negative	Mjedisli Natyror – Kohëzoni i popullatave dhe	Mjedisli Natyror – Zonat e Mbrojtura	Mbetjet – Kompletimi i landfilleve	Zhurmat – Reduktimi i zhurmave në deri në nivelo materiale dhe asetet	Trashëgimia kulturore – Ruajtja	Pelazhi – Ruajtja		Mesatarja
Sistemet Territoriale të Bashkisë Vau-Dejës													
Sistemi Urban – Zhvillim policentrik, densifikim dhe gjithëpërfshirje													
Zhvillim hapësiror policentrik dhe një marrëdhënie të re urbane - rurale.	1	1	1	1	1	1	0	3	1	3	1	1	1.25
Akses më të mirë në një infrastrukturë multimodale, e cila është jo vetëm më e efektshme, por edhe miqësore ndaj mjedisit.	2	2	3	3	3	3	3	3	3	3	3	2	2.75
Konservim dhe zhvillim të pasurive natyrore dhe të trashëgimisë historike kulturore, në kuptim të përmirësimit dhe të aktivizimit të këtyre aseteve në jetën urbane.	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3.00
Sistemi Ujor													
Mbrojtjen e burimeve ujore nëntokësore dhe mbitokësore.	3	3	0	3	3	3	3	0	0	0	0	3	1.75
Rigjenerimi i korridoreve natyrore përgjate luginave të lumenjve.	3	3	0	0	3	3	3	0	0	0	0	3	1.50
Sistemi Bujqësor – Eficencë për një sektor bujqësor konkurrues													
Ruajtje, Konsolidim dhe Modernizim.	2	2	1	0	2	1	0	1	0	3	0	2	1.17
Vendosja e një rrjeti të suksesshëm të zinxhirit ekonomik bujqësor: prodhim - grumbullim - përpunim - tregtim, me qëllim rritjen e vlerës së zinxhirit ekonomik.	0	0	0	0	0	0	0	2	0	3	0	0	0.42
Krijimi i qendrave/poleve bujqësore dhe profilizimi i këtyre të fundit bazuar në traditën e kultivimit të kulturave vendore.	2	2	1	1	2	0	0	2	1	3	0	2	1.33
Specializim në prodhim dhe përpunim të prodhimeve dhe produkteve karakteristike të zonës.	0	0	0	0	0	3	0	0	0	3	0	0	0.50
Sistemi Natyror – Menaxhimi Inteligent i pasurive natyrore dhe trashëgimisë kulturore													
Rritja e rolit të mjedisit në zhvillimin ekonomik të vendit; integrimi i sistemit natyror në vlerën ekonomike të sektorëve të zhvillimit.	3	3	2	2	1	2	3	0	2	2	3	3	2.17
Rritja e rolit të mjedisit në cilësinë e jetës urbane përmes promovimit dhe krijimit të aksesit të përshtatshëm ndaj zonave natyrore.	3	3	3	1	3	3	3	0	3	3	3	3	2.58

Objektiva Mjedisore	OM 1	OM 2	OM 3	OM 4	OM 5	OM 6	OM 7	OM 8	OM 9	OM 10	OM 11	OM 12	
Objektivat dhe politikat e Planit	Toka – Përdorimi i qëndrueshëm i tokës	Toka – Shfrytëzimi i burimeve natyrore	Ajri – Emetimet e ndotëseve	Faktorët klimatike – Adaptimi ndaj ndryshimeve	Uji – Kufizimi i efekteve negative	Mjedisit Natyror – Kohëzimi i popullatave dhe	Mjedisit Natyror – Zonat e mbrojtura	Mbretërit – Kompletimi i landfilleve	Zhurmat – Reduktimi i zhurmave në deri në nivelet	Popullsia dhe asetet materiale – Kohëzimi social	Trashëgimia kulturore – Ruajtja	Pezizmi – Ruajtja	Mesatarja
Sistemet Territoriale të Bashkisë Vau-Dejës													
Sistemi i Infrastrukturrës - Rrëzja e aksesueshmërisë së vendit dhe një shpërndarje e balancuar e flukseve													
Transporti													
Organizimin e territorit në sistemin e hierarkizimit të qendrave urbane dhe zhvillimi i koridoreve të integruara të flukseve të infrastrukturrës.	1	1	1	1	1	1	1	2	2	3	1	1	1.33
Zhvillimi i transportit multimodal dhe miqësor ndaj ambientit.	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3.00
Sigurimin, zgjerimin, dhe sipas rastit ngritjen e rrjetëve dhe koridoreve të rrëzja infrastrukture dhe mirëfunksionalitetit të tyre.	2	2	3	1	0	0	0	2	3	3	0	2	1.50
Turizmi													
Zhvillimi dhe rritja e turizmit Natyror dhe Kulturor, bazuar në potencialet e shumta që zotëron territori.	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3.00

Në përgjithësi, në këndvështrimin e përputhshmërisë me objektivat mjedisore, objektivat dhe politikat e Planit, janë si më poshtë:

- ✓ objektivat përputhen plotësisht (4 objektive)
- ✓ objektivat përputhen pjesërisht (8 objektiva)
- ✓ lidhja mes objektivave është e zbehte (2 objektiva)

Në këndvështrimin e lidhjes mes objektivave të Planit dhe objektivave mjedisore, vërehet një diversifikim i përputhshmërisë sipas fushave përkatëse mjedisore. Konkretisht:

- Secila prej objektivave të Planit (përveç 1 objektive të sistemit të Infrastrukturrës dhe objektivave të sistemit Bujqësor) është në përputhshmëri të plotë me të paktën 3 objektiva mjedisore;
- Shtatë objektiva të planit kanë një lidhje të pjesshme me të paktën një objektive mjedisore;
- Shtatë objektiva të planit kanë një lidhje të zbehte me të paktën 1 objektiv mjedisor;
- Dy objektiva të planit që lidhen me sistemin urban dhe turizmin janë në përputhshmëri të plotë me të gjitha objektivat mjedisore;
- Secila prej objektivave të planit (përveç dy objektive që lidhet me sistemin urban dhe turizmin) nuk kanë lidhje me të paktën 1 objektiv mjedisor;

Edhe në këndvështrimin e lidhjes mes objektivave të Planit dhe objektivave mjedisore diversifikimi i përputhshmërisë është i lartë. Sidoqoftë objektiva mjedisore OM 10:Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme, është objektivat me nivelin më të lartë të përputhshmërisë me objektivat mjedisore.

Plani ka përcaktuar gjithashtu gjashtë objektiva strategjike si më poshtë:

	PROGRAMET	PROJEKTET
OBJEKTIVA STRATEGJIKE 1: PAJISJA ME SHËRBIMET BAZË	1.1 Përmirësimi i rrjeteve teknike	Përmirësimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale
		Mirëmbajtja dhe zhvillimi i rrjetit të furnizimit me ujë
		Përmirësimi dhe zhvillimi i sistemit të kanalizimeve
		Sistemi i pastrimit të ujërave të zeza me gropa septike në zonat periferike
	1.2 Ruajtja e peizazhit dhe siguria e territorit	Sistemi për mbledhjen e mbetjeve të ngurta urbane
		Pastrimit të rrugëve të qytetit
	1.3 Shërbimet publike	Realizimi i veprave për mbrojtjen e qendrave të banuara nga përmbytjet dhe erozioni
		Shërbimet bazë (kopshte, shkolla fillore, qendrat shëndetësore bazë, kujdesi për të moshuarit)
		Shërbimi i autobusëve shkollor
		Përmirësimi i shërbimeve administrative të ofruara
OBJEKTIVA STRATEGJIKE 2: LËVIZJA ME MËNYRA TË NDRYSHME	2.1 Rrugët automobilistike	Qyteti mik i fëmijëve
		Përmirësimi i rrugës Shkodër-Pukë-Kukës
		Përmirësimi i rrugës përgjatë rrëzës së maleve
		Përmirësimi i rrugës Vau-Dejës-Bushat-Velipojë
		Përmirësimi i rrugës Vau-Dejës-Koman (Projekt Pilot)
		Përmirësimi i rrugës Vau-Dejës-Vig
		Përmirësimi i rrugës Koman-Uk-Bibaj
	2.2 Korridori lumor	Realizimi i rrugës Hajmel-Nënshatë
		Realizimi i linjës së transportit ujor Vau-Dejës-Koman (Projekt Pilot)
		Realizimi i shtigjeve dhe rrugëve për lidhjen e stacioneve të tragetit me fshatrat malorë
	2.3 Ndërhyrje të tjera për lëvizjen	Kalimi i lumit me zgjidhje të ndryshme në pjesët e territorit të ndara nga lumi
		Stacion shkëmbimi intermodal në Vau-Dejës dhe Mjedë
		Përmirësimi i dy stacioneve hekurudhore në Vau-Dejës dhe Hajmel
OBJEKTIVA STRATEGJIKE 3: QENDRAT URBANE	3.1 Pole shërbimesh për territorin përreth	Sistemi i transportit publik Vau-Dejës, Bushat, Barbullush, Hajmel
		Realizimi i pistave të biçikletave
	3.2 Zhvillimi i qendrave lokale	Pol për shërbime turistike, ekonomike, kulturore, shoqërore shëndetësore dhe teknike (Vau-Dejës/Mjedë)
		Pol për shërbime të ndihmës teknike, logjistike dhe organizative për bujqësinë (Bushat/Rranxë) (Projekt Pilot)
		Zhvillimi i qendrës urbane Vau-Dejës (Projekt Pilot)
		Zhvillimi i qendrës urbane Mjedë
		Zhvillimi i qendrës urbane Bushat (Projekt Pilot)
		Zhvillimi i qendrës urbane Rranxa
		Zhvillimi i qendrës urbane Barbullush
		Zhvillimi i qendrës urbane Koman
		Zhvillimi i qendrës urbane Hajmel
		Zhvillimi i qendrës urbane Nënshatë
		Zhvillimi i qendrës urbane Stajkë
		Zhvillimi i qendrës urbane Kosmaç

		Zhvillimi i qendrës urbane Vig
		Zhvillimi i qendrës urbane Benë
	3.3 Rikualifikimi urban	Rikualifikimi i qendrës urbane Vau-Dejës (Projekt Pilot)
OBJEKTIVA STRATEGJIKE 4: TURIZMI	4.1 Turizmi mjedisor	Park lumor rajonal: krijimi i një korridori të mbrojtur mjedisor mes zonave të mbrojtura të Alpeve dhe Bunës/Velipojës për realizimin e një itinerari turistik
		Zhvillimi i eksursionizmit dhe sporteve ujore përgjatë lumit Drin
		Zhvillimi i plazheve dhe rekreacionit pranë stacioneve të tragetit përgjatë lumit Drin
		Realizimi i një korridori të gjelbër Vau-Dejës-Vig, përgjatë lumit Gjadër përfshirë promovimin e kalasë së Vigut
		Zhvillimi dhe promovimi i vlerave turistike të Fushës së Liqethit
	4.2 Turizmi kulturor	Realizimi i një itinerari për turizmin kulturor Sapë-Danjë-Sardë-Koman (Projekt Pilot)
		Promovimi i vlerave arkeologjike të Komanit
		Realizimi i një itinerari për turizmin energjetik
		Projekt për rehabilitimin dhe ruajtjen e ndërtesave tradicionale (kullat) dhe ansambleve urbane (Fshati i Ri)
		Projekt ndriçimi skenografik i kalasë së Sardës dhe digave të Vau-Dejës dhe Komanit
	4.3 Ndërhyrje të tjera për zhvillimin e turizmit	Krijimi i një tregu artizanal dhe etnografik për rajonin e Zadrimës, në Vau-Dejës
		Realizim qendrash për agro-turizëm dhe turizëm eno-gastronomik
		Projekt për pyllëzim mjedisor të kodrës së Zefjanës
		Projekt për certifikimin dhe brandimin e prodhimeve lokale me markën e zonës (p.sh. 'Zadrima')
		Projekt për koordinimin ndërkufitar me bashkinë Tropojë për zhvillimin e integruar të turizmit
OBJEKTIVA STRATEGJIKE 5: BUJQËSIA, BLEGTORIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT	5.1 Strukturat e shërbimit	Realizimi i tre qendrave agro-ushqimore për grumbullimin dhe evadimin e prodhimit në Bushat, Hajmel dhe Mjedë (Projekt Pilot)
		Treg prodhimesh bujqësore dhe blegtorale me km zero në Stajkë
		Përmirësim dhe zhvillim i rrjetit të kanaleve ujitëse dhe kulluese në zonat fushore si dhe masat kundër erozionit dhe përmbytjeve në zonat malore
		Organizim i degës së prodhimit bujqësor dhe blegtoral pranë bashkisë
		Nxitja e shoqërizimit të punës për rritjen e prodhimit bujqësor
	5.2 Rritja e prodhimtarisë	Qendër përpunimi, standardizimi, magazinimi për gështenjën, lajthinë e butë, kumbullën dhe eterovajoret në Shllak dhe Temal
		Zhvillimi i kultivimit të orizit në fshatrat Barbullush, Kukël dhe Dheu i Lehtë
		Zhvillimi i komplekseve blegtorale në Bushat, Vau-Dejës dhe Shllak
		Zhvillimi i peshkimit dhe rezervateve në liqenin e Vau-Dejës
		Zhvillimi i serave të perimeve në Kosmaç dhe në fshatra të tjera të bashkisë
		Zhvillimi i baxhove në Hajmel, Vig-Mnelë dhe Shllak
		Zhvillimi i vreshtave në Hajmel, Bushat, Vau-Dejës e Vig-Mnelë
		Asistencë teknike e veçantë Part-Time me specialistë të profilizuar për dy asete me rëndësi të bashkisë: a) Kultivimi i perimeve në sera; b) Kultivimi i vreshtave dhe teknologjia e përpunimit të rrushit

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 6: ENERGJIA		Zbatimi i projektit për mbjelljen e 150 ha shgegë në 6-të fshatra me nga 25 ha në bllok (Projekt Pilot)
		Park bletësh në Shllak e Temal
	6.1 Zhvillimi i prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme	Zhvillimi i impianteve për prodhimin e energjisë fotovolatike
		Zhvillimi i impianteve për prodhimin e energjisë së biomasës
	6.2 Diferencimi i prodhimit të energjisë	Modernizim i landfillit të Bushatit nëpërmjet ndërhyrjeve për ripërdorimin, riciklimin, prodhimin e biogazit dhe pyllëzimin e kurorës
		Program për nxitjen e realizimit të impianteve për vetëkonsum energjetik

SEKSIONI 8: VLERËSIMI I OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Vau-Dejës përcakton programe specifike për çdo politike apo objektiv strategjike, të cilat ndahen më tej në projekte specifike. Projektet strategjike mund të jenë të llojeve të ndryshme. Edhe pse të gjitha kanë si synim zhvillimin e përgjithshëm të territorit, ato mund të kontribuojnë në mënyra të ndryshme në arritjen e objektivave strategjike. Plani i ka ndarë projektet në:

- 1- Projekte Bazë - projekte që janë të nevojshme për të siguruar kushtet nga ku mund të nisin proceset e zhvillimit.
- 2- Projekte Zhvillimi - janë të paktë në sasi por mjaft të rëndësishme dhe të aftë për të nxitur proceset spontane dhe vetë-financuese të zhvillimit.

Në Tabelën 8-1 janë identifikuar programet strategjike që pritet të shkaktjnë ndikime direkte në mjedis, në lidhje me objektivat mjedisore të përcaktuara. Shkurtimeisht, këto programe përfshijnë zhvillimin e rrjetit infrastrukturor, projekte urbane, projekte prodhimi, zhvillimin dhe promovimin e zonave natyrore e kështu me radhë

Ky seksion përfshin Vlerësimin e projekteve specifike në lidhje me përputhshmërinë e tyre me objektivat mjedisore. Vlerësimi i projekteve strategjike është bërë mbi bazën e përcaktimit të klasifikimit mesatar të përputhshmërisë së secilit projekt me të 12 objektivat mjedisore. Vlerësimi i përputhshmërisë së projekteve me objektivat mjedisore është kryer duke ndjekur shkallëzimin e mëposhtëm:

Shpjegimi	Shkalla e Vlerësimit
Projekti përputhet plotësisht me objektivat mjedisore	> 75 %
Projekti përputhet pjesërisht me objektivat mjedisore	51 – 75 %
Lidhja mes projektit dhe objektivave mjedisore është jo e qartë; përputhshmëria e projektit me objektivat mjedisore është e kushtëzuar	26 – 50 %
Projekti nuk përputhet me objektivat mjedisore	0 – 25 %

Krahasimi i programeve strategjike me objektivat mjedisore është paraqitur në Tabelën 8.3.

Vlerësimi i paraqitur në Tabelën 9.1 është një derivat i Vlerësimit të bërë dhe paraqitur në Tabelën 8.3 më poshtë. Kjo e fundit paraqet Vlerësimin e impakteve që vijnë prej zbatimit të Planit ndaj arritjes së objektivave mjedisore për çdo projekt specifik. Tabela 9.1 tregon gjithashtu së gjatë zbatimit të projekteve specifike të programeve strategjike mund të shkaktohen impakte të pranueshme nga këndvështrimi i objektivave mjedisore (shkalla A, B apo C) ndërkohë që nuk janë evidentuar impakte të rëndësishme (shkalla D, E).

Ka një lidhje ndërmjet shkallës së Vlerësimit (A, B dhe C) në Tabelën 9.1 dhe shkallës së Vlerësimit (PL, PP dhe PK) në Tabelën 8.3.

Lidhja mes dy tabelave është si me poshtë:

Tabela 8.1 Lidhja midis shkallëve të vlerësimit

Tabela 9.1	Tabela 8.3
Shkalla A	Përputhshmëri e Lartë (PL)
Shkalla B	Përputhshmëri e Pjesëshe (PP)
Shkalla C	Përputhshmëri e Kushtëzuar (PK)

Numri absolut i shkalleve respektive për çdo program, domethënë numri i A-vë, B-vë dhe C-vë në Tabelën 9.1 është konvertuar në pikë përqindjeje tek shkalla e Vlerësimit (PL%, PP% dhe PK%) në Tabelën 8.3.

Për shembull: *programi 2.1 Rrugët automobilistike në Tabelën 9.1 është vlerësuar me shtatë A (s'ka impakt/impakt pozitiv për 7 objektiva mjedisore nga 12 gjithsej, ose 58.33% e totalit), tre B (ndikim i parëndësishëm për 3 objektiva ose 25.00% e totalit) dhe dy C (ndikimi behet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse, për 2 objektiva 16.67% e totalit). Kështu që, në Tabelën 8.4, programi 2.1 vlerësohet të jetë 58.33% në Përputhshmëri të Larte, 25.00% në Përputhshmëri të Pjesëme dhe 16.67% në Përputhshmëri të Kushtëzuar.*

Programet strategjike më poshtë do të përputhen plotësisht apo pjesërisht me objektivat mjedisore, gjatë zbatimit dhe funksionimit të aktiviteteve përkatëse. Për të gjitha aktivitetet duhet të garantohet zbatimi i masave zbutëse për të reduktuar ndikimin në mjedis, sipas kërkesave të legjislacionit përkatës.

Tabela 8.2 Programet Strategjike që pritet të shkaktojnë Ndikime në Mjedis

OBJEKTIVA STRATEGJIKE		Objektivat Mjedisore
		PROGRAMET
1	PAJISJA ME SHËRBIMET BAZË	1.1 Përmirësimi i rrjeteve teknike
		1.2 Ruajtja e peizazhit dhe siguria e territorit
		1.3 Shërbimet publike
2	LËVIZJA ME MËNYRA TË NDRYSHME	2.1 Rrugët automobilistike
		2.2 Korridori lumor
		2.3 Ndërhyrje të tjera për lëvizjen
3	QENDRAT URBANE	3.1 Pole shërbimesh për territorin përreth
		3.2 Zhvillimi i qendrave lokale
		3.3 Rikualifikimi urban
4	TURIZMI	4.1 Turizmi mjedisor
		4.2 Turizmi kulturor
		4.3 Ndërhyrje të tjera për zhvillimin e turizmit
5	BUJQËSIA, BLEGTORIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT	5.1 Strukturat e shërbimit
		5.2 Rritja e prodhimtarisë
6	ENERGJIA	6.1 Zhvillimi i prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme
		6.2 Diferencimi i prodhimit të energjisë

Tabela 8.3 Krahاسimi i programeve specifike në kuadrin e përputhshmërisë së tyre me objektivat mjedisore; përqindjet e ndikimeve të vlerësuara

OBJEKTIVA STRATEGJIKE		PROGRAMET	Shkalla e Vlerësimit*		
			PL%	PP%	PK%
1	PAJISJA ME SHËRBIMET BAZË	1.1 Përmirësimi i rrjeteve teknike	58.33%	41.67%	0.00%
		1.2 Ruajtja e pelzazhit dhe siguria e territorit	100.00%	0.00%	0.00%
		1.3 Shërbimet publike	50.00%	41.67%	8.33%
2	LËVIZJA ME MËNYRA TË NDRYSHME	2.1 Rrugët automobilistike	58.33%	25.00%	16.67%
		2.2 Korridori lumor	100.00%	0.00%	0.00%
		2.3 Ndërrhyrje të tjera për lëvizjen	75.00%	25.00%	0.00%
3	QENDRAT URBANE	3.1 Pole shërbimesh për territorin përreth	58.33%	41.67%	0.00%
		3.2 Zhvillimi i qendrave lokale	25.00%	25.00%	50.00%
		3.3 Rikualifikimi urban	25.00%	25.00%	50.00%
4	TURIZMI	4.1 Turizmi mjedisor	100.00%	0.00%	0.00%
		4.2 Turizmi kulturor	100.00%	0.00%	0.00%
		4.3 Ndërrhyrje të tjera për zhvillimin e turizmit	41.67%	58.33%	0.00%
5	BUJQËSIA, BLEGTORIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT	5.1 Strukturat e shërbimit	25.00%	75.00%	0.00%
		5.2 Rritja e prodhimtarisë	75.00%	25.00%	0.00%
6	ENERGJIA	6.1 Zhvillimi i prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme	66.67%	33.33%	0.00%
		6.2 Diferenciali i prodhimit të energjisë	91.67%	8.33%	0.00%

Legjenda:

PL% – Përqindja e Përputhshmërisë së Lartë;

PP% – Përqindja e Përputhshmërisë së Pjesëshe;

PK% – Përqindja e Përputhshmërisë së Kushtëzuar.

Si konkluzion i përgjithshëm, bazuar edhe në analizën që u është bërë programeve në



Përputhshmeri e larte



Përputhshmeri e pjeseshme



Përputhshmeri e kushtezuar



Papërputhshmeri

tabelën Tabela 8.4) mund të thuhet se objektivat strategjike të planit janë në përputhshmëri me objektivat mjedisore.

Krahasimi i objektivave strategjike paraqitet si më poshtë:

- Pothuajse të gjithë programet që bëjnë pjesë në objektiven strategjike Nr. 1 dhe 2: Përmirësimi i rrjeteve teknike, ruajtja e peizazhit dhe siguria, korridoret lumore apo programet që përmbajnë projekte me ndikim të ulët në mjedis, janë në përputhshmëri me objektivat mjedisore.
- Të gjithë programet që i përkasin objektivës strategjike Nr. 3: Qendrat Urbane, kanë një impakt negativ në mjedis kryesisht gjatë fazës së ndërtimit. Këto impakte zbehen dhe pjesërisht zhduken nën zbatimin e masave zbutëse.
- Programet që bëjnë pjesë në Objektiven Strategjike Nr. 4: Turizmi – dhe kryesisht programet që kanë të bëjnë me turizmin mjedisor dhe kulturor kanë një impakt të ulët në mjedis dhe përputhshmëria me objektivat është e lartë.
- Programet që bëjnë pjesë në Objektivat Strategjike Nr. 5 dhe 6, përgjithësisht janë të përputhshme me objektivat mjedisore, pasi projektet këto programe përfshijnë kanë impakt të ulët në mjedis ose kanë ndikim pozitiv pasi kanë të bëjnë me pyllëzim apo ulje të çlirimit të gazeve të dëmshme në ambient dhe përdorimi i tyre për prodhim energjie.

8.1 VLERËSIMI I PROJEKTEVE PILOT

Në kuadër të projekteve të zhvillimit, është e domosdoshme të identifikohen ata që kanë për detyrë të shfaqin, me fakte, potencialet e zhvillimit të identifikuar për territorin përkatës ("projektet pilot"). Këto ndërhyrje, janë të lidhura ngushtë me strategjinë e zhvillimit të identifikuar për zonën në studim, por janë të një përmase më të vogël, edhe pse me domethënie dhe ndikim të fortë komunikues. Karakteristika kryesore e këtyre projekteve është, që të realizohen shpejt dhe me pak fonde: bëhet fjalë kryesisht për projekte demonstruese, për të cilat nuk është e nevojshme që të ketë shpenzime të mëdha kapitale, ndërkohë që është e rëndësishme të jenë në gjendje të nisin menjëherë, dhe të jenë në gjendje të tregojnë, sa më shpejt, në kohë të shkurtër, frytet e veprimeve të zhvillimit të identifikuar në planin e propozuar.

Strategjia lokale duhet të mbështetet në disa projekte të cilat duhet të jenë të realizueshme në një kohë të shkurtër, me qëllim që të tregojnë aftësinë vepruese të zgjedhjeve të bëra, nëpërmjet disa ndërhyrjeve të cilat do të shërbejnë edhe si shembuj për projektet e ardhshme (projekte pilot).

Nëntë projektet pilot të përcaktuar për Bashkinë Vau-Dejës janë si më poshtë:

- Përmirësimi i rrugës Vau Dejës-Koman;
- Realizimi i linjës së transportit ujor Vau-Dejës – Koman;
- Pol për shërbime të ndihmës teknike, logjistike dhe organizative për bujqësinë (Bushat/Rranxë);
- Zhvillimi i qendrës urbane Vau-Dejës;
- Zhvillimi i qendrës urbane Bushat;
- Rikualifikim i qendrës urbane Vau-Dejës
- Realizim i një itinerari për turizmin kulturor Sapë – Danjë – Sardë – Koman;
- Realizimi i tri qendrave agro-ushqimore për grumbullimin dhe evadimin e prodhimit në Bushat, Hajmel dhe Mjedë;

- Zbatimi i projektit për mbjelljen e 150 ha shegë në zona kodrinore, në 6-të fshatra me nga 25 ha në bllok.

1- Përmirësimi i rrugës Vau-Dejës-Koman

Përshkrimi i projektit

Projekti parashikon përmirësimin e lëvizjes së makinave të rrugës së brendshme që lidh Vau-Dejën me Komanin, nëpërmjet sistemimit të veprave të artit shtesë dhe shtresës sipërfaqësore të rrugës. Do të kryhen punime për përmirësimin dhe zgjerimin e karrexhatës, modernizimin, zëvendësimin dhe/ose realizimin e veprave të artit shtesë (ura, mure mbajtëse, kanale drenazhimi etj.) si dhe zëvendësimi i plotë i shtresës së asfaltit.

Rezultatet e pritshme

Reduktimi i kohës mesatare të udhëtimit në aksin e konsideruar, reduktimi i aksidenteve rrugore dhe i rrezikut, reduktimi i trafikut në rrugët alternative, shtimi i emetimeve të ndotura në tokat bujqësore në të cilat kalon rruga për të cilat duhen marrë masa zbutëse (kanale mbledhëse dhe trajtimi i ujërave të shiut, barriera me pemë dhe bimë); rritja e zhurmave në territoret ku kalon rruga, të cilat duhet të kompensohen me barriera kundër zhurmave.

Reduktimi i kostove sociale të aksidenteve rrugore dhe të ndotjes; reduktimi i kohës dhe kostos së transportit privat.

2- Realizimi i linjës së transportit ujor nga Vau-dejës në Koman

Përshkrimi i projektit

Projekti parashikon vendosjen e një linje të re tragei për transportin e njerëzve dhe mallrave me nisje nga Vau-Dejës për në Koman, i cili plotëson natyrshëm linjën lumore e cila tashmë ekziston ndërmjet Komanit dhe Fierzës.

Projekti bazohet në ndërtimin e një moli për nisjen/mbërritjen e trageve në Vau-Dejës dhe Koman, si dhe ndërtimin e stacioneve të ankorimit përgjatë itinerarit lumor. Stacionet e ankorimit do të ndërtohen në pika strategjike dhe afër komuniteteve lokale bujqësore që ndodhen në afërsi të liqenit; ato do të kenë funksionin e pikave të reja të nisjes për turistët që synojnë të vizitojnë fshatrat bujqësorë dhe resurset natyrore në brendësi të territorit (mole ankorimi, shërbime dyqani dhe restoranti, plazhe për banjo dielli etj.).

Projekti ka për qëllim realizimin e infrastrukturave publike kryesore ndërkohë që funksionimin e linjës dhe shërbimet synon t'ia besojë operatorëve privatë.

Rezultatet e pritshme

Transporti lumor paraqitet si një mjet i vlefshëm alternativ, efikas dhe shumë ekologjik për transportin e mallrave dhe të personave, sidomos në zona pak të aksesueshme dhe shumë të ndjeshme nga pikëpamja ambientale. Rikuperimi dhe stabilizim i kushteve të jetesës dhe të aktiviteteve ekonomike të komuniteteve rurale.

Lidhja me banimet e brendshme dhe malore të arritshme me shtigje të reja;

Mundësi përfitimi, të ardhura dhe punësim për ekonomitë e mundshme të induktuara të strukturës (restorante, agro-turizëm, dyqane artizanale që mund të realizohen në stacionet kryesore, dhe me vëmendje të madhe në cilësinë e peizazhit dhe mjedisore të trajektorës së brendshme, në pikat e ndryshme të ndalimit, me rritjen e punësimit dhe nxitjen e prodhimit të të mirave materiale dhe shërbimeve.

3- Ndërhyrjet në favor të Bujqësisë

- a) Pol për shërbime të ndihmës teknike, logjistike dhe organizative për bujqësinë (Bushat/Rranxë).

Përshkrimi i projektit

Projekti parashikon realizimin e një poli të integruar për shërbimet e asistencës teknike për bujqësinë. Ndërhyrja bazohet (nga pikëpamja e veprave) në krijimin e godine të re për zyrat në të cilën do të duhet të kryhen aktivitetet e përkrahjes teknike dhe trajnimit profesional për punonjësit në aktivitetin bujqësor të zonës (që nuk janë përgjegjës për projektin). Qendra gjithashtu do të pajiset me një kabanon të vogël për pajisjet teknike.

Rezultatet e pritshme

Përmirësimi i kushteve të shërbimit dhe aksesit ndaj shërbimeve bazë nga popullsia lokale (shoqërore-sanitare, kulturore, ekonomia dhe shërbime administrative)

- b) Realizimi i tre qendrave agro-ushqimore për grumbullimin dhe evadimin e prodhimit në Bushat, Hajmel dhe Mjedë.

Përshkrimi i projektit

Projekti parashikon krijimin e tre qendrave të mbledhjes dhe klasifikimit të prodhimit bujqësor në zonën e Bushatit, Hajmelit dhe Mjedës, të dedikuara për mbledhjen e grurit dhe kulturave industriale, frutave dhe perimeve, produkteve të bulmetit etj. Qendrat do të jenë të specializuara sipas vendndodhjes së tyre. Ajo e Bushatit do të ketë në fokus prodhimet fushore dhe ato të serave, ajo e Hajmelit, prodhimet e vreshtave dhe ullishtave ndërsa qendra e Mjedës do të shërbejë për ndërlidhjen me transportin hekurudhor për shpërndarjen e prodhimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Tri qendrat e mbledhjes dhe klasifikimit duhet të jenë të lidhura me njëra tjetrën dhe me sistemin e shitjes së produkteve. Secila nga qendrat do të përbëhet nga një ambient për klasifikimin e mjeteve të transportit, disa kabanone për magazinimin e përkohshëm të produkteve, një zyrë për menaxhimin e flukseve.

Rezultatet e pritshme

Rritja e përfitimit bujqësor për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme në këtë sektor, përmirësimin dhe specializimin e prodhimit të ushqimit bujqësor.

4- Ndërhyrjet për Zhvillimin e Qendrave Urbane

- a) Zhvillimi i qendrës urbane Vau-Dejës.

Përshkrimi i projektit

Projekti parashikon përforcimin e qendrave urbane të Vau-Dejës, në përputhje me veprat që janë në fazë realizimi, në lidhje me krijimin e hapësirave të reja publike dhe objekteve kolektive dhe private (hapësira tregtare dhe shërbime private); qëllimi i këtij projekti është që të krijojë një aks të ri urban / shëtitore publike që në lidhje me objektivat kryesorë, të synojë lidhjen e zonave qendrore të qytetit me stacionin e ri të propozuar të transportit lumor drejt digës së Komanit, duke i dhënë zgjidhje disa zonave të afërta në degradim urban.

Projekti synon të kontribuojë në krijimin e një "efekti urban" në pjesën më qendrore të strukturës ekzistuese të banimit, nëpërmjet realizimit të hapësirave publike e pajisur me cilësitë e duhura për jetën sociale dhe për aktivitetet kulturore dhe rekreative. Gjatë hartimit të projektit duhet të merret parasysh prania e disa burimeve dhe kanaleve ujore në afërsi të qendrës së

qytetit të cilat mund të integrohen në forma të ndryshme në hapësirat e reja publike që do të realizohen (shatërvanë, ujëvara, kanale ujore, etj.)

Rezultatet e pritshme

Përmirësimi i kushteve të shërbimit dhe aksesit ndaj shërbimeve bazë nga popullsia lokale (shoqërore-sanitare, kulturore, ekonomia dhe shërbime administrative).

b) Zhvillimi i qendrës urbane Bushat.

Përshkrimi i projektit

Projekti parashikon ndërtimin e një qendre urbane lokale në fshatin Bushat, e kuptuar si një përqendrim i funksioneve të tipit kolektiv dhe të shërbimit për popullsinë vendase (shërbime administrative të decentralizuara, shërbime sanitare bazë, qendra kulturore, shërbime tregtare, hapësira për fëmijë).

Projekti synon të kontribuojë në krijimin e një "efekti urban" në pjesën më qendrore të strukturës ekzistuese të banimit, nëpërmjet realizimit të hapësirave publike e pajisur me cilësitë e duhura për jetën sociale dhe për aktivitetet kulturore dhe rekreative.

Ndërhyrja bazohet në sistemimin e organizuar të hapësirave publike, nëpërmjet realizimit të vendeve për shëtitje, për pushim dhe për jetën e përbashkët.

Rezultatet e pritshme

Përmirësimi i kushteve të jetës urbane, rritja e standardit të jetesës, cilësi më e lartë e hapësirave publike.

c) Rikualifikim i qendrës urbane Vau-Dejës.

Përshkrimi i projektit

Projekti parashikon një ndërhyrje për rikuperimin dhe përmirësimin e kushteve të banimit të lagjeve me shtëpi të përkohshme, që presin zgjidhje prej vitesh.

Ndërhyrja bazohet në rikuperimin dhe rikonstruksionin e ndërtesave ekzistuese për të sjellë në nivelet bashkëkohore standardin e banimit, por edhe për sistemimin urbanistik të zonës në të cilën ndodhen banesat (rrugët lokale, hapësirat publike, arredimi urban etj.)

Rezultatet e pritshme

Përmirësimi i kushteve të jetës urbane, rritja e standardit të jetesës, cilësi më e lartë e hapësirave publike.

5- Itinerari turistik kulturor Sapë - Vig - Danjë – Sardë – Koman

Përshkrimi i projektit

Projekti parashikon realizimin e një itinerari turistik kulturor mes destinacioneve kulturore Sapë-Danjë-Sardë-Koman, atraksione kryesore turistike arkeologjike dhe kulturore.

Secili destinacion ka nevojë për një përmirësim në rrugët e aksesit. I gjithë itinerari do të përbëhet nga rrugë për biçikleta, për këmbësorët dhe itinerare lumore. Në çdo destinacion, do të realizohen hapësira të vogla pushimi të pajisura me struktura në mbështetje të vizitës turistike. Është e dëshirueshme që projekti të ecë njëkohësisht me aktivitetet studimore dhe ruajtëse të vendeve të tilla të rëndësishme kulturore.

Rezultatet e pritshme

Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore vendase, zhvillimi i qëndrueshëm i ekonomisë vendase, kontrolli dhe mbrojtja e aktivitetit të zhvillimit turistik në zonë, mirëqenia dhe argëtimi i popullsisë vendase.

6- Mbjellja e 150 ha shegë

Përshkrimi i projektit

Projekti parashikon mbjelljen e 150 hektarë shegë në zonat kodrinore në gjashtë blloqe prej 25 hektarë për t'u realizuar në dy fshatra të njesisë Vig-Mnelë (Mnelë e Vogël dhe Vig) dhe katër fshatra të njesisë Hajmel (Hajmel, Nënshat, Paçram dhe Pistull).

Shega është një produkt që mund të kultivohet mirë në zonë, me kërkesë në rritje të produkteve të freskëta dhe atyre të përpunuara. Ky projekt është hartuar më parë nga DBU Shkodër në bashkëpunim me K.Q Shkodër në kuadër të planit strategjik të komunës Hajmel.

Projekti të mund të zbatohet në harkun kohor të 15 viteve duke realizuar 10 hektarë në vit.

Rezultatet e pritshme

Kualifikimi i peizazhit bujqësor lokal, në kontrast me degradimin dhe ekspozimin ndaj rrezikut hidrogeologjik të shpateve në kushtet e paqëndrueshmërisë aktuale ose të mundshme.

Zhvillimi dhe shumëllojshmëria e prodhimit të verës vendase, rritja e kushteve të punës, të ardhura dhe fitime; rritja dhe përmirësimi cilësor i prodhimeve të sektorit.

Ndikimet e projekteve në mjedis

Gjatë zbatimit të projekteve, priten të ndodhin impakte pozitive dhe negative. Impaktet pozitive priten për ajrin dhe ndryshimet klimatike si edhe për popullatat dhe asetet materiale. Vlerësimi i rezultateve tregon se nuk do të ketë impakte mbi faktorët klimatike duke konsideruar që mjetet e transportit do të vijojnë të rinovohen në të ardhmen edhe me tej, gjë që do të sjellë si pasojë përmirësim të cilësisë së ajrit dhe cilësisë së shëndetit human, midis të tjerave. Për më tej në pjesën pozitive të impakteve mbi popullatën dhe asetet materiale do të vijë si rezultat i zbatimit të infrastrukturës në përgjithësi që do të bejë të mundur pakësimin e kohës së udhëtimit, sigurinë në lëvizje, përafrimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane dhe shërbimet publike në përgjithësi.

Përgjithësisht, shumica e impakteve negative janë të lidhura me fazën e planifikimit (pozicionimi i infrastrukturës në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme), pasi Shqipëria ka veçori të theksuara diverse dhe të shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peizazhi që mund të ndikohen konsiderueshëm prej zhvillimeve të infrastrukturës, sidomos atyre me shtrirje të gjere dhe korridoreve sipas sektorëve (transport, energji, ujë, etj.). Impaktet negative shfaqen në fazën e planifikimit prej aspekteve të përdorimit të tokës, efekteve në ujë, natyrë (si biodiversiteti edhe zonat me status të mbrojtur), trashëgiminë kulturore dhe peizazhin. Këto impakte do të kërkojnë krijimin e një programi bashkëkohor mbi masat zbutëse dhe një zbatim të përshtatshëm të këtyre masave.

SEKSIONI 9 VLERËSIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE

9.1 Vlerësimi i pasojave nga zbatimi i Planit dhe ndikimet e pasojave të zbatimit të Planit për realizimin e objektivave mjedisore të Planit

9.1.1 Toka

Objektivi Mjedisor 1: Garantimi i menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të tokës dhe mbrojtja e saj

Ndikimi me i madh gjatë fazës së ndërtimit pritet në zhvillimet e infrastrukturës, sidomos asaj rrugore, të mbetjeve, të qendrave të shërbimeve, etj., ndërkohe që nga fusha të tjera do të jenë të kufizuara në një territor më të ngushtë lokal. Nuk priten ndikime në ato sektorë ose nën sektorë ku përqendrimi me i madh i aktiviteteve do të ketë të bëjë me plotësimin e boshllëqeve ligjore dhe të strukturës (aktivitete soft) ku gjithë detyrat dhe angazhimet do të jenë të natyrës institucionale dhe organizative.

Përmes okupimit të tokës, ndërtimet në infrastrukture prodhojnë ndikime të gjera të pakthyeshme, që reflektohen pas zhvillimit si një ndryshim në përdorimin e tokës. Toka bujqësore dhe pyjet do të pësonin shkatërrim të pakthyeshëm në seksionet e marra nga ndërtimet e reja ose ato të rindërtuara mbi seksionet e vjetra. Shpesh ndërtimet e reja krijojnë edhe fragmentime të tokës bujqësore. Ndikimet afatshkurtër (të riparueshme) që mund të ndodhin gjatë fazës së ndërtimit përfshijnë lidhjet përmes tokave bujqësore ose pyjore, dëmtimet dhe okupimet e tokave ose dëmtimin e produkteve për shkak të afërsisë me sheshet e ndërtimit, ndotjet e tokës etj.

Për shkak të zhvillimeve të reja në infrastrukture dhe pozicionimi i vendosjeve të tyre, përdorimi i tokës bujqësore ekzistuese pëson ndryshim nga ana e pozicionimit të lidhjeve të reja infrastrukturore. Masat që zbatohen mund të sjellin rënien e përhershme të potencialit dhe prodhimtarisë së tokës bujqësore që nënkupton humbjen e përhershme të funksionimit të tokës për prodhimtarinë bujqësore. Nëse masat e infrastrukturës shtrihen edhe përtej territoreve aktuale të zhvillimit, fragmentimi i tokës bujqësore do të rritet dhe kushtet për prodhimtarinë bujqësore do të përkeqësohen edhe më tej.

Veç parashikimeve të bëra në plan do të merren në konsideratë edhe parashikimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar.

Në territorin e bashkisë do të kalojë gjithashtu korridori i mëposhtme energjetike:

- IAP-KOSOVË. IAP degëzohet në rajonin Shkodër- Lezhë, për të furnizuar Kosovën nëpërmjet Kukësit duke realizuar Unazën Perëndimore të Ballkanit Western Ballkan Rings (WBR).

Objektivi Mjedisor 2: Parandalimi i shfrytëzimit të burimeve natyrore, duke rritur nivelin e përdorimit të materialeve të riciklueshme nga mbetjet që gjenerohen gjatë ndërtimit/rehabilitimit të infrastrukturës.

Aktivitetet ndërtimore në përgjithësi (rindërtime ose të reja) të infrastrukturës janë burim i prodhimit të sasive të mëdha të mbetjeve, dhe gjithashtu krijojnë presione mbi përdorimin e burimeve natyrore. Mbetjet gjenerohen jo vetëm përkohësisht gjatë fazës së ndërtimit, por edhe në mënyrë të vazhdueshme gjatë fazës operacionale si edhe për efekt të proceseve të mirëmbajtjes së strukturave. Impakti nga gjenerimi i mbetjeve është i përhershëm dhe në mjaft

raste i pakthyeshëm në lidhje me impaktin ndaj burimeve natyrore. Prandaj, ky impakt negativ ndaj mjedisit duhet të pakësohet me anë të masave për menaxhimin e mbetjeve.

Duke konsideruar mënyrën sesi gjenerohen dhe llojin e strukturës, sasitë e mbetjeve të gjeneruara nga zhvillimet në infrastrukturë prej çdo sektori ekonomik duhet të konsiderohen si sasi të mëdha, sidomos prej veprave të nivelit kombëtar ose rajonal, ndërkohe që sasitë e mbetjeve nga zhvillimet në nivel lokal priten të jenë më të lokalizuara dhe më të pakta krahasuar me dy nivelet e para.

Ndërtimet e reja ose zgjerimet e infrastrukturave sipas sektorëve, brenda kuadrit të zbatimit të masave specifike të angazhimeve për secilin nga drejtimit e veprimeve prioritare respektive të Planit, ofrojnë një mundësi ideale gjatë fazës së ndërtimit për ripërdorimin ose procesimin e materialeve dhe mbetjeve industriale të prodhuara, ku efekti i sinergjise reflektohet veçanërisht në faktet e mëposhtme:

- Sasira të mëdha mbetjesh mund të përdoren veçanërisht në ndërtimet e rrugëve dhe infrastrukturave të ngjashme ku materialet mbushëse janë mjaft të nevojshme;
- Substanca potenciale toksike të mbetjeve mund të mobilizohen në mënyrë permanente në rast se ato përdoren në mënyrën e duhur;
- -Kompozite të reja të ndërtimit shpesh kanë karakteristika më të mira funksionale në krahasim me ato konvencionale.

Në vijim të zbatimit të masave specifike që paraqiten në Plan, administrimi ekonomik i burimeve natyrore duhet të mbështetet nga masa të tjera të përgjithshme shtesë që promovojnë pakësimin e ndotjes së mjedisit duke përdorur materiale të riciklueshme në ndërtimin dhe rindërtimin e infrastrukturës së parashikuar për çdo sektor. Prandaj, masa të tilla duhet të përgatiten dhe të përfshihen që në fazat e hershme të programeve të zhvillimit në çdo sektor dhe për çdo masë specifike më vete.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që paraqiten në Seksionin 10 duhet të merren parasysh për të realizuar këtë objektiv.

9.1.2 Ajri

Objektivi Mjedisor 3: Garantimi i arritjes së objektivave afatgjata për sasitë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, për të arritur përputhshmërinë me kufijtë maksimale të lejueshëm nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferike.

Shkarkimet e ndotësve janë karakteristike gjatë fazës së ndërtimit të infrastrukturës dhe atë të operimit në një sërë aktivitetsesh nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë, por në lidhje direkte me Planin ndikimi kryesor vjen nga sektori i transportit.

Gjatë fazës së ndërtimit ose të rindërtimit të infrastrukturës, shkarkimi i ndotësve krijon impakt afat-shkurtër në mjedis, kështu që shumica e efekteve të tyre janë të kthyeshme.

Gjatë fazës së operimit të infrastrukturës, shumica e shkarkimeve janë të pranishme si në ajër edhe në ujë e toke, në varësi të proceseve të aktiviteteve që krijohen nga operimi i infrastrukturës përkatëse.

Zbatimi i masave specifike që synojnë arritjen e qëllimeve të Planit pritet të kenë një impakt pozitiv për shkak të pakësimit të shkarkimeve të ndotësve, së pari për shkak të masave të parashikuara lidhur me sistemet multimodale të transportit siç janë transporti transferues me kargo dhe pjesërisht në transportin e pasagjereve ujë - toke me mjetet rrugore dhe hekurudhore.

Masa të tjera nga sektorët që emetojnë shkarkime të ndotësve në ajër priten gjithashtu të kontribuojnë me efekte pozitive për shkak të pakësimit të ndotësve të shkarkuar, në veçanti të atyre që synojnë pakësimin e bllokimeve/ngjeshjes dhe përdorimin më të madh të sistemit publik të transportit si edhe kontrollit të shkarkimeve në ajër nga industritë dhe promovimit të mëtejshëm të energjive të gjelbra përmes investimeve të pritshme në hidrocentrale dhe gazin natyror.

Megjithatë, ekziston edhe rreziku që përmirësimi i mëtejshëm i rrjetit rrugor do të prodhojë të ashtuquajturin “kërkesë e detyruar” për shkak të pakësimit të ngjeshjes, i cili nga ana tjetër mund të rris sasinë e shkarkimeve të ndotësve, veçanërisht në zona ku nuk kishte ndotje para së të zbatoheshin masat e Planit. Gjithsesi, impaktet negative me përmirësimin e rrjetit rrugor mund të pakësohen dhe madje të parandalohen përmes marrjes njëkohësisht të masave të përgjithshme për promovimin e përdorimit të rrjetit publik të transportit të pasagjereve dhe biçikletave.

Sfidat kryesore dhe prioritetet të prezantuara në SKZHI II që pasqyrohen edhe në Plan janë: (1) kompletimi i adoptimit dhe zbatimit të standardeve Europiane mbi cilësinë e ajrit urban dhe shkarkimeve në ajër; (2) konsolidimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit sipas standardeve Europiane; dhe (3) adoptimi e zbatimi i planeve të veprimit mbi cilësinë e ajrit si në nivel Qendror dhe atë lokal.

Duke konsideruar që sektori i transportit prodhon sasira të konsiderueshme shkarkimesh të ndotësve të ajrit brenda sasisë së lejuar tavan të shkarkimeve në ajër të përcaktuara/synuara për Shqipërinë, mund të ishte me e përshtatshme të supozohej për vlera më të ulta të përcaktuara/synuara për shkarkimin total të ndotësve në Shqipëri në mënyrë që të pakësohen shkarkimet e ndotësve nga transporti.

Objektivi strategjik është “Arritja e përmirësimeve të matshme në 2020 për cilësinë e ajrit përmes”:

- Objektivit prej 40% pakësim në nivelin e ndotësve në zonat urbane;
- Arritja e niveleve objektiv të ndotësve të ajrit duke u bazuar në shëndetin human, sipas vlerave respektive: për NOX - 40 μm^3 , për PM10 - 40 μm^3 , për PM2.5 - 25 μm^3 dhe SO2 - 125 μm^3 .

Shpërndarja reciproke e ngarkesës për të arritur tavanet e shkarkimeve kombëtare vjetore për çdo sektor (energji, industri, tregti dhe shërbime, transport, bujqësi dhe menaxhim i mbetjeve) do të përcaktohet më në detaje përmes mendimeve prej Programit Operacional të përputhshmërisë më tavanet e shkarkimeve kombëtare. Gjithsesi, kërkesat për pakësimin e shkarkimeve nga transporti nuk priten të jenë me të ulta sesa pakësimi mesatar i përcaktuar për shkarkimin total të ndotësve në Shqipëri. Për këtë arsye, tavanet e shkarkimit për NOx dhe PM_{2.5} që janë ndotësit kryesorë prej transportit rrugor janë përcaktuar në bazë të pakësimit indikativ në shkarkimet ndotëse.

Rinovimi i mjeteve motorike kontribuon së tepërmi në pakësimin e shkarkuesve ndotës, si edhe zhvillimi i standardeve sipas tipave të aprovuar për mjetet siguron që shumica e shkarkimeve të ndotësve të synuara për transportin të arrihen. Masat për promovimin e transportit publik të pasagjereve dhe transportin hekurudhor kargo kontribuojnë gjithashtu në pakësimin e shkarkimit të ndotësve.

Plani nuk mund të adresojë specifikash promovimin e rinovimit të mjeteve, por me anë të të gjitha masave/veprimeve, veçanërisht atyre që promovojnë transportin publik të pasagjereve

dhe transferimin e transportit kargo nga rruga në hekurudhe, ka ndikim pozitiv në mjedis dhe kontribuon qenësisht në arritjen e synimeve për shkarkimet kombëtare.

Përsa i takon shkarkimeve të grimcave pezulli në ajër, ato do të pësojnë rritje të përkohshme në zonat ku do të zbatohen masat e rindërtimit të infrastrukturës sipas sektorëve (impakte të kthyeshme). Në përputhje me rregullat që rregullojnë masat për pakësimin e shkarkimeve të grimcave nga sheshet e ndërtimit, zbatimi i punimeve në ndërtim garanton që rritjet e përkohshme lokale të ndotësve të mjedisit në ajër të jenë ende të pranueshme për mjedisin dhe njerëzit.

Transporti është burimi kryesor ndotës i ajrit të mjedisit përmes grimcave pezull në ajër. Grimcat mund të japin një sere impaktesh negative mbi shëndetin: ato shkaktojnë dhe rendojnë astmat, krijojnë arterosklerozë, përkeqësojnë përvijimin e sëmundjeve të frymëmarrjes dhe kardiovaskulare, shkaktojnë kancer, etj. Raporti i mortalitetit në zonat ku ndotja me grimca pezull është i lartë, është 15 – 20 % më i lartë në krahasim me zonat me ajër relativisht të pastër.

Pritet që zbatimi i masave të Planit të ulin në mënyrë permanente shkarkimet e grimcave nga transporti rrugor, së pari për shkak të eliminimit të bllokimeve të trafikut, menaxhimit më të mirë të shtresave sipërfaqësore të rrugëve dhe përdorimit të më shumë mjeteve rrugore me efikasitet energjie.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që paraqiten në Seksionin 10 duhet të merren parasysh për të realizuar këtë objektiv.

9.1.3 Faktorët klimatike

Objektivi Mjedisor 4: Adoptimi i infrastrukturës në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve sere në nivelet e përcaktuara në SKZHI II.

Një sërë aktiviteteve ndërtimore të infrastrukturës dhe praktika sektoriale kanë impakt permanent (të kthyeshmë) mbi shkarkimet e gazeve sere (GHG), që përbejnë shkaku kryesor të ndryshimeve klimatike. për shkakun që karburantet fosile (nafta dhe derivatet) çlirojnë GHG në ajër gjatë përdorimit përfaqësojnë në këto momente burimin më të rëndësishëm të energjisë në sektorin e transportit e bëjnë sot këtë sektor të parin si burim shkarkimesh të gazeve sere në Shqipëri, pasi sektori i energjisë këtu është hidro. Impakti në ndryshimet klimatike është gjithashtu pasojë në kushtet e motit dhe klimës që po rriten çdo vit. Një tjetër pasojë e temperaturave të larta globale janë ndryshimet në modelimet e fenomeneve mesatare klimatike dhe ngjarjet më të shpeshta të kushteve ekstreme të motit (thatësira, përmytje, erozione, stuhi me breshër, vale të nxehta, temperatura të ulëta me ngrica, etj.).

Shqipëria ende nuk ka bërë transpozimin e këtij vendimi, që planifikohet të ndodhe në 2018. Kjo periudhë është brenda kohës së zbatimit të Planit, prandaj parashikimet e këtij vendimi në lidhje me faktorët klimatike duhet të adresohen në avangard. për më tepër, SKZHI II vendos synimin për shkarkimet e gazeve sere në 2020 si vijon:

- Një synim 8% reduktim të GHG siç krahasohet me skenarin bazë⁸ dhe
- Një synim 40% reduktim në sasinë e HCFC-s (hidroklorofluorokarbon).

⁸ Projektionet aktuale të shkarkimit të GHG në 2020 tregojnë 18,000 Gg COeq. Ky projektion do të rishikohet gjatë 2016 në kuadër të Komunikimit të Tretë Kombëtar për UNFCCC. Në rastin e financimit ndërkombëtar për NAM-an (masat e përshtatshme kombëtare për pakësimin e GHG) pakësimi i GHG mund të rritet me 16% krahasuar me skenarët bazë

Shkarkimet e gazeve sere nga sektorë të tille si transporti rrugor, bujqësia, energjia, etj. përfaqësojnë një rrezik të konsiderueshëm për masat zbutëse të ndryshimeve klimatike. Në vijim veç shkarkimeve të përkohshme të gazeve sere gjatë fazës së ndërtimit të veprave infrastrukturore të parashikuara në Plan, shkarkimet e gazeve sere priten të rriten edhe pse do të merren masa për të eliminuar mjaft pengesa. Zbatimi i masave specifike duhet të garantojnë përdorim më të madh të transportit publik, metodave të reja bujqësore të kultivimit dhe vaditjes, energjisë së rinovueshme, etj. Promovimi i këtyre masave dhe përdorimi i mjeteve të reja të energjisë eficiente do të kontribuojë në parandalimin e shkarkimeve nga sektorët kontribues në GHG në fazën afat-mesme dhe ndoshta një rënie pas 2020.

Transporti ngelet sektori kyç në arritjen e objektivave mbi masat për ndryshimet klimatike i vijuar nga sektori bujqësor dhe përdorimi i tokës.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që paraqiten në Seksionin 10 duhet të merren parasysh për të realizuar këtë objektiv.

9.1.4 Uji

Objektivi Mjedisor 5: Kufizimi i efekteve negative mbi ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ujërat e njelmët, dhe burimet e ujit të pijshëm.

Impaktet me të mëdha për arritjen e këtij objekti mjedisor pritet nga zhvillimet e sektorëve kyç të lidhur me ujin si edhe ato që mund të ndikojnë në cilësinë dhe funksionimin natyror të baseneve ujore. (ujësjellës/kanalizimet, vaditja dhe bujqësia e blegtoria në përgjithësi, industria ushqimore dhe përpunuese, shërbimet dhe turizmi, shëndetësia, etj.).

Impaktet mbi ujërat sipërfaqësore, nëntokësore, ujërat e njelmët dhe burimet e ujit të pijshëm janë karakteristike të periudhës së ndërtimeve ose rindërtimeve të infrastrukturës dhe gjithashtu në vijim të operimit të strukturave edhe me tepër. Kjo në varësi respektive të sektorëve përkatës në lidhje me nevojën për përdorimin e ujit ose ndërveprimet me burimet dhe trupat natyrore ujore. Në shumicën e rasteve këto impakte krijohen si të limituara në mjedisin lokal, megjithatë në mjaft raste ndodh efekti kumulativ i impaktit dhe krijohen ngarkesa ndotjeje të mëdha ndotëse që ngrihen në nivel rajonal dhe disa here edhe ndërkuftar përtej kufijve. Impaktet ndërtimore të infrastrukturës ngelen në përgjithësi afat- shkurtër dhe të rikthyeshme (rasti p.sh. i cilësisë së ujërave). Pas fazës ndërtimore, impaktet janë kryesisht më pak të përhapura, por të pakthyeshme permanente (rasti p.sh. i impaktit të morfologjisë së vijës ujore natyrore, kushteve hidrologjike, ruajtja e zonave). Impaktet e mësipërme mund të prodhojnë ndryshime në elementet cilësore për krijimin e statusit ekologjik të ujërave sipërfaqësore, që janë elementet biologjik, hidromorfologjik, mbështetës, kimik dhe fiziko-kimik dhe në statusin kimik të ujërave. Nëse udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse vëzhgohen, ndryshimet në elementet cilësore nuk do të kapërcejnë së tepërmi që të kërcënojnë arritjen e objektivave mjedisore.

Veprimet e sektorëve që ndikojnë në ujërat dhe objektivat mjedisore mbi ujërat përmbledhen si me poshtë:

- Pozicionimi i veprave infrastrukturore mund të ndikojë në mënyrë permanente të drejtpërdrejtë ose indirekt situatën hidrologjike në një zone të caktuar duke sjelle edhe situatë eko-morfologjike mbi rrjedhën e ujit;
- Rrjedhja e vazhdueshme e substancave të rrezikshme që rezultojnë nga burime të ndryshme ndotëse

- Derdhja e substancave të rrezikshme për shkak të ngjarjeve të jashtëzakonshme (impakt potencial direkt, në distance të largët deri ndërkufitar mbi cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësor, impakt potencial mbi ujërat balneare);
- Rrezik i lartë ekzistent nga përmbytjet (aplikimi i zgjidhjeve ndërtimore me këtë kriter si rrezik i lartë) në zonat që përmyten ose masa rregulluese në rrjedhën e ujërave; ndryshime në situatën hidrologjike në një zone të caktuar, përfshire pakësimin në zonat mbajtëse (direkt ose në distance);
- Pozicionimi i strukturave infrastrukturore në zonat akuiferike me ndjeshmëri të lartë ose shumë të lartë mund të kenë impakt negative mbi burimet ujore ekzistuese dhe potenciale (direkt, indirekt, ndërkufitar);
- Pozicionimi në zonat e ujërave të mbrojtur të burimeve ujore (ndikim lokal, potencialisht rajonal dhe ndërkufitar).

Shqipëria ka aprovuar Ligjin Nr. 111/2012 “Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore” dhe “Strategjinë Kombëtare Sektoriale për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet 2014-2040”, “Strategjinë Ndërsektoriale për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025” dhe “Planin Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2025”. Midis të tjerave, këto dokumente përcaktojnë që aktivitete në ujë dhe tokat anash ujërave mund të kryhen vetëm nëse ato janë bazuar mbi planet e zhvillimit hapësinor dhe nuk mund të pozicionohen diku tjetër pa gjeneruar kosto të larta disproporcionale. Pozicionimi i këtyre aktiviteteve mund të ndikojnë thellësisht mbi statusin ekologjik të rrjedhave ujore dhe të pakësojnë zonat e mbajtjes dhe impaktet kumulative mbi biodiversitetin e zonës dhe shërbimet e ekosistemeve të zonës.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që paraqiten në Seksionin 10 duhet të merren parasysh për të realizuar këtë objektiv.

9.1.5 Natyra

Objekti Mjedisor 6: Garantimi i kohezionit të popullatave dhe mbrojtjes së biodiversitetit.

Impaktet që kanë të bëjnë me fragmentimin e habitateve dhe biodiversitetin janë karakteristike gjatë fazës së ndërtimit ose rindërtimit të infrastrukturës dhe me tej. Ato vërehen më tepër në mjedisin lokal, ndërsa në rastin e projekteve me shtrirje të gjerë impaktet ndihen edhe në nivelin rajonal dhe përgjatë kufijve (p.sh. rrugët e migrimit të shpendëve, vijat ujore të kalimit ndërkufitar etj.). Gjatë ndërtimit ose rindërtimit të infrastrukturës, impaktet janë kryesisht afat-shkurtër dhe të kthyeshe (p.sh. ndotje nga zhurmat e sheshit të ndërtimit, kafshët largohen prej makinerive të ndërtimit, etj.). Pas ndërtimit, impaktet janë kryesisht permanente dhe të pakthyeshe për shkak të ndryshimeve në përdorimin e tokës (p.sh. ndërprerja e rrugëve të migrimit, rritja e zhurmës nga strukturat e zhvilluara në vend, pengesa në mjedis – linja elektrike, etj.).

Ndërtimi i strukturave të reja dhe rindërtimi ose modernizimi i infrastrukturës ekzistuese mund të rezultojë në:

- Humbje të zonave të habitatit dhe llojeve të habitatit dhe përfaqësuesve individuale të llojeve të bimëve dhe kafshëve (impakt direkt, i përhershëm);
- Impakt direkt, permanent mbi funksionimin e disa habitateve për shkak të fragmentimit të habitatit;
- Në rastin e aktiviteteve me shtrirje të gjere në një habitat më të rrezikuar, një impakt direkt është i mundshëm mbi biodiversitetin e zonës me të ngushte ose të gjere (impakt permanent);

- Kalimet e reja shpesh fragmentojnë habitatët e kafshëve të egra dhe ndërpresin rrugët migratore dhe rrugicat e fluturimit ose pengojnë migrimin e disa grupeve të kafshëve (veçanërisht të gjitarëve dhe amfibeve, nëse një rrugë kryqëzohet me një korridor migrimi ose fluturimi, konflikte me shpendët dhe lakuriqet e natës janë gjithashtu të mundshme), të cilat mund të pengojnë në mënyrë permanente migrimin e kafshëve individuale midis popullatave individuale dhe të shkaktojnë një rënie të biodiversitetit në disa zona (impakt direkt, kumulativ, i largët);
- Shumica e problemeve të migrimit ndodhin në fazat e ndërtimit të infrastrukturave të mëdha ku nuk ka përkujdesje për rindërtimin e kalimeve dhe komunikimeve të shkëputura të habitatëve (p.sh. ndërtimi i urave të gjelbra). Kjo duhet të merret parasysh kur projektohet dhe ndërtohet (impakt direkt, në distance);
- Zhurma ka impakt negative veçanërisht për shpendët dhe gjitarët dhe nuk është i pranishëm vetëm në distancën me të afërt të aktivitetit, por përhapet mjaft me gjere (impakt në distance);

SKZHI II prezanton sfidat kryesore lidhur me mbrojtjen e mjedisit, të cilat janë: (1) nevoja për të krijuar rrjetin ekologjik Natura 2000 për Shqipërinë dhe Komunitetin Evropian; (2) ristrukturimin dhe forcimin organizativ të strukturave menaxhuese të zonave të mbrojtura; dhe (3) nevoja për të garantuar zbatim me efektiv të planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura dhe planet e veprimt për llojet dhe habitatet.

Gjatë fazës së projektimit dhe sidomos përpara nisjes së fazës së zbatimit të aktiviteteve specifike individuale të Planit duhet të përfshihen masa që do të lehtësojnë ruajtjen e korridoreve migratore të kafshëve dhe në këtë mënyrë të arrihet objektivi i SKZHI II "Përmirësimi dhe forcimi i mbrojtjes së natyrës".

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që paraqiten në Seksionin 10 duhet të merren parasysh për të realizuar këtë objektivi.

Objektivi Mjedisor 7: Ruajtja e zonave që kanë një status të veçantë mbrojtjeje, prej aktiviteteve me ndikime të konsiderueshme.

Vëmendje e veçantë duhet të kushtohet nëse strukturat e infrastrukturës pozicionohen në zonat e mbrojtura ku mund të ndodhin humbje permanente të sipërfaqeve të kualifikuara, tipat kyç të habitateve, habitatet e llojeve, impakte mbi integritetin, funksionalitetin dhe kohezionin e zonave. Këtu janë të mundshme edhe impaktet permanente dhe direkte mbi cilësinë e veçorive të vlerave dhe të tipave të tyre për shkak të të cilave është bere deklarimi i veçorisë. Duke qene se një pjese e mire e territorit të Shqipërisë është deklaruar zone me një status natyror të mbrojtur, ka mjaft mundësi që ndërtimet e reja të kalojnë pranë ose hyjnë në territoret e këtyre zonave.

Impaktet në zonat me status natyror të mbrojtur janë të mundshme gjatë periudhës së ndërtimeve të reja ose rindërtimeve të sistemeve të infrastrukturës dhe në vijim. Ato janë me të dukshme në mjedisin lokal, ndërkohe që për aktivitete të zgjeruara, ato mund të ndjehen në nivel rajonal dhe përtej kufirit (p.sh. impakti mbi kohezionin dhe integritetin e rrjetit të Natura 2000). Gjatë periudhës së ndërtimeve të reja ose rindërtimeve të sistemeve të infrastrukturës, impaktet janë kryesisht afat-shkurtër dhe të kthyeshëm (p.sh. ndotje nga zhurma në kantierin e ndërtimit, turbullimi i vijave ujore). Pas ndërtimit, impaktet janë kryesisht permanente dhe të pakthyeshme për shkak të ndryshimeve në përdorimin e tokës (p.sh., rritje e ndotjes nga zhurmat prej transportit, pengesat në mjedis, shkatërrimi i habitateve të një lloji të kualifikuar, etj.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që paraqiten në Seksionin 10 duhet të merren parasysh për të realizuar këtë objektiv.

9.1.6 Mbetjet

Objektivi Mjedisor 8: Kompletimi tërësor i infrastrukturës së landfillëve dhe njëkohësisht reduktim i sasisë së depozitimit të mbetjeve në landfill nëpërmjet proceseve të reduktimit dhe rritjes së riciklimit e ripërdorimit.

Problemet/shqetësimet kryesore që lidhen me këtë sektor janë listuar më poshtë:

- Prania e zonave të ndotura të njohura si Hot-Spote (mbetje kimike, materiale të rrezikshme) që akoma nuk janë sistemuar;
- Prania e vend-depozitimeve të hapura (të ligjshme dhe të paligjshme) të hedhjes së mbetjeve;
- Kapacitet i pamjaftueshëm i landfillëve ekzistues/mungesa e tyre;
- Menaxhimi i mbetjeve është akoma në nivele të ulta, sisteme grumbullimi miks ka vetëm në qytete;
- 70% e ish komunave nuk e ofrojnë fare shërbimin e mbledhjes së mbetjeve.
- Mbetjet inerte, mbetjet e rrezikshme, mbetjet spitalore dhe mbetjet e kafshëve nuk trajtohen sipas kërkesave ligjore, mungesa e landfillëve për mbetjet e rrezikshme. Nuk ka landfill të veçanta, trajtim i veçuar bëhet vetëm nga sektori privat.
- Ndarja në burim e mbetjeve/riciklimi, e cila megjithëse është kërkesë ligjore që prej vitit 2011, nuk realizohet në praktike.
- Kuadri ligjor i përgjigjet kërkesave të BE-së, por nuk mund të ndryshojë realitetin për shkak të mungesës në investime

Bashkia Vau-Dejës duhet të përqendrohet kryesisht në arritjen e objektivave të përcaktuara në legjislationin kuadër të mbetjeve, Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve dhe Arritjen e afateve të VKM nr. 418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim" të rrymave të mbetjeve për të reduktuar sasinë e mbetjeve që do të depozitohen përmes:

- a) Optimizimit të grumbullimit të mbetjeve;
- b) sigurimit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në burim;
- c) promovimit të ripërdorimit të produkteve;
- d) përgatitjes së veprimtarive të ripërdorimit;
- e) përmirësimit të cilësisë së riciklimit të mbetjeve.

Realizimi i grumbullimit të diferencuar të mbetjeve do të realizohet të paktën për këto rryma:

- a) letër/karton;
- b) metal;
- c) plastikë;
- d) qelq.
- Njësia e Qeverisjes Vendore, në planet e përgjithshme vendore të hartuara sipas nenit 20 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", si dhe planet vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve të hartuara sipas nenit 13 të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, duhet të parashikojë vendin për depozitimin e përkohshëm të mbetjeve inerte dhe landfillet për mbetjet inerte.

- Në zbatim të VKM nr. 608, datë 17.09.2014 "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio" Bashkia Vau-Dejës, të hartojë rregullat që duhen zbatuar për grumbullimin dhe menaxhimin e mbetjeve bio, i cili përcaktohet në planin vendor të menaxhimit të mbetjeve, të përgatitur në përputhje me Planin Rajonal dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve.

Djegje të mbetjeve në fushe, përhapja e ndotësve nëpërmjet ajrit konsiderohet si një rrezik serioz për shëndetin, gjë që krijon rreziqe potenciale për shëndetin e banoreve lokale. Rrjedhjet e mbetjeve nga fusha ndotin ujerat sipërfaqësore të lumenjve që kalojnë pranë. Pamje e shëmtuar vizive e territorit që ndikon në imazhin e tij të përgjithshëm dhe tërheqës për aktivitetet, vizitorët dhe banorët. Mbetjet e këtyre zonave depozitohen në lumenj ose në ane të rrugëve të cilat pastrohen nga ujërat dhe në këtë mënyrë zhvendosen në një pjese tjetër toke dhe në fund në rrjedhjet ujore.

Plani synon eliminimin e venddepozitimeve të mbetjeve përgjatë lumenjve si dhe mbulimin e venddepozitimeve të hapura dhe përdorimin e tyre si hapësira të gjelbra.

Ka efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Ka dhe një efekt të drejtpërdrejtë në aktivitetet turistike dhe ekonomike të vendit.

Nevoja dhe investime për landfillin e Bushatit, për përmirësimin dhe mirëmbajtje Nuk kursehen hapësira dhe ka impakte negative në mjedis mungesa e infrastrukturës për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve (konteniere), nxitja e ripërdorimit, riciklimit dhe rikuperimit. Nga Zonat rurale që nuk mbulohen me shërbim një sasi e konsiderueshme mbetjesh qarkullojnë në rrjetin hidrik duke krijuar një potencial ndotës, duke ndikuar kështu veçanërisht në degradimin e zonave të mbrojtura bregdetare dhe ulur kështu aftësinë e tyre ripërtëritëse. Ndikim tjetër negativ është edhe degradim i peizazhit dhe mjedisit. Shumica e ish komunave (sot njësi administrative), rreth 70% e tyre, nuk e ofrojnë fare shërbimin e mbledhjes së mbeturinave. Ndërtesat e shumta informale nuk kanë mbledhje të rregullt të mbetjeve të ngurta.

Plani parashikon ngritjen e infrastrukturës se duhur për trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe bashkitë duhet ta konsiderojnë këtë një prioritet me nisjen e planeve të përgjithshme vendore. Strategjitë në Infrastruktura dhe përpunim të mbetjeve duhet të ndërmerren nga ministritë e linjës dhe NJQV- të.

Rrezik potencial për shëndetin nga hedhja e mbetjeve të rrezikshme (MRR) dhe atyre klinike në zona të pacaktuara. Shkarkimi i MRR në ujë, ajër ose toke shkakton rreziqe për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin, sjell ndotjen e tokës dhe ujerave nëntokësore pastrimi i të cilave kërkon kosto të mëdha. Hedhja e MRR në kanale dëmton sistemin e kanalizimeve dhe ve në rrezik funksionimin e impianteve të trajtimit të bimëve.

Plani parashikon riciklimin përkrah rritjen se kapacitetit të landfilleve. Gjithashtu rekomandohen masa dhe programe për riciklimin e mbetjeve të cilat do të kishin një impakt në zgjatjen e përdorimit të landfilleve duke siguruar edhe përfitim ekonomik.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që paraqiten në Seksionin 10 duhet të merren parasysh për të realizuar këtë objektiv.

9.1.7 Ndotja prej zhurmës

Objekti i Mjedisor 9: Reduktimi i ndotjes së zhurmës/akustike dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE dhe OBSH.

Në zona individuale pritet një nivel më i lartë ndotjeje mjedisore gjatë fazës së ndërtimit dhe më tej gjatë fazës së operimit. Për këtë, masat zbutëse do të duhet të realizohen gjatë fazës së ndërtimit, veçanërisht mbikëqyrja e shkarkimeve të përshkruara prej makinerive të ndërtimit, vendosja e një kohe të limituar për ndërtimin dhe nëse nevojitet zbatimi i masave për të parandaluar zhurmën të përhapet në mjedis.

Impaktet gjatë fazës operacionale do të jenë afat-gjatë. Si rregull, projektet me shtrirje të gjere ose si korridore (rruge, linja tubacionesh, shtylla elektrike, etj.) nënkuptohet kanë impakt më të madh mbi mjedis dhe në mënyrë direkte përgjatë korridoreve, por në të njëjtën kohë mund të zbuten me ridrejtimin e aktiviteteve ato bëjnë të mundur të pakësojnë impaktet lokale sidomos aty ku densiteti i popullsisë është i lartë.

Në përputhje me legjislacionin mbi mbrojtjen nga zhurmat, kushtet e mëposhtme mund të aplikohen gjatë fazës së operimit të strukturave të reja në infrastrukture:

- Një burim i ri zhurme nuk duhet të prodhojë ndotje përtej kufirit të lejuar të zhurmës në mjedis;
- Një burim i ri zhurme nuk duhet të rrisë ndotjen nga zhurma, në një zonë ku zhurma ishte tashmë përtej kufirit të lejuar, përpara se të vendosej ky aktiviteti i burimit të ri;
- Masat e mbrojtjes nga zhurma duhet të garantojnë parandalimin dhe pakësimin e zhurmës që vjen nga përdorimi ose operimi i një burimi në mjedis.

Nga aspekti i mbrojtjes prej zhurmave, këto masa mbrojtëse të referuara në legjislacion duhet të përdoren për të pakësuar ndotjen nga zhurmat në të gjitha aktivitetet e pritshme për të ulur dhe mbajtur me poshtë se niveli ligjor i përcaktuar. Zbatimi i masave të mëtejshme shtese për mbrojtjen nga zhurmat do të jetë i nevojshëm në zonat e qendrave të mëdha urbane dhe korridoret e lidhjeve të infrastrukturës.

Në pozicionimin e veprimeve mbi infrastrukturën sipas sektorëve të zhvillimit në hapësirë, zgjidhjet e përgjithshme dhe teknike do të duhet të sigurohen të tilla që garantojnë se ndotja nga zhurmat nuk e tejkalon kufirin e lejuar. Gjithë masat zbutëse që kërkohen burojnë nga legjislacioni dhe synimet janë të vendosura në SKZHI-II.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që paraqiten në Seksionin 10 duhet të merren parasysh për të realizuar këtë objektiv.

9.1.8 Popullatat dhe asetet materiale

Objekti Mjedisor 10: Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme.

Në vijim të impakteve mbi shëndetin human, arritjet e këtyre objektivave influencojnë gjithashtu konsiderueshëm situatën ekonomike të njerëzve dhe asetet materiale që ata kanë në dispozicion. Gjithashtu, ato kanë sinergji të rëndësishme pasi synojnë të kufizojnë rritjen e mbipopullimit, kërkojnë përdorim në rritje të zgjidhjeve mbi ofrimin e shërbimeve dhe infrastrukturës, hapësirës dhe energjisë, si edhe të efekteve të dëmshme mbi asetet materiale për shkak të ekspozimit të tyre në mjedise të ndotura. Impaktet do të jenë pozitive, permanente dhe rajonale.

Për sa i takon problemeve kryesore që lidhen me çështjet e mirëqenies, sigurisë dhe shëndetit, në mënyrë të përmbledhur ato kanë të bëjnë me aksesimin e trafikut dhe transportit në zonat urbane dhe rurale, lidhur ngushtë me lëvizshmërinë drejt tregjeve dhe ruajtjen e lidhjeve në komunitet. Ndërkohë komunitetet lokale e kanë sfidën më të madhe me ruajtjen e situatës

social-ekonomike (përfshire bujqësinë, hortikulturen, akuakulturen, pyjet, shërbimet utilitare, edukimin etj.).

Zhvillimet e parashikuara në Plan detyrimisht që do të shkaktojnë me shume trafik, me shume emetime, me shume zhurme dhe me shume trysni mbi burimet natyrore. për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm Plani parashikon, nder të tjera edhe zhvillimin e sistemeve të trajtimit të mbetjeve dhe të ujerave të zeza. në këtë këndvështrim problemet që shkaktohen nga menaxhimi i dobët i këtyre sistemeve ka gjasa të zvogëlohen.

Nder rreziqet dhe shkaqet e tyre mund të përmendim:

- Rritjen e nivelit të zhurmave dhe uljen e cilësisë së ajrit, që shkaktohen nga shtimi i trafikut, rritja e aktiviteteve urbane dhe shtimi i zhurmave nga aktivitetet e shërbimeve në komunitet;
- Cilësia e ulet e ujit të pijshëm e shkaktuar nga pakësimi i burimeve ujore për shkak të keqmenaxhimit të tyre si dhe për shkak të rritjes së ndotjes dhe eutrofikimit
- Rritja e sasisë së mbetjeve në vendet e paautorizuara që vjen si pasoje e keqmenaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe mungesës së ndërgjegjësimit.
- Zhvillimet e reja në qendrat urbane dhe industriale do të sjellin rritjen e numrit të banoreve dhe të përdoruesve të rrugëve, duke sjelle kështu një rrezik real për sigurinë e njerëzve.

Fokusimi në zhvillimet infrastrukturore që i përgjigjen realizimit të qëllimeve dhe objektivave përkatëse, kryesisht për t'i shërbyer rritjes së pritshme të numrit të vizitoreve në zonat përkatëse, mbart me vete rrezikun që komunitetet dhe vendbanimet ekzistuese mund të neglizhohen nga pikëpamja e shërbimeve komunitare. Ndërkohë që zhvillimi i përgjithshëm social-ekonomik pritet që të kontribuojë në rritjen e mirëqenies së njerëzve, ekziston rreziku që rritja ekonomike të ketë një shpërndarje të çekuilibruar.

Nder rreziqet dhe shkaqet e tyre mund të përmendim:

- Mungesa e transportit dhe lëvizshmërisë e shkaktuar nga humbja e lidhjeve me token bujqësore, plazhet dhe shërbimet sociale, si dhe nga një transport publik i pamjaftueshëm
- Prishja e cilësisë së jetës që vjen si pasoje e zhvillimeve të reja të cilat dëmtojnë mënyrën tradicionale të jetesës dhe sjellin rritje të kostove baze të jetesës.

Ndërgjegjësimi i njerëzve mbi problemet mjedisore nuk rezulton automatikisht me ndryshimin e sjelljeve të tyre. Duke dhënë informacione, rritur ndërgjegjësimin, dialogimin me të gjitha palët e interesuar dhe me përfshirjen e publikut në proceset vendimmarrëse për politikat e propozuara do të kontribuojë së tepërmi në ndryshimin e modeleve të sjelljes përse i takon zgjidhjeve të qëndrueshme, gjë që është theksuar së tepërmi edhe në udhëzimet strategjike të Planit Kombëtar Mjedisor të Veprimit.

Plani ofron zgjidhje që kanë të bëjnë me mobilitete të qëndrueshme alternative si është rasti i trafikut të biçikletave që klasifikohet midis mënyrave më të përshtatshme të transportit në terma mjedisor dhe të shëndetit. në nivel kombëtar ky përafrim me anë të sistemit të rrugëve për biçikletat mund të lehtësojë transferimet në distancat e zakonshme të lëvizjeve nëpër qytete dhe zonat fushore dhe bregdetare në distanca të shkurtra dhe për rekreacion në distance të gjata. Krijimi i rrugëve të biçikletave dhe rrugicave të marshimeve me anë të aksesimit të përshtatshëm në qendrat e rekreacionit do të kishte një impakt pozitiv në shëndetin human (impakt lokal).

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që paraqiten në Seksionin 10 duhet të merren parasysh për të realizuar këtë objektiv.

9.1.9 Trashëgimia kulturore

Objektivi Mjedisor 11: Ruajtja e shtrirjes, përmbajtjes dhe veçorive të zonave dhe strukturave të trashëgimisë kulturore.

Zhvillimet e infrastrukturës mund të krijojnë impakte direkte në njësi dhe zona të trashëgimisë kulturore gjatë fazës së ndërtimit dhe më tej të operimit si rezultat i efekteve të mëposhtme:

- Degradimi i veçorive të peizazhit përreth njësive të trashëgimisë kulturore (impakt indirekt, i pakthyeshem);
- Dëmtimi i strukturave të trashëgimisë kulturore (impakt direkt, i pakthyeshem);
- Shkatërrim i mbetjeve arkeologjike gjatë fazës së ndërtimit (impakt direkt, lokal, i pakthyeshem);
- Vibrime që mund të shkaktojnë dëmtime të strukturave të trashëgimisë kulturore (impakt indirekt, i pakthyeshem);
- Çlirime gazrash ndotës që bëjnë pjese në kontribuimin e shirave acid dhe që shkaktojnë dëmtime të strukturave të trashëgimisë (impakt indirekt, kumulativ, në distance).

Pozicionimi i infrastrukturës sipas sektorëve do të ndryshojë në mënyre permanente përdorimin e hapësirës në këto zona. për këtë, duhet të zbatohen masa të përshtatshme për të ruajtur veçoritë e zonës së trashëgimisë kulturore. Nga aspekti i ruajtjes së mbetjeve arkeologjike, aktivitetet në mjedis konsiderohen akte destruktive (p.sh. gërmimet). Kërkime paraprake arkeologjike në plan të gjere do të duhet të kryhen, rezultatet e tyre do të duhet të merren në konsideratë kur të pozicionohen strukturat e infrastrukturës dhe masat për të ruajtur mbetjet arkeologjike do të duhet të zbatohen.

Në vijim të impakteve direkte permanente, zbatimi i veprimeve të Planit mund të ndikojë gjithashtu në trashëgiminë kulturore në mënyrë indirekte, dmth. duke përqësuar veçoritë e peizazhit në mjedisin përreth njësive të trashëgimisë kulturore, vibracionet mund të shkaktojnë dëmtime në strukturat e trashëgimisë kulturore, dhe shkarkimet e gazeve që janë përbërës të shirave acide mund të shkaktojnë dëme në strukturat e monumenteve. për më tepër në efektet indirekte, impakti i gazeve mund të jete kumulativ dhe të ndikojë në distanca të mëdha.

Gjatë fazës së operimit, këto veprime mund të kenë një impakt të drejtpërdrejtë pozitiv mbi trashëgiminë kulturore. Arritja me lehtë tek zonat me rendësi historike dhe kulturore do të rezultojë në rritjen e numrit të vizitoreve. Nga ana tjetër, një impakt pozitiv i drejtpërdrejtë mund të kthehet shpejt në impakt negativ. Me shume vizitore mund të prodhohen me shume mbetje dhe të rritin ndotjen akustike.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që paraqiten në Seksionin 10 duhet të merren parasysh për të realizuar këtë objektiv.

9.2 Mbetjet

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 8

Zhvillimet e parashikuara padyshim që mbartin pasojën e gjenerimit të shtuar të sasisë së mbetjeve, të cilat mund të cenojnë integritetin e shtresave të ujërave nëntokësore dhe ndotja me kimikate të rrezikshme mund të kalojë në shtresat nëntokësore. Nga ana tjetër mund të

shkaktohen sëmundje kancerogjene deri në largësi të mëdha prej zonës së ndotur. Pikat e vjetra e të nxehta përbejnë rrezik jo vetëm për shëndetin e njeriut, por krijojnë ambient për investime të reja para pastrimit të duhur. Gjenerimi i mbetjeve ka efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit si dhe në integritetin e zonave të mbrojtura mjedisore.

Masat zbutëse që duhen parashikuar dhe zbatuar lidhur me administrimin e mbetjeve janë si me poshtë:

- Rehabilitimi/Inkapsulimi i hot-spot-eve mjedisore, rinovimi urban dhe ripërdorimi i tokës, duke i kthyer në zone të gjelbra me vlere rekreative për qytetin, të tjerat në përputhje me normat e sigurisë.
- Propozohet të studiohen të gjitha territoret e objekteve industriale që kane përdorur ose gjeneruar kimikate të rrezikshme për shëndetin dhe të ndahen mbi bazën e shkallës së rrezikut, duke zbatuar të gjitha direktivat e BE-së që lidhen me kontaminimin e rrezikshëm të tokës.
- Plani të përcaktojë dhe të ndajë zonat e ligjshme dhe të paligjshme të hedhjes së mbetjeve.
- Identifikimi i venddepozitimeve, si dhe përcaktimi i prioriteteve, planifikimi dhe duhet bërë dhe raportimi. Rekomandimin e rregullimeve institucionale dhe financiare për të arritur këtë.
- Hartimi i projekteve të standardizuara dhe mbështetja teknike duhet t'u ofrohen zonave të mbetjeve dhe autoriteteve lokale për të garantuar cilësinë e përshtatshme të planeve dhe që rezultatet e tyre të jenë të krahasueshme. në kuadrin e reformës territoriale bashkitë duhet të zgjerojnë shërbimin në këto zona.
- Zhvillimi i infrastrukturës dhe përfshirja në planet rajonale e vendore të menaxhimit të mbetjeve
- Janë të domosdoshëm buxhete të mjaftueshme për menaxhimin e mbetjeve, që përfshijnë gjithashtu dhe sektorin privat
- Planet duhet të saktësojnë orientimin drejt trajtimit të tyre sipas hierarkisë që është më praktikja dhe me e arritshmja në nivelet e ulta, të ndërlidhura me masa që varen shumë nga aktoret kryesore në qeverisjen Qendrore, politikat e saj dhe përgjegjësitë e prodhuesve. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve duke vendosur standarde lokale, për të cilat kane rënë dakord të 3 nivelet.
- Duhet planifikuar zonat e përshtatshme për vendndodhjen e zonës së riciklimit, kompostimit, duke konsideruar me përparësi ndikimin në mjedis.
- Krijimi i kushteve të duhura për donatorët ndërkombëtarë (veçanërisht për fondet e BE-së) për të financuar infrastrukturën e nevojshme.
- Forcimi i mekanizmave për mbledhje me të mire të tarifave dhe zbatimi i sanksioneve.

9.2.1 Peizazhi

Objektivi Mjedisor 12: Garantimi i ruajtjes së peizazheve të veçanta dhe zonave peizazhistike me veçori dalluese në nivel kombëtar dhe krijimi i një imazhi peizazhi me cilësi të lartë.

Përcaktimi i impaktit mbi cilësinë e peizazhit, buron kryesisht nga veçoritë vizive të hapësirës dhe nga elementet karakteristike të peizazhit që janë të pranishme në këtë hapësirë. Peizazhi

cenohet me shume nga infrastruktura që shtrihet në zona të hapura, ku impaktet janë me të dukshme për shkak të një niveli të larte shtrirjeje (impakte të përhershme, të pakthyeshme. Ndikimi është veçanërisht i larte në rastin e një ndërhyrjeje infrastrukturore në zona me peizazh të jashtëzakonshëm, apo me tipare të veçanta, si dhe në zona peizazhistike me elemente natyrore të mbrojtur, të cilët mbartin një kuptim të rëndësishëm simbolik.

Impaktet mbi veçoritë peizazhistike të zonave mund të përkufizohen si direkte, kumulative, indirekte dhe të dobëta. Strukturat infrastrukturore në hapësirë, bëhen elemente të peizazhit dhe pjesë përbërëse e tij. Kështu që, sistemimi i këtyre strukturave duhet të behet në përputhje me tipologjinë ekzistuese të peizazhit. Marrja në konsideratë e veçorive natyrore dhe topografisë se zonës ku parashikohet të zhvillohet projekti, do të reduktoje fragmentimin e peizazhit.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që paraqiten në Seksionin 10 duhet të merren parasysh për të realizuar këtë objektiv.

9.2.2 Konkluzion mbi Vlerësimin

Tabela 9-1 me poshtë paraqet Vlerësimin e impakteve mbi zbatimin e Planit bazuar në realizimin e objektivave mjedisore, të paraqitura për secilin veprim.

Tabela 9.1 tregon se impaktet mbi objektivat mjedisore mund të ndodhin gjatë zbatimit të secilit prej veprimeve individuale (niveli A, B dhe C), ndërkohe që nuk u pa e nevojshme të vlerësohej me gradën D (veprimi në kundërshtim të plote me objektivat mjedisore). në përgjithësi, u vu re që me anë të pozicionimit të përshtatshëm të aktiviteteve hapësinore dhe duke ndërmarrë gjithë masat zbutëse, të gjithë grupet e veprimeve janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor. në përputhje me gjetjet, janë propozuar masa zbutëse të përgjithshme dhe specifike në Seksionin 10.

Gjatë zbatimit të projekteve, priten të ndodhin impakte pozitive dhe negative. Impaktet pozitive priten për ajrin dhe ndryshimet klimatike si edhe për popullatat dhe asetet materiale. Vlerësimi i rezultateve tregon se nuk do të ketë impakte mbi faktorët klimatike duke konsideruar që mjetet e transportit do të vijnë të rinovohen në të ardhmen edhe me tej, gjë që do të sjellë si pasoje përmirësim të cilësisë së ajrit dhe cilësisë së shëndetit human, midis të tjerave. për me tej në pjesën pozitive të impakteve mbi popullatën dhe asetet materiale do të vijë si rezultat i zbatimit të infrastrukturës në përgjithësi që do të beje të mundur pakësimin e kohës së udhëtimit, sigurinë në lëvizje, përafrimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane dhe shërbimet publike në përgjithësi.

Përgjithësisht, shumica e impakteve negative janë të lidhura me fazën e planifikimit (pozicionimi i infrastrukturës në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme), pasi Shqipëria ka veçori të theksuara diverse dhe të shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peizazhi që mund të ndikohen konsiderueshëm prej zhvillimeve të infrastrukturës, sidomos atyre me shtrirje të gjere dhe korridoreve sipas sektorëve (transport, energji, ujë, etj.). Impaktet negative shfaqen në fazën e planifikimit prej aspekteve të përdorimit të tokës, efekteve në ujë, natyrë (si biodiversiteti edhe zonat me status të mbrojtur), trashëgiminë kulturore dhe peizazhin. Këto impakte do të kërkojnë krijimin e një programi bashkëkohor mbi masat zbutëse dhe një zbatim të përshtatshëm të këtyre masave.

Impakte negative mbi shëndetin human mund të ndodhin për shkak të rritjes së ndotjes nga zhurmat dhe impaktet në cilësinë e ajrit, veçanërisht në zonat me densitet të larte banimi ku do të përqendrohen edhe një seri veprimesh në territor të ngushte dhe kjo do të ndikojë kryesisht në fazën e zbatimit të projekteve specifike.

Tabela 9.1 Vlerësimi i shkallës së ndikimit të programeve strategjike në objektivat mjedisore

OBJEKTIVA STRATEGJIKE		Objektivat Mjedisore	OM	OM	OM	OM	OM	OM	OM	OM	OM	OM	OM
			1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
		PROGRAMET	Toka - Rindodimi qëndrueshëm i tokës	Toka - Shfrytëzimi bujqësorë natyrorë	Ajri - Emetimet e ndotëseve	Faktorët klimatike - Adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike	Ujë - Kufizimi i efektit negativ	Mjedisat Natyrore - Kohëzotimi i biodiversitetit	Mjedisat Natyrore - Zonat e mbrojtura	Mbrojtja - Kompletimi i llojeve	Zhvatja - Reduktimi i zhvatjeve në nivelin e ODSH-të	Popullsia dhe shteti material - Kufizimi i zhvatjeve të trafikut	Traheqja kulturore - Ruajtja
1	PAJISJA ME SHËRBIMET BAZË	1.1 Përmirësimi i rrjeteve teknike	A	A	B	B	B	A	A	A	A	A	B
		1.2 Ruajtja e peizazhit dhe siguria e territorit	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A
		1.3 Shërbimet publike	A	A	B	B	B	A	B	C	A	A	A
2	LËVIZJA ME MËNYRA TË NDRYSHME	2.1 Rrugët automobilistike	C	B	A	A	A	B	A	A	B	A	C
		2.2 Korridor i lumor	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A
		2.3 Ndërrhyrje të tjera për lëvizjen	B	B	A	A	A	A	A	A	A	A	B
3	QENDRAT URBANE	3.1 Pole shërbimesh për territorin përreth	B	B	A	A	A	B	A	A	B	A	B
		3.2 Zhvillimi i qendrave lokale	C	C	C	B	C	B	B	C	A	A	C
		3.3 Rikualifikimi urban	C	C	C	B	C	B	B	C	A	A	C
4	TURIZMI	4.1 Turizmi mjedisor	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A
		4.2 Turizmi kulturor	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A	A
		4.3 Ndërrhyrje të tjera për zhvillimin e turizmit	B	B	A	A	A	B	B	A	B	A	B
5	BUIQËSIA, BLEGTORIA DHE KULTIVIMI I PESHKUT	5.1 Strukturat e shërbimit	B	B	B	B	B	B	B	A	B	A	B
		5.2 Rritja e prodhimit	B	B	A	A	A	A	A	A	B	A	A
6	ENERGJIA	6.1 Zhvillimi i prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme	C	C	A	A	A	C	A	A	C	A	C
		6.2 Diferenciali i prodhimit të energjisë	A	A	A	A	A	A	A	A	B	A	A

Legjenda:

- A** s'ka impakt/impakt pozitiv;
- B** ndikim i parëndësishëm;
- C** ndikimi behet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse;

9.3 Impaktet Kumulative

Impaktet mjedisore kumulative përcaktohen në këtë Raport si një kombinim i impakteve të zbatimit të veprimeve të Planit në aspekte të ndryshme të mjedisit.

Në zbatimin e veprimeve të Planit, impaktet mjedisore kumulative variojnë sipas aspekteve individuale të mjedisit.

Kur vlerësohen impaktet mbi token, ajrin dhe faktorët klimatike, impaktet kumulative të zbatimit të veprimeve të Planit shprehen si shuma e impakteve të të gjitha masave, si të tilla në Vlerësimin e impakteve kumulative mbi:

- token, zona tokë bujqësore dhe e pyjeve e fragmentuar për shkak të integritetit të strukturave të infrastrukturës së re që kombinohen;

- asetet minerale, shkalla e riciklimit të gjenerimit të mbetjeve ndërtimore gjatë fazës së ndërtimit dhe rindërtimit që kombinohen;
- ajrin, shkarkimet e ndotësve që pasojnë zbatimin e masave që kombinohen; dhe
- faktorët klimatike, shkarkimet e gazeve sere që pasojnë zbatimin e masave që kombinohen

Nga aspekti i impakteve mbi ajrin dhe faktorët klimatike, impaktet kumulative si shume e impakteve të të gjithë veprimeve të Planit janë të rëndësishme për realizimin e objektivave mjedisore të përcaktuar për sektorët e Bashkisë Vau-Dejës për 2031 në lidhje me:

- menaxhimin e mbetjeve të ndërtimit;
- shkarkimet tavane të ndotësve
- sasia vjetore me e larte e shkarkimit të gazeve sere.

Kur vlerësohen impaktet mbi ujin, natyrën, trashëgiminë kulturore dhe peizazhin, impaktet kumulative zakonisht nuk mund të shprehen si një shume e impakteve të të gjithë veprimeve për të arritur synimet e Planit. Kur vlerësohen impaktet kumulative në aspektet e përmendura më sipër, karakteristikat e një impakti individual që kontribuon në impaktet kumulative janë shume të rëndësishme. Këto janë përgjithësisht karakteristika në të cilat impaktet ndryshojnë njëri nga tjetri sipas vendit (impakt direkt dhe në distancë) dhe kohës (afat-shkurtër, afat-mesëm dhe afat-gjatë, përkohësisht dhe permanent) të impaktit.

Kur vlerësohen impaktet mbi shëndetin human, impaktet kumulative të zbatimit të veprimeve të Planit shprehen si një kombinim i impakteve që kontribuojnë në shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve dhe zakonisht referohen për:

- reduktimin e ekspozimit në nivelet e tejkaluara të zhurmës;
- reduktimin e ekspozimit në nivelet e tejkaluara të ajrit të ndotur në mjedis;
- masat që lehtësojnë veprimtari çlodhëse dhe rekreative në një mjedis të shëndetshëm për distanca të shkurtër, veçanërisht gjatë shkëmbimeve ditore (impaktet u vlerësohen midis popullatës).

Kur vlerësohen impaktet mbi popullatën dhe asetet materiale, impaktet kumulative të zbatimit të veprimeve në Plan shprehen si një kombinim i impakteve të ndryshme që ndikojnë në hapësirën e tyre të jetesës dhe në jetën e tyre. Masat për të arritur synimet e Planit janë pozitive nga aspekti i impakteve mbi popullsinë dhe asetet materiale, nëse impaktet kumulative të tyre kontribuojnë në arritjen e kohezionit social, sigurinë dhe qëndrueshmërinë.

SEKSIONI 10. UDHEZIME DHE MASA ZBUTËSE

Ky paragraf përcakton udhëzimet dhe masat mbrojtëse për të siguruar arritjen e objektivave të rëndësishëm mjedisore në fushat e veçanta. Duke zbatuar udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse, ndikimet negative të përshkruara në seksionet më sipër do të parandalohen dhe do të sigurohet arritja e objektivave mjedisore.

Për më tepër, ky seksion ofron disa masa specifike zbutëse të zbatueshme për programet dhe projektet specifike të përshkruara në Plan. Është e rëndësishme të theksohet se lista e dhënë me poshtë e masave specifike për zbutjen nuk është shteruese. Masa me të detajuara në aspektin e përmbajtjes dhe analizës do të duhet të përgatiten si pjese e VNM-ve individuale për çdo projekt specifik të Planit.

10.1 Toka

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivat Mjedisore 1 dhe 2

Masa Zbutëse Specifike

- **Punimet në dhera të ndotura**

- Gjatë punimeve mund të zbulohen dhera të ndotura. Këto dhera duhen larguar. Pastaj duhet vendosur toke artificiale me gjeomembrane, argjile dhe shtrese plehu, mbi të cilën duhet të mbillet bar dhe peme. Kjo toke artificiale duhet të mbuloje edhe sipërfaqet e ndotura që nuk do të lëvizin.
- Të gjithë materialet ndotës (dherat dhe mbetjet) që do të largohen, duhet të depozitohen dhe groposen në vende të caktuara ku duhet të jene të izoluar nga ujërat nëntokësore.

- **Ndotja e tokës**

- Toka që shtrihet nën rrugë mund të jete në rrezik gjatë ndërtimit, pasi mund të ndotet nga derdhjet e hidrokarbureve dhe ato kimike. Pastaj toka mund të shërbejë si një burim ndotjeje kur përshkohet nga ujërat nëntokësore.

- **Ripërdorimi i materialit të gërmuar**

- Materiali, i cili gërmohet nga prerja e seksioneve është një burim natyral dhe përdorimi i tij në baze të një skeme do të maksimizohet duke përdorur teknika konstruktive të cilat intensifikojnë ngjeshjen e materialeve për t'u përdorur si mbushje inxhinierike.
- Megjithatë, pashmangshmërisht do të ketë një sasi të konsiderueshme material, i cili, për shkak të veçorive të tij fizike dhe strukturore, nuk është i përshtatshëm për t'u përdorur si mbushje inxhinierike brenda skemës. Megjithatë, ky material mund të jete i përshtatshëm për aktivitete të tjera, siç është krijimi i peizazhit, ku nuk aplikohen kërkesa kaq të rrepta strukturore. Ripërdorimi i këtij materiali do të maksimizohet brenda skemës, dhe çdo material i tepërt do të transportohet jashtë.
- Materiali i gërmuar i parashikuar për ripërdorim do të trajtohet dhe transportohet në minimum, dhe o të depozitohet në mënyre të tilla që të minimizojë ndikimet e gërryerjes. Koha midis gërmimit dhe ripërdorimit gjatë periudhës së lagësht duhet të jete sa më e vogël. Gjatë periudhave të zgjatura me lagështire, kontraktori duhet të ndërpresë gërmimin dhe vendosjen e materialit për të parandaluar degradimin për shkak të lagështirës.

- **Erozioni**

- Duhet ndërmarrë mbrojtja e argjinaturës nga erozioni, me qëllim që të sigurohet stabilizimi i argjinaturës, përfshirë edhe përzgjedhjen e materialeve më pak të korodueshëm, përdorimin e gabioneve dhe gurëve të thyer, si dhe një ngjeshje të mire, veçanërisht përreth urave dhe tobinove.
- Mbjellja duhet përfunduar sa më shpejt të jete e mundur, menjëherë pas mbushjes, për të lehtësuar rigjenerimin e një mbulese stabilizuese të tokës. Aty ku është e nevojshme do të kërkohet hapje e kanaleve për të siguruar mbjelljen e suksesshme të bimëve.
- Aty ku është e nevojshme, zonat e shkarkimit prej strukturave kulluese do të pajisen me gurë të thyer, për të reduktuar erozionin, veçanërisht në rastet kur janë instaluar strukturat e kullimit dhe/ose nivelet e formacioneve të rrugës janë ngritur dhe krijojnë shpatë të zhveshura, të cilat kërkojnë stabilizim, përpara fillimit të sezonit të shirave.

10.2 Ajri

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 3

Gjatë përgatitjes së politikave dhe projekteve të reja në infrastrukturë, duhet të respektohen udhëzimet dhe masat në vijim, në mënyrë që të arrihen objektivat e reduktimit të ndotjes së ajrit të ambientit në zonat e ndikimit të aktiviteteve përkatëse:

➤ *Cilësia e ajrit - komuniteti*

- Monitorim të rasteve të sëmundjeve dhe shkaktareve
- Përcaktimi i zonave urbane të reja me cilësi të lartë ajri për popullsinë
- Dizajnim me kushtet dhe kriteret e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, mirëmbajtje dhe zëvendësim i materialeve rezistonte ndaj ndryshimit të temperaturave dhe lagështisë
- Përdorim i mjeteve të transporti publik me emetime të gazeve në nivele të ulëta ose me filtra ajri të reduktimit maksimal
- Përcaktimi i zonave industriale me teknologji të lartë dhe me emetime të gazeve në sasi të ulët

➤ *Cilësia e ajrit - ekosistemet*

- Identifikimi dhe monitorimi i burimeve të gazeve që shkaktojnë shiun acid
- Komunikim ndërkufitar institucional për të shmangur incidentet mjedisore të qarkullimit të ajrit si dhe përcaktimi i masave konkrete të veprimit në raste të incidenteve ndërkufitare
- Përcaktimi i kriterëve të tjetërsimit të sipërfaqeve të tokës dhe qëllimit të përdorimit të saj që në fazat e projektimit
- Shtimi i sipërfaqeve me pyje dhe bimësi
- Strukturimi i kërkesave për lende drusore
- Përcaktimi i masave të emergjencave në rastet e aksidenteve industriale për zvogëlimin e ndikimeve në mjedis dhe në cilësinë e tij

Masa Zbutëse Specifike

- Monitorimi i cilësisë së ajrit në të gjithë territorin e vendit duke vendosur stacione automatike të monitorimit si në zonat urbane dhe ato rurale (te gjitha bashkitë të kenë dy- tre stacione monitorimi sipas specifikes së zonave industriale dhe të banimit)
- Koordinimi midis institucioneve Qendrore dhe vendore për Vlerësimin e kushteve mjedisore që lidhen me cilësinë e ajrit dhe me masat ndaj ndryshimeve klimatike

Gjatë fazës së ndërtimit, masat me të zakonshme specifike të rekomanduara në punimet infrastrukturore rrugës konsistojnë në:

- Implementimi i sistemit të shtypjes së pluhurit: ujitja e aneve të rrugëve, përdorimi i ndarjeve të rrugëve për të kufizuar nxjerrjen e pluhurit (për shembull përdorimi i larjes së rrotave, gjë që behet përditë);
- Kufizimi i shpejtësisë së impianteve të lëvizshme në rrugë.
- Ulja e ndikimit nga ndërtimi përfshin gjithashtu:
 - vendndodhjen potenciale të zonave që kërkohen instalimin e kantierit, magazinim si dhe zonat e stabilizimit të tokës; dhe
 - rrugët e transportit që përdoren për shpërndarjen e materialeve.

Për sa i përket fazës së shfrytëzimit të infrastrukturës propozohen masat specifike të mëposhtme:

- kontrolli i kufijve të shpejtësisë së automjeteve gjatë sezonit me nivelin më të lartë të ndotjes së ajrit me pezulli në qendrat kryesore urbane;
- mirëmbajtje e rregullt e sipërfaqeve rrugore për të pakësuar sa me shume që të jete e mundur ringritjen e pezullive.

10.3 Faktorët klimatike

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 4

10.3.1 Masat zbutëse ndaj ndryshimeve klimaterike

Zbatimi i masave për të arritur objektivat e Planit duhet të marrë parasysh të ashtuquajturat objektiva indikative për të reduktuar emetimet e gazit, të cilat janë të përcaktuara deri në vitin 2020 në SKZHI II për reduktimin e emetimeve të gazit serre. Në këtë kuadër duhet mbajtur në vëmendje si me poshtë:

- përcaktimi i masave të emergjencave civile për të shmangur/zbutur ndikimet nga kushtet ekstreme të motit
- Përcaktimi i kriterëve dhe politikave për futjen e teknologjive bashkëkohore në bujqësi si dhe praktikave me të mira të bujqësisë organike
- zbatimi i një politike parkimi kufizuese në zonat urbane;
- integrimi i çështjeve të ndryshimeve klimatike në kuadrin politik dhe ligjor duke specifikuar institucionet dhe përgjegjësitë për identifikimin, zbatimin dhe monitorimin e masave zbutëse/përshtatësi ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

10.3.2 Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike

Për të arritur objektivin mjedisor në lidhje me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duhet të sigurohen si me poshtë:

- në terma afatgjatë, infrastruktura duhet të jetë më pak e ndjeshme ndaj pasojave të reshjeve ekstreme (shirave, dëborës, apo edhe ngricave);
- gjatë planifikimit të çdo ndërtimi të ri apo zgjerimi të strukturave ekzistuese, duhet të kryhet një analize ndjeshmërie e infrastrukturës së parashikuar në kushtet ekstreme të motit, dhe në baze të rezultateve të saj, duhet të përgatitet një plan masash për të reduktuar në mënyrë të përhershme pasojat e këtyre fenomeneve;
- zbatimi i masave për të reduktuar ndjeshmërinë e infrastrukturës ndaj kushteve ekstreme të motit duhet të behet një detyrë qendrore e menaxhimit të çdo lloj infrastrukture. Qëllimi i zbatimit të këtyre masave duhet të bazohet sidomos në reduktimin e demit të shkaktuar për përdoruesit e infrastrukturës së ndjeshme ndaj motit, nëse ata nuk mund ta përdorin atë;
- duhet të përcaktohen qarte udhëzimet për metodologjinë, procedurat dhe realizimin e mbledhjes së informacionit mbi kushtet ekstreme të motit, si dhe për planifikimin dhe zbatimin e masave për të reduktuar ndjeshmërinë e infrastrukturës së parashikuar ndaj kushtet ekstreme të motit.

Masa Zbutëse Specifike

- Shtimi i sipërfaqeve me pyje dhe bimësi
- Strukturimi i kërkesave për lëndë drusore
- Dizenjimi dhe përcaktimi i kriterëve të ndërtimit të infrastrukturave nëntokësore me materiale dhe struktura rezistente ndaj kushteve të motit dhe në veçanti ndaj temperaturave të larta dhe lagështisë
- Ndalimi i ndërhyrjeve ilegale në infrastrukturën nëntokësore
- Monitorimi i vazhdueshëm i kushteve ekologjike të mjediseve natyrore,
- Monitorimi i dinamikës së vijës bregdetare dhe nivelit të detit
- Monitorimi i nivelit të detit dhe cilësisë së ujërave në zonat ligatinore dhe ujërat nëntokësore
- Monitorimi i vijës bregdetare dhe sasisë së sedimenteve që vijnë nga lumenjtë
- Monitorimi i lëvizjes së tokës dhe tjetërsimit të saj
- Monitorimi i marrjes së zhavorreve nga shtretërit e lumenjve
- Përcaktimi i zonave të lejuara për ndërtim HEC-esh dhe digash për bujqësinë
- Monitorimi i gjendjes së monumenteve dhe veprave të trashëgimisë kulturore
- Monitorimi i lëvizjes së popullsisë në zonat urbane dhe rurale
- Zbatimi i kodeve të reja të ndërtimit për ndërtesat sociale dhe kulturore duke përdorur materiale termoizoluese dhe rezistente ndaj kushteve të motit
- Ndërtimi i impianteve të trajtimit të mbetjeve të lëngëta urbane dhe industriale për të zvogëluar sasinë e lendeve ndotëse në mjediset ujore, tokësore dhe ajrore
- Përcaktimi i zonave buferike për rastet e ndikimeve nga rritja e nivelit të detit.

10.4 Uji

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 5

Në mënyrë që të kufizohen efektet e presionit që do të ushtroje infrastruktura e parashikuar në burimet ujore dhe kështu të parandalohen ndikimet negative në cilësinë e ujit (sidomos ujit të pijshëm), duhet të shmanget integrimi hapësinor i infrastrukturës së re në zonat e mbrojtura ujore.

Në integrimin hapësinor të infrastrukturës së re, është e nevojshme që të shmanget integrimi i objekteve në zonat në rrezik nga përmbytjet dhe erozioni si pasoje e tyre. Në rast të ndërhyrjeve në këto zona, duhet të provohet se niveli ekzistues i rrezikut nga përmbytjet në zonën përreth nuk do të rritet. Udhëzimi i lartpërmendur duhet të merret parasysh në mënyrë që të reduktoje presionin e infrastrukturës së re në zonat në rrezik nga përmbytjet, dhe për të siguruar se niveli i rrezikut nga përmbytjet në zona të veçanta nuk do të rritet.

Kur planifikohen ndërhyrjet në zonat me rrezik jashtëzakonisht të lartë, shume të lartë dhe të lartë të akuifereve, është e nevojshme që të studiohen dhe planifikohen zgjidhjet e duhura teknike për të parandaluar ndikimet negative gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit, si dhe në rastin e ngjarjeve të jashtëzakonshme (p.sh. rrjedhjet e substancave të rrezikshme). Shqyrtimi i udhëzimit të lartpërmendur do të reduktoje probabilitetin e ndotjes nëntokësore, duke siguruar ndikime të kufizuara të presionit të infrastrukturës së re në ujerat nëntokësore.

Sa më shume që të jete e mundur, infrastruktura e re nuk duhet të ndërhyjë në toke bregdetare. Aktivitetet e tilla mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në statusin ekologjik të rrjedhave ujore, të zvogëlojnë basenet mbrojtëse ujore, dhe të prodhojnë ndikime kumulative mbi biodiversitetin e zonës dhe shërbimet e ekosistemeve të zonës. Në rastet e përjashtimit të kësaj mase, kjo duhet të bëhet e mundur vetëm në baze të argumentimit të eksperteve, duke deklaruar se elementi i infrastrukturës nuk mund të integrohet në vende të tjera pa shpenzime jashtëzakonisht të larta. Në llogaritjen e këtyre shpenzimeve duhet të përfshihen edhe kostot që vijnë si pasoje e pakësimit të shërbimeve që vijnë nga ekosistemi. Shqyrtimi i udhëzimit të lartpërmendur do të beje llogaritjen e kostove me të sakte dhe të balancuar. Duhet të priten më pak aktivitetet zonat bregdetare. Kjo do të parandalonte ndikime të rëndësishme negative në gjendjen ekologjike të rrjedhave ujore.

Masa Zbutëse Specifike

- Në rast se zbatimi i një projekti specifik do të ndikojë ndjeshëm në ndonjë akuifer, gjatë hartimit të dokumentacionit të projektit duhet bërë edhe një vlerësim i dëmit ndaj ujerave nëntokësore. Vlerësimi duhet të përfshijë gjithashtu edhe një mënyrë për ta kaluar këtë zone (si p.sh. ndërtimin e një ure) për të garantuar mbrojtjen e ujit nëntokësor.
- Duhet bërë përcaktimi i zonave me specifike për qëllime të përdorimit të ujerave për HEC-e, rezervuare, për bujqësinë.
- Duhet planifikuar zgjidhjet e duhura teknike për të parandaluar ndikimet negative mbi ujerat e larjes, gjatë fazave të ndërtimit dhe shfrytëzimit të infrastrukturës, si dhe në rastet e ndodhjeve të jashtëzakonshme (p.sh. derdhjet e substancave të rrezikshme).
- Ndikimet e ndotjes do të shmangen duke adoptuar praktika të mira të menaxhimit të punës në terren, siç janë:

- - Nuk do të autorizohet depozitimi i produkteve të dëmshme në një distance më pak se 50 m nga brigjet e lumenjve si dhe do të kufizohet pranë rrjedhave të tjera ujore siç janë kanalet kulluese;
- - Ambientet e magazinimit duhet të rrethohen dhe mbulohen për të parandaluar derdhje të ndryshme;
- - Kanalet anësore do të ndërtohen përpara ndërtimit të rrugës, për të parandaluar derdhjen e rrjedhjeve të rrugës gjatë ndërtimit, në lume, apo kanalet kulluese;
- - Kur derdhjet nga kantieri duhet të shkarkohen në një lume, norma e derdhjeve duhet të kontrollohet, në mënyrë që ajo të mos shkaktojë përmbajtje lokale në rrjedhën e ujit, apo erozioni;
- - Në rast se ka derdhje serioze të kimikateve apo lëngjeve gjatë ndërtimit, kontraktori duhet të hartojë një program të masave për ujerat sipërfaqësore dhe nëntokësore. Marrja e mostrave të ujerave nëntokësore duhet të bëjë in situ matjen e pH, turbullirës dhe përcjellshmërisë elektrike. Të gjitha veprimet e kërkuara dhe, nëse nevojiten, analizat, duhet të bëhen në përputhje me legjislacionin shqiptar.

10.5 Mjedisi Natyror

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivat Mjedisore 6 dhe 7

Për të ruajtur në mënyrë të përhershme mjedisin natyror dhe biodiversitetin, duhet të merren parasysh masat e mëposhtme:

- Shfrytëzimi i infrastrukturës ekzistuese ka përparësi mbi ndërtimin e infrastrukturës së re;
- Nëse aktivitetet në mjedisin e paprekur nuk mund të shmangen, duhet të shmangen aktivitetet në zonat e mbrojtura, zonat me rendësi mjedisore dhe zonat me karakteristika të çmuara natyrore;
- Prioritet duhet t'i jepet varianteve me më pak ndikim në rrugët e migrimit të kafshëve të egra (variante të cilat kalojnë më shume neper tunele dhe variante të cilat ndërpresin më pak rrugët e migrimit);
- Duhet të sigurohen pasazhe të përshtatshme për kafshët e egra, gjë që është në përputhje me praktikat me të mira evropiane. Para se të planifikohet çdo ndërtim i ri, duhet të kryhet një studim apo të përmbledhen rezultatet e studimeve ekzistuese, të cilat do të lehtësonin integrimin në mënyrë të përshtatshme të një strukture të caktuar në një vend (formën, madhësinë, dhe sistemin e objektit dhe rrethinave të tij). Planet duhet gjithashtu të parashikojnë pasazhe për kafshët e vogla (amfibet, gjitarët e vegjël, zvarranikeve) në baze të studimeve ekzistuese ose, nëse është e nevojshme, hulumtimeve shtesë.

Periudha për zbatimin e projekteve duhet të rregullohet sipas cikleve jetësore të kafshëve dhe bimëve, d.m.th.:

- duke ju përshtatur kafshëve pa apo me aktivitete me një shtrirje në një masë të vogël, që përkon me periudhën kur kafshët kanë nevojë për qetësi, ose nuk mund të lëvizin larg, sidomos gjatë periudhës së riprodhimit, shumimit, rritjes, dhe dimërimit;

- duke ju përshtatur bimëve duke lehtësuar prodhimin e farës, mbjelljen natyrore dhe format e tjera të riprodhimit.

Respektimi i masës do të zvogëlojë shqetësimet për ciklet e jetës së kafshëve dhe bimëve dhe do të rrisë probabilitetin për të arritur apo ruajtur një gjendje të favorshme të popullsisë. Mundësitë e arritjes së objektivit për ruajtjen e biodiversitetit do të jenë më të larta.

Prandaj, ndërhyrja hapësinore e infrastrukturës së parashikuar në zonat e propozuara për mbrojtje duhet të shmangët për të parandaluar konfliktet e mundshme dhe ndikimet negative në arritjen e objektivave mjedisore të ruajtjes së natyrës.

Masa Zbutëse Specifike

Projektet specifike duhet të plotësohen me detyrën për të mbrojtur në mënyrë me adekuate llojet e veçanta të kafshëve prej rreziqeve që vijnë si pasoje e ndërtimit të infrastrukturës së re. Duhet të zbatohet masa zbutëse specifike: *Sigurimi i korridoreve të migrimit dhe siguria e kafshëve*. Përmbajtja e kësaj mase duhet të jete si më poshtë:

- Të ulet fragmentimi i habitateve të llojeve, duke krijuar pasazhe për kafshët e egra në linjat ekzistuese të lëvizjes (veçanërisht për gjitarët dhe amfibet). Për këtë qëllim, fillimisht, duhet të kryhet një studim apo të përmbledhen të dhënat nga monitorimet ekzistuese rreth vdekshmërisë së kafshëve të egra në rrugë. Pastaj, bazuar në gjetjet e studimit, do të krijohen lehtësira për migrimin e kafshëve të egra. Në kuadër të kësaj mase, do të përgatitet një liste prioritare e zonave "te zeza" ku kafshët rrezikohen me shume dhe në këto zona do të zbatohen masat zbutëse përkatëse (sistemim të vendkalimeve, gardhe anësore etj.). Gjithashtu kjo gjë ndikon pozitivisht në përmirësimin e sigurisë së trafikut.
- Në zonat ku planifikohet infrastruktura e re, duhet të sigurohet ruajtja e rrugëve ekzistuese të migrimit, duke ndërtuar strukturat e duhura dhe duke kryer gjithë sistemimet e tjera për të parandaluar lëvizjen e kafshëve të egra (sidomos mishngrënësve, lakuriqëve të natës dhe amfibeve).

Këto masa do të lehtësojnë lidhjet mes habitateve (rivendosin apo ruajnë rrugët e migrimit) të specieve dhe arrijnë e objektivat mjedisore që lidhen me mbrojtjen e natyrës.

10.6 Zhurmat

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 9

Kur të planifikohen politikat për zhvillimin e infrastrukturës së parashikuar, në mënyrë që të zvogëlohet ndotja akustike në mjedis në përputhje me objektivat e përcaktuara në SKZHI II, është e nevojshme të sigurohen masa që kontribuojnë në:

- reduktimin e ekspozimit të zonave urbane ndaj ndikimeve negative;
- mbrojtjen e mjedisit.

Ndotja akustike është veçanërisht e lartë në qendrat urbane dhe në zonat e qendrave më të rëndësishme me zhvillime infrastrukturore. Prandaj është e domosdoshme që të merren masa për të zvogëluar ndotjen e mjedisit. Zbatimi i masave është i nevojshëm në zonat me ndotje të tepruar akustike në situatën aktuale, ndërsa duhet gjithashtu të merren masa zbutëse në të gjitha zonat ku Plani parashikon infrastrukture të re.

Masat për mbrojtjen e mjedisit nga zhurma në duhet të përqendrohet kryesisht në: (a) masat për të reduktuar emetimet e zhurmës në burim; (b) masat për të parandaluar shtrirjen e

zhurmës në mjedis; dhe (c) nëse është e nevojshme, masa për krijimin e kushteve të përshtatshme të jetesës në ndërtesat e mbiekspozuar.

Masat për të reduktuar emetimet e zhurmës në burim janë me të efektshme. Emetimet e reduktuara të zhurmës nga burimet e saj mund të arrihet kryesisht përmes modernizimit të logjistikës në përdorim, riorganizimit të flukseve të trafikut dhe orareve të kryerjes së ndërhyrjeve infrastrukturore, etj. Qëllimi i SKZHI II në lidhje me vlerat e zhurmës në vitin 2020 është të arrije objektivin e 56 dB/ditë dhe 45 dB/natë.

Masat për të siguruar kushte të duhura jetësore (përmirësimi me hapësira mbrojtëse i izolimit nga zhurma i dritareve në ndërtesat e ekspozuara së tepërmi) janë të përshtatshme në zonat ku masat e tjera nuk janë teknikisht të zbatueshme apo ekonomikisht të qëndrueshme.

Masa Zbutëse Specifike

Rritje e ndikimeve të ndotjes akustike pritët gjithashtu gjatë zbatimit të aktiviteteve të infrastrukturës. Ndikimet e fazës së ndërtimit do të jenë afatshkurtër dhe të kthyeshme. Në veçanti, për të reduktuar ndikimet gjatë zbatimit të aktiviteteve, duhet të merren masat e mëposhtme zbutëse:

- Përdorimi i pajisjeve dhe makinerive të ndërtimit të prodhuara në përputhje me normat e emetimeve të zhurmës nga makineritë të ndërtimit, në përputhje me rregullat mbi emetimet e zhurmës nga makineritë e përdorura në vende të hapura dhe në përputhje me direktivat përkatëse të BE-së;
- Do të ndiqen mënyrat më të mira të praktikueshme, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen e duhur të impianteve, për të minimizuar zhurmat e prodhuara nga operacionet në terren, dhe në të gjitha rastet, në përputhje me rregullat shqiptare;
- Sheshet e ndërtimit dhe rrugët e transportit duhet të zgjidhen në mënyrë të tillë që ndotja akustike nga makineritë e transportit, funksionimi i pajisjeve në kantier dhe ndërtimet e objekteve, të mos tejkalojë vlerat kufi në ndërtesat me të afërta;
- Çdo implant, i tillë si gjeneratorë apo pompa, që është i nevojshëm të përdoret para dhe pas orarit zyrtar të punës, do të jete i rrethuar nga një barrierë akustike apo reflektor portativ;
- Implementimi i masave të përkohshme për të mbrojtur nga zhurma zonat e populluara pranë kantierëve të ndërtimit dhe rrugëve të transportit ku janë tejkaluar vlerat kufi.
- Respektimi i afateve kohore për ndërtimin afër zonave të populluara;
- Publiku i gjerë dhe banoret e zonës do të informohen paraprakisht kur të kryhen vepra që emetojnë zhurma të konsiderueshme;
- Në kantierin e punimeve nuk do të përdoret asnjë makineri apo pajisje që shkakton shqetësim të publikut për shkak të zhurmës.

10.7 Popullsia dhe asetet materiale

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 10

Zhvillimet e reja infrastrukturore (sidomos qendrat multimediale të transportit) pritët që të shkaktojnë një rritje të niveleve të zhurmës në mjedisin përreth tyre. Për të shmangur një përkeqësim të mjedisit ku jetohet në zonën përreth këtyre zhvillimeve, ky fakt duhet të mbahet

në vëmendje kur të behet verifikimi i mundësive për zhvillim në fazat e mëvonshme, në kuadër të sigurimit të një lidhje multimodale në rajonin përreth.

Projektet specifike duhet të kenë në fokus edhe garantimin që infrastruktura e re vihet në dispozicion të të gjithë përdoruesve. Kjo pritet të inkurajojë përfshirjen me aktive të komunitetit në kuadër të sistemimeve infrastrukturore, në mënyrë që ta bëjë atë më të arritshme për të gjitha shtresat dhe kategoritë sociale.

Kur planifikohen politikat dhe projektet e reja, prioritet duhet t'i jepet përmirësimit të lidhjeve dhe zhvillimit në zonat më pak të zhvilluara. Zbatimi i projekteve të kësaj natyre do të përmirësojë aksesin, dhe kështu do të kontribuojnë në zhvillimin më të shpejtë ekonomik në zonat më pak të zhvilluara.

10.8 Trashëgimia kulturore

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 11

Zhvillimi i infrastrukturës së parashikuar mund të ndikojë të njësite dhe zonat kulturore, veçanërisht në aspektin e degradimit të karakteristikave të peizazhit të rrethinave të njësive të trashëgimisë kulturore, dëmtimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, si dhe shkatërrimit të mbetjeve arkeologjike nga vibrimet gjatë ndërtimit të objekteve të cilat mund të shkaktojnë dëme në objektet e trashëgimisë kulturore. Për të shmangur këto ndikime, duhet të merren parasysh si më poshtë:

- Prioritet është mos vendosja e infrastrukturës së re në zonat e trashëgimisë kulturore. Duhet të ruhet sidomos integriteti dhe tiparet e peizazheve kulturore, zonave të ndikimit të trashëgimisë arkitektonike dhe mbetjeve arkeologjike.
- Në kuadër të ruajtjes së mbetjeve arkeologjike, aktivitetet në mjedis konsiderohen akte destruktive (p.sh. gërmimi). Do të duhet të kryhen hulumtime të shumta paraprake arkeologjike, rezultatet e të cilave do të duhet të merren parasysh kur të përcaktohet vendosja e infrastrukturës së re. Gjithashtu do të duhet të zbatohen masat për të ruajtur mbetjet arkeologjike.
- Zbulimet e një rëndësie të madhe mund të kërkojnë ndryshimin e punëve përgatitore (projektit) për një detyrë të veçantë. Në rast të zbulimit të gjetjeve apo mbetjeve arkeologjike, do të njoftohet menjëherë autoriteti përkatës. Zona më pas do të studiohet dhe mundësisht do të rrethohet; duke mos lejuar asnjë zhvillim të mëtejshëm në atë zone derisa çështja të zgjidhet sipas procedurave të përcaktuara.
- Në rastet kur vendet arkeologjike mund të rrezikohen nga aktivitetet e ndërtimit, vendi do të jete i mbrojtur nga rrethimi për të parandaluar dëmtimin e paqëllimshëm ose si pasoje e neglizhencës ndaj arkeologjisë.
- Me integrimin e infrastrukturës së parashikuar në mjedis, përmirësimet brenda korridoreve apo strukturave ekzistuese kanë përparësi mbi ndërtimet e reja.
- E gjithë puna e ndërtimit do të jetë e kufizuar brenda korridorit të punimeve. Në rast se nevojiten më shumë hapësira ose aktivitete të lidhura me ndërtimin jashtë korridorit të punimeve, do të informohen paraprakisht autoritetet kombëtare përkatëse.

10.9 Peizazhi

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 12

Për të siguruar ruajtjen e peizazheve të jashtëzakonshme, zonave të peizazheve me karakteristika të dallueshme në nivel kombëtar dhe një imazh të cilësisë së larte të peizazhit, duhet të ndiqen udhëzimet e mëposhtme:

- Ndërhryjet e infrastrukturës së re nuk duhet të integrohen në zonat e veçanta të peizazhit apo peizazheve me karakteristika të dallueshme në nivel kombëtar;
- Në integrimin hapësinor të projekteve specifike duhet të kërkohen vende jashtë zonave me peizazhe të veçantë apo zonave me peizazhe me karakteristika të dallueshme në nivel kombëtar;
- Duhet të zbatohen masat e duhura teknike për të siguruar një imazh të cilësisë së larte të peizazhit, veçanërisht në rastin e aktiviteteve në njësite e ruajtura apo të pasura kulturore të natyrës;
- Me integrimin e infrastrukturës së parashikuar në mjedis, përmirësimet brenda korridoreve apo strukturave ekzistuese kane përparësi mbi ndërtimet e reja.

10.9.1 Strategjia e Peizazhit

Në rastet kur projekti specifik i mbivendoset ndonjë peizazhi ekzistues bujqësor apo rural, duhet të ndiqet një qasje ku synohet mbrojtja e vlerave rurale dhe rezidenciale dhe pasurimi i peizazhit përgjatë aneve të rrugës. Objektivat e punimeve peizazhistike:

- Të zhvillohet një peizazh, karakteristikat e të cilit lidhen me modelin, shkallen dhe diversitetin e karakteristikave të peizazhit ekzistues;
- Të minimizohen ndërhryjet vizuale dhe të zvogëlohet natyra negative e çdo pengese vizuale;
- Për të mbrojtur, të rikthehen apo të zmadhohen elementet e peizazhit ekzistues, të prekur drejtpërdrejt nga propozimi;
- Të ndihmohet në krijimin e kushteve të këndshme e të sigurta të drejtimit të mjeteve;

10.9.2 Masat e përgjithshme zbutëse ndaj peizazhit

Gjatë zgjedhjes dhe projektimit të detyrave të propozuara, konsideratë duhet t'i jepet shmangies së ndikimeve kudo që të jete e mundur në këtë kuadër, alternativa përfundimtare e miratuar për çdo projekt duhet të zgjidhet e tille që të minimizojë ku të jete e mundur ndikimin në karakteristikat e banimit, karakteristikat topografike, pemët dhe pyjet. Megjithatë, disa ndikime janë të pashmangshme, dhe masat e propozuara synojnë të zbutin natyrën negative të këtyre ndikimeve.

Në rastet kur shtrirja vertikale propozon argjinatura të larta që krijojnë ndikime të rëndësishme në mjedis, këto përf forcime të larta nuk duket të jenë optimizuar. Ato duhet të jenë ku është e mundur, të reduktuara deri në nivelin e tokës apo 1m lartësi.

Masa të tjera të përgjithshme përfshijnë:

- Në skarpata, për të parandaluar rënien e shkëmbinjve, duhet të jenë më të preferueshme bordurat e gjera se platformat e ndërmjetme. Skajet e skarpatave duhet të rrumbullakosen. Shpatet e parregullta duhet të jenë më të preferueshme se sipërfaqet geometrike.

- Zbatimin e standardeve kombëtare shqiptare të rrugëve për pastrimin e kantierëve dhe rivegjetacionin, për të siguruar ruajtjen e komoditeteve të nevojshme të peizazhit.
- Për mbushje, shpatet duhet ti nënshtrohen mbjelljes hidraulike me një përzierje fare që përfshin si farat e barit, ashtu edhe të shkurreve mesdhetare. Përveç kësaj, mbjellja në vendet e ndjeshme, veçanërisht në afërsi të ambienteve të banimit dhe rekreacionit, do të përdoret për të reduktuar apo zbutur pengesat vizuale të shkaktuara nga ngritja e argjinaturave të projektit, sidomos në kryqëzime.
- Për zonat potenciale në një nivel (pas optimizmin të lartësisë së projektit) bimësia e propozuar do të përmirësojë ndikimet negative të automjeteve, si dhe hapësirën vizuale të projektit të propozuar.
- Përgjatë gjatësisë së projektit përkatës do të trajtohen sipas rastit: venddepozitimet për mbeturinat, zonat e përkohshme të ndërtimit, zonat e peizazhit brenda kryqëzimeve, zonat e vogla të fushave të copëzuara, feramat apo pronat e tjera të siguruara për ndërtimin e projektit. Zonat e përkohshme të ndërtimit do të jenë të rrethuara dhe të integruara vizualisht duke përdorur mbjelljen e bimëve sipas kërkesës.

Masa Zbutëse Specifike

- Në zonat kodrinore/malore, hapësira që kërkon okupimin e tokës do të ruhet në minimum, me qëllim që të shmanget prerja e panevojshme e pemëve.
- Në zonat përgjatë brigjeve detare/lumore, sipërfaqja e tokës së okupuar do të mbahet në minimum, me qëllim shmangien e prerjes së panevojshme të pemëve në këto zona.
- Aty ku është e mundur, argjinaturat e projektit duhet të ulen në minimumin e mundshëm.
- Pjerrësitë e argjinaturave do të jenë sa më të buta. Mbi gjithë argjinaturat do të shpërndahet dhë, dhe ato do të mbillen me bime që mund të adoptohen në kushtet lokale.
- Në vendet ku rruga kalon pranë pronave private, do të ngrihen mbulesa bimore, me qëllim reduktimin e ndërhyrjes pamore.

SEKSIONI 11: MONITORIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Sistemi i monitorimit të ndikimeve në mjedis, të cilat do të shkaktohen nga zbatimi i Planit, është një mjet i thjeshtë për t'u përdorur për një monitorim efektiv.

Monitorimi i ndikimeve është jashtëzakonisht i rëndësishëm për zbatimin e Planit, dhe në përputhje me Ligjin 91/2013 dhe Direktivën 2001/42/EC, zbatimi i një program duhet të monitorohet, me qëllim që të identifikohen efektet negative të paparashikuara, në mënyrë që të krijohet mundësia për një reagim të hershem ndaj këtyre efekteve dhe të bëhen adaptimet e mundshme.

Në këtë kuadër, është hartuar edhe sistemi i monitorimit të ndikimeve kryesore në mjedis, të cilat pritet që të shkaktohen nga zbatimi i Planit. Këto ndikime janë identifikuar gjatë Vlerësimit të ndikimeve mjedisore të planit përkatës. Sistemi i monitorimit përfshin të gjithë indikatorët përkatës për çdo sektor mjedisor (biodiversiteti, cilësia e ajrit, ndryshimet klimatike, toka, uji, peizazhi, trashëgimia kulturore, etj.) dhe identifikon autoritetin dhe përgjegjësinë për matjen e çdo indikatorit mjedisor të propozuar.

Grumbullimi i të dhënave sugjerohet që të mbështetet në dy burime:

- (a) të dhënat e para që merren nga matja e parametrave të mjedisit;
- (b) Vlerësimi i indikatorëve mjedisore.

Procesi i mbledhjes së të dhënave përmes matjeve mund të realizohet duke përfshirë Autoritetet Rajonale, por edhe Institucionet Shtetërore (përmes Ministrisë së Mjedisit), Pushtetin Lokal, institucione kërkimore shkencore dhe ato profesionale, si dhe ndërmarrjet e shërbimeve publike (landfillet, ujësjellës – kanalizime etj.). Matja e indikatorëve mjedisore është një proces kompleks; ai është një proces që kryhet rregullisht dhe për më tepër, në mënyrë të vazhdueshme.

Në këtë këndvështrim duhet që të bazohemi në eksperiencën dhe në sistemet e monitorimit që përdoren nga strukturat e tjera, duke theksuar, nga njëra anë, monitorimin e zbatimit të standardeve të nevojshme të matjeve nga strukturat e tjera, dhe kryesisht nga operatorët përkatës (përmes përfshirjes së tyre në procesin e nxjerrjes së lejeve përkatëse mjedisore), dhe nga ana tjetër, duke u përqendruar tek procesi i grumbullimit, përpunimit dhe shpërndarjes së të dhënave.

Autoritetet Rajonale duhet të luajnë një rol kyç në procesin e administrimit dhe shpërndarjes së të dhënave. Në këtë kontekst, autoritetet përkatëse duhet të planifikojnë dhe të veprojnë si një qendër mbledhjeje, analizimi dhe shpërndarjeje të informacionit. Me konkretisht, roli i Autoriteteve Rajonale duhet të përfshijë sa më poshtë:

- Mbledhjen e të dhënave prej matjeve që kryhen nga shërbimet publike dhe private rajonale, qoftë në mënyrë të përhershme, qoftë të përkohshme.
- Mbledhjen e të dhënave baze që kryhet nga ndërmarrjet e shërbimeve publike (landfillet, ujësjellës kanalizime, OSHEE, strukturat e menaxhimit të zonave të mbrojtura etj.).
- Marrjen e të dhënave baze që mblidhen nga administrata publike (si p.sh. Sistemi Kombëtar i Monitorimit të Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësore, etj.).
- Marrjen e të dhënave bazë që mblidhen nga institucionet kërkimore shkencore dhe organizata të tjera.

- Analizën dhe sintezën e të dhënave, me qëllim nxjerrjen e konkluzioneve mbi gjendjen e mjedisit në një zone të caktuar.
- Ruajtjen e të dhënave dhe krijimin e intervaleve kohore me qëllim monitorimin e gjendjes së mjedisit në kohe të caktuara.
- Shpërndarjen e të dhënave përmes raporteve përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Këto raporte synojnë qe:

- (a) të plotësojnë kërkesat e legjislacionit,
- (b) të informojnë palët që marrin pjesë në procesin e planifikimit dhe monitorimit të zbatimit të Planit (vendim-marrësit),
- (c) të informojnë publikun që preket nga Plani.

Tabela me poshtë paraqet programin e monitorimit të ndikimeve mjedisore të Planit. Tabela është hartuar sipas sektorëve të mjedisit si me poshtë:

- ✦ Biodiversiteti
- ✦ Popullsia
- ✦ Shëndeti i njerëzve
- ✦ Fauna
- ✦ Flora
- ✦ Toka
- ✦ Uji
- ✦ Ajri
- ✦ Faktorët klimatike
- ✦ Asetet e prekshme
- ✦ Trashëgimia kulturore (përfshirë trashëgiminë arkitektonike dhe arkeologjike)
- ✦ Peizazhi
- ✦ Lidhja mes këtyre faktorëve

Për çdo sektor mjedisor janë dhënë indikatorët përkatës, strukturat përgjegjëse për monitorimin, parametrat mjedisore dhe frekuenca e monitorimit.

Siç u përmend edhe me sipër, theksohet që monitorimi i ndikimeve të Planit në mjedis do të realizohet, aty ku është e mundur, duke përdorur të dhëna që dalin nga:

- ✓ Sistemi ekzistues i monitorimit të parametrave mjedisore nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) apo institucione të tjera. Disa parametra që maten dhe japin të dhëna janë:
 - Cilësia e ajrit (niveli i ndotjes),
 - Cilësia e ujit (ujerat sipërfaqësore, ujerat nëntokësore).
- ✓ Studime të veçanta dhe të pavarura për identifikimin e ndikimeve mjedisore në kuadër të programeve apo projekteve të tjera.
- ✓ Raportet e përgatitura nga kontraktorë/konsulentë të ndryshëm, me të dhëna të drejtpërdrejta ose të referuara nga VNM-te individuale të projekteve specifike infrastrukturore të financuara nga buxheti i shtetit apo donatorët e huaj

Tabela 11.1 Monitorimi i ndikimeve në mjedis prej zbatimit të planit

Faktori Mjedisor	INDIKATORI	AUTORITETI MONITORUES	PARAMETRAT MJEDISORE	FREKUENCA E MONITORIMIT	KOMENTE
Biodiversiteti-fauna - flora	- Numri i habitateve të rëndësishme - Sipërfaqja me zona të mbrojtura - Biodiversitetit - Ekonomia pyjesh - Zona natyrore	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Administrata e Zonave të Mbrojtura Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Drejtoria e Zhvillimit Rajonal & Integrimit Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve	- Numri dhe gjendje e habitateve - Numri dhe/ose sipërfaqja me zona të mbrojtura - Numri i specieve endemike dhe të rralla - Sipërfaqja e mbuluar me pyje - Numri i zonave natyrore dhe sipërfaqja e tyre.	Sipas Planit të Menaxhimit Çdo vit	
Popullsia shëndetë e njerëzve	- Jetëgjatësia e popullsisë - Aksidentet në pune - Varfëria	Drejtoria e shëndetit Publik Inspektorati Shtetëror i Punës Shërbimi Kombëtar i Punësimit	- Vitet e jetëgjatësisë së shëndetshme - Numri i aksidenteve të regjistruara - Përqindja e njerëzve që jetojnë nën minimumin jetik	Çdo vit	
Toka	- Degradimi i tokës - Menaxhimi i mbetjeve - Prodhimi i mbetjeve - Riciklim dhe ripërdorim i mbetjeve	Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Ministria e Bujqësisë Bashkia dhe Ministria e Transporteve dhe Infrastrukturës Bashkia	- Përqindja e tokës së degraduar - Sasitë e mbetjeve të eliminuara në landfille - Gjenerimi i mbetjeve për fryme dhe totali % e ricikluar (letër, xham, mbetje bashkiake bio të degradueshme, alumin)	Çdo vit	

Uji	- Cilësia e ujerave sipërfaqësore - Cilësia e ujerave nëntokësore - Përqindja e riciklimit të ujit - Përqindja e popullsisë së lidhur me shërbimin e trajtimit të ujerave të ndotur	Autoriteti i Menaxhimit të Baseneve Këshilli Teknik i Ujit Agjencia Kombëtare e Mjedisit Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	- Total N, total P, BOD-et, COD, SS, TDS, pH, përcjellshmëria, etj. - pH, përcjellshmëri, fortësia, kloridet, sulfatët, COD, BOD, nitrati, nitrimi, total P, metalet, detergjentet, ngarkesa toksike e mikrobiologjike, etj.	Kampionim dhe matje sipas miratimit të kushteve mjedisore për çdo ITUN, çdo 6 muaj.	- Sipas Ligjit nr. 34/2013 qe amendon Ligin nr. 9115, datë 24.7.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujerave të ndotura" - Ligji nr. 9915, datë 12.05.2008 "Për Kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujerave të ndotura"
Ajri	- Ditët kur tejkalohen normat e cilësisë së ajrit⁹ - Shkarkimet sipas Burimit	Agjencia Kombëtare e Mjedisit	SOx, NOx, PM10, gazet sere, Pb, CO	Çdo vit	Sistemi i Monitorimit të Cilësisë së Ajrit të Ndotur
Faktorët Klimatike	- Shkarkimet e Gazeve Sere(sipas burimit %) - kërkesa për energji (Alokimi i prodhimit të energjisë sipas burimit) - Përqindja e BER¹⁰(%) - Mjetet në qarkullim	Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Enti Rregullator i Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor	SOx, NOx, PM10, gazet sere, Pb, CO Përqindja e Energjisë nga BER (%) Numri i automjeteve të udhëtareve	Çdo vit	Sistemi i Monitorimit të Cilësisë së Ajrit të Ndotur
Trashëgimi a kulturore Peizazhi	- Numri i godinave të ruajtura që restaurohen - Numri i vizitoreve - Gjelbërim urban për frymë	Bashkia, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Ministria e Ekonomisë dhe Turizmit	Numri i godinave të ruajtura që restaurohen Numri i vizitoreve Gjelbërim urban për frymë	Çdovit	

⁹Kufijtë Kombëtar për cilësinë e ajrit (SKZHI II)

¹⁰BER-Burimet e Energjisë së Rinovueshme

SEKSIONI 12: PROCESI I KONSULTIMEVE

Pjesëmarrja e grupeve të interesit dhe konsultimi me ta ka qenë një pjesë integrale e procesit të hartimit të VSM-së. Përfshirja efektive e grupeve përkatëse të interesit ka dhënë kontributin në cilësinë e Vlerësimit, ka sjelle të dhëna për analizën dhe raportin e VSM-se, dhe do të mbështesë zbatimin e planit pas miratimit të tij, si dhe do të kontribuojë në një pranim me të lehte dhe me të zbutur të projekteve përkatës.

Qëllimi i konsultimeve me grupet e interesit ka qenë i dyanshëm:

1. Krijimi i mundësisë për të gjitha grupet e interesit që, në mënyrë efektive dhe në kohën e duhur, të kontribuonin në procesin e VSM-se, duke dhënë opinionet dhe duke bere komentet përkatëse.
2. Marrja e informacionit, mbledhja e të dhënave dhe verifikimi i gjetjeve dhe konkluzioneve të VSM-se.

Për të pasur konsultime dhe pjesëmarrje efektive të grupeve të interesit është bere identifikimi i tyre, është përcaktuar qëllimi i angazhimit të tyre dhe janë përzgjedhur mënyrat e konsultimit dhe pjesëmarrjes.

Gjatë procesit të hartimit të VSM-së janë konsultuar grupet e mëposhtme:

- Ministritë e linjës
- Autoritetet mjedisore
- Njësitet e qeverisjes vendore
- OJF-te
- Universitetet
- Publiku i gjerë

Datë 24.07.2016 Dëgjese publike

Ditën e hënë, më 24 korrik, konsulenti në bashkëpunim me bashkinë Vau-Dejës dhe me pranimin e përfaqësuesit të Ministrisë së Mjedisit organizua takimin e parë lidhur me Vlerësimin Strategjik Mjedisor. Në këtë takim u prezantuan pikat dhe çështjet kryesore që do të trajtohen në raportin paraprak të VSM-së. Në përfundim të takimit u diskutua lidhur edhe me shqetësimet e specialistëve të bashkisë mbi mjedisin.



Vlerësimi Strategjik Mjedisor
Konsultim me grupet e Interesit

Emri Mbledhësi	Institucioni	Positioni	Tel. / Cel.	E-mail
Edna Gerbeti	B. V. Daga	Imp. e Pjesësi	0695152655	zija.gerbeti@johorif
Drusata Lumani	Ministria e Mbrojtjes	Specialiste	0675802164	drusata.lumani@gmail.com
Admiral Hasanbegaj	Instituti Vendiçor M. K. K. K.		0682022240	admiral.hasanbegaj@vendiçor.gov.al
Edna Gjergji	B. V. Daga	Imp. e Pjesësi	0695152655	edna.gjergji@vendiçor.gov.al
Nikolina Karamitri	B. V. Daga	Imp. e Pjesësi	0673760836	nikolina.karamitri@vendiçor.gov.al
Joseta Markolej	B. V. Daga	Imp. e Pjesësi	0695498711	joseta.markolej@vendiçor.gov.al
Indrit Gjonçec	B. V. Daga	Imp. e Pjesësi	0692613094	indrit.gjonçec@vendiçor.gov.al
Anisa Llango	UTS-01	Imp. e Pjesësi	0695519234	anisa.llango@live.com
Adriana Mulla	UTS-01	Imp. e Pjesësi	0624666080	adriana.mulla@vendiçor.gov.al
Adriana Mulla	UTS-01	Imp. e Pjesësi	0634666080	adriana.mulla@vendiçor.gov.al

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR

BASHKIA VAU-DEJËS



VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

Konsultimi me publikun për çështjet që do të trajtohen në Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM), bazohet në:

Vendimin nr.219, datë 11.03.2015 "Për përcaktimin e rregullore e të procedurave për konsultimet me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

Konsultimi me grupet e interesit është i regulluar (angazhimi që Qeveria dhe Bashkia kanë marrë në përfshirjen e publikut në vendim-marrje, në të gjitha çështjet që prekin interesin e tij.

Ky takim paraqet momentin e radhës të përfshirjes së drejtpërdrejtë të grupeve të interesit në hartimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor në kuadër të Planit të Përgjithshëm Vendorë për Bashkinë Vau-Dejë.



**ÇËSH TJET KRYESORE MJEDISORE QË DO TË TRAJTOHEN
NË RAPORTIN E VSM-SË**



-TOKA

Territori i ri i Bashkisë Vau-Dejës karakterizohet nga një larmishmëri e madhe tokash, të cilat përdoren për bujqësi, industri, aktivitete të ndryshme minerare, turizëm malor etj.

**ÇËSH TJET KRYESORE MJEDISORE QË DO TË TRAJTOHEN
NË RAPORTIN E VSM-SË**



-Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore

Zhvillimin e bujqësisë në këtë bashki, përç klimës dhe tokave të përshtatshme e ka favorizuar edhe rrjeti hidrografik që përshkon territorin e tij.

Cilat janë politikat që mendohen të ndiqen në vitet e ardhshme për mbrojtjen dhe ruajtjen e burimeve ujore mbeten ende në proces hartimi.

**ÇËSHJET KRYESORE MJEDISORE QË DO TË TRAJTOHEN
NË RAPORTIN E VSM-SË**



-Menaxhimi i mbetjeve

Ndonëse kjo Bashki është angazhuar në zbatimin me sukses të Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, menaxhimi i tyre mbetet ende problematik, dhe një sfidë kryesore sidomos mbas Reformës së re Territoriale.

**ÇËSHJET KRYESORE MJEDISORE QË DO TË TRAJTOHEN
NË RAPORTIN E VSM-SË**



-AJRI DHE CILËSIA E TIJ

Cilësia e ajrit ka problematikat e veta të cilat lidhen ngushtë me aktivitete të caktuara industriale, ndërtimore, transportit, djegien e mbetjeve dhe materialeve të tjera.


**ÇËSHJET KRYESORE MJEDISORE QË DO TË TRAJTOHEN
NË RAPORTIN E VSM-SË**



-PYJET DHE KULLOTAT

Territoret e kësaj bashkie janë të pasura me sipërfaqe pyjore dhe kullosore, të cilat këto 20 vitet e fundit kanë pësuar ndryshime të mëdha.

**ÇËSHJET KRYESORE MJEDISORE QË DO TË TRAJTOHEN
NË RAPORTIN E VSM-SË**



-Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura

Sipërfaqja e Bashkisë Vau-Dejës, paraqet vlera të larta përsa i takon biodiversitetit, si dhe ka në brendësi të saj sipërfaqe të konsiderueshme të zonave të mbrojtura.

Dëgjese Publike, datë 07.11.2017

Më datë 07 nëntor 2017, në komunën e Bushatit u organizua dëgjesa publike për Vlerësimin Strategjik Mjedisor. Në takim, përveç përfaqësuesve të komunitetit lokal dhe grupeve të interesit, morën pjesë: përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, administratorë të njësive administrative, përfaqësues nga Zyra e Planifikimit të Territorit të Bashkisë si dhe ekspertë të kompanisë konsulente UTS-01.

Konsulenti fillimisht prezantoi punën e bërë për hartimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe u kërkoi të pranishmëve sugjerime dhe mendime në lidhje me dokumentin e paraqitur.

Ndër të tjera, pikat kryesore për të cilat u diskutua ishin:

- Propozimi për të zgjeruar zonën e mbrojtur të propozuar "Parku rajonal i luginës së Drinit";
- Reflektimi i vlerave finale të planit të zhvillimit të territorit në VSM;

Në mbyllje të dëgjesës u theksua edhe njëherë rëndësia e përfshirjes së komunitetit dhe grupeve të interesit në këtë proces.





Vlerësimi Strategjik Mjedisor Bashkia Vau-Dejës


plan i përgatitur në vend

Prezantimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor

DËGJESE PUBLIKE – RAPORTI PARAPRAK

- Vau-Dejës, 07 nëntor 2017 -

SISTEMET TERRITORIALE (Përdorimi i Tokës)



SISTEMI I PERDORIMIT TË TOKËS

	%	%
SISTEMI NATYROR	68.89	69.27
SISTEMI UJOR	5.1	5.1
SISTEMI BUJQËSOR	19.52	21.33
SISTEMI URBAN	5.95	3.72
SISTEMI INFRASTRUKTUROR	0.52	0.56

OBJEKTIVAT MJEDISORE

Toka

Objektiva Mjedisore 1 (OM 1): Garantimi i menashimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të tokës dhe mbrojtja e saj.

Objektiva Mjedisore 2 (OM 2): Parandalimi i shfrytëzimit të burimeve natyrore, duke rritur nivelin e përdorimit të materialeve të riciklueshme nga mbetjet që gjenerohen gjatë ndërtimit/rehabilitimit të infrastrukturës.

Airi

Objektiva Mjedisore 3 (OM 3): Garantimi i arritjes së objektivave afatgjata për sajtë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, për të arritur përputhshmërinë me kufijtë maksimale të lejueshëm nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferike.

Erësonat klimatike

Objektiva Mjedisore 4 (OM 4): Adoptimi i infrastrukturës në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sajtë vjetore të emetimeve të gazeve serë në nivelet e përcaktuara në SKZH II.

Ujë

Objektiva Mjedisore 5 (OM 5): Kufizimi i efektëve negative mbi ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore, ujërat e njehtët, ujërat bregdetare dhe burimet e ujit të pijshëm.

Mjedi natyror

Objektiva Mjedisore 6 (OM 6): Garantimi i kohëzimit të popullatave dhe mbrojtjes së biodiversitetit.

Objektiva Mjedisore 7 (OM 7): Ruajtja e zonave që kanë një status të veçantë mbrojtjeje, prej aktivitetëve me ndikime të konsiderueshme.

OBJEKTIVAT MJEDISORE

Mbetjet

Objektiva Mjedisore 8 (OM 8): Kompletimi i tërësor i infrastrukturës së landfillëve e incineratoreve dhe qëndrueshëm reduktimi i sajtë të depozitimit të mbetjeve në landfill nëpërmjet proceseve të reduktimit dhe rritjes së riciklimit e ripërdorimit.

Zhurma

Objektiva Mjedisore 9 (OM 9): Reduktimi i ndotjes së zhurmës/akustike dhe përfundimi me nivelet e rekomanduara nga BE dhe OBSH.

Popullsia dhe asetet materiale

Objektiva Mjedisore 10 (OM 10): Përmirësimi i kohëzimit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme.

T trashëgimia Kulturore

Objektiva Mjedisore 11 (OM 11): Ruajtja e shtrirjes, përmbajtjes dhe veçantive të zonave dhe strukturave të trashëgimisë kulturore.

Peizazhi

Objektiva Mjedisore 12 (OM 12): Garantimi i ruajtjes së peizazheve të veçanta dhe zonave peizazhike me veçori dalluese në nivel kombëtar dhe krijimi i një imazhi peizazhi me cilësi të lartë.

[illegible]

- 1- PAKILIA ME SMERKIAUS BAZE
- 2- LÉVILIA ME MĖNYRA TĖ MONTAIME
- 3- CHONDEAT URSANI
- 4- TURIZM
- 5- MUJOMIA, ELBOTORIA DNE KULTIVIM I PESKUT
- 6- ENEROLIA

Քվե-պնակակազմ	Խմբի քվե-պնակակազմ	Խմբի քվե-պնակակազմ
Քվե-պնակակազմի քվե-պնակակազմ	1	1-10
Քվե-պնակակազմի քվե-պնակակազմ	2	11-20
Քվե-պնակակազմի քվե-պնակակազմ	3	21-30
Քվե-պնակակազմի քվե-պնակակազմ	4	31-40
Քվե-պնակակազմի քվե-պնակակազմ	5	41-50

Objekt des Monitoring	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032	2033	2034	2035	2036	2037	2038	2039	2040	2041	2042	2043	2044	2045	2046	2047	2048	2049	2050	2051	2052	2053	2054	2055	2056	2057	2058	2059	2060	2061	2062	2063	2064	2065	2066	2067	2068	2069	2070	2071	2072	2073	2074	2075	2076	2077	2078	2079	2080	2081	2082	2083	2084	2085	2086	2087	2088	2089	2090	2091	2092	2093	2094	2095	2096	2097	2098	2099	2100	2101	2102	2103	2104	2105	2106	2107	2108	2109	2110	2111	2112	2113	2114	2115	2116	2117	2118	2119	2120	2121	2122	2123	2124	2125	2126	2127	2128	2129	2130	2131	2132	2133	2134	2135	2136	2137	2138	2139	2140	2141	2142	2143	2144	2145	2146	2147	2148	2149	2150	2151	2152	2153	2154	2155	2156	2157	2158	2159	2160	2161	2162	2163	2164	2165	2166	2167	2168	2169	2170	2171	2172	2173	2174	2175	2176	2177	2178	2179	2180	2181	2182	2183	2184	2185	2186	2187	2188	2189	2190	2191	2192	2193	2194	2195	2196	2197	2198	2199	2200	2201	2202	2203	2204	2205	2206	2207	2208	2209	2210	2211	2212	2213	2214	2215	2216	2217	2218	2219	2220	2221	2222	2223	2224	2225	2226	2227	2228	2229	2230	2231	2232	2233	2234	2235	2236	2237	2238	2239	2240	2241	2242	2243	2244	2245	2246	2247	2248	2249	2250	2251	2252	2253	2254	2255	2256	2257	2258	2259	2260	2261	2262	2263	2264	2265	2266	2267	2268	2269	2270	2271	2272	2273	2274	2275	2276	2277	2278	2279	2280	2281	2282	2283	2284	2285	2286	2287	2288	2289	2290	2291	2292	2293	2294	2295	2296	2297	2298	2299	2300	2301	2302	2303	2304	2305	2306	2307	2308	2309	2310	2311	2312	2313	2314	2315	2316	2317	2318	2319	2320	2321	2322	2323	2324	2325	2326	2327	2328	2329	2330	2331	2332	2333	2334	2335	2336	2337	2338	2339	2340	2341	2342	2343	2344	2345	2346	2347	2348	2349	2350	2351	2352	2353	2354	2355	2356	2357	2358	2359	2360	2361	2362	2363	2364	2365	2366	2367	2368	2369	2370	2371	2372	2373	2374	2375	2376	2377	2378	2379	2380	2381	2382	2383	2384	2385	2386	2387	2388	2389	2390	2391	2392	2393	2394	2395	2396	2397	2398	2399	2400	2401	2402	2403	2404	2405	2406	2407	2408	2409	2410	2411	2412	2413	2414	2415	2416	2417	2418	2419	2420	2421	2422	2423	2424	2425	2426	2427	2428	2429	2430	2431	2432	2433	2434	2435	2436	2437	2438	2439	2440	2441	2442	2443	2444	2445	2446	2447	2448	2449	2450	2451	2452	2453	2454	2455	2456	2457	2458	2459	2460	2461	2462	2463	2464	2465	2466	2467	2468	2469	2470	2471	2472	2473	2474	2475	2476	2477	2478	2479	2480	2481	2482	2483	2484	2485	2486	2487	2488	2489	2490	2491	2492	2493	2494	2495	2496	2497	2498	2499	2500	2501	2502	2503	2504	2505	2506	2507	2508	2509	2510	2511	2512	2513	2514	2515	2516	2517	2518	2519	2520	2521	2522	2523	2524	2525	2526	2527	2528	2529	2530	2531	2532	2533	2534	2535	2536	2537	2538	2539	2540	2541	2542	2543	2544	2545	2546	2547	2548	2549	2550	2551	2552	2553	2554	2555	2556	2557	2558	2559	2560	2561	2562	2563	2564	2565	2566	2567	2568	2569	2570	2571	2572	2573	2574	2575	2576	2577	2578	2579	2580	2581	2582	2583	2584	2585	2586	2587	2588	2589	2590	2591	2592	2593	2594	2595	2596	2597	2598	2599	2600	2601	2602	2603	2604	2605	2606	2607	2608	2609	2610	2611	2612	2613	2614	2615	2616	2617	2618	2619	2620	2621	2622	2623	2624	2625	2626	2627	2628	2629	2630	2631	2632	2633	2634	2635	2636	2637	2638	2639	2640	2641	2642	2643	2644	2645	2646	2647	2648	2649	2650	2651	2652	2653	2654	2655	2656	2657	2658	2659	2660	2661	2662	2663	2664	2665	2666	2667	2668	2669	2670	2671	2672	2673	2674	2675	2676	2677	2678	2679	2680	2681	2682	2683	2684	2685	2686	2687	2688	2689	2690	2691	2692	2693	2694	2695	2696	2697	2698	2699	2700	2701	2702	2703	2704	2705	2706	2707	2708	2709	2710	2711	2712	2713	2714	2715	2716	2717	2718	2719	2720	2721	2722	2723	2724	2725	2726	2727	2728	2729	2730	2731	2732	2733	2734	2735	2736	2737	2738	2739	2740	2741	2742	2743	2744	2745	2746	2747	2748	2749	2750	2751	2752	2753	2754	2755	2756	2757	2758	2759	2760	2761	2762	2763	2764	2765	2766	2767	2768	2769	2770	2771	2772	2773	2774	2775	2776	2777	2778	2779	2780	2781	2782	2783	2784	2785	2786	2787	2788	2789	2790	2791	2792	2793	2794	2795	2796	2797	2798	2799	2800	2801	2802	2803	2804	2805	2806	2807	2808	2809	2810	2811	2812	2813	2814	2815	2816	2817	2818	2819	2820	2821	2822	2823	2824	2825	2826	2827	2828	2829	2830	2831	2832	2833	2834	2835	2836	2837	2838	2839	2840	2841	2842	2843	2844	2845	2846	2847	2848	2849	2850	2851	2852	2853	2854	2855	2856	2857	2858	2859	2860	2861	2862	2863	2864	2865	2866	2867	2868	2869	2870	2871	2872	2873	2874	2875	2876	2877	2878	2879	2880	2881	2882	2883	2884	2885	2886	2887	2888	2889	2890	2891	2892	2893	2894	2895	2896	2897	2898	2899	2900	2901	2902	2903	2904	2905	2906	2907	2908	2909	2910	2911	2912	2913	2914	2915	2916	2917	2918	2919	2920	2921	2922	2923	2924	2925	2926	2927	2928	2929	2930	2931	2932	2933	2934	2935	2936	2937	2938	2939	2940	2941	2942	2943	2944	2945	2946	2947	2948	2949	2950	2951	2952	2953	2954	2955	2956	2957	2958	2959	2960	2961	2962	2963	2964	2965	2966	2967	2968	2969	2970	2971	2972	2973	2974	2975	2976	2977	2978	2979	2980	2981	2982	2983	2984	2985	2986	2987	2988	2989	2990	2991	2992	2993	2994	2995	2996	2997	2998	2999	3000
Objekt des Monitoring	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032	2033	2034	2035	2036	2037	2038	2039	2040	2041	2042	2043	2044	2045	2046	2047	2048	2049	2050	2051	2052	2053	2054	2055	2056	2057	2058	2059	2060	2061	2062	2063	2064	2065	2066	2067	2068	2069	2070	2071	2072	2073	2074	2075	2076	2077	2078	2079	2080	2081	2082	2083	2084	2085	2086	2087	2088	2089	2090	2091	2092	2093	2094	2095	2096	2097	2098	2099	2100	2101	2102	2103	2104	2105	2106	2107	2108	2109	2110	2111	2112	2113	2114	2115	2116	2117	2118	2119	2120	2121	2122	2123	2124	2125	2126	2127	2128	2129	2130	2131	2132	2133	2134	2135	2136	2137	2138	2139	2140	2141	2142	2143	2144	2145	2146	2147	2148	2149	2150	2151	2152	2153	2154	2155	2156	2157	2158	2159	2160	2161	2162	2163	2164	2165	2166	2167	2168	2169	2170	2171	2172	2173	2174	2175	2176	2177	2178	2179	2180	2181	2182	2183	2184	2185	2186	2187	2188	2189	2190	2191	2192	2193	2194	2195	2196	2197	2198	2199	2200	2201	2202	2203	2204	2205	2206	2207	2208	2209	2210	2211	2212	2213	2214	2215	2216	2217	2218	2219	2220	2221	2222	2223	2224	2225	2226	2227	2228	2229	2230	2231	2232	2233	2234	2235	2236	2237	2238	2239	2240	2241	2242	2243	2244	2245	2246	2247	2248	2249	2250	2251	2252	2253	2254	2255	2256	2257	2258	2259	2260	2261	2262	2263	2264	2265	2266	2267	2268	2269	2270	2271	2272	2273	2274	2275	2276	2277	2278	2279	2280	2281	2282	2283	2284	2285	2286	2287	2288	2289	2290	2291	2292	2293	2294	2295	2296	2297	2298	2299	2300	2301	2302	2303	2304	2305	2306	2307	2308	2309	2310	2311	2312	2313	2314	2315	2316	2317	2318	2319	2320	2321	2322	2323	2324	2325	2326	2327	2328	2329	2330	2331	2332	2333	2334	2335	2336	2337	2338	2339	2340	2341	2342	2343	2344	2345	2346	2347	2348	2349	2350	2351	2352	2353	2354	2355	2356	2357	2358	2359	2360	2361	2362	2363	2364	2365	2366	2367	2368	2369	2370	2371	2372	2373	2374	2375	2376	2377	2378	2379	2380	2381	2382	2383	2384	2385	2386	2387	2388	2389	2390	2391	2392	2393	2394	2395	2396	2397	2398	2399	2400	2401	2402	2403																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																					

Paslygusioje yra kelios programos su baigimo paba ir objektyviais kriterijais Nr. 1 iki 2. Pateiktose i septyniolika klausimų, rasę pasirašyti arba įrašyti, laimėjimai kartais ar programai su patvirtintomis priemonėmis su šiais turimi ir apytiksliai lygiavimui su objektyviais kriterijais.


Taigi programų su baigimo paba ir objektyviais kriterijais Nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86, 87, 88, 89, 90, 91, 92, 93, 94, 95, 96, 97, 98, 99, 100, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 108, 109, 110, 111, 112, 113, 114, 115, 116, 117, 118, 119, 120, 121, 122, 123, 124, 125, 126, 127, 128, 129, 130, 131, 132, 133, 134, 135, 136, 137, 138, 139, 140, 141, 142, 143, 144, 145, 146, 147, 148, 149, 150, 151, 152, 153, 154, 155, 156, 157, 158, 159, 160, 161, 162, 163, 164, 165, 166, 167, 168, 169, 170, 171, 172, 173, 174, 175, 176, 177, 178, 179, 180, 181, 182, 183, 184, 185, 186, 187, 188, 189, 190, 191, 192, 193, 194, 195, 196, 197, 198, 199, 200, 201, 202, 203, 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 223, 224, 225, 226, 227, 228, 229, 230, 231, 232, 233, 234, 235, 236, 237, 238, 239, 240, 241, 242, 243, 244, 245, 246, 247, 248, 249, 250, 251, 252, 253, 254, 255, 256, 257, 258, 259, 260, 261, 262, 263, 264, 265, 266, 267, 268, 269, 270, 271, 272, 273, 274, 275, 276, 277, 278, 279, 280, 281, 282, 283, 284, 285, 286, 287, 288, 289, 290, 291, 292, 293, 294, 295, 296, 297, 298, 299, 300, 301, 302, 303, 304, 305, 306, 307, 308, 309, 310, 311, 312, 313, 314, 315, 316, 317, 318, 319, 320, 321, 322, 323, 324, 325, 326, 327, 328, 329, 330, 331, 332, 333, 334, 335, 336, 337, 338, 339, 340, 341, 342, 343, 344, 345, 346, 347, 348, 349, 350, 351, 352, 353, 354, 355, 356, 357, 358, 359, 360, 361, 362, 363, 364, 365, 366, 367, 368, 369, 370, 371, 372, 373, 374, 375, 376, 377, 378, 379, 380, 381, 382, 383, 384, 385, 386, 387, 388, 389, 390, 391, 392, 393, 394, 395, 396, 397, 398, 399, 400, 401, 402, 403, 404, 405, 406, 407, 408, 409, 410, 411, 412, 413, 414, 415, 416, 417, 418, 419, 420, 421, 422, 423, 424, 425, 426, 427, 428, 429, 430, 431, 432, 433, 434, 435, 436, 437, 438, 439, 440, 441, 442, 443, 444, 445, 446, 447, 448, 449, 450, 451, 452, 453, 454, 455, 456, 457, 458, 459, 460, 461, 462, 463, 464, 465, 466, 467, 468, 469, 470, 471, 472, 473, 474, 475, 476, 477, 478, 479, 480, 481, 482, 483, 484, 485, 486, 487, 488, 489, 490, 491, 492, 493, 494, 495, 496, 497, 498, 499, 500, 501, 502, 503, 504, 505, 506, 507, 508, 509, 510, 511, 512, 513, 514, 515, 516, 517, 518, 519, 520, 521, 522, 523, 524, 525, 526, 527, 528, 529, 530, 531, 532, 533, 534, 535, 536, 537, 538, 539, 540, 541, 542, 543, 544, 545, 546, 547, 548, 549, 550, 551, 552, 553, 554, 555, 556, 557, 558, 559, 560, 561, 562, 563, 564, 565, 566, 567, 568, 569, 570, 571, 572, 573, 574, 575, 576, 577, 578, 579, 580, 581, 582, 583, 584, 585, 586, 587, 588, 589, 590, 591, 592, 593, 594, 595, 596, 597, 598, 599, 600, 601, 602, 603, 604, 605, 606, 607, 608, 609, 610, 611, 612, 613, 614, 615, 616, 617, 618, 619, 620, 621, 622, 623, 624, 625, 626, 627, 628, 629, 630, 631, 632, 633, 634, 635, 636, 637, 638, 639, 640, 641, 642, 643, 644, 645, 646, 647, 648, 649, 650, 651, 652, 653, 654, 655, 656, 657, 658, 659, 660, 661, 662, 663, 664, 665, 666, 667, 668, 669, 670, 671, 672, 673, 674, 675, 676, 677, 678, 679, 680, 681, 682, 683, 684, 685, 686, 687, 688, 689, 690, 691, 692, 693, 694, 695, 696, 697, 698, 699, 700, 701, 702, 703, 704, 705, 706, 707, 708, 709, 710, 711, 712, 713, 714, 715, 716, 717, 718, 719, 720, 721, 722, 723, 724, 725, 726, 727, 728, 729, 730, 731, 732, 733, 734, 735, 736, 737, 738, 739, 740, 741, 742, 743, 744, 745, 746, 747, 748, 749, 750, 751, 752, 753, 754, 755, 756, 757, 758, 759, 760, 761, 762, 763, 764, 765, 766, 767, 768, 769, 770, 771, 772, 773, 774, 775, 776, 777, 778, 779, 780, 781, 782, 783, 784, 785, 786, 787, 788, 789, 790, 791, 792, 793, 794, 795, 796, 797, 798, 799, 800, 801, 802, 803, 804, 805, 806, 807, 808, 809, 810, 811, 812, 813, 814, 815,

- ✓ 4 OBJEKTIVA PERPLITHEN PLOTËSISHT
- ✓ 8 OBJEKTIVA PERPLITHEN PJEJËSISHT
- ✓ 2 OBJEKTIVA KANË UDHJE TË ZBEHTË

Մասնագիտացման ոլորտ	Համալսարանական	Մագիստրոսական
Քաղաքացիական իրավունք	1	100%
Քաղաքացիական գործընթաց	1	100%
Քաղաքացիական ծառայություն	1	100%
Բաժնի ընդունում	0	0
Քաղաքացիական ծառայություն	1	100%

VLERËSIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE TE PROJEKTEVE

HARTËZIMI I PROJEKTEVE BASHKIA VAU-DEJËS




Konsolidimi i kullit
 Konsolidimi i peshqerit
 Konsolidimi i kullit
 Konsolidimi i kullit

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË	PROJEKTA	Shifra e Vlerësimit*		
		2015	2020	2025
1. PABLIA ME JEDHIMET GAZË	1.1 Përmirësimi i rrjetit të ujërave	10.00%	10.00%	10.00%
	1.2 Rregullimi i peshqerit dhe ujërave të kalibrit	10.00%	10.00%	10.00%
	1.3 Shërbimet publike	10.00%	10.00%	10.00%
2. LËVIZJA ME MËNYRA TË NËNËNËNË	2.1 Shërbimet tregëtare	10.00%	10.00%	10.00%
	2.2 Shërbimet tregëtare	10.00%	10.00%	10.00%
	2.3 Shërbimet tregëtare	10.00%	10.00%	10.00%
3. QENDRA E URBANË	3.1 Përmirësimi i qendrës urbane	10.00%	10.00%	10.00%
	3.2 Shërbimet tregëtare	10.00%	10.00%	10.00%
	3.3 Shërbimet tregëtare	10.00%	10.00%	10.00%
4. PABLIA	4.1 Përmirësimi i peshqerit	10.00%	10.00%	10.00%
	4.2 Përmirësimi i peshqerit	10.00%	10.00%	10.00%
	4.3 Shërbimet tregëtare	10.00%	10.00%	10.00%
5. QENDRA, BASHKËRIA DHE KULTURA E PESHQERIT	5.1 Shërbimet tregëtare	10.00%	10.00%	10.00%
	5.2 Shërbimet tregëtare	10.00%	10.00%	10.00%
	5.3 Shërbimet tregëtare	10.00%	10.00%	10.00%
6. QENDRA	6.1 Shërbimet tregëtare	10.00%	10.00%	10.00%
	6.2 Shërbimet tregëtare	10.00%	10.00%	10.00%
	6.3 Shërbimet tregëtare	10.00%	10.00%	10.00%

PROJEKTE MJEDISORE

MODERNIZIMI I LANDFILIT TË BUSHATIT NËPËRMJET NDRËHYRJEVE PËR RIFËRDORIMIN, RICKLIMIN, PRODHIMIN E BOGAZIT DHE PYLLËZIMIN E KURORËS

POZICIONIMI




Projekti parashikon:

- ndërtimin e centraleve me biogaz për prodhimin e energjisë elektrike përmes tretjes anaerobe dhe kompostimit të mbetjeve të ngurta organike dhe të biomasës;
- pyllëzim i kurorës së landfillit

PROJEKTE MJEDISORE

MBJELLJA E 150 HA SHEGË

POZICIONIMI



Projekti parashikon mbjelljen e 150 hektarë shegë në zonat kodrinore në gjashtë blloqe prej 25 hektarë për t'u realizuar në dy fshatra të njësisë Vig-Mnelë (Mnelë e Vogël dhe Vig) dhe katër fshatra të njësisë Hajmet (Hajmet, Nënshat, Paçram dhe Pistull).


Projekti ka për qëllim:

- kualifikimi i peizazhit bujqësor lokal,
- rritja e kushteve të punës, të ardhura dhe fitime
- rritja dhe përmirësimi cilësor i prodhimeve të sektorit

PROJEKTE MJEDISORE

PROJEKT PËR PYLLËZIMIN MJEDISOR TË KODRËS SË ZEFJANËS

POZICIONIMI



Projekti parashikon:

- ndërhyrje për pyllëzimin e mjedisit të kodrës së Zefjanës dhe realizimin e shtigjeve ekskursionistike për turistët dhe banorët;
- mbrojtje dhe promovim mjedisor dhe i peizazhit;
- zvogëlimi të rrezikut hidrogeologjik të zonës.



**PARK LUMOR RAJONAL: KËLIMI I NJË KORRIDORI TË MBROJTUR
MJEKISOR MES ZONAVE TË MBROJTURA TË ALPEVE DHE
BUNËS/VELPOJËS PËR REALIZIMIN E NJË ITINERARI TURISTIK
POTENCIAL**



Projekti normalizācija

- [illegible]

Kordkubeh i gylfud
Lund Gylfud

Projekti parashikoni:

ndërlinim e një korridor të gjelbër përgjysë // rrethës së lumit
Oqindër, për mbrojtjen e krugjeve lumore së bashku me
realizimin e një rruge për biçikleta dhe këmbësorë për
soditjen e zonës dhe shfrytëzimin e saj // orkestrimi i kërcës
së Vigës.

**Zare e mbretit
Lumi i Bardhë**

**Monuments Nature:**

- 2. Săpînle e Mădăgăsc
- 1. Fânle e Liqetli
- 2. Fragment i llyerjle taktanle Săpînle e Poj

Zona e mbrojtur e argjendit

Parkul Natyror Regional i Lumë Drin

KONKLUZIONE

- Zbatimi i projekteve, pritet të sjellë impakte pozitive dhe negative. Impakt pozitiv pritet të ketë në drejtim të cilësisë së ajrit, ndryshimeve klimatike, si edhe për popullatat dhe asetet materiale.
- Vlerësimi i rezultateve tregon se nuk do të ketë impakte mbi faktorët klimatikë duke konsideruar që mjetet e transportit do të vijnë të rinovohen në të ardhmen edhe më tej, gjë që do të sjellë përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe cilësisë së shëndetit human.
- Impaktet pozitive mbi popullatën dhe asetet materiale do të vijnë si rezultat i zbatimit të infrastrukturës në përgjithësi që do të bëjë të mundur pakësimin e kohës së udhëtimit, sigurinë në lëvizje, afërsimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane, etj.

KONKLUZIONE

- Përgjithësisht, shumica e impakteve negative janë të lidhura me fazën e zbatimit të projekteve të parashikuara në PPV (projekte infrastrukturore, bujqësore dhe turistike) dhe janë kryesisht të përkohshme (deri në përfundim të punimeve). Territori i bashkisë ka veçori të larmishme dhe të shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peisazhiste që mund të ndikohen konsiderueshëm prej zhvillimeve të infrastrukturës, sidomos atyre me shtrirje të gjerë dhe koridoreve sipas sektorëve (transport, energji, ujë, etj.).
- Impaktet negative shfaqen në fazën e planifikimit prej aspekteve të përdorimit të tokës, efekteve në ujë, natyrë (si biodiversiteti edhe zonat me status të mbrojtur), trashëgiminë kulturore dhe peizazh. Këto impakte do të kërkojnë krijimin e një programi bashkëkohor mbi masat zbutëse dhe një zbatim të përshtatshëm të këtyre masave qëllimi i të cilave është zvogëlimi i impakteve negative në mjedis.

FALEMINDERIT PËR VËMENDJEN

MIRËPRESIM KOMENTET TUAJA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 136 Prot.

Tirane, me 12.05. 2005

Vendimi Nr.4, Nr.127 Regj.

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.268, datë 24.04.2003 "Për çertifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Alfred LAKO

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Ethem RUKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Zhvillimit Ekonomik,
Tregtisë dhe Sipërmarrjes

LICENCË



LN-7564-03-2014	NUIS/NIPT: K91424007C
Subjekti: Alfred Lako	
Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, Rruga Medar Shtylla, Pallati 142, Shkalla 4, Apartamenti 53, 50 metra përballë KMY	
Kodi: III.2.A (1+2)	Kod tjetër:
Data e lëshimit: 03/03/2014	Afati i vlefshmërisë: Pa afat
Kategoria	
Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis	
Nënkategoria	
Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis	
Veprimtari specifike	
1. Ndikim në mjedis 2. Auditim mjedisor	
Specialiteti	

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Auditim mjedisor. Vlerësim i ndikimit në mjedis.

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë



Nënshtkrimi i sportellit:

Dajana *Stojà*



ILARIA È PROBLEMA MEDICOR

ILARIA È PROBLEMA MEDICOR

DATE: 08/20/03
 TIME: 1:50:00
 OFF: ALBERTA
 UNIT: 0004
 IN: 10000000
 FROM: 0000



MIRATUAR ME VENDIMIN E KKT-së Nr. 3 Datë 27.04.2018

[illegible]



EMERITIMILETES:
IARȚA E ZONAVE TI MBRĂȚURĂ EXISTIVESH DIE TE
PRODUCIARĂ



Downloaded from www.worldscientific.com by UNIVERSITY OF NEWCASTLE on 07/11/17. For personal use only.

State	State Code
Alabama	AL0001
Alaska	AK0001
Arizona	AZ0001
Arkansas	AR0001
California	CA0001
Colorado	CO0001
Connecticut	CT0001
Delaware	DE0001
District of Columbia	DC0001
Florida	FL0001
Georgia	GA0001
Hawaii	HI0001
Idaho	ID0001
Illinois	IL0001
Indiana	IN0001
Iowa	IA0001
Kansas	KS0001
Kentucky	KY0001
Louisiana	LA0001
Maine	ME0001
Maryland	MD0001
Massachusetts	MA0001
Michigan	MI0001
Minnesota	MN0001
Mississippi	MS0001
Missouri	MO0001
Montana	MT0001
Nebraska	NE0001
Nevada	NV0001
New Hampshire	NH0001
New Jersey	NJ0001
New Mexico	NM0001
New York	NY0001
North Carolina	NC0001
North Dakota	ND0001
Ohio	OH0001
Oklahoma	OK0001
Oregon	OR0001
Pennsylvania	PA0001
Rhode Island	RI0001
South Carolina	SC0001
South Dakota	SD0001
Tennessee	TN0001
Texas	TX0001
Utah	UT0001
Vermont	VT0001
Virginia	VA0001
Washington	WA0001
West Virginia	WV0001
Wisconsin	WI0001
Wyoming	WY0001




PLANI I PËRGJITHSHEM VENDOR I BASHKISE VALDEJES
EMERTIMI FILET3:
MARIA K. KUNSLANDT IN UMT



MIRATUAR ME VENDIMIN E KKT-56 Nr. 3 Datë 27.04.2018

[illegible]




PLANNI TERCUTTI SILEN VENDOR) BASINISE VAL DEJES

MARIA P. FLUKSIT TE UNUT



MIRATUAR ME VENDIMIN E KKT-SË Nr. 3 Datë 27.04.2018

[illegible]



PLAN I PËRCITSHËN VENDOR I BASHKISË VALLDELES

EMERTHALLI ELET.

IAKARIA E FLOKUSIT E USHQBAMUT

[illegible]

I PËRCJITSHËM VENDOR I BASHKISË VAU-DEJËS
FLUKSEVE



Legjendë



PLANI I PËRCJITSHËM VENDOR I BASHKISË VAU-DEJËS
ENERGJITËS
I KRAJËS PËR INDSHËN



MIRATUAR ME VENDIMIN E KKT-së Nr. 3 Datë 27.04.2018

Shprehja	Shprehja	Shprehja
1. Përcjtitshëm vendor	1. Përcjtitshëm vendor	1. Përcjtitshëm vendor
2. Përcjtitshëm regional	2. Përcjtitshëm regional	2. Përcjtitshëm regional
3. Përcjtitshëm kombëtar	3. Përcjtitshëm kombëtar	3. Përcjtitshëm kombëtar
4. Përcjtitshëm ndërkombëtar	4. Përcjtitshëm ndërkombëtar	4. Përcjtitshëm ndërkombëtar
5. Përcjtitshëm global	5. Përcjtitshëm global	5. Përcjtitshëm global